

PËRGJEGJSHMËRIA FINANCIARE E PREMTIMEVE TË POLITIKËS SHQIPTARE

NJË ANALIZË QË MAT BESUESHMËRINË E
PREMTIMEVE ZGJEDHORE DHE PËRMBUSHJEN E KËTYRE
PREMTIMEVE SI PJESË E PROGRAMEVE QEVERISËSE

POLITFAKT.al

**SA TË BESUESHME KANË
QENË PREMTIMET ELEKTORALE?**

**SA JANË PËRMBUSHUR PREMTIMET
ELEKTORALE NGA PROGRAMET E QEVERIVE
PËRGJATË 2009-2021?**

PËRGJEGJSHMËRIA FINANCIARE E PREMTIMEVE TË POLITIKËS SHQIPTARE 2009 – 2017

Një analizë që mat besueshmërinë e premtimeve zgjedhore dhe përmbushjen e këtyre premtimeve, si pjesë e programeve qeverisëse

Pregatitja dhe shpërndarja

Qendra ALTAX

Tetor 2020 – Shkurt 2021

Deklarimi përgjegjësishë/ Disclaimer

Materiali studimor është realizuar si pjesë e projektit “Përgjegjshmëria financiare e premtimeve të politikanëve në Shqipëri, 2009-2017” të mbështetur financiarisht nga Programi i Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SHBA në Tiranë. Opinione, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Departamentit të Shtetit

© Të gjitha të drejtat të rezervuara. Përmbajtja e këtij studimi mund të përdoret lirish prej përdoruesve, por jo për qëllime fitimprurëse, me kusht që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me njohjen e “Qendrës AL-TAX” si burim informacioni.



Me mbështetjen financiare të
Programit të Granteve të Vogla të
Komisionit për Demokraci të
Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë

KUSHTET E PËRDORIMIT DHE ZBATIMIT

Analiza e paraqitur në kontekstin e projektit “Përgjegjshmëria financiare e premtimeve të politikanëve në Shqipëri, 2009-2017” bazohet në një metodologji që e ka pikënisjen në verifikimin e premtimeve gjatë fushatave zgjedhore dhe programeve gjatë qeverisjeve, që janë rrjedhojë dhe sintezë e premtimeve zgjedhore përballë dokumentave kryesore të shtetit, si: strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, progamet zhvillimorë dhe ekonomikë shumë-vjecarë, programet buxhetore afatmesme, të dhëna studimore dhe raporte nga organizata të huaja dhe vendase dhe dinamikat e ecurisë së ligjeve në funksion të premtimeve. Metodologjia e studimit është zhvilluar në bashkëpunim me ekspertë dhe partnerë kryesorë të ALTAX përmes një procesi konsultativ. Gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura në këtë publikim nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Qendrës ALTAX. Të dhënat në këtë raport janë objekt ndryshimi pa paralajmërim. Termat përfshijnë sektorë të ndryshëm të jetës së vendit.

Kur ky raport për të cilin është burimi Qendra ALTAX shpërndahet ose riprodhohet, ai duhet të paraqitet me saktësi dhe t'i atribuohet ALTAX. Kjo kërkesë për cilësinë e burimit duhet ti bashkangjitet çdo përdorimi të të dhënave dhe komenteve, qoftë të marra direkt nga ALTAX ose nga një përdorues tjetër.

Përdoruesit që shkarkojnë Raportin “Përgjegjshmëria financiare e premtimeve të politikanëve në Shqipëri, 2009-2017” dhe e vënë në dispozicion të të tjerëve përmes çdo lloji shpërndarjeje ose shkarkimi bien dakord të bëjnë përpjekje të arsyeshme për të komunikuar dhe promovuar pajtueshmërinë nga përdoruesit e tyre përfundimtarë me këto terma.

Përdoruesit që synojnë të shesin Raportin “Përgjegjshmëria financiare e premtimeve të politikanëve në Shqipëri, 2009-2017”, si një produkt i pavarur, ose pjesërisht duhet të marrin fillimisht leje nga Qendra ALTAX.

Dokumenti mund të lexohet te www.altax.al

Nëse keni kërkesa apo pyetje dërgojini tek altax@altax.al

RRETH STATUSIT TË STUDIMIT

Ky raport analitik është përgatitur për qëllime të projektit Përgjegjshmëria financiare e premtimeve të politikanëve në Shqipëri, 2009-2017”, i zbatuar nga Qendra ALTAX. Teksti i studimit bazohet mbi vlerësime dhe supozime të referuara në informacione zyrtare dhe publikime të lidhura me objektin e studimit duke pasqyruar një pozicion, i cili synon të përshtatet me frymën dhe qasjen e Qendrës, pa synuar të përshtatë informacione të burimeve referuese. Pjesë të raportit studimor janë përgatitur nga kontribute të nxjerra nga analiza të sektorëve dhe janë përshkruar me detaje në këtë tekst. Kjo iniciativë është një proces qytetar i shoqërisë civile, i krijuar për të komunikuar me grupet e interesit për të diskutuar tema kritike për komunitetet e tyre, për të mbledhur informacione vepruese për t'i kuptuar më mirë ato çështje, si dhe për t'u përfshirë në dialog me aktorët politikë qendrorë dhe lokalë në mënyrë që ata të zhvillojnë zgjedhje bazuar mbi premtime korrekte, transparente, të besueshme dhe të matshme në funksion të interesit publik. Në respektim të përmbajtjes së raportit studimor, nuk ka asnjë pjesë që të dalë në kundërshtim me politikat dhe qëllimin mbi të cilin është organizuar Qendra, apo të flasë në emër të palëve të interesit të përmendura në raport. Të dhënat e përfshira dhe që janë pjesë e studimit nuk përmbajnë huazime apo tekste që përkojnë me botime të tjera, duke ofruar gjetje autentike. Përmbajtja e dokumentacionit të raportit analitik është e verifikuar me kujdes, e analizuar për gabime të natyrave të ndryshme, apo për ndonjë gabim të çdo lloji. As autorët, por as edhe Qendra nuk mbajnë përgjegjësi nëse teksti kuptohet sikur është duke folur në emër të palëve të tjera, të funksioneve apo detyrave që mbulohen dhe janë fushë përgjegjësie e institucioneve shtetërore duke mbajtur përgjegjësi vetëm për atë çfarë është pjesë e analizës dhe gjetjeve të konkluduara nga vetë autorët. Ky status duhet të vlejë për çdo pjesë të këtij studimi, i cili konceptohet si një dokument integral dhe duhet lexuar si i tillë. Studimi iu nënshtrua një procesi konsultimi me përfaqësues nga shoqëria civile, ekspertë të ekonomisë, financave, shëndetësisë, industrisë, infrastrukturës, arsimit, sindikatave, organizatave të ndryshme dhe ekspertë të shoqërisë civile, pa dashur të jetë shterues në përmendjen e gjithë ekspertëve të fushave të tjera.

Mirënjohje

(SHQIP) Qendra ALTAX falënderon në mënyrë të veçantë rrjetin e ekspertëve dhe stafit që u vendos në funksion të analizës studimore për punën e bërë në mbledhjen e të dhënave, përpunimin e tyre, analizimin dhe seleksionimin, si dhe një falënderim të dedikuar për dizajnerin për formatimin e bërë këtij publikimi.

ALTAX është një iniciativë think-tank shqiptare e asistuar nga ekspertë të sektorëve të ndryshëm dhe analistë të politikës fiskale, duke synuar një qasje të re të politikës dhe kornizës ekonomike shqiptaro-evropiane që ndihmon integrimin. Si një organizatë tërësisht apolitike, puna e gjithë pjesëmarrësve rezultoi të ishte e pandikuar nga asnjë palë dhe kjo ka ndikuar në cilësinë e gjetjeve dhe peshën që përmban analiza sintetike nga skanimi i premtimeve të politikanëve shqiptarë. ALTAX përfaqëson interesat e taksapaguesve, si një qendër e pavarur, në rolin e një komentuesi dhe monitoruesi të financave publike, politikës fiskale, kuadrit ligjor, zbatimit të ligjit, politikave sociale dhe pabarazive sociale në shpërndarjen e mirëqenies duke vlerësuar qasjen e politikave me qëllim promovimin e zhvillimeve në Shqipëri.

Ne falënderojmë kolegët tanë nga KRIIK Albania, të cilët ofruan konsultim, që e ndihmuan shumë analizën. Ne gjithashtu dëshirojmë t'u tregojmë mirënjohje ekspertëve dhe analistëve të ndryshëm për ndarjen me ne të ideve dhe komenteve të tyre gjatë gjithë procesit të realizimit të kësaj analize skaner.

Ne jemi të ndërgjegjshëm që fazat në të cilat kaloi ky raport ishin një sfidë e vështirë jo vetëm për ALTAX, por edhe për vetë kontributorët, të cilët me përvojën dhe organizimin e tyre arritën që të përçojnë në këtë raport pjesët më të përzgjedhura të mozaikut të zgjedhjeve të dekadës së fundit bashkë me problematikat dhe veçantitë e tyre.

Acknowledgements

(ENGLISH) ALTAX CENTER specially thanks the network of experts and the staff dedicated to this analysis for the work done in collecting data, processing them, as well as a dedicated thanks to the designer for the formatting of this publication.

ALTAX is an Albanian think-tank initiative assisted by experts of various sectors and fiscal policy analysts, aiming at a new approach to Albanian-European political and economic framework assisting integration. ALTAX represents the interest of taxpayer and is founded to help, increasing the knowledge and education about the implementation in the right way of fiscal policies and public finances management. We are organized and work based on the principle "Right from the start".

As a completely apolitical organization, the work of all participants turned out to be uninfluenced by any party and this has affected the quality of the findings and the importance of the synthetic analysis from scanning the promises of Albanian politicians.

We thank our colleagues from KRIIK Albania, who provided insight that greatly assisted the analysis. We would also like to show our gratitude to the different experts and analysts for sharing with us their ideas and comments during the course of this analysis.

We are aware that the stages that this report went through were a difficult challenge not only for ALTAX, but also for the direct contributors themselves, who with their experience managed to follow in this report the most selected pieces of the mosaic of the political elections of the last decade together with their problems and peculiarities.

PËRMBLEDHJE

(SHQIP) Në kontekstin e zbatimit nga Qendra ALTAX të projektit “Përgjegjshmëria financiare e premtimeve të politikanëve shqiptarë, 2009 – 2017”, periudhë e cila përmbledh tri zgjedhjet politike më të fundit (2009, 2013, and 2017), tashmë në këtë kohë para fushate zgjedhore 2021 është momenti kulmor për të kontribuar me gjetjet dhe analizën e bërë mbi premtimet nga fushatat e kaluara për opinionin publik. Analiza e premtimeve zgjedhore është pjesa e projektit të mbështetur nga Programit të Granteve të Vogla të Komisionit për Demokraci të Ambasadës së SH.B.A.-së në Tiranë.

Qëllimi që synohet të arrihet me këtë studim analitik i premtimeve të tri partive kryesore në vend është mbyllur në tërësinë e tij duke marrë për bazë ecurinë e secilit premtim në raport me konsiderimin e tij, si një qasje që duhet të fitojë besueshmëri nga publiku.

Analiza është orientuar duke ballafaquar premtimet elektorale, të kategorizuara sipas sektorëve ekonomikë (bazuar te ndarjet e linjave ministrore) me dokumentet kryesore strategjike sektoriale dhe programet ekonomike dhe fiskale disa vjecare, programet buxhetore afatmesme, kuadrin makroekonomik dhe fiskal, si dhe dokumente të aprovuara në nivel kombëtar lidhur me qasjen integruese të vendit (Programi Kombëtar për Integrimin Europian).

Për secilën periudhë premtimesh zgjedhore janë bërë krahasimet me dokumentacionin si më lart të periudhës që përkon me fushatën elektorale, të konsideruar si informacioni që zotërohet njësoj nga të gjitha palët dhe që qëndron përmbi partitë politike për vetë rëndësinë e tyre.

Në varësi të analizës është bërë edhe kategorizimi i premtimeve në (a) premtime të matshme dhe të besueshme, (b) premtime të matshme, por pjesërisht të besueshme, (c) premtime të pamatshme.

Nga klasifikimi i premtimeve politike për secilën parti është vijuar me ndërtimin e rasteve ilustruese duke dhënë përgjigje nëpërmejt analizës pyetjeve dhe gjetjeve të tilla, si:

- Çfarë lloj premtimesh jepen gjatë fushatave, sipas besueshmërisë dhe mundësisë se matjes se tyre nga publiku, si dhe sa është raporti mes premtimeve të besueshme dhe jo të besueshme?

Rezulton se shumica e premtimeve janë jo të besueshme apo të pamatshme, për arsye se nuk kanë qasje në asnjë dokument kryesor.

- Analizë krahasuese në lidhje me tematika, që i kanë premtuar të dy partitë e mëdha politike, p.sh. ekonomine.

Rezulton se premtimet pjesërisht të besueshme bëhen nga partitë, që janë në opozitë dhe tema e ekonomisë nuk shfaqet asnjëherë me analizë të buxhetit. Në këtë studim, ALTAX ka bërë analizë të kostove buxhetore për premtimet që lidhen me financat publike.

- Çfarë ndikimi ka patur në mbajtjen e premtimeve në qeveritë e koalicionit, apo kur ka qenë parti e vetme në qeverisje?

Rezulton se aleancat kanë ndikuar pak në programet qeverisëse, por për tema specifike ato kanë shërbyer për identifikimin e partive.

- Çfarë referencash/analizash dhe transparence përdorin partitë politike kur hartojnë premtimet e tyre?

Rezulton se Partitë që janë në qeverisje dhe bëjnë premtime u përmbahen kryesisht dokumentave strategjike të miratuara nga to, ndërsa opozita premtim për qasje që nuk përkon gjithnjë me përmbajtjet e këtyre dokumenteve duke tentuar rifillimin e politikave sipas premtimeve.

Rezulton se në asnjë parti nuk i kushtohet vëmendja, që u takon për të prezantuar politikën e lidhura me kërkesat/çështjet nga grupe të rëndësishëm interesi, si p.sh. sindikatat. Një reflektim tjetër mbi premtimet është momenti se sa ato zbatohen kur hartohet programi qeverisëse duke bërë ballafaqimin e tyre me programet buxhetore dhe ndryshimet sektoriale legjislativë.

Në mbyllje të raportit, nëpërmjet ndjekjes së linjës së premtimit nga fillimi i fushatës deri në përfshirjen në program dhe më tej në përmbushjen ose jo të tij nga partia/të që fitojnë votëbesimin konstatohet, se niveli i përmbushjes është më pak se gjysma e premtimeve të deklaruara. Partitë i riciklojnë premtimet e papërmbushura nga programet qeverisëse, si premtime të reja në zgjedhjet e ardhshme, por pa analizuar performancën e tyre.

Në fund të raportit jepen në formën e përmbledhjes edhe disa komente kyçe lidhur me gjithë analizën mbi përgjegjshmërinë e kostos buxhetore të premtimeve, të cilat kanë ndikim direkt në ekonomi dhe te qytetarët. Gjithë përmbajtja e analizës tenton të hapë një diskutim lidhur me sensibilizimin e njerëzve nëpërmjet analizës ekonomike dhe financiare të premtimeve të besueshme dhe atyre që nuk janë të besueshme nëse maten me dokumentet strategjike dhe buxhetore.

ABSTRACT

(ENGLISH) In the context of the implementation by the ALTAX Center of the project “Financial Accountability of Promises of Politicians”¹, for the last three political elections in Albania (2009, 2013, and 2017), now before the official electoral campaign we make public the report with findings and analyzes for public opinion about the promises for last decade. Analysis of election promises is part of the project supported by the Democracy Commission Small Grants of U.S. Embassy in Tirana, Albania.

The purpose of this analytical study about all the promises of the three main parties in Albania is closed in its entirety based on the performance of each promise in relation to their consideration as an approach that should gain credibility from the public.

The analysis is focused in comparing electoral promises, categorized by economic sectors (based on ministerial line divisions) with key sectoral strategic documents and multi-year economic and fiscal programs, medium-term budget programs, macroeconomic and fiscal frameworks, and important documents, such as National Program for European Integration etc.

For each period of election promises, comparisons have been made with the above documentation of the period corresponding to the election campaign, considered as information that is equally owned by all parties and that stands above the political parties for their own importance.

Depending on the analysis, promises are categorized into (a) measurable and believable promises, (b) measurable but unbelievable promises, (c) non-measurable promises.

From the classification of political promises for each party it is followed by the construction of illustrative cases by analyzing topics and findings such as:

- *Political parties have not made their campaign promises transparent in any of the sources of information.*
- *Most promises are unbelievable or non-measurable, because they do not have access to any key documents.*
- *Most unbelievable promises are made by the parties that are in opposition and the topic of economics is never accompanied by budget analysis. In this analysis ALTAX has made an analysis of budget costs from total promises related to public finances (government budget).*
- *The alliances have had little influence on governance programs, but on specific topics that have served to identify them.*
- *The ruling parties adhere mainly to the strategic documents adopted by them, while the opposition parties promise different approach outside this framework by attempting to promise new and unconnected policies with this strategic framework*
- *No party pays the attention it deserves to present claims/ issues-related policies from this important stakeholder group.*

Another important section on the report is the part where promises should be transposed in government programs to be implemented. In this regard we analyzed the medium terms budget programs, key macroeconomic indicators and key sectoral legislative changes with government program for three last governments.

The analysis is concluded, that most of the promises are not included in the same way as promised and the governing programs are built very generalized, without being able from citizens to identify the specific promises.

At the end of the report, by following the line of promise from the beginning of the electoral campaign until its fulfillment by the party / parties that win the vote of confidence, it is concluded that the level of fulfillment is less than half of the promises. The parties recycle the unfulfilled promises from the governing programs as new promises, but without analyzing their performance.

In the form of a summary of findings will be presented comments regarding the whole analysis on the responsibility of the budget cost of the promises that have a direct impact on the economy and the citizens, aiming to open a discussion related to sensitizing people through analysis. economic and financial of credible promises and those that are not credible if measured by strategic and budgetary documents.

¹ part of a project supported by the US Embassy Small Grants Program in Tirana

Terma dhe përkufizime

AKBN	Agjensia Kombëtare e Burimeve Natyrore
AKSHI	Agjensia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AKM	Agjensia Kombëtare e Mjedisit
ALB EITI	Nisma për Transparencë në Industrinë Nxjerrëse
ASHK	Agjensia Shtetërore e Kadastrës
BE	Bashkimi Europian
BSH	Banka e Shqipërisë
CPI	Indeksi Perceptimit të Korrupsionit
DAR	Drejtori Arsimore Rajonale
DCED	Komiteti i Donatorëve për Zhvillimin e Ndërmarrjeve
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
ERE	Enti Rregullator i Energjië
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
EUROSTAT	Statistikat Europiane
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FSDKSH	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
HEC	Hydrocentral
IHD	Investimet e Huaja Direkte
ISSH	Instituti i Sigurimeve Shoqërore
INSTAT	Instituti i Statistikave
KMF	Kuadri Makroekonomik e Fiskal
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KM	Këshilli i Ministrave
LAL	Ligji i Arsimit të Lartë
LOFKLD	Ligji për organizimin dhe funksionimin e Këshilit të Lartë të Drejtësisë
LGJK	Ligji i Gjykatës Kushtetuese
LSI	Lëvizja Socialiste për Integrim
LTA	Ligji i Tatimit mbi të Ardhurat
LGJA	Ligji i Gjykatës Administrative
LKSSH	Ligji i Kontributeve të Sigurimeve Shëndetësore
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MD	Ministria e Drejtësisë
MEI	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSH	Ministria e Shëndetësisë
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
OSHEE	Operatori Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OSHC	Organizata të Shoqërisë Civile
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PEF	Programi Ekonomik dhe Fiskal
PD	Partia Demokratike
PS	Partia Socialiste

SESH	Sistemi Elektroenergetik Shqiptar
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
TAP	Trans Adriatik Pipeline
UNESCO	Organizata Arsimore, Shkencore dhe Kulturore e Kombeve të Bashkuara
UK	Ujësjellës-Kanalizime
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
WORLD BANK	Banka Botërore

PËRMBAJTJA

Metodologjia	Faqe.....10
Hyrje	Faqe.....15
PJESA 1	
Panorama e përgjithshme dhe tiparet e fushatave elektorale, 2009-2017	Faqe.....16
1.1. Panorama e përgjithshme e fushatës elektorale, 2009	Faqe.....16
1.2. Panorama e përgjithshme e fushatës elektorale, 2013	Faqe.....17
1.3. Panorama e përgjithshme e fushatës elektorale, 2017	Faqe.....18
1.4. Analiza të mëparshme tematike nga të tjera organizata	Faqe.....19
PJESA 2	
Premtimet e partive kryesore politike, 2009 - 2017	Faqe.....22
2.1. Premtimet e fushatës elektorale, 2009	Faqe.....22
2.2. Premtimet e fushatës elektorale, 2013	Faqe.....25
2.3. Premtimet e fushatës elektorale, 2017	Faqe.....28
PJESA 3	
Matja dhe besueshmëria e premtimeve elektorale, 2009-2017	Faqe.....33
3.1. Premtimet e ngjashme dhe qasja e partive ndaj tyre	Faqe.....33
3.2. Premtimet me natyrë buxhetore dhe kostot e tyre	Faqe.....36
3.3. Premtimet dhe konsistenca e tyre gjatë fushatave elektorale	Faqe.....37
3.4. Vlerësimi i premtimeve dhe matja e tyre	Faqe.....40
PJESA 4	
Premtimet elektorale në programet qeverisëse, 2009 - 2017	Faqe.....56
4.1. Programi qeverisës dhe niveli i realizimit të premtimeve, 2009-2013	Faqe.....56
4.2. Programi qeverisës dhe niveli i realizimit të premtimeve, 2013-2017	Faqe.....60
4.3. Programi qeverisës dhe niveli i realizimit të premtimeve, 2017-2021	Faqe.....63
PJESA 5	
Trendi i ofertave elektorale dhe mbajtja e premtimeve, 2009-2017	Faqe.....67
5.1. Ofertat elektorale dhe tendenca e tyre	Faqe.....67
5.2. Kostoja e ofertave elektorale dhe tkurrja e tyre në buxhetet faktike	Faqe.....69
5.3. Informacionet dhe referencat vizionare në përgatitjen e ofertave elektorale	Faqe.....72
PËRFUNDIME	Faqe.....75
SHTOJCA	Faqe.....78
PREMTIMET PD, PS, LSI NË 2009	Faqe.....78
PREMTIMET PD, PS, LSI NË 2013	Faqe.....110
PREMTIMET PD, PS, LSI NË 2017	Faqe.....136
PREMTIMET NË PROGRAMIN QEVERISËS PD DHE LSI, 2009-2013	Faqe.....152
PREMTIMET NË PROGRAMIN QEVERISËS PD DHE LSI, 2013-2017	Faqe.....173
PREMTIMET NË PROGRAMIN QEVERISËS PD DHE LSI, 2017-2021	Faqe.....202

Metodologjia e studimit

Analiza me titullin “PËRGJEGJSHMËRIA FINANCIARE E PREMTIMEVE TË POLITIKËS SHQIPTARE, 2009 – 2017” është realizuar në formën e hulumtimit bazuar te krahasimi shkaqeve.

1. Qasja dhe qëllimi i përdorimit të metodologjisë

Kjo metodë e hulumtimit kryesisht është bazuar te faktori i krahasimit., e cila përdoret në këtë studim analitik për të përfunduar ekuacionin shkak-pasojë midis dy ose më shumë të dhënave (premtimeve) për partitë politike përpara, gjatë dhe pas fushatës elektorale, ku një e dhënë është e varur nga e dhëna tjetër, por jo detyrimsht. Në analizën që trajtohet nga kjo metodologji do të përdoren premtimet e tri partive kryesore në vend, Partia Demokratike (PD), Partia Socialiste (PS) dhe Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI).

Në analizimin e të dhënave janë përdorur baza krahasimi në drejtimin e një qasje bazuar në aspektet ligjore, aspekte strategjike, programe në nivel kombëtar ekonomike dhe sektoriale, por pa patur domosdoshmërisht krahasim statistikor. Baza tjetër e krahasimit është përballja e premtimeve që lidhen me prekjen e parashikimeve të buxhetit në vlerën e përlogaritur (ose ashtu si është thënë nga drejtuesit politikë të partive). Këto të dhëna ose grupe të dhënash janë përdorur ashtu siç ekzistojnë në strukturën e tyre natyrale në burimet e të dhënave.

Analiza nuk është kufizuar në trajtime të fakteve statistikore të grupeve të të dhënave, por shtrihet në analizimin se si ndryshojnë ato ose grupet e ndryshme nën ndikimin e të njëjtave ndryshime. Ky hulumtim është kryer pavarësisht nga lloji i marrëdhënies që ekziston midis dy ose më shumë subjekteve politike. Analiza e të dhënave bazuar te strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale përdoret për të paraqitur qartë rezultatin e marrë duke përdorur këtë metodë sasiore të hulumtimit, duke u nisur nga fakti se dokumentet strategjike të një vendi marrin rëndësi të dorës së parë përtej qeverisë që e miraton, për vetë kohëzgjatjen dhe misionin që përmbajnë ato.

2. Metodatat kryesore të të dhënave

Metoda kryesore e marrjes së të dhënave për analizën është bërë bazuar te të dhënat kërkimore sekondare.

Kjo metodë përfshin mbledhjen e të dhënave sasiore nga burimet ekzistuese të të dhënave si interneti, burimet qeveritare, raportet studimore, burimet kërkimore mediatike, etj.

Hartimi dhe renditja e premtimeve të grumbulluara janë të përcjella me kujdes duke u bazuar te njohuritë dhe përvoja e studiuesve, si dhe duke përdorur burimet e të dhënave nga fjalimet kryesore dhe prezantimet e drejtuesve kryesorë të partive politike, që kanë qenë edhe faktorë në krijimin e qeverive pas mbarimit të zgjedhjeve në vitet 2009, 2013 dhe në 2017.

Studimi ka përfshirë shumicën e premtimeve kryesore dhe jokryesore duke synuar që të paraqiten të gjitha citimet dhe premtimet e dhëna nga liderët kryesorë të partive.

3. Metoda e analizës së të dhënave

Pas mbledhjes së të dhënave të papërpunuara është kaluar në realizimin e filtrimit dhe më tej të analizës së këtyre të dhënave për të nxjerrë përfundime vleresuese. Është e rëndësishme të përmendim se në këtë studim janë lidhur rezultatet me objektivin e hulumtimit duke përcaktuar edhe rëndësinë statistikore te rezultateve.

Është e rëndësishme gjithashtu të përmendim se në studim kemi marrë parasysh ato aspekte të hulumtimit, të cilat u morën në konsideratë në procesin e mbledhjes së të dhënave dhe janë raportuar në këtë studim me ndryshimin midis asaj që ishte planifikuar kundrejt asaj që ka rezultuar në të vërtetë.

Për të bërë analizën e të dhënave është përdorur metoda e krahasimit midis premtimeve të deklaruara para zgjedhjeve në kuadrin e fushatës elektorale me të njëjtat premtime për rastet kur njëri koalicion ka fituar shumicën dhe të drejtën për të qeverisur dhe i ka përfshirë premtimet në programin qeverisës. Në rastin e krahut humbës nuk ka vijuar më tej kjo mënyrë krahasimi, pasi të dhënat e përdorura për analizë përpara fushatës mbyllën deri aty në rastin e humbjes së zgjedhjeve.

Me metodën e analizës statistikore midis grupeve të të dhënave është vijuar më tej duke krahasuar në çdo premtim me peshë ndikuese, për secilin sektor publik që merr fonde nga buxheti i shtetit apo ndikon në jetën e qytetarëve dhe bizneseve (ndryshimet ligjore). Bazuar te krahasimet e premtimeve të fushatës zgjedhore me Programet Buxhetore Afatmesme (PBA) dhe Buxhetet vjetore është krijuar një seri të dhënash krahasuese, ku premtimi nga njëra anë (sipas ndarjes sektoriale) krahasohet me vlerën e përfshirë (ose jo) në PBA për periudhën në të cilën referohet premtimi duke theksuar edhe diferencën që rezulton midis vlerës së llogaritur të premtimit dhe hapësirës së buxhetit për shpenzim.

P.sh. nëse është premtuar që do të rriten rrogat e mësuesve nga viti 2017 me 30%, atëherë do të bëhet llogaritja se sa i ka kushtuar buxhetit vjetor ky premtim në vlerë absolute. Më tej ky premtim krahasohet me parashikimin që gjendet në PBA 2017 -2019, për të krahasuar vlerën e premtimit me vlerën që përcaktohet për këtë zë në sektorin e arsimit.

4. Burimi i të dhënave

Të dhënat e disponueshme në internet janë ato që janë shfrytëzuar gjerësisht duke cituar në çdo rast të përmendur si burim informacioni edhe linkun nga është marrë e dhëna/informacioni.

Me informacionin e bollshëm në faqet e ndryshme informative dhe statistikore është synuar që të përzgjidhen edhe burime të besueshme informative, pasi informacioni në lidhje me shumicën e temave të hulumtimit edhe pse është i disponueshëm mundet të ketë gabime apo pasaktësi. Kjo analizë kryqëzuese na ka ndihmuar në rritjen e vlefshmërisë së të dhënave kryesore sasiore dhe cilësore, si dhe në vlerësimin e rëndësisë së të dhënave të mbledhura.

Burimet qeveritare dhe joqeveritare të informimit janë përdorur gjithashtu lidhur me programet qeverisëse, por edhe të dhëna për Programin Buxhetor Afatmesëm të viteve 2009-2017, si dhe të dhëna të tjera statistikore dhe financiare, që janë grumbulluar si informacion i gatshëm për tu përdorur për analizën studimore të bazuar te krahasimi. Këto të dhëna janë konsideruar prej nesh si të besueshme dhe të thelluara duke i përdorur për të rritur vlefshmërinë e përmbajtjes të të dhënave kërkimore të studimit.

Informacione publike të marra nga mediat kryesore janë një burim i përdorur me masë në kryerjen e kërkimit, për arsyen se mediat e referuara janë ende në tregun mediatik një burim i besueshëm informacioni. Nisur nga fakti se mediat e shkruara kanë kopje të rëndësishme të të dhënave për premtimet që janë deklaruar më herët se interneti të ishte përdorur masivisht si sot (vitet 2009-2013 dhe përpara kësaj periudhe) janë analizuar dhe vlerësuar edhe këto informacione që përbëjnë një pjesë të vitit 2009.

Ato janë një bazë me informacione dhe dokumente të vlefshme nga të cilat janë nxjerrë informacione, që kanë plotësuar ato që nuk mundeshin të gjendeshin me dy burimet si më lart.

5. Sqarimi i shmangieve dhe parregullsive

Ndryshimi i sistemit zgjedhor nga maxhoritar-proporcional në rajonal-proporcional, i cili ishte thelbi i reformës zgjedhore të kryer në Shqipëri e filloi zbatimin prej vitit 2009. Ky ndryshim i madh politik i reformës zgjedhore

është edhe momenti që na shërbeu për të përzgjedhur si periudhë fillestare për kryerjen e analizës pikërisht vitin 2009. Rrjedhimisht përfshirja e kësaj periudhe e bën analizimin e premtimeve të dy partive kryesore politike edhe pjesë të barabarta të ekuacionit (premtime/programe qeverisëse të PD dhe premtime/programe qeverisëse të PS).

Për të shmangur më tej anësinë dhe për të bërë më të plotë dhe të qartë analizën, por edhe kuptimin e koalicioneve dhe ndikimin e partive pjesëmarrëse në premtimet e partive kryesore është përfshirë në analizë edhe LSI. Arsyeja është bazuar te fakti i qeverisjeve, ku kjo forcë politike ka qenë faktorizuese në krijimin e qeverive. PD në mandatin e dytë qeverisi bashkë me LSI. Gjithashtu PS në mandatin e parë qeverisi me LSI. Në këtë këndvështrim ne trajtojmë premtimet e LSI, si forca e tretë politike, përcaktuese e qeverisjeve në dy procese zgjedhore duke analizuar gjetjet se në çfarë niveli programi i saj elektorale është përfshirë në programin qeverisës.

Nga analiza dalin edhe disa gjetje, se sa ndikojnë premtimet e partive në programet qeverisëse, si dhe devijimet që mund të ndodhin edhe nga vetë programet fillestare qeverisëse duke i krahasuar me programet buxhetore që janë zbatuar mbi 10 vitet e fundit. Një gjetje tjetër rezulton nga analiza e fakteve, se cila forcë politike e ka patur realizimin bazuar te premtimet e veta.

6. Shmangiet dhe gabimet

Shmangiet dhe gabimet janë pjesë e mundshme e analizës. Por, në llogaritjet e kryera kjo shmangie nuk arrin të abstrahojë nga rrjedha e të dhënave bazë të buxhetit. Në gjithë llogaritjet e kryera është përdorur rumbullakosja e vlerave.

Ne jemi të hapur të pranojmë komente dhe llogaritje, kur kanë burime dhe referenca të sakta duke na i dërguar në adresën tonë të emailit altax@altax.al. Ne do të pasqyrojmë gabimin e korriguar duke vendosur edhe burimin e tij.

HYRJE

Premtimet janë në thelbin e komunikimit politik të çdo partie. Sa më të besueshme të jenë ato, aq më shumë ndihmojnë në sigurimin e një mandati qeverisjeje. Pa premtimet, asgjë nuk do të arrihej.

Premtimet elektorale rrallë menaxhohen me aq kujdes sa aktivitetet e përditshme të partive politike. Si rezultat, projektet e rëndësishme që nisin nga premtimet shpesh nuk arrijnë të mbarojnë dhe nuk materializohen duke u zvarritur mandat pas mandati duke humbur mundësitë dhe burimet, që favorizohen nga momenti dhe konjunkturat politike.

Arsyet që kërkojmë të përçojmë me analizën tonë orientohen te sqarimet e performancës së premtimit të shndërruar në pjesë të programit politik qeverisës. Përveç vështirësisë lidhur me nivelin e besueshmërisë dhe matjes së premtimeve nga publiku është gjithashtu edhe niveli i dobët/ulët i mbikëqyrjes së tij gjatë procesit të zbatimit të tij, i pasuar edhe nga motivimi i pakët që ai përçon duke i pararendur fatit politik të një dështimi afatgjatë.

Qytetarët e pa angazhuar në zbatimin dhe monitorimin e premtimeve politike nuk arrijnë të shohin lidhjen midis kontributit të tyre apo të njerëzve që ata kanë besim dhe vlerësimi mbi përmbushjen e premtimeve të shndërruara në programe të qeverisë. Ata e kuptojnë gjithë procesin e realizimit të premtimeve si një mundësi e pakët për ta ndryshuar apo për ta rinegociuar me qeverinë, dhe për ta përfshirë si pjesë të programit të saj. Në këto rrethana, qasja e tyre me zbatimin e një programi të bazuar mbi premtimin nuk pajtohet dhe ky realitet konsiderohet prej tyre se nuk lidhet më tej me ta apo me fatin e familjes dhe komunitetit të tyre.

Morali politik zvogëlohet në rastin e premtimeve elektorale euforike dhe të pabesueshme duke i hapur vend mundësisë për abuzim me përgjegjshmërinë politike në komunikimin e realitetit qeverisës të vendit.

Pjesa themelore e një premtimi të mirë është i lidhur me përgjigjen e pyetjes se: Si mund të bëhet një premtim i matshëm dhe i besueshëm?

Përgjigja duhet të gjendet te kutia e premtimeve, që bazohet tek arritja e qëllimeve sipas sfidave të zhvillimit, të cilat duhet të jenë pjesë e qasjeve strategjike, integruese dhe në funksion të zbatimit të programeve buxhetore. Çdo premtim i mirë ka mundësinë të mbahet kur qëndrimi/vullneti politik dhe burimet e duhura janë të përcaktuara në raport të drejtë me njëra-tjetrën.

Ashtu si idetë e mira janë të padobishme pa zbatimin, po ashtu edhe premtimet e mira janë të kota pa llogaridhënien e monitoruar dhe raportimin e ecurisë së tyre bazuar mbi të dhëna të besueshme.

Ky raport analitik shqyrton të gjitha premtimet e përmendura nga liderët kryesorë të partive qeveribërëse dhe i kategorizon ato veç e veç sipas sektorëve të ekonomisë dhe jetës së vendit. Në këtë mënyrë është e mundur që të realizohet analiza bazuar në operacionalizime të ndryshme të nocionit të premtimeve zgjedhore me fuqinë e një programi qeverisës në të ardhmen duke parë dinamikën e tij nga fillimi deri në fund.

Ky studim është i përbërë nga 5 pjesë, ku secila prej tyre ka 3-4 nënpika, që trajtojnë tematikat sipas titullit. Në vijim paraqite një përmbledhje e tyre për të qartësuar strukturën e raportit dhe gjejeve.

1. Panorama e përgjithshme e tipareve të tri fushatave

Këtu përfshihen renditjet e premtimeve kryesore që kanë karakterizuar tri fushatat, si dhe komentet e bëra nga të tjerë (nëse ka) lidhur me fjalën e mbajtur në formën e një paraqitje parathënëse të asaj çfarë pritet të shtjellohet në këtë analizë (politikat kryesore dhe premtimet e mëdha me ndikim në buxhet, p.sh. pensionet). Premtimet kryesore janë renditur sipas krahëve të buxhetit (të ardhurat dhe shpenzimet), p.sh. Taksat për të ardhurat, si dhe Infrastruktura, Energjia, Transporti, Ekonomia, Mbrojtja sociale, Shëndetësia, Arsimi, Kultura, Bujqësia,

Rendi, Mjedis e Turizmi, etj. për shpenzimet. Bazuar te ndarja sektoriale jepen edhe qasjet e besueshmërisë dhe nivelit të përmbushjes. Kjo strukturë e renditjes së premtimeve do të mbahet në gjithë përmbajtjen e analizës. Për këtë kapitull të dhënat që do të përdoren nuk do të jenë dosmosdoshmërisht të përdorshme edhe në kapitujt në vijim

2. Premtimet elektorale

Premtimet janë kategorizuar në (a) të besueshme, (b) pjesërisht të besueshme, (c) të pamatshme
Në këtë pjesë është ndjekur metodologjia në reflektim të qartësisht, se si ta lexojmë dhe kuptojmë rrugëtimin e një premtimi elektorale të matshëm dhe të besueshëm?

Në këtë kontekst ne kemi përdorur argumentat si më poshtë, se premtimet që do të vlerësohen si të matshme dhe të besueshme sipas analizës duhet të jenë:

- *Publike*. Politikanët i publikojnë dhe i bëjnë të qarta premtimet që kanë shqiptuar publikisht duke i përmbledhur në një program politik elektorale, që qartëson strategjinë, objektivat, llogaritjet dhe kufizimet e një liste përmbushjesh dhe mospërmbushjesh të kërkesave të votuesve. Arsyeja kryesore për këtë qasje është ruajtja e reputacionit dhe besueshmërisë së tyre.

- *Të besueshme*. Premtimet duhet të krijojnë siguri te votuesit dhe të jenë të besueshme nëpërmjet procesit të vlerësimit të tyre, kur ato mundet të maten bazuar te transparenca dhe monitorimi lidhur me nivelin e përmbushjes së tyre. Por, besueshmëria dhe matja e premtimëve elektorale duhet të burojë dhe të referohet në dokumente tashmë në qarkullim që parashikojnë politikën kryesore, si p.sh. Strategjitë, Programet kombëtare, Marrëveshjet nderkombetare, Programet ekonomike e fiskale etj.

- *Të ndershme dhe të argumentuara*. Politikanët dhe aq më tepër liderët e partive marrin përgjegjësi personale kur bëjnë premtime kundrejt detyrimit që duhet të përmbushin ato. Këtu qëndron përgjegjëshmëria e dhënies së një premtimi që nuk duhet të bazohet te fakti se të flasësh nuk kushton, por te zotimi se pas premtimit të dhënë qëndron llogaria financiare që e bën premtimin të besueshëm se do të zbatohet në rast të fitores në zgjedhje.

- *Të mbështetura te misioni politik i zgjedhjeve*. Kur politikanët dhe votuesit komunikojnë me njeri-tjetrin, të parët votuesit përpiqen të shpjegojnë pse kërkesa e tyre është e rëndësishme, ndërsa politikanët priren të vazhdojnë të zbatojnë programet e tyre edhe kur ata hasin bllokime të paparashikuara. Ata madje priren të adresojnë pasi janë në qeverisje edhe në mënyrë jo besnike shqetësimet e votuesve, në vend që t'i përmbushin ato ashtu si kanë premtuar kur janë zotuar në fushatën elektorale.

Nisur nga ky sqarim, i lidhur me nevojën për ta paraqitur secilin premtim politik gjatë periudhave të fushatave zgjedhore, nga ana jonë është zbatuar klasifikimi i tyre duke u bazuar në argumentet si më lartë, por duke përfshirë tashmë në procesin e vlerësimit të besueshmërisë dhe matjes së premtimeve edhe përgjigjet ndaj pyetjeve më poshtë:

- ✓ A ka publikuar partia program elektorale (manifesti politik) ku bazohet premtimi?
- ✓ A i referohet premtimi Kuadrin Makroekonomik dhe Fiskal apo Programit Buxhetor Afatmesëm?
- ✓ A i referohet ndonjë Strategji sektoriale apo ndërsektoriale?
- ✓ Referencë tjetër e lidhur me specifikat e premtimit (p.sh. Programi Kombëtar i Integritit, ligje specifike nga procesi anëtarësimit në BE)?

Në varësi të gjetjeve sipas vlerësimeve të procesit dhe rezultatit të përgjigjes janë ndërtuar kategorizimet e premtimeve (me konvencionet), që ndahen në tri nivele:

- ✓ Premtim i matshëm dhe i besueshëm
- ± Premtim i matshëm, pjesërisht i besueshëm²
- ? Premtim i pamatshëm³

² nëse nuk ka referencën e plotë, apo dhe të dhëna të plota për ta matur zbatueshmërinë

³ Të pamatshme janë ato premtime, kur informacioni aktual nuk është i mjaftueshëm për të gjykuar premtimin, edhe pse premtimi është specifik dhe mund të përcaktohet si një premtim. P.sh. në premtime të caktuara, statistikat përkatëse nuk

3. *Krahësimi i premtimeve midis dy krabëve të politikës dhe përballja e tyre me kapacitetet buxhetore*

Analiza në këtë pjesë zërthehet në dy nënpjesë, për të bërë llogaritje financiare, për të ballafaquar politikën dhe programet me qasjet buxhetore të natyrës së ngjashme, p.sh. pensionet, projektet e investimeve, taksat. Në këtë ballafaqim do të hartojmë edhe një format tabelar duke vendosur në njërin krah premtimin dhe në tjetrin nivelin buxhetor të arritur.

4. *Premtimet elektorale dhe programet qeverisëse*

Kjo pjesë do të analizohet me 3 nënpjesë për të komentuar përfshirjen dhe përmbushjen e premtimeve elektorale në programe qeverisëse duke bërë ballafaqimin me llogaritjet buxhetore në vitet e qeverisjes. Synimi është të shikohet devijimi nga programi elektor, duke parë konsistencën e premtimeve, por edhe tendencën e tyre nga njera fushatë në tjetrën. Në këtë pjesë do të analizojmë deri në vitin e fundit të çdo qeverie se si ka qenë performanca e premtimeve elektorale, për ato premtime që janë përfshirë në programet e qeverisjes.

Qëllimi i vlerësimit është të pasqyrojë ecurinë relative të secilit premtim, të përfshirë në programin qeverisës.

Matja konkludon në tri vlerësime, në raport me nivelin e ecurisë:

I përmbushur – Premtimi/programi është i saktë dhe nuk ka asgjë të rëndësishme që mungon.

Në progres – Premtimi/programi është i saktë/pjesërisht i saktë, por nuk ka arritur finalizimin, apo janë lënë detaje të rëndësishme ose janë nxjerrë gjërat jashtë kontekstit.

Nuk është përmbushur – Premtimi/programi nuk është i saktë dhe nuk është arritur.

Vlerësimi për secilin premtim të përfshirë në program do të bëhet duke i analizuar ato sipas sektorëve të qeverisjes, duke patur dy linja kryesore vlerësimi: (a) buxhetore – fiskale, (b) ligjore - rregullatore. Dallimi midis vlerësimeve është i lidhur ngushtë me përfshirjen ose jo në Programin Buxhetor Aftamesëm, apo në Buxhetet dhe pasqyrat buxhetore vjetore, si edhe për rastet kur ballafaqimi ka nevojë të krahasohet me Kuadrin makroekonomik fiskal etj., me raportime të medias dhe të institucioneve qendrore publike, me studime specifike, ligje të miratuara, apo të dhëna nga INSTAT, si dhe statistikat europiane.

Barra e provës është mbi premtuesin. Në i vlerësojmë premtimet bazuar në informacionin e prezantuar në kohën kur bëhet premtimi.

5. *Trendi i ofertave elektorale dhe standarti i mbajtjes së premtimeve*

Ndarja është në 3 nënpjesë duke tentuar të shqyrtojmë se si bien premtimet në rastet kur partitë vijnë në qeverisje. Një analizë specifike do të bëhet se kush nga partitë i ka mbajtur më shumë premtimet.

Raporti ndjek rregullin duke i përcaktuar premtimet zgjedhore, që gjenden në ndonjë rast edhe në manifeste zgjedhore, si angazhime për të ardhmen dhe që plotësojnë kushtin që mund të konsiderohen si një objektivi që mund të bëhet vlerësimi nëse veprimi është ndërmarë apo do të ndërmerret me të vërtetë apo jo.

Nëse një premtim shfaqet disa herë në mënyra të ndryshme, atëherë është formulimi më specifik, ai që testohet për atë çfarë parashikohet të kryhet në të ardhmen. Vëmendje i kushtohet kuptueshmërisë së premtimit dhe jo thjesht formulimi i tij.

jane në dispozicion, dhe në raste të tjera informacionet dhe statistikat nuk kanë kuptim të përbashkët se cilat duhet të përdoren midis burimeve.

PJESA 1 -Panorama e përgjithshme dhe tiparet e fushatave elektorale 2009-2017

Shqipëria prej vitit 2020 zhvillon një sistem demokratik me mangësi, por që përbën një nivel të ndryshëm në raport me periudhat më përpara. Kjo do të thotë se Shqipëria është një demokraci përfaqësuese, por ka ende nevojë për një konsolidim të proceseve dhe institucioneve demokratike. Krijimi i një kulture të fortë politike demokratike është një detyrë e pandërprerë, që kërkon përfshirjen e të gjithë qytetarëve. Mënyra e funksionimit të partive politike, Kuvendit dhe Qeverisë, forma se si shoqëria civile është e përfshirë në proceset politike dhe të vendimarrjes, por dhe modeli si bëhet edukimi politik dhe qytetar janë çështje po kaq të rëndësishme.

1.1. Panorama e përgjithshme e fushatës elektorale, 2009

Fushata elektorale për zgjedhjet parlamentare të 28 Qershorit 2009 u parapri nga një zhvillim politik, i cili do të ndikonte në mënyrë vendimtare jo vetëm në rreshtimin e forcave politike por edhe në retorikën e tyre publike dhe programet elektorale. Në Prill 2008, Partia Demokratike (në qeverisje) dhe Partia Socialiste (në opozitë) u dakordësuan për të miratuar një paketë ndryshimesh në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Ndryshime të cilat ndër të tjera sanksionuan edhe ndryshimin e sistemit zgjedhor nga mazhoritar të korrektuar me proporcional në proporcional rajonal me 12 zona zgjedhore. Ky pakt politik mundi të krijonte një atmosferë të relaksuar politike mes dy forcave kryesore në qeverisje dhe opozitë ndërsa thelloi ndarjen brenda kampit të majtë opozitar. Grewa e urisë së deputetëve të Lëvizjes Socialiste për Integrim brenda sallës së Kuvendit nuk mundi të pengonte ndryshimet kushtetuese, por konfirmoi gjithësesi ndarjen e së majtës në dy koalicione zgjedhore në fushatën e vitit 2009.

Partia Demokratike e Kryeministrit Sali Berisha regjistroi koalicionin “Aleanca e Ndryshimit” në përbërje të të cilit ishin 16 subjekte politike. Në betejën për të siguruar mandatin e dytë qeverisës, demokratët u përqëndruan tek bilanci i tyre i qeverisjes së mandatit të parë dhe nën sloganin “Shqipëria po ndryshon” kërkuan votat e qytetarëve shqiptarë duke ruajtur *status quo*-në. Retorika e përdorur nga Kryeministri Sali Berisha bazohej kryesisht tek mbajtja e premtimit për rritjen e rrogave dhe pensione. Anëtarësimi i Shqipërisë në Aleancën e Atlantikut të Veriut, dorëzimi i aplikimit për statusin e vendit kandidat për anëtar të Bashkimit Evropian, investimet në infrastrukturë e veçanërisht kantieri në zhvillim i asaj çka u konsiderua si Rruga e Kombit (Milot—Morinë) ishin “asat nën mëngë” të fushatës së demokratëve.

Partia Socialiste e drejtuar nga Kryebashkiaku i Tiranës Edi Rama regjistroi koalicionin “Bashkimi për Ndryshim” në përbërje të të cilit ishin pesë subjekte politike. Katër vjet pas kalimit të socialistëve në opozitë dhe dy vjet pas rikonfirmimit të së majtës në zgjedhjet e pushtetit lokal, Edi Rama shpallti vizionin e tij nën sloganin “Përtej të majtës dhe të djathtës”, në dukje një huazim nga “rruga e tretë” e Tony Blair dhe Anthony Giddens. Përmes turit “Dialogu me Shqipërinë” që parapriu fushatën e 2009-tës, Rama testoi elektoratin duke përpunuar edhe “brumin” e tezave politike. Gjatë fushatës, në cilësinë e kreut të opozitës, Rama mbajti një ligjërim misionar duke ju drejtuar elektoratit “refuzues” ndaj klasës politike. Rrjedhimisht, në këto shina ecën dhe “treni” i fushatës ku Rama pozicionet kundër të gjithëve, kundër qeverisjes së 20 viteve duke premtuar diçka ndryshe, të cilësuar “politikë e re” në kontrast me “politikën e vjetër”. Rama e përshkruan “politikën e vjetër” si politikë të urrejtjes dhe cinizmit, barrikadave partiake, klienteliste apo nepotike.

Lëvizja Socialiste për Integrim udhëhoqi koalicionin “Aleanca Socialiste për Integrim” e përbërë nga gjashtë subjekte politike. Katër vjet pas krijimit të saj si subjekt politik, si dhe një beteje të egër përballë socialistëve në Korrikun e vitit 2005, por dhe një aleance me ta dy vite më vonë, LSI e kryesuar nga Ilir Meta rikthehej sërish përballë dy forcave të mëdha PS dhe PD. Me sloganin “Koha për Veprim”, retorika e fushatës së kësaj force politike shënjestron dy partitë kryesore. E pozicionuar si një forcë e ekstremit të majtë, LSI sulmon socialistët

se nuk mbrojnë sa duhet këtë elektorat, ndërsa fokusi kryesor i saj mbetet retorika kundër Kryeministrit Sali Berisha dhe qeverisjes së tij.

Gjasthtë subjekte të tjera politike të djathta u regjistruan si koalicioni “Aleanca Poli i Lirisë”. Ky grup partish nuk arriti të kishte një hapësirë të qenësishme në debatin elektorat, ndikuar dhe nga profili jo i lartë i subjekteve politike përbërëse, por edhe pozicionimi i tyre përballë koalicionit të djathtë qeverisës. Gjithsesi, në këtë alternativë politike spikati angazhimi i ish-Kryeministrit demokrat, Aleksander Meksi.

Sipas rezultatit zyrtar të shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, koalicioni qeverisës “Aleanca e Ndryshimit” fitoi 70 mandate deputetësh, koalicioni opozitar “Bashkimi për Ndryshim” mori 66 mandate, ai “Aleanca Socialiste për Integrim” mori 4 mandate ndërsa grupimi i katërt “Poli i Lirisë” nuk arriti të ketë përfaqësim në Parlament.

Lëvizja Socialiste për Integrim pranoi ftesën e Kryeministrit në detyrë Sali Berisha për të ndërtuar koalicion pasgjedhor duke përcaktuar kështu edhe fituesin e zgjedhjeve të 28 Qershorit.

1.2. Panorama e përgjithshme e fushatës elektorale, 2013

Fushata elektorale për zgjedhjet parlamentare të 23 Qershorit 2013 u parapri nga shpërbërja e koalicionit qeverisës mes Partisë Demokratike dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim. Kjo e fundit, dy muaj përpara zgjedhjeve, më 1 Prill deklaroi kalimin në opozitë duke premtuar se nuk do të tërhiqte mbështetjen në Parlament për qeverinë e Partisë Demokratike deri në ditën e fundit të mandatit qeverisës, si shenjë e besnikërisë për përmbylljen e plotë të koalicionit të firmosur katër vite më parë.

Partia Demokratike e Kryeministrit Sali Berisha bëri lëvizjen e vet dhe tërhoqi pranë vetes disa deputetë të opozitës socialiste, duke garantuar kështu vazhdimësinë e qeverisë në muajt e mbetur, pa qenë borxhli ndaj “besës politike” të Lëvizjes Socialiste për Integrim.

Koalicioni midis Partisë Socialiste dhe Lëvizjes Socialiste për Integrim nuk kaloi pa debate për shkak jo vetëm të historikut të përplasjeve midis dy forcave politike (2005, 2008, 2009).

Dy vite më parë, në 21 Janarin e vitit 2011 socialistët patën dalë në rrugë në një protestë të dhunshme e cila përfundoi me 4 protestues të pafajshëm të vvarë me armë zjarri. Tubimi opozitar vinte pak ditë pas publikimit në media të një videopërgjimi të dyshuar si aferë korruptive, në të cilin shfaqej zv.kryeministri Ilir Meta në një bisedë me Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Dritan Prifti.

Jo vetëm kaq, por aleanca mes PD dhe LSI bëri që pak muaj pas protestës, Majin e vitit 2011, Kryetari i Partisë Socialiste Edi Rama të humbiste mandatin e Kryebashkiakut të Tiranës në zgjedhjet lokale. Zgjedhje që u shoqëruan me shumë tension për shkak të asaj çka u cilësua nga opozita e majtë si rrëmbim në tavolinë i mandatit të kryetarit të Bashkisë së Tiranës në favor të Lulzim Bashës, ish ministër në qeverisjen e Sali Berishës.

Partia Demokratike u regjistrua në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si drejtuese e koalicionit “Aleanca për Punësim, Mirëqenie dhe Integrim”, pjesë e të cilit ishin 25 subjekte politike. Me sloganin “Ne jemi ndryshimi. Përpara!” demokratët kërkuan votën e shqiptarëve për mandatin e tretë qeverisës. Duke reklamuar bilancin 8 vjeçar qeverisës, Partia Demokratike synonte të bindte votuesit se ndryshimi të cilin kërkonte opozita socialiste në fakt po bëhej realitet nga mazhoranca në pushtet. Premtimet për pagat e pensionet ashtu sikurse investimet në infrastrukturën rrugore dhe veprat e gjenerimit të energjisë elektrike (hidrocentralet) mbetën shtylla e retorikës politike në fushatën e demokratëve.

Partia Socialiste, si forca kryesore e opozitës regjistroi në KQZ koalicionin “Aleanca për Shqipërinë Evropiane”, pjesë e të cilit ishin 34 forca politike, mes të cilave edhe Lëvizja Socialiste për Integrim e Ilir Metës. Si për t’ju përshtatur realitetit të ndryshëm politik, socialistët përqafuan sloganin “Rilindje” duke premtuar një tjetër epokë

politike në vend, ndërsa LSI-ja e Ilir Metës zgjodhi si slogan “Të ecim më shpejt”, që në vetvete tentonte të ishte një justifikim për largimin nga aleanca me PD dhe afrimin me socialistët e Edi Ramës. Ndryshe nga 4 vite më parë, socialistët në programin elektorale të “Rilindjes” përfshijnë një listë të gjatë premtimesh konkrete për çdo fushë të qeverisjes. Ndërkaq, LSI fokusohet kryesisht tek tema e punësimit dhe mbështetja për të rinjtë duke dashur ti japë kësaj force politike një “bazament” të ri për mbështetje elektorale.

Përtej dy koalicioneve, u shfaqën edhe dy forca politike, të cilat tentuan të çajnë rrymën për të shkundur sistemin politik: Aleanca Kuqezi e drejtuar nga Kreshnik Spahi, ish nënkryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Fryma e Re Demokratike e ish-Presidentit Bamir Topi, i larguar nga detyra dhe i braktisur nga lidhshipi zyrtar i demokratëve. Ish-ministri socialist i financave Arben Malaj, ish-ministri i Lëvizjes Socialiste për Integrim Dritan Prifti dhe ambientalisti Sazan Guri tentuan të garojnë të pavarur përkatësisht në Vlorë, Fier e Tiranë.

Pas votimeve të 23 Qershorit Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çertifikoi rezultatit përfundimtar duke i dhënë Partisë Socialiste 66 mandate, Partisë Demokratike 49, Lëvizjes Socialiste për Integrim 16, Partisë për Drejtësi, Integrim dhe Unitet 4, Partisë Republikane 3, Partisë Bashkimi për të Drejtat e Njeriut 1 dhe Partisë Kristiandemokrate 1. Koalicioni i majtë me 84 mandate deputetësh do të merrte të drejtën për të zgjedhur Kryeministrin dhe qeverisur katër vitet e ardhshme deri në 2017 duke zyrtarizuar kështu rrotacionin e pushtetit.

1.3. Panorama e përgjithshme e fushatës elektorale, 2017

Një valë protestash të opozitës në rrugë me kërkesën për krijimin e një qeverie teknike, e cila do të çonte vendin drejt zgjedhjeve parapruri fushatën për zgjedhjet e vitit 2017. Protestat e Partisë Demokratike dhe aleatëve të saj kulmuan me ngritjen e asaj çka u cilësua “Çadra e lirisë” në sheshin “Skënderbe”, poshtë zyrës së Kryeministrit Edi Rama. Kreu i mazhorancës zgjodhi partnerin e tij qeverisës, Ilir Metën në detyrën e Presidentit të Republikës duke garantuar futjen e LSI në zgjedhje.

Pas përkallëzimit të gjuhës politike dhe përpjekjeve të partnerëve ndërkombëtarë për arritjen e një konsensusi politik midis opozitës dhe mazhorancës, një takim kokë më kokë midis Kryeministrit Edi Rama dhe kryetarit të opozitës Lulzim Basha do të çonte tek arritja e marrëveshjes mes tyre. Marrëveshja e 17 Majit do të mundësonte shtyrjen me një javë të datës së zgjedhjeve, të cilat u zhvilluan më pas në 25 Qershor. Partia Demokratike pranoi të bëhet pjesë e qeverisë me ministra teknike duke marrë postet e zv.kryeministrit, të Ministrit të Brendshëm, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Arsimit.

Ndërkaq, Lëvizja Socialiste për Integrim ruante postet e Ministrit të Mjedisit, Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Ministrit të Integritimit Evropian dhe Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural. PD mori kontrollin edhe të disa institucioneve të tjera, si: OSHEE, Drejtoria e Burgjeve, Zyra e Përgjithshme e Regjistrimit të Pasurive, Avokatura e Popullit, Kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Për herë të parë, tri forcat politike kryesore ishin pjesë e të njëjtës qeverie, ndërsa u regjistruan në zgjedhje për të konkuruar secila për llogarinë e saj, pa koalicione parazgjedhore.

Me sloganin “Shqipëria që duam”, socialistët e Edi Ramës dolën në fushatë duke kërkuar një votë masive për të garantuar krijimin e qeverisë në mandatin e dytë pa nevojën e një koalicioni të detyruar me Lëvizjen Socialiste për Integrim. Me një gjuhë të butë ndaj demokratëve dhe më agresive ndaj LSI-së, së drejtuar tashmë nga Petrit Vasili, termat kryesorë të fushatës së socialistëve do të ishin “tepsia” dhe “timoni”, që nënkuptonin tortën e pushtetit dhe drejtimin e qeverisjes e që duhet të mbaheshin sa më larg duarve të aleatit. Ndonëse socialistët hartuan programin e tyre elektorale, pak kush arriti të marrë vesh se cilat ishin premtimet dhe angazhimet politike, pasi vendin e tyre e zunë batutat.

Partia Demokratike e Lulzim Bashës me daljen nga çadra dhe futjen në kabinetin qeverisës “Rama” shpalosi sloganin “Republika e Re”. E kritikuar jo pak si një përpjekje për të shkëputur Partinë Demokratike nga shenjat dhe elementët e saj tradicional politik, nisma e Bashës u përkthye më shumë si një parathënie e paktit të

pashpallur të 17 Majit, që do të çonte në një bashkëqeverisje me socialistët edhe pas zgjedhjeve. Këtë e përforcoi edhe më shumë retorika politike e Bashës i cili gjithashtu zgjodhi një gjuhë të butë ndaj socialistëve të Ramës por shumë më të ashpër ndaj Lëvizjes Socialiste për Integrim.

Me Ilir Metën të dorëhequr, të votuar në Parlament si President, por ende të pa betuar në detyrë, Lëvizja Socialiste për Integrim u drejtua nga dyshja Petrit Vasili e Monika Kryemadhi. Me sloganin “Një shans për të gjithë” duket se jo vetëm tentonte të garantonte mbështetjen e qytetarëve me vota, por edhe të jepte mesazhin se është ajo forca politike, e cila u jep shanset të mëdhenjve për të prekur apo jo pushtetin. E ndodhur përballë sulmeve të njëkohëshme nga Partia Socialiste dhe Partia Demokratike, Lëvizja Socialiste për Integrim do të thërriste në ndihmë jo zyrtarisht edhe Presidentin e zgjedhur Ilir Meta, i cili nuk hezitoi të bëhej pjesë e takimeve elektorale.

Edhe në këto zgjedhje, nuk do të mungonin subjektet e reja politike, të cilat synonin që të shembnin dominancën e tri partive kryesore PS, PD dhe LSI. U regjistrua dhe mori pjesë në garë Partia Libra e drejtuar nga ish-ministri socialist Ben Blushi dhe Sfida për Shqipërinë e drejtuar nga ish-zv.ministri i demokratëve Gjergj Bojaxhi.

Pas votimeve, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve çertifikoi rezultatin zyrtar duke i dhënë Partisë Socialiste 74 mandate, Partisë Demokratike 43 të tilla, Lëvizjes Socialiste për Integrim 19. Ndërkaq, Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet arriti të marrë 3 mandate dhe Partia Socialdemokrate mori 1. Socialistët morën kështu “tepsinë” dhe “timonin” duke fituar të drejtën për të qeverisur të vetëm në katër vitet 2017-2021.

1.4. Analiza të mëparshme tematike nga të tjera organizata⁴

Mbikëqyrja publike për bërjen e transparencës lidhur me përgjegjshmërinë e premtimeve zgjedhore, apo edhe të programeve qeverisëse është një nismë që ka mbi një dekadë që është pjesë e organizimit nga shoqëria civile. Ideja është që qytetarët duhet të luajnë role më të drejtpërdrejta në vendimmarrjen publike ose të paktën të angazhohen më thellë me çështje politike. Politikanët, nga ana tjetër duhet të jenë përgjegjës ndaj këtij lloji angazhimi. Në praktikë, çfarë duhet të rezultojë nga procesi i monitorimit publik është plotësimi i mëtejshëm i rolit të qytetarëve, si votuesë, ose si rojtarë të normave demokratike elektorale përmes formave më të drejtpërdrejta të përfshirjes në informim dhe votim. Nga një skanim kryesisht nëpërmjet internetit të gjithë projekteve sa lidhen me procesin e monitorimit të premtimeve zgjedhore në nivel qendror dhe vendor kemi identifikuar më poshtë ato projekte dhe publikime, që rezultojnë edhe më të përfaqësuarat, pa pretenduar se kjo renditje është shteruese.

1. Partnerët Shqipëri (PSH) filloi në shtator të 2010 zbatimin e projektit “Fuqizimi i praktikave demokratike të pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset zgjedhore” në qytetet Korçë, Pogradec, Berat

⁴ <https://www.rda-korca.org/sq/portfolio/projekti-ndjekja-dhe-verifikimi-i-premtimeve-t%C3%AB-fushat%C3%ABs-zgjedhore-n%C3%AB-shqip%C3%ABri>
<https://www.rda-korca.org/sites/default/files/Raporti%20i%20premtimeve%20para%20zgjedhore.pdf>
<https://www.matesielektor.al/projekti-yne>
<https://portavendore.al/wp-content/uploads/2019/05/Barometri-Bujqesor-i-Bashkise-Devoll.pdf>
<https://faktoje.al/category/premtime/>
<https://www.facebook.com/vertetematesi/>
<https://www.ndi.org/sites/default/files/IDM%20Audit%20of%20Political%20Engagement%20%28Shqip%29.pdf>
<https://www.dw.com/sq/premtimet-parazgjedhore-p%C3%ABr-uljen-e-varf%C3%ABris%C3%AB-n%C3%AB-shqip%C3%ABri/a-16868222>
https://partnersalbania.org/wp-content/uploads/2016/01/Advokacia_dhe_Zgjedhjet_Vendore2011.pdf
<https://portavendore.al/bashkia-durres/premtime-elektorale/>
<https://www.botasot.info/shqiperia/702083/premtimet-elektorale-ne-shqiperi-710-mije-vende-pune-per-11-vjet/>
<https://www.infocip.org/al/?p=11953>
<https://www.reporter.al/partite-politike-shqiptare-e-gjejne-veten-ne-shterpesi-premtimesh-elektorale/>
<https://qq.com.al/index.php/2021/02/10/analize-e-premtimeve-dhe-politikave-kombetare-per-rinine-dhe-arsimin-2013-2021/>

dhe Elbasan. Projekti u mbështet nga Balkan Trust for Democracy, një projekt i Fondit Gjerman Marshall dhe Ambasada Amerikane në Shqipëri. Kjo nismë synoi të forcojë demokracinë në vend përmes pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në proceset zgjedhore. Nisma e PSH konsistoi në ngritjen e grupeve aktive lokale në qytetet e targetuara, forcimin e kapaciteteve, lehtësimin, mbështetjen dhe këshillimin e tyre për hartimin dhe zbatimin e fushatave të advokatisë si dhe monitorimin e premtimeve të bëra nga kandidatët për kryetar bashkie gjatë fushatës zgjedhore, në mbrojtje të interesave të qytetarëve. Fushatat advokuese treguan rëndësinë e fokusimit në çështje konkrete të komunitetit si një mjet për tejkalimin e mosbesimeve të lidhura me partitë. Përmes metodave të zbatuara, qytetarët përvetësuan njohuri dhe aftësi për teknikat lobuese dhe advokuese, si dhe ngritjen e partneriteteve dhe bashkëpunimeve që i ndihmuan ata gjatë fushatës së zhvilluar në qytetin e tyre.

2. Një studim i qendrës Shqiptare për Qeverisje Mjedisore – ACEG me temë “Barometri i performancës së Bashkisë Devoll”, sipas përcaktimeve të neneve 26, 27 dhe 28 të ligjit 139/2015 analizoi performancën e një mandati qeverisës në Bashkinë Devoll. Me anë të kësaj analize u synua informimi i qytetarit për të kërkuar më shumë llogari ndaj të zgjedhurve të tij. Sipas raportit të ACEG, performanca e bashkisë Devoll mbetet në nivelin e ndërhyrjeve tradicionale para reformës së re territoriale dhe detyrimet ligjore apo premtimet elektorale janë zbatuar në masën 50 përqind.

3. Në një artikull të saj, Deutsche Welle thotë se varfëria është ndër temat më të artikuluar gjatë fushatave elektorale. Megjithëse 2 partitë politike në garë ofrojnë shifra konkrete për hapjen e vendeve të reja të punës, PS 300 mijë vende të reja pune dhe PD 250 mijë vende pune, nga analiza e ekspertëve të ekonomisë, realizimi i këtij premtimi në kushtet e krizës është i vështirë. Ata janë skeptikë më së shumti për ofertën politike që vjen nga PD.

4. Nga një vëzhgim i emisionit investigativ “Fiks Fare” në TCH, partitë politike fituese në zgjedhje që nga 2005 e deri në periudhën e emisionit nuk i kanë mbajtur premtimet për hapjen e vendeve të reja të punës. Nëse kjo do të ndodhte Shqipëria do të numëronte 710 mijë të punësuar të rinj. “Fiks Fare”, ju referua premtimeve elektorale të koalicionit të djathtë në dy mandate, pikërisht në vitin 2005 dhe 2009, si dhe premtimit elektorale të koalicionit të majtë në vitin 2013. Në vitin 2005 ishte kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, i cili premtoi se do të krijonte 250 mijë vende të reja pune. Në vitin 2009, sërish Sali Berisha, që u zgjodh kryeministër, premtoi se do të hapte dhe 160 mijë vende të reja pune. Me të njëjtën retorikë vijoi në vitin 2013 edhe Partia Socialiste. Kreu i PS, Edi Rama deklaroi në atë kohë se po të fitonte zgjedhjet brenda mandatit të parë do të krijonte 300 mijë vende të reja pune. Ndërkaq, premtimet nuk janë ndalur në asnjë rast zgjedhësh. Në analizën e Fiks Fare, nisur nga të dhënat e INSTAT, nga viti 2005 janë shtuar 226 mijë punonjës të rinj ose 484 mijë punonjës më pak sesa kanë qenë premtimet elektorale gjatë këtyre viteve.

5. Premtimet elektorale kanë qenë temë e artikujve dhe në media. Portali “Faktoje” ka analizuar premtimin e kryetarit të bashkisë së Vlorës dhënë qytetarëve në vitin 2015 për furnizim me ujë të qytetit në 24 orë. Në sondazhin e “Faktoje” me qytetarët e Vlorës, u konstatua se ky premtim nuk është mbajtur. Sipas “Faktoje”, depozitat mbi tarracë apo çati, dëshmojnë për mungesë të ujit të rrjedhshëm 24 orë.

6. Studimi “Analiza e Angazhimit Politik” i kryer nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) ofron bazë të dhënash unike në Shqipëri në lidhje me politikën dhe angazhimin e qytetarëve në procese politike. Studimi synonte të njihnte më mirë qëndrimet publike ndaj një sërë treguesish të angazhimit politik që evidentojnë njohuritë dhe interesin e pjesëmarrësve për sistemin politik, nivelin e veprimit publik dhe të pjesëmarrjes në procese politike, kuptimin e efikasitetit dhe kënaqësisë nga institucionet dhe proceset politike. Studimi paraqiti gjetjet nga një sondazh të kryer në 12 qarqe të vendi për një sërë treguesish për angazhimin politik në periudhën 8-26 shkurt 2016. Sipas gjetjeve të studimit, pjesëmarrësit interesoheshin për politikën, por nuk kishin njohuri të thella për institucionet. Përkundrazi, ata ndjeheshin më të informuar ndaj qeverisjes vendore.

7. Në studimin për përmirësimin e Kodit Zgjedhor i realizuar nga INFOCIP, premtim zgjedhor apo program elektorale nuk ekzistonte literalisht fare në KOD. Sipas studimit, në KOD subjekti zgjedhor nuk kishte

asnjë detyrim për të depozituar formalisht programin elektorale. Nga INFOCIP, kjo “harresë” konsiderohet një mangësi sistematike që ka sjellë pasojë dramatike sa i takon besueshmërisë së publikut tek partitë politike dhe mandej edhe tek institucionet, që ato formësojnë tekta vijën në pushtet. Nisur nga kjo, vetë debati publik apo politik i shkëlqes së programit apo mos-mbajtjes së premtive është i paligjitime, për të mos thënë irracionale, porë kjo në optikën eparimeve të shtetit të së drejtës. Studimi i INFOCIP ka dalë në përfundimin, se në KOD duhen bërë parashikime të sakta për një mekanizëm kontrolli efikas, që e adreson këtë “harresë”. Sipas studimit kjo do të vinte para përgjegjësisë publike subjektet elektorale. Studimi e shih si domosdoshmëri nevojën për parashikime të bazuara në programe elektorale që janë konceptuar që në fillim të jenë programe qeverisëse.

8. Në një artikull të publikuar në portalin “Reporter”, në 29 maj të vitit 2017, analizohet premtimi elektorale i Partisë Socialiste, si forcë qeverisëse për hapjen e 220 mijë vendeve të reja të punës për katër vitet e ardhshme. Më herët PS pat premtuar hapjen e 300 mijë të tilla më 2013. Statistikat zyrtare të Institutit të Statistikave treguan se numri i të punësuarve në fund të vitit 2016 qe afro 1.17 milionë shqiptarë, me rritje 171 mijë vetë në krahasim me shtatorin 2013, kurse numri i të papunëve që po kërkonin punë në Dhjetorin 2016 ishte 192 mijë vetë, afro 6 mijë më pak se sa në Shtator 2013. Gazetari shkruan në analizën e tij se nga Shtatori i vitit 2013 deri në Dhjetor 2016, numri i të punësuarve me pagë në Shqipëri është rritur me 134 mijë vetë, shumë larg premtimit për 300 mijë vende pune.

9. Fondacioni “Fondacioni Agjensia Rajonale e Zhvillimit Korçë” me anë të projektit “Ndjekja dhe verifikimi i premtimeve të fushatës zgjedhore në Shqipëri” krijoi “Matësin elektorale”, një platformë që analizonte premtimet elektorale të 140 deputetëve fituesë gjatë fushatës elektorale të 2017 dhe 61 kryetarëve të bashkive në zgjedhjet vendore të 2015 dhe 2019. Ky projekt synonte të ndihmonte qytetarët shqiptarë, që të njihen me premtimet e kandidatëve dhe të kontrollojnë nivelin e arritjes së tyre. Po ashtu, ai synonte edhe rritjen e angazhimit qytetar në monitorimin e investimeve dhe shpenzimeve të bashkive.

10. Qëndresa Qytetare ka analizuar gjatë fillimvitit 2021 premtimet dhe politikat e zbatuara gjatë 8 viteve të fundit, nivelin e realizimit të tyre dhe nevojën për të riparë dhe rikonsideruar nga aktorët politikë çështjet me interes të lartë për të rinjtë dhe studentët. Kjo nismë i shërben nxitjes dhe orientimit të debatit konstruktiv, të bazuar në fakte dhe evidenca për të përmirësuar cilësinë e ofertave politike për rininë dhe arsimin nga forcat politike që konkurojnë në zgjedhjet e 25 Prillit.

Fakti që studimet dhe monitorimet e kaluara përdorin metoda të ndryshme për të hetuar dhe gjurmuar përmbushjen dhe vërtetësinë e programeve qeverisëse dhe premtimeve elektorale duke u bazuar në përkufizime të ndryshme për të funksionalizuar nocionin e premtimit zgjedhor përforcon mendimin se partitë përgjithësisht i marrin seriozisht premtimet e tyre zgjedhore, por matja e tyre dhe sqarimi për opinionin është në tërësi proces i komplikuar.

Monitorimet dhe studimet e kaluara ndryshojnë kur bëhet fjalë për mënyrën sesi verifikohet përmbushja. Shumica e monitorimeve dhe analizimeve të përmbushjes janë mbështetur kryesisht në dokumente zyrtare dhe burime informacioni të shkruara, por të pakryqëzuara si të dhëna me njëra-tjetrën duke marrë për bazë vetëm një të dhënë të caktuar.

Ndërkohë, studimi jonë i cili ka ngjashmëri në zhvillimin e tij me një analizë të fakteve me të dhënat që janë të publikuara ka një qasje tjetër dhe mbështetet në krahasimet e premtimeve nga qeveria dhe opozita në harkun kohor të një dekade, si dhe duke kaluar gjithë premtimin nëpër filtrat e dokumentacionit kryesor buxhetor dhe njësoj për të gjitha palët.

PJESA 2 - Premtimet e partive kryesore politike 2009 - 2017

Kërkesat e votuesve presin përgjigje nga ofruesit e premtimeve politike. Të dy palët e kanë të nevojshme të kalojnë protokolle komunikimi, që nisin më përpara se fillimi i fushatave elektorale. Qëllimi i komunikimeve është i lidhur me mënyrën dhe formën se si kërkesat e qytetarëve do të përmbushen, kur do të përmbushen, si dhe cilat burime do të përdoren. Kjo fazë mbaron kur ofruesi bën një premtim, që votuesi e pranon në shumicën e tij.

Ofruesi më i besueshëm i premtimeve fiton të drejtën për të qeverisur, me pritshmërinë që të mbajë fjalën për realizimin e premtimit. Ndërkohë, opozita dhe votuesit do të vazhdojnë edhe më tej me interpretimin dhe riinterpretimin e premtimeve duke kërkuar që për secilin hap të realizimit të premtimit të egzistojnë marrëveshje transparente. Në plan të parë, secili grup votuesish kërkon që premtimi i tyre të ketë përparësi dhe burime të garantuara. Mirëpo, shpesh qeveria që tashmë i ka kthyer në program qeverisje shumë apo disa nga premtimet e dhëna kërkon të rinegociojë kushtet e realizimit të premtimit, apo ta shtyjë për një mandat të mëvonshëm qeverisje përmbushjen e premtimit. Ky moment i ndryshimit të “kontratës” me votuesit, e bazuar në premtimet e bëra ka nevojë për të kuptuar arsyen për rinegociatat që kryejnë partitë duke kërkuar arsye dhe argumenta nëse kanë ndryshuar përparësitë apo rrethanat për realizimin e premtimeve. Kjo fazë përfundon kur qeveria e deklaron të plotësuar premtimin dhe ia paraqet për vlerësim votuesit. Ky moment kërkon ndërhyrjen e shoqërisë civile dhe ekspertizës së saj, bashkë me grupe të tjera interesi (media, organizatat e biznesit, sindikatat, ekspertëve jo partiakë, etj.) që të shprehen mbi nivelin sasior dhe cilësor të përmbushjes së premtimit.

Fillimisht në këtë pikë të raportit do të analizojmë premtimet e partive. Në pjesët në vijimësi do të analizojmë premtimet sipas partisë apo koalicioneve që kanë fituar mandatin e votuesve për qeverisje të përfshira në programin qeverisës.

Nga një krahasim i premtimeve për të tri fushatat zgjedhore lidhur me fokusin nga partitë, shikohet se premtimet specifike dhe të adresuara sipas sektorëve dhe problematikave të zhvillimit të vendit janë në masë

Tab.1 Premtimet specifike dhe të përgjithshme, 2009-2017

Nr.	Premtimet specifike dhe të përgjithshme	2009	2013	2017
1	Premtimet specifike	92%	97%	93%
2	Premtimet e përgjithshme	8%	3%	7%

Shënim. Premtimet analitike të Shtojcës

dominuese mbi 90 përqind, ashtu si prezantohen edhe në Tabelën 1. Ndërkohë, premtimet e përgjithshme dhe ato politike që kanë një natyrë përfaqësimi të përgjithshëm janë më të pakta në peshën e tyre. Këto premtime më së shumti përfaqësojnë tema për anti korrupsionin, për oligarkët, si dhe tema që kanë të bëjnë me të ardhmen e vendit sipas vizionit të partive.

2.1. Premtimet e fushatës elektorale 2009

Në aspektin e respektimit të një etike në kuadër të barazisë së garës zgjedhore përpara fillimit të fushatës, përmendim më poshtë edhe Vendimet e Qeverisë dhe Ligjet e miratuara në prag fushate, por që për efektin dhe mesazhin që ato përcjellin kanë ndikimin e tyre në zgjedhjet e vitit 2009. Edhe pse Kodi Zgjedhor në këtë vit nuk parashikon sanksione, këto vendime kanë një hije morale që paraqet një situatë pabarazie të palëve në garën e zgjedhjeve.

Në rrjedhë kohore kronologjike këto vendime të miratuara janë:

27/04/2009

- ✓ Kryeministri njoftoi rritjen e pagave dhe pensioneve.

13/05/2009

- ✓ Miratohet ulja e tarifës së pagesës për përdorimin e kullotave shtetërore për blektorët nga 300 në 100 leke.

13/05/2009

- ✓ Shtohet lista e barnave të rimbursueshme me 70 artikuj të tjerë;
- ✓ Qeveria mori vendim për rritjen e pagës minimale në shkallë vendi nga 170 në 180 mijë lekë;
- ✓ Qeveria vendos dhënie falas të librave për arsimin parauniversitar për familjet në ndihmë ekonomike;
- ✓ Qeveria ul në 1 euro tarifën e përdorimit të ujërave të brendshme dhe detare për rritjen e peshkut.

28/05/2009

- ✓ Këshilli i Ministrave miraton fondin për shpërblimin prej 5.000 lekë për çdo lindje të fëmijëve.

11/06/2009

- ✓ Qeveria miratoi vendimin për uljen e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve nga 2-4 herë;
- ✓ Qeveria miratoi sot vendimin për rritjen e pagesës mujore të personave me statusin e të verbrit.

18/06/2009

- ✓ Kryeministri ngarkoi ministrinë përkatëse për të përgatitur vendimin për amendimin e ligjit për pensionet. Ky vendim do të ulë moshën e pensioneve për minatorët me 5 vjet, si dhe do të ketë fuqi prapavepruese, në mënyrë që të mbulojë të gjithë minatorët dhe ish minatorët shqiptarë. Gjithashtu në bazë të këtij vendimi, pensionet e minatorëve do të ngrihen në nivelin më të lartë të mundshëm për këtë kategori.
- ✓ 6 mijë familje të tjera, kryesisht në Tiranë, banesat e të cilëve legalizohen. Rreth 1300 familje, të cilave ju privatizohen banesat në Kombinatin dhe tek ish shkollat e Partisë. E vërteta është që procesi i legalizimit po shkon drejt fazës më të shpejtë, pasi të përgatitura për proces janë mbi 150 mijë objekte.
- ✓ Qeveria miratoi sot vendimin "Për kthimin në fond banesash të disa objekteve të ish-kombinatit të Tekstileve, në Tiranë, të Ndërmarrjes Mekanike-Tekstili, Tiranë dhe të ish shkollës së Partisë, Tiranë", në të cilat aktualisht banojnë 195 familje që i përkasin shtresës së ish- të përndjekurve politikë.

Në vijim do të prezantohen fillimisht premtimet elektorale sipas sektorëve për secilën nga tri partitë politike kryesore në vend.

Tab.2 **PREMTIMET ZGJEDHORE TE TRE PARTIVE KRYESORE NE ZGJEDHJET 2009**

Nr.	Premtimet sipas sektorëve 2009	PD	PS	LSI
1	Fiskale dhe Buxhetore	6	20	5
2	Shëndetësia	3	15	8
3	Mbrojtja sociale dhe pensionet	3	15	13
4	Punësimi	2	3	4
5	Arsimi, Gruaja dhe Rinia	13	16	18
6	Bujqësia dhe fshati	13	22	12
7	Mjedisi dhe Turizmi	0	11	0
8	Infrastruktura dhe veprat publike	16	1	6
9	Energjia	6	0	1
10	Fasonët	0	0	4
11	Minatorët, naftëtarët, ushtarakët	1	7	4
12	Emigrantët	0	7	2
13	Legalizimet dhe pronat	2	6	4
14	Integrimi	1	3	1
15	Politike	1	7	1
16	Të përgjithshme	5	9	1
PREMTIME GJITHSEJ		72	142	84

Shënim. Premtimet analitike të Shtojcës

Tabela 2 tregon, se nga 298 premtime elektorale gjithsej nga tri partitë, PS në aspektin sasior ka premtuar sa 48% të gjithë premtimeve. Ndërkohë, LSI ka premtuar sa 28% të gjithë premtimeve dhe PD një sasi premtimesh sa 24% e të gjithë premtimeve.

Në një analizë horizontale të premtimeve, partitë së bashku kanë bërë më shumë premtime për bujqësinë dhe fshatin (47 premtime), si dhe për arsimin, rininë dhe gruan (47 premtime).

Premtimet për politikën fiskale dhe buxhetin, si dhe premtimet për mbrojtjen sociale dhe pensionet zënë vendin e dytë. Në vijim, një numër më i pakët i premtimeve janë bërë për shëndetësinë (26 premtime) dhe për infrastrukturën dhe veprat publike (23 premtime).

Në analizën e premtimeve të partive sipas sektorëve shikohet, se:

- PD e ka bërë numrin më të madh të premtimeve për infrastrukturën dhe veprat publike (16 premtime), për arsimin, rininë dhe gruan, si dhe për bujqësinë dhe fshatin ka bërë respektivisht nga 13 premtime. Ndërsa, për sektorët e tjerë, numri i premtimeve është më pak se numri 6.

- PS e ka bërë numrin më të madh të premtimeve për bujqësinë dhe fshatin (22 premtime), për arsimin, rininë dhe gruan ka bërë 16 premtime, si dhe për shëndetësinë e mbrojtjen sociale dhe për pensionet ka bërë respektivisht nga 15 premtime.

- LSI e ka bërë numrin më të madh të premtimeve për arsimin, rininë dhe gruan (18 premtime), për mbrojtjen sociale dhe pensionet (13 premtime), si dhe për bujqësinë dhe fshatin (12 premtime), ndërsa për shëndetësinë ka bërë 8 premtime. Për sektorët e tjerë ka bërë një sasi premtimesh më pak se numri 6.

Në premtimet specifike, PS dhe LSI kanë premtuar edhe për kategori dhe grupe shoqërore, që përkojnë me bazën e votuesve, si punonjësit e industrisë, ushtarakët e liruar si dhe një shtim të premtimeve për emigrantët. LSI ka premtime specifike për industrinë fason duke dalluar nga dy partitë e tjera. Këtë interes me premtimet e tyre, ata me një qasje të dukshme elektorale e kanë orientuar edhe drejt pronarëve të pasurive të paluajtshme, por edhe ndaj banorëve që jetojnë dhe punojnë në zonat me ndërtime informale.

Në premtimet e tyre elektorale të dy partitë e krahut të majtë kanë një prirje për të motivuar votuesit me premtime për politika sociale.

PD si një parti e krahut të djathtë, e cila ka bërë një ofertë për vijimësinë e qeverisjes së saj, i ka orientuar premtimet në drejtim të bujqësisë dhe fshatit, por edhe drejt arsimit, rinisë dhe gruas, si politika që janë një vijimësi e programit qeverisës të PD.

Një dallim i premtimeve të PD me partitë e krahut të majtë është numri i lartë i premtimeve për infrastrukturën, ku specifikisht janë premtimet për mjedisin, të cilat duket se janë vijimësi apo fronte të planifikuara për programe të ardhme, si pjesë e qeverisjes dhe jo një ndarje programore politike.

Nga krahasimi sasior i numrit të premtimeve midis pozitës dhe opozitës shikohet se *kejo e fundit ka një numër premtimesh sa trefishi i premtimeve të pozitës.*

2.2. Premtimet e fushatës elektorale 2013

Në kuadër të ruajtjes së një etike, në respekt të barazisë së garës zgjedhore përpara fillimit të fushatës, paraqesim më poshtë Vendimet e Qeverisë dhe Ligjet e miratuara në prag fushate. Për efektin dhe mesazhin që ato përcjellin konstatojmë se kërkojnë të ndikojnë në votën e zgjedhjeve të vitit 2013. Kjo praktikë, që edhe në këto zgjedhje nuk parashihet si një vepër e dënueshme nga Kodi Zgjedhor përbën rutinën e shëmtuar morale të përcimit të moralit të dëmshëm për besueshmërinë e votuesve ndaj partive dhe sistemit.

Në rrjedhë kohore kronologjike, vendimet e qeverisë, të cilat kanë një rritje të numrit të tyre në këto zgjedhje janë:

23/01/2013

- ✓ Vendim i Qeverisë për kalim në pronësi të tokës poseduesve informalë të objekteve.

01/02/2013

- ✓ Vendim i Qeverisë për vijimin e procedurave të privatizimit të AlbPetrol sh.a.

06/02/2013

- ✓ Akt Normativ i Qeverisë për dhënie leje përdorimi subjekteve me shkelje të lejeve të kushteve të lejeve ndërtimit.

13/02/2013

- ✓ Vendim i Qeverisë për përjashtim nga TVSH për hekurin dhe çimenton për ndërtimin e HEC.

04/03/2013

- ✓ Vendim i Kuvendit për mbajtjen e referendumit për tri projekt-akte të integritimit;
- ✓ Ligji për mediat audiovizive;
- ✓ Ligj për shitjen e HEC Ulëz-Shkopet shoqërisë Kurum International sh.a.

13/03/2013

- ✓ Vendim i Qeverisë për miratimin e koncesionit të markimit të karburanteve.

27/03/2013

- ✓ Vendim i Qeverisë për përcaktim autoriteti kontraktues për koncesionin e “Kalasë së Turrës”, Synej, Kavajë.

28/03/2013

- ✓ Ligj për kontratë koncesioni për HEC Devoll;
- ✓ Ligj për përjashtim nga taksat dhe tarifatat vendore antenat celulare;
- ✓ Ligj për përjashtimin e pagave nën 30 mijë lekë nga tatimi mbi të ardhurat.

01/04/2013

- ✓ Ligj për përjashtim nga TVSH i lendeve të para për bujqësinë dhe për blegtorinë.

03/04/2013

- ✓ Vendim i Qeverisë për dhënie koncesioni për përdorim burimi ujor “Sasaj”;
- ✓ Vendim i Qeverisë për dhënie me koncesion të terminalit të trageteve në portin e Durrësit.

15/04/2013

- ✓ Ligj për projektin e gazsjellësit Trans Adriatik (projekti TAP).

18/04/2013

- ✓ Ligj për dhënien në përdorim të truallit institucioneve arsimore, shëndetësore dhe të përkujdesjes shoqërore;
- ✓ Ligj për faljen e taksës së qarkullimit për mjetet e sekuestruara/konfiskuara dhe përjashtimi nga penalitetet për mospaguesit e taksës vjetore të mjeteve të përdorura.

24/04 – 25/04/2013

- ✓ Vendim i Qeverisë për përjashtim të TVSH së makinerive dhe paisjeve për HEC private;
- ✓ Vendim i Qeverisë për miratim të kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore, në favor të poseduesve të objekteve informale;
- ✓ Vendim i Qeverisë për privatizimin në favor të 220 familjeve të pastreha të disa objekteve të ish-Kombinatit të Autotraktorëve, uzina Fonder -Mek, Shkozë, Tiranë”;
- ✓ Vendim i Qeverisë Për shpërblimin e 800 pronarëve për sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale në qytetet kryesore të vendit;
- ✓ Vendim i Komitetit të Zhvillimit të Rajoneve për financim të projekteve infrastrukturore për 1.5 miliard lekë;
- ✓ Ligj, ku përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat individuale nga shitja e tokës bujqësore;
- ✓ Ligj për koncesionet dhe partneritetin publik-privat;
- ✓ Ligj, ku ulen kontributet e sigurimeve shëndetësore për gjithë kategorite e punonjësve;
- ✓ Ligj për koncesionin e skanimit të kontejnerëve e automjeteve të tjera;
- ✓ Ligj për financimin e projektit të ndërtimit të Portit të Peshkimit të Durrësit;
- ✓ Ligj për ndërtimin e segmentit Qukës–Qafëplloçë, si pjesë e korridorit rrugor Tiranë–Korçë.

29/04/2013

- ✓ Ligj për miratimin e kredisë për projektin e tatimit elektronik (E-Taxation).

02/05/2013

- ✓ Vendim i Qeverisë ku kompensohen nga buxheti i shtetit TVSH e paguar nga fermerët për lëndët e para.
- ✓ Akt normativ i Qeverisë, ku lejohet rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme për individët duke ulur pagesën e tatimit mbi pasurinë deri në 31/10/2013.

15/05/2013

- ✓ Vendim i Qeverisë, për pagimin e rimbursimit të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH) për “Kurum International” sh.a.

22/05/2013

- ✓ Vendim i Qeverisë për koncesionet për 6 HEC-e.

30/05/2013

- ✓ Vendimi i Qeverisë për miratimin e kalimit të pronësisë së 1.700 parcelave ndërtimore, në favor të poseduesve të objekteve informale në disa qytete kryesore në vend;
- ✓ Ligj për zgjatjen e afatit të amnitisë fiskale deri në 31.12.2013.

19/06/2013

- ✓ Vendim i Qeverisë për shpërblimin e 286 pronarëve mbi sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale.

Në frymën e vendimeve të marra nga Qeveria dhe Kuvendi ndër të tjera janë premtuar:

- financimi për Lungomaren;
- mbështetje e zgjerim të Partneritetit Publik Privat;
- vendimi i qeverisë për rritjen e rrogave me hyrje në fuqi në Shtator 2013, pas zgjedhjeve.

Në vijim paraqiten premtimet elektorale, sipas sektorëve për tri partitë politike kryesore në vend.

Tab.3 **PREMTIMET ZGJEDHORE TE TRE PARTIVE KRYESORE NE ZGJEDHJET 2013**

Nr.	Premtimet sipas sektorëve 2013	PD	PS	LSI
1	Fiskale dhe Buxhetore	8	12	10
2	Rendi Publik	0	3	0
3	Shëndetësia	0	6	9
4	Mbrojtja sociale	3	8	6
5	Punësimi	5	1	5
6	Arsimi, Gruaja dhe Rinia	3	9	10
7	Bujqësia dhe peshkimi	10	14	9
8	Mjedisi dhe Turizmi	4	10	5
9	Infrastruktura dhe industria	19	9	12
10	Energjia dhe pasuritë nëntokësore	4	15	10
11	Pensionet, ushtarakët, fasonët	7	8	1
12	Strehimi social	0	2	4
13	Përndjekurit	1	3	0
14	Legalizimet dhe pronat	2	6	0
15	Integrimi	1	1	1
16	Politike	3	5	0
17	Emigrantët	1	1	4
PREMTIME GJITHSEJ		71	113	86

Shënim. Premtimet analitike te Shtojca

Sipas Tabelës 3, në zgjedhjet politike të vitit 2013, premtimet elektorale vijnë në numër më të vogël në totalin e tyre për të tria partitë së bashku (gjithsej 270 premtime), me një pakësim me 10 përqind. Nga premtimet e bëra nga tri partitë, PS ka premtuar sa 42% të gjithë premtimeve. LSI ka premtuar sa 32% e të gjithë premtimeve. PD ka premtuar sa 26% të gjithë premtimeve.

Partitë kanë premtuar më së shumti për infrastrukturën dhe industrinë (40 premtime), për bujqësinë dhe fshatin (33 premtime), për buxhetin dhe politikën fiskale (30 premtime), si dhe për energjinë dhe pasuritë nëntokësore (29 premtime).

Nga analiza e premtimeve të bëra prej secilës prej tri partive sipas sektorëve, shikohet se:

- PD ka bërë numrin më të madh të premtimeve për infrastrukturën dhe industrinë (19 premtime), për bujqësinë dhe peshkimin (10 premtime), për pensionet dhe mbrojtjen sociale (10 premtime), si dhe për buxhetin dhe politikën fiskale (8 premtime). Për sektorët e tjerë, numri i premtimeve është më pak se numri 5.

- PS ka bërë numrin më të madh të premtimeve për energjinë dhe pasuritë nëntokësore (15 premtime), për bujqësinë dhe peshkimin (14 premtime), për buxhetin dhe politikën fiskale (12 premtime), si dhe për mjedisin dhe turizmin (10 premtime). Për sektorët e tjerë numri i premtimeve është më i vogël se numri 9.

- LSI ka bërë numrin më të madh të premtimeve për arsimin, rininë dhe gruan (18 premtime), për mbrojtjen sociale dhe pensionet (13 premtime), si dhe për bujqësinë dhe fshatin (12 premtime), ndërsa për shëndetësinë ka bërë 8 premtime. Për sektorët e tjerë ka bërë një sasi premtimesh më pak se numri 6.

Në premtimet specifike, PS adresohet direkt për rendin publik. LSI adresohet me premtime specifike për strehimin social dhe për emigrantët. PD nuk ka bërë premtime specifike.

PD vjen në zgjedhjet e 2013 pas një qeverisje në koalicion me LSI me premtime që janë më shumë të lidhura me investimet dhe programet e kryera gjatë qeverisjes 8-vjecare në infrastrukturë dhe bujqësi. Një vijimësi e numrit të lartë dhe konsistencës së premtimeve shikohet te sektori i infrastrukturës.

Nga krahasimi sasior i numrit të premtimeve midis pozitës dhe opozitës shikohet se pozita ka një numër premtimesh më të shumtë se numri i premtimeve të opozitës.

2.3. Premtimet e fushatës 2017

Edhe në këtë fushatë zgjedhore, megjithëse u pranua të mos përdoshin mundësitë dhe burimet publike për të krijuar favorizim të partisë në detyrë në krahasim me partitë e tjera, ne konstatojmë se ka vazhduar e njëjta praktikë që është përdorur edhe në zgjedhjet e kaluara, ku Vendimet e Qeverisë dhe Ligjet e miratuara në prag fushate krijojnë të njëjtin efekt dhe mesazh te votuesit me moralin që ato përcjellin për ndikimin e tyre në zgjedhjet e vitit 2017. Edhe në këtë vit, Kodi Zgjedhor nuk parashikon dënime për këto veprime.

Vendimet e marra në prag të fushatës zgjedhore në rrjedhë kronologjike janë renditur më poshtë.

26/01/2017

- ✓ Ligj për bashkëpunim financiar 2010, për projektin "Linja e transmisionit 400 kV, Shqipëri–Maqedoni"

02/02/2017

- ✓ Ligj për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit.

08/02/2017

- ✓ Vendim i Qeverisë për shpërblimin e 42 pronarëve për sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale;
- ✓ Vendim i Qeverisë për kalimin e së drejtës së pronësisë për 977 parcela të objekteve të legalizuara dhe kompensimin financiar të pronarëve të pasurive të paluajtshme që preken prej tyre.

01/03/2017

- ✓ Vendim i Qeverisë për ngushtimin e diferencave në masën e pensioneve, ku rritja e pensioneve për kategori të caktuara shkon nga 3.8 herë deri 4.4 herë.

08/03/2017

- ✓ Vendim i Qeverisë për trajtimin me shtesa mbi pagë të punonjësve në arsimin parauniversitar, oficeret, në pushtetin vendor, etj

15/03/2017

- ✓ Vendim i Qeverisë për trajtimin me shtesa mbi pagë të punonjësve të Policisë së Shtetit, mjekeve dhe infermiereve.

21/03/2017

- ✓ Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për detajimin e programit të zhvillimit të infrastrukturës vendore dhe rajonale, vlera 1 miliard leke për vitin 2017.

29/03/2017

- ✓ Vendim i Qeverisë për trajtimin me shtesa mbi pagë për punonjësit e personelit akademik në institucionet publike të arsimit të lartë;

- ✓ Vendim i Qeverisë për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata me shoqërinë Rozafa shpk për pasurinë “Objekte dhe truall, të Agjencisë së Rezervave Materiale të Shtetit Labinot, Elbasan”, (pjesa e mbetur);

12/04/2017

- ✓ Vendim i Qeverisë për miratimin e bonusit, që jepet shoqërisë për ndërtimin e Rrugës së Arbrit
- ✓ Vendim i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve për detajimin e programit të zhvillimit të infrastrukturës vendore Tiranë, vlera 140 milion lekë për vitin 2017;
- ✓ Vendim i Qeverisë për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik.

19/04/2017

- ✓ Vendim i Qeverisë për trajtimin shtesa mbi pagë të punonjësve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe arsimit parauniversitar

20/04/2017

- ✓ Ligj për ratifikimin e marrëveshjes për bashkëpunimin teknik për projektin “Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, nxitja e punësimit dhe arsimit profesional”.

27/04/2017

- ✓ Ligj për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, për programin e menaxhimit të mbetjeve të ngurta, masat shoqëruese (raioni Vlorë);
- ✓ Ligj për ratifikimin e ndryshimit nr. 1 të marrëveshjes së kredisë lidhur me financimin e projektit “Modernizimi i sistemit arsimor në Shqipëri nëpërmjet e-edukimit”;
- ✓ Ligj për të ndryshuar TVSH për turizmin, e cila ulet në 6% nga 20%;
- ✓ Ligj për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti, të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfitimit të pensioni.

04/05/2017

- ✓ Ligj për ratifikimin e marrëveshjes së huas, për programin e infrastrukturës bashkiake III/IV, furnizimi me ujë dhe kanalizime për Berat -Kuçovë, Delvinë, Gjirokastrë, Kamëz, Librazhd dhe Lushnjë;
- ✓ Ligj për ratifikimin e marrëveshjes, për projektin “Programi i infrastrukturës komunale III dhe IV;
- ✓ Ligj për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, për financimin e programit të infrastrukturës bashkiake III/IV, furnizimi me ujë dhe kanalizime për qytetet e Beratit, Kuçovës, Delvinës, Gjirokastrës, Kamzës, Librazhdit dhe Lushnjës.

Premtimet e fushatës nuk janë thjesht fjalë të lëshuara për të tërhequr vëmendjen e votuesit, por ato ofrojnë një mekanizëm që votuesit të zgjedhin midis palëve ofertuese në një lojë të përsëritur, çdo herë që thirren zgjedhjet.

Në këtë kuptim, premtimet e besueshme zgjidhin një problem koordinimi që lind natyrshëm në kontekst të problemeve të administrimit të shtetit dhe vendit, ku shumë drejtuesë politikë duhet të menaxhojnë premtimet që ata shprehin me atë çfarë ka bërë kundërshtari i tyre, por edhe ajo çfarë ata kanë bërë vetë apo aleatët e tyre për premtimet që japin.

Në *Tabelën 4* shohim, se në zgjedhjet politike të vitit 2017 krahasuar me vitin 2013, në totalin e tyre për të tria partitë së bashku premtimet janë në numër më të vogël. Sasia e premtimeve është 44 përqind më pak. Gjithsej nga tri partitë janë bërë 152 premtime.

Tab.4 **PREMTIMET ZGJEDHORE TE TRE PARTIVE KRYESORE NE ZGJEDHJET 2017**

Nr.	Premtimet sipas sektorëve 2017	PD	PS	LSI
1	Fiskale dhe Buxhetore	15	16	14
2	Rendi dhe siguria	2	0	0
3	Punësimi	0	1	3
4	Shëndetësia	1	5	2
5	Mbrojtja sociale	3	4	1
6	Arsimi, Gruaja dhe Rinia	7	15	2
7	Bujqësia dhe fshati	7	8	11
8	Mjedisi dhe Turizmi	2	0	5
9	Infrastruktura dhe veprat publike	1	0	1
10	Pensionet	1	2	0
11	Pasuritë natyrore dhe Energjia	0	3	2
12	Përndjekurit	1	1	0
13	Minatorët, naftëtarët	1	0	0
14	Legalizimet dhe pronat	1	1	0
15	Strehimi social	0	2	0
16	Politike	10	1	0
PREMTIME GJITHSEJ		52	59	41

Shënim. Premtimet analitike te Shtojca

PS ka një numër premtimesh sa 39% të gjithë premtimeve. LSI ka një numër premtimesh sa 27% e të gjithë premtimeve. PD ka premtuar sa 36% të gjithë premtimeve. Në krahasim me fushatën zgjedhore në 2013, PS, LSI dhe PD kanë një rënie të numrit të premtimeve.

Premtimet më të shumta në numër për të tri partitë së bashku i përkasin më shumë politikës fiskale dhe shpenzimeve buxhetore (45 premtime), sektorit të bujqësisë dhe peshkimit (26 premtime), si dhe sektorit të arsimit, gruas dhe rinisë (24 premtime). Sektorët e tjerë kanë një numër të vogël premtimesh.

Nëse e analizojmë këtë shpërndarje të premtimeve sektoriale sipas tri partive, vërejmë se:

- PD e ka bërë numrin më të madh të premtimeve për bujqësinë (7 premtime), për arsimin, rininë dhe gruan (7 premtime), si dhe për shpenzimet buxhetore dhe politikën fiskale (15 premtime). Për sektorët e tjerë, numri i premtimeve është shumë i ulët.

- PS e ka bërë numrin më të madh të premtimeve gjithashtu në të njëjtët sektorë si PD, ku për bujqësinë ka bërë (8 premtime), për shpenzimet shtesë të buxhetit dhe politikën fiskale (15 premtime), si dhe për arsimin, gruan dhe rininë (15 premtime). Për sektorët e tjerë numri i premtimeve është shumë i ulët.

- LSI e ka bërë numrin më të madh të premtimeve për bujqësinë (11 premtime), për shpenzimet e buxhetit dhe politikën fiskale (14 premtime), si dhe për mjedisin dhe turizmin (5 premtime). Për sektorët e tjerë ka bërë një numër të ulët premtimesh.

Në premtimet specifike PD adresohet për rendin publik. LSI adresohet me premtime specifike për punësimin.

PS vjen në zgjedhjet e 2017 pas një qeverisje në koalicion me LSI me premtime që janë më shumë të lidhura me vijimësinë e projekteve të investimeve në infrastrukturë, bujqësi dhe energji.

Nga krahasimi i numrit të premtimeve midis pozitës dhe opozitës shikohet se pozita ka një numër premtimesh më të vogël se numri i premtimeve të opozitës (PD dhe LSI).

Mosreferimi i premtimeve te politikat afatgjata, një realitet që duhet ndryshuar

Vlerësimi i strategjisë është i nevojshëm për të rishikuar objektivat dhe përmbushjet e tyre në vazhdimësinë e stafetës së qeverisjeve. Nga ana tjetër, një zhvillim i qëndrueshëm duke zbatuar strategjitë stimulon gjenerimin e proceseve reformuese dhe ruan historikun dhe gjurmën e produktit të secilës prej partive që kanë kontribuar.

Votuesit dhe vetë anëtarët e partive duhet të jenë vazhdimisht të azhurnuar dhe të vetëdijshëm për përparimin e bërë në arritjen e objektivave të vendit. Ndërsa faktorët kritikë të suksesit ndryshojnë është pikërisht ky motivim që i bashkon të gjithë njerëzit të përfshihen në veprime korrigjuese të nevojshme dhe në të mirë të vlerave të përbashkëta.

Nëse shikojmë Tabelën 5, secila nga partitë që analizohen ka një nivel të ulët të referimit në dokumentet kryesore strategjike sektoriale dhe ekonomike e financiare. PD në zgjedhjet e vitit 2009, kur kërkonte të vijonte qeverisjen ka një referencë të premtimeve të këto dokumente në një nivel të lartë. Megjithatë duke marrë në konsideratë që të gjithë këto dokumente janë hartuar me ekspertë të qeverisë, por edhe të asistuar nga ekspertë të huaj kjo referencë është një qasje e argumentuar. Një nivel të lartë referimi ka edhe LSI. Por edhe PS ka një nivel që tregon për vlerësimin e premtimeve bazuar te dokumentet strategjike të vendit, megjithëse është në nivele më poshtë se dy partitë e tjera.

Në zgjedhjet e vitit 2013, PD ulet në një nivel referimi të premtimeve te strategjitë më poshtë se 50% krahasuar me 2009. Kjo tendencë e premtimeve spjegohet me numrin e lartë të tyre për bujqësinë, politikën fiskale dhe turizmin, të cilat nuk janë të parashikuara qartësisht në dokumentet strategjike. Edhe PS dhe LSI kanë rënie të vogla të referimeve të premtimeve të tyre në dokumentet strategjike, për të njëjtën arsye si në rastin e PD.

Në vitin 2017, të tria partitë kanë rritje të argumentimeve të premtimeve nga referenca te dokumentet strategjike, por përsëri për arsye të euforisë dhe dëshirës për të maksimalizuar votat për partitë e tyre kanë dalë jashtë formateve që përcaktonin strategjitë.

Referenca e premtimit	PD			PS			LSI		
	2009	2013	2017	2009	2013	2017	2009	2013	2017
Te STRATEGJI/PBA	50	40	33	45	63	53	39	42	31
Në raport me premtimet gjithsej	69%	28%	39%	63%	56%	62%	75%	71%	76%

Shënim. Premtimet analitike te Shtojça

Edhe pse shikohet se ka referim të Premtimeve elektorale te Strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale, te Programet Kombëtare, te Programet Buxhetore Afatmesme, te Kuadri Makroekonomik Fiskale, si dhe te dokumente kombëtare, që kanë afat veprimi përtej mandatit të një qeverisje, gjithsesi duhet që ato të jenë të përfshira në çdo premtim që hartohet dhe shërben si pjesë e fushatës zgjedhore.

Mungesa e referencës në këto dokumente bazë si për partitë që janë në qeverisje, por edhe ato që pretendojnë të qeverisin krijon probleme për to të shikojnë efektet e kombinuara të programeve të ndryshme në proces apo të parashikuara. Kjo mangësi ka diktuar natyrshëm qasje të reja më të vështira, pasi nëse shikojmë që çdo qeverisje pothuajse zhbën politikat e kaluara dhe nis politika të reja fillimi. Votuesit nuk arrijnë të kuptojnë se cilat ndryshime rezultojnë efektive të adresohen për vijimësinë e proceseve zhvillimore të vendit.

Një qasje tjetër që ne e kemi shqyrtuar lidhur me mungesën e referencës të partive politike në të njëjtat dokumente strategjike dhe vizionare ka ndikuar dukshëm në mosarritjen e procesit të bashkëpunimit, që ndikon në ndryshime të shpeshta të vizionit të vendit për të njëjtat strategji, ndërsa mundet që të ndryshojnë vetëm përbërësit individualë të programit të vendit, të cilët mund të vlerësohen veçmas pa ndikuar në rezultatin e përgjithshëm.

Kjo lloj përvoje e mosbashkëpunimit të partive jo për arsye ideologjike, por për të promovuar protagonizmin e tyre do të ndikojë me vlerë e kundërta. Votuesve do tu vlente koordinimi i ekspertizave të partive politike, njësoj si ndodh me rastin e rishikimeve të kodit zgjedhor.

Për strategjitë më të rëndësishme të vendit nuk mund të ketë ndarje politike, por vetëm një qasje që mundet të shikojë të përveçmen partiake të e përbashkëta e dokumenteve strategjike, veçanërisht për të vlerësuar qëndrueshmërinë dhe rëndësinë e tyre. Ata mundin të përpiqen të nxjerrin konkluzione nëse kontributet u zgjidhën mirë në lidhje me situatën fillestare dhe si do të azhurnohet qasja lidhur me sfidat e reja të vendit, pavarësisht se kush nga partitë e ka radhën që të qeverisë. E gjithë kjo qasje do të japë mundësinë e një stafete midis partive dhe jo një “fillimi” të ri për çdo mandat të ri qeverisje duke ndërtuar strategjitë e reja mbi rrënojat e atyre egzistuese.

Një shembull që mund të përmendim është përfshirja e premtimeve për politikën fiskale apo dokumente themelore të financave, njësoj si ndodh me përcaktimet e politikave për tu miratuar dhe zbatuar duke u bazuar në kalendarin e dakordësuar me BE.

Duke mos parasysh në masë të madhe asnjë strategji sektoriale ndodh që politikat nuk vijnë për të ndërtuar një traditë, por mbivendosen duke krijuar konfuzion dhe çoroditje.

Paqartësitë në artikullimin e premtimeve dhe problemet me transparencën dhe konsistencën

Gjatë monitorimit të fushatave zgjedhore përgjatë vitete 2009 – 2017 vërejmë momente të tilla, që janë të përsëritura dhe që kanë tendencë të përsëriten. Për këtë arsye ne i japim një vend të caktuar në këtë analizë, me synimin që konsistenca dhe transparenca e premtimeve të jetë e qartë, me të njëjtën qëndrueshmëri dhe që të ketë transparencë nga fillimi dhe deri në momentin që fituesi merr drejtimin e qeverisë.

Kështu nisur nga fushata të ndryshme zgjedhore të PD është vërejtur:

1. Paqartësi në artikullimin rreth të ardhurave të pataknuara dhe nivelit të taksave. Në disa deklarime të muajve para fushatës thuhet nuk taksohen pagat deri 30,000 lekë, ndërsa gjatë fushatës rritet në 32,000 lekë.
2. Taksa për transferimin/shitjen e pronës në një moment është përmendur 9%, më pas premtohet tarifë fikse 0.5% të vlerës së pronës dhe në përfundim në fushatë raportohet tarifë fikse 30,000 lekë.
3. Masa e energjisë falas që mbulohet nga Buxheti për familjet në nevojë përpara fushatës deklarohet 200 kilovat ndërsa në fushatë rritet në 300 kilovat.
4. Në artikullimin publik në mënyrë të qëllimshme ose jo, në disa raste 300 kilovatët e mbuluar nga shteti për energjinë elektrike konfuzohet nëse janë për familjet në nevojë apo për gjitha familjet.
5. E njëjta paqartësi në artikullim krijohet edhe përsa i takon faturës së ujit. Nënkuptoheq që mbulohet e gjithë sasia e ujit e konsumuar apo një masë jetike e cila nuk rezulton e referuar.
6. Paketa e PS “1 miliard për rindërtimin” për aktivizimin e kapitalit privat në sektorët prioritar, ku përfshihen:
 - Ndërtimi i një spitali rajonal dhe rehabilitim 10 institucione shëndetësore
 - Ndërtimi i 53 shkollave të reja dhe rehabilitim i 88 të tjerave, 6 shkolla profesionale
 - Ndërtimi i Rrugës së Arbrit, Tiranë-Thumanë-Vorë, Kardhiq-Delvinë, Kashar-Rrogozhinë, Milot-Balldren, Oriku-Himarë.

Nuk u përmendën në mënyrë transparente gjatë fushatës së vitit 2017, por kjo vlerë u la e padetajuar duke lënë hapësira perceptimi që të përfshinte gjithë votuesit. Në fakt nuk ishte e tillë, Në momentin e përfundimit të zgjedhjeve të gjitha adresimet e investimeve të mësipërme u shpallën si një paketë në vlerën e 1 miliard US.D⁵.

Partitë janë bërë shumë të varura nga kërkimi dhe analizat e të dhënave duke identifikuar nëpërmjet këtyre qasjeve grupet e mbështetësve të partisë dhe votuesit besnikë. Duke përdorur këto informacione në formate jo konsistente, në fakt partitë rihartojnë planet për të ndërtuar një premtim që të çon në fitore dhe mbi këtë qëndrim ka pak rëndësi për ta mënyra e përcjelljes dhe përmbajtja finale e premtimit.

⁵ <https://www.zeriamerikes.com/a/3911672.html>

PJESA 3 - Matja dhe besueshmëria e premtimeve elektorale, 2009-2017

Fushata e premtimeve ndikon në pritshmërinë e votuesve, lidhur me faktin se cilat politika të reja dhe të vjetra do të prezantohen drejtuesit politikë. Kjo qasje politike e premtimeve i shndërron ato të besueshmet në një pikë referimi për votuesit duke lidhur premtimet e politikave me rizgjedhjen e ardhshme.

3.1. Premtimet e ngjashme dhe qasja e partive ndaj tyre

Ne vërejmë, se strategjitë zgjedhore të partive politike nuk janë ndërtuar thjesht për të përcjellë një koment negativ për vitet e qeverisjes së partisë kundërshtarë, por edhe për të demonstruar se është *“koha për ndryshim të vërtetë”*. Ky slogan është një nga më të përdorurit nga drejtuesit e partive kryesore, por edhe partive të vogla. Politikat kryesore të tilla, si: heqja apo ulja e taksave, prezantimi i skemave për subvencione për shtresat në nevojë, për rritjen e pensioniseve, për subvencionimin e bujqve, për forcimin e rolit të gruas, për të nxitur të rinjtë janë pikërisht temat e përcuara në vite nga partitë, duke tentuar të përcjellin idenë e ndryshimit të votuesit.

Kështu, p.sh., programi politik i PS dhe LSI në vitet 2009-2017 ka prezantuar si domosdoshmëri për të ndryshuar modelin e menaxhimit të vendit me qasje dhe mekanizma të rinj. Këto ndryshime janë kërkuar prej votuesve të kuptohen si një axhendë e re radikale për ndryshim.

Programi politik i PD për të njëjtën periudhë është prezantuar gjithashtu në të njëjtën formë dhe përmbajtje si modeli që kanë prezantuar partitë e majta. Në këtë drejtim ngjashmëria e modeleve dhe mekanizmave për të zbatuar është pjesa më pak shqetësuese për votuesit.

Por, brenda ngjashmërisë së modelit, secili grup votuesish që mbështet PD, PS apo LSI i shikon ato si të afta për të trajtuar çështje të caktuara, por jo për të njëjtat sektorë.

Në përgjithësi, premtimet rreth shëndetësisë dhe arsimit kanë sjellë më shumë përfitime për PS, LSI dhe partitë e majta. Ndërkohë, premtimet për taksimin dhe ecurinë e investimeve të qëndrueshme kanë sjellë përfitime më të shumta për PD dhe partitë e djathta.

Megjithatë edhe pse premtimet janë bërë duke patur edhe identifikim të partive politike me premtime të caktuara, nëse shikojmë faktet e buxhetit rezulton se premtimet janë larg mbajtjes së tyre prej partive.

Premtimet për politikën fiskale

Të dyja krahët e politikës, si të majtët dhe të djathtët kanë premtuar sistematikisht uljen e taksave, apo edhe heqjen e tyre për bujqësinë, peshkimin apo edhe për industrinë minerare. Ndërsa, qasja është e njëjtë dhe në mënyrë të përsëritur është premtuar ulja e taksave, mekanizmat për ta realizuar atë kanë qenë të ndryshëm. Të dy palët në ngjashmërinë e tyre kanë harruar apo nuk kanë trajtuar me përgjegjshmëri fenomenin e evazionit tatimor dhe informalitetit në ekonomi, që ka minuar vazhdimisht qasjen për të bërë ekonominë me premtime të realizueshme nëpërmjet uljes së taksave. Sipas të dhënave në Tabelën 6, pesha e premtimeve për ulje dhe shkurtime normash tatimore në raport me premtimet gjithsej të secilës parti kanë një rritje të dukshme nga PD dhe nga LSI në vitin 2017, respektivisht me 9 përqind dhe 36 përqind. PS ka një numër më të vogël premtimesh në 2017, por në dy fushatat e kaluara ka ruajtur të njëjtën balancë me partitë e tjera në premtimet që ka bërë.

Tab. 6 Premtimet buxhetore dhe fiskale, 2009-2017

Premtimet buxhetore dhe fiskale	PD			PS			LSI		
	2009	2013	2017	2009	2013	2017	2009	2013	2017
Ulje/Heqje Taksash	1%	4%	15%	4%	9%	8%	7%	10%	46%
Shtim shpenzimesh buxhetore	54%	41%	35%	21%	23%	44%	33%	34%	22%
<i>Në raport me premtimet gjithsej</i>	56%	45%	50%	25%	33%	53%	40%	44%	68%

Shënim. Premtimet analitike të Shtojcës

Premtimet për shtimin e buxhetit për sektorët


Kjo kategori premtimesh është pjesa e përbashkët për të gjitha partitë duke mos patur ndryshim në tipin e premtimit, por vetëm në mënyrën si duan ta arrijnë atë, ku në dekadën e fundit kanë përdorur edhe politizimin e diskutimit rreth mënyrës së taksimit të të ardhurave individuale.

Sipas Tabelës 6, peshë e premtimeve për shpenzime shtesë nga buxheti në raport me premtimet gjithsej të secilës parti (PD dhe LSI) ka rënie graduale nga zgjedhjet e 2009 te zgjedhjet e 2017. PS ka një kah në rritje të peshës së premtimeve për shtimin e fondeve buxhetore në 2017, por që ndikohet nga ulja e numrit specifik të premtimeve në 2017. Në krahasimin e premtimeve të ngjashme për sektorët e qeverisjes, si dhe për tema sociale shikohet se të gjithë partitë synojnë premtime që dalin përtej mundësive të buxhetit me 2-3 herë më shumë se një vit i zakonshëm fiskal duke mos marrë parasysh mundësitë e të ardhurave dhe shpenzimeve që duan kohë dhe kapacitete të prokurohen dhe të realizohen si programe buxhetore. Një spjegim më i hollësishëm jepet në pikën 3.2. më poshtë lidhur me kostot buxhetore të programeve.

Premtimet për punësimin

Në analizën e premtimeve të punësimit, nëse i referohemi studimeve të thelluara rezulton një lidhje direkte mes rritjes së PBB-së dhe rritjes së punësimit, e cila vlen në rastin e premtimeve të bëra nga partitë shqiptare. Kështu, në nivel global, sipas *Kapsos* (2005) konstatohet se për çdo 1 pikë përqindje të rritjes shtesë të PBB-së, gjatë tri periudhave midis 1991 dhe 2003 punësimi i përgjithshëm është rritur midis 0.3 dhe 0.38 pikë përqindjeje. Nisur nga parashikimet dhe fakti mbi treguesit e rritjes ekonomike të prezantuara në serinë e publikimeve të MFE, Kuadrit makroekonomik dhe fiskal, Programeve ekonomike *nuk ka patur asnjëherë mundësi reale të rritjes në periudhën 2009-2021*, që të përkojë me arritjen e nivelit të punësimit të premtuar. Nga llogaritjet tona, rritja maksimale e mundur me projeksionet e rritjes së PBB-së në Shqipëri nuk premtun për më shumë se 22.000 – 25.000 vende pune për vitet me rritje ekonomike mbi 3 - 4 përqind, pra me një rritje të pandërprerë dhe jo me luhate. Ndërkohë, kur shikojmë premtimet për punësimin nga secila parti politike ato kanë rezultuar si premtime të pamundura për tu realizuar, as në gjysmën e nivelit të premtuar nga dy partitë e mëdha.

Grafik 1



Premtimet për mbrojtjen sociale

Për mbështetjen sociale, ku përfshihen ndihmat ekonomike, përkrahja për shtresa të caktuara sociale, etj.⁶ premtimet e partive kanë përsëri ngjashmëri në secilën nga tri fushatat zgjedhore që kemi analizuar. Në të gjitha premtimet e partive ka një ofertë për kryerje shpenzimesh shtesë, në rast të fitimit të zgjedhjeve, që shkojnë nga

⁶ <http://www.portal.tlas.org.al/sq/ndihme-ekonomike>

2 deri 3 herë më shumë nga sa përfituesit kanë marrë në kohën kur është kryer premtimi (shih Tabelën 7). Ndërsa shikojmë se premtimet janë rritur me disa herë, nga të dhënat që analizojmë për rritjen reale të ndihmës ekonomike ajo nuk është më shumë se 50% e vlerës së premtuar nga secila parti, duke përfshirë në këtë llogaritje premtimet që nga viti 2009.

Tab.7 Shpenzimet për mbështetje sociale, 2009 -2020

mld. Lekë

Nr.	Shpenzime për mbështetje sociale	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
1	Pagesa e Papunësisë	868	982	876	984	800	912	615	691	346	336	505	888
2	Ndihma ekonomike	16,061	16,706	16,369	18,011	19,370	22,849	17,662	20,026	20,714	20,671	20,189	23,996
3	Kompensimi ish-përndjekurve	2,200	1,000	1,500	1,699	2,991	1,759	1,967	1,979	2,298	997	1,199	1,000
4	Bonusi lindjeve/Kompensim pasurie			1,600								2,364	2,820
GJITHSEJ		19,129	18,688	20,345	20,694	23,161	25,520	20,244	22,696	23,358	22,004	24,257	28,704


Burimi: MFE

Premtimet për pensionet

Premtimet për rritjen e pensioneve kanë një tjetër ngjashmëri në qasje të fushatave të partive politike. Të gjitha partitë kanë bërë premtime në tendenca të ndryshme, por që gjithnjë kanë demonstruar vullnetin për rritjen e pensioneve. Nëse analizojmë faktin e rritjes së pensioneve nga viti bazë i analizës 2009 dhe deri më sot (ashtu si tregohet te Grafiku 2), premtimet për një rritje pensionesh dy -tri herë në raport me vitin bazë të ballafaquara me rritjen faktike të tyre deri në vitin 2020 nuk tregojnë më shumë se 36 përqind rritje.

Grafik 2

Masa mesatare e pensioneve në qytet dhe fshat, 2009-2019



Duke mos pretenduar që të kemi shtuar gjithë listën e argumentave të ngjashme, ne shikojmë se premtimet e dhëna nuk janë mbajtur për këto segmente përfituesish, që lidhen me kategori mjaft të ndjeshme votuesish. Realizimi i premtimeve sipas tendencës së performancës së përmbushjes së tyre për periudhën 10 vjeçare mund të arrihet për të paktën prej 15-17 vitesh me vonesë.

Nisur nga llogaritjet, mendojmë se ka pak vend për premtime shtesë, duke qenë se llogaritjet fiskale nuk shikojnë hapësirë për shpenzime të shtuara të buxhetit, nisur nga koha që jetojmë dhe ndikimet që ka buxheti nga katastrofa natyrore e vitit 2019, si dhe kriza globale shëndetësore e vitit 2020 dhe që vijon edhe në vitin 2021.

3.2. Premtimet me natyrë buxhetore dhe kostot e tyre

Premtimet zgjedhore kanë patur tipar të tyre me rëndësi për strategjitë elektorale të partive politike koston buxhetore për secilin vit që janë zhvilluar zgjedhjet që ne kemi analizuar (2009, 2013 dhe 2017).

Nëse e shikojmë këtë rëndësi nga ana e sasisë së premtimeve shikojmë se premtimet për shtim shpenzimesh buxhetore kanë një rënie për secilën nga partitë kryesore (shih Tab.8). Ndërkaq, premtimet për politikën fiskale (ulje/heqje taksash) kanë një rritje të tyre nga njera-fushatë në tjetrën.

Nisur nga ky fakt që flet për peshën e këtyre premtimeve në raport me totalin e premtimeve të bëra, natyrisht që analiza pas pjesës sasiore duhet të orientohet te pjesa cilësore, që lidhet me efektin që duhet të mbarten nga buxheti për secilin premtim të dhënë.

Në llogaritjen që kemi bërë për kostot buxhetore të premtimeve sipas sektorëve ku ato janë adresuar janë marrë në konsideratë llogaritjet bazuar mbi efektet pozitive⁷, për rastet e ndikimeve të tilla në ekonomi dhe sistemin fiskal, si dhe efektet negative që nuk përfshijnë brenda tyre pjesën e buxhetit që është i zbatueshëm përpara premtimit (pra, efekte neto financiare dhe fiskale të premtimeve).

Llogaritjet e kryera janë bërë bazuar mbi premtimet, pa u ndikuar nga argumenti i pabesueshmërisë së tyre dhe sqarimeve që jepen në tabelat më poshtë. Kjo llogaritje e bërë mbi bazë premtimesh, vlen për të sqaruar lexuesin se sa mundet të shkojë një kosto e caktuar, nëse hipotetiko gjithë premtimet që janë dhënë do të ishin të mundshme për tu realizuar.

Tab.8 **KOSTOT FISKALE E BUXHETORE TE PREMTIMEVE ELEKTORALE, 2009, 2013 DHE 2017** *mlld. Lekë*

Nr.	Efekti te Buxheti i Shtetit	PD			PS			LSI		
		2009	2013	2017	2009	2013	2017	2009	2013	2017
1	Të hyra në buxhet	10	11	11	9	19	22.5	9	11	8.5
2	Shpenzime në buxhet	-123.4	-126	-147	-47.5	-131.5	-98	-66.2	-141.1	-138
REZULTATI/EFEKTI NË BUXHI		-113.4	-115	-136	-38.5	-112.5	-75.5	-57.2	-130.1	-129.5

Shënim. Tabelat analitike të kostove janë te Shtojca

Në llogaritjet që pasqyrohen në Tabelën 8, si përmbledhje e tabelave analitike te Shtojca, shikohet se:

- PD ka një nivel premtimesh në vlerë, lidhur me shtimin e shpenzimeve buxhetore më shumë se partitë e tjera në vitet 2009 dhe 2017, por po ashtu edhe në efektin e të ardhurave fiskale në vitin 2009 dhe 2013. Rritja e të ardhurave më të mëdha në 2013 vjen nga efekti i premtimit të rritjes së pagës dhe të punësuarve. Peshën më të madhe të efekteve të shtimit të shpenzimeve në 2009 e mbajnë premtimet për infrastrukturën, për bujqësinë dhe për arsimin. Në vitin 2013, këtë peshë e mbajnë premtimet për pensionet, për bujqësinë dhe infrastrukturën. Në vitin 2017, peshën më të madhe të shtimit të shpenzimeve për buxhetin e mbajnë premtimet e dhëna për heqjen/uljen e taksave, arsimi, ulja e kontributit të sigurimeve dhe pensionet.

- PS ka një shtim në vlerë të dallueshme në të ardhurat fiskale në vitin 2013 dhe 2017 dhe kjo vjen si pasojë e premtimit për punësim në sasi shumë të mëdha, si dhe efektet e investimeve në vitin 2017 me paketën 1 miliard. Peshën më të madhe të efekteve të shtimit të shpenzimeve e mbajnë premtimet për infrastrukturën, për bujqësinë dhe për arsimin. Peshën më të madhe të efekteve të shtimit të shpenzimeve në 2009 e mbajnë premtimet për infrastrukturën, për shëndetësinë dhe për arsimin. Në vitin 2013, peshën më të madhe e mbajnë premtimet për infrastrukturën rrugore dhe ndërtimore turistike, për bujqësinë, për energjinë, ujësjellës-

⁷ premtimi për punësimin mundëson një llogaritje pozitive të ndikimit të shtimit të kontributeve të sigurimeve, por edhe të TVSH-së nisur nga efekti i shtuar nga pagat e të punësuarve rishtazi në konsumin e përgjithshëm. Nga ana tjetër, premtimet për rritje pensionesh lidhen me pjesën e kontributit të buxhetit për të mbuluar fondin e plotë të pensioneve. Premtimet e tjera janë llogaritur me efektet që rrjedhin nga aplikimi i kostove sipas qasjeve teknike, publikimeve statistikore, raporteve institucionale, por edhe llogaritje nga studime dhe ekspertët e partive politike.

kanalizime dhe shëndetësinë. Në vitin 2017 peshën më të madhe të shtimit të shpenzimeve për buxhetin e mbajnë premtimet e dhëna për bujqësinë, infrastrukturën rrugore, arsimin.

- LSI ka një efekt të shtimit të shpenzimeve në buxhet duke filluar nga viti 2013 dhe në vijim në vitin 2017. Shtimi i shpenzimeve buxhetore nga premtimet në vitin 2013, rëndohet nga premtimet për infrastrukturën rrugore, për arsimin, për shëndetësinë dhe për bujqësinë. Në vitin 2017, shtimi i shpenzimeve buxhetore vjen nga premtimet për shëndetësinë, arsimin, bujqësinë dhe mbrojtjen sociale.

Në premtimet e vitit 2009 llogaritet si një hyrje shitesë në të ardhurat efekti nga premtimet për investimet e huaja dhe zhvillimin ekonomik. Efekte pozitive në buxhet nga punësimi janë të një niveli më të vogël se dy partitë e mëdha.

3.3. Premtimet dhe konsistenca e tyre gjatë fushatave elektorale

Duke analizuar fushatat zgjedhore të epruidhës 2009-2017 vërehet se edhe vetë kandidatët janë thjesht me qasje ideologjike dhe jo ekonomike gjatë përcjelljes së premtimeve të partisë politike, apo ato që ata zotohen direkt vetë. Në ditën kur kandidatët do të jenë fitues të zgjedhjeve, ata nuk kanë përfitim direkt nga gjithë premtimet që u jepen votuesve gjatë fushatës zgjedhore. Në këtë mjedis politik, çdo kandidat zgjedh politikën alternative që ai preferon më shumë, pavarësisht nga çdo premtim fushate që mund të jetë bërë. Por, nisur nga fakti i premtimeve të zgjedhjeve të kaluara që kanë synuar të ndryshojnë besimin e votuesve në një mënyrë të tillë, që të rritë probabilitetin e kandidatëve për tu zgjedhur, atëherë ne shikojmë dukshëm që kandidatët kanë bërë premtime të tilla pavarësisht se çfarë kanë patur ndërmend të bënë kur të zgjidheshin. Fakte të tilla janë koalicionet zgjedhore, ku kandidatët e koalicionit kanë bërë premtime të atilla që kanë synuar maksimalizimin e besueshmërisë së votuesve, por që kur kanë bërë pjesë në qeverisje nuk kanë përfshirë pjesë të programit qeverisës ato premtime që kanë bërë.

Tab. 9 **Konsistenca ndaj premtimeve 2009-2017**

numër

Nr	Tipi i premtimeve	PD			PS			LSI		
		2009	2013	2017	2009	2013	2017	2009	2013	2017
1	Fiskale dhe buxhetore	6	8	15	20	12	16	5	10	14
2	Sociale	3	3	4	15	12	7	13	9	2
3	Shëndetësore	3	0	1	15	6	5	8	9	2
4	Edukimi dhe gruaja	13	3	7	16	9	15	18	10	2
5	Infrastruktura dhe energjia	22	23	2	7	24	3	7	22	3
6	Bujqësia dhe Turizmi	13	14	9	33	24	8	12	14	15
7	Punësimi	2	5	0	3	1	1	4	5	3
8	Siguria/fasonet/ushataraket/minoret	1	3	2	3	10	1	8	1	0
9	Politike	9	12	12	30	15	3	9	6	0
PREMTIME GJITHSEJ		72	71	52	142	113	59	84	86	41

Shënim. Premtimet analitike të Shtojcës

Në analizën e konsistencës ndaj premtimeve sipas sektorëve të partive politike, sipas Tabelës 9 kemi vërejtur një këmbëngulje më të fortë për premtime për grupet e votuesve, që lidhen me qasjet ideologjike të partive, por që edhe këto premtime kanë devijime përgjatë fushatave duke u ndikuar nga rrethanat sociale.

Për pjesën sociale edhe pse ka një numër më të lartë premtimesh nga PS, shikohet se ato kanë ardhur në rënie përgjatë harkut kohor të zgjedhjeve 2009-2017. E njëjta situatë e premtimeve shikohet edhe për sektorin shëndetësor, si dhe për bujqësinë e turizmin. Ndërsa, premtimet për infrastrukturën kanë luhajtje të madhe, që lidhen më së shumti me politika që përkrijnë me strategjinë për të qenë pranë votuesve me sa më shumë premtime elektorale në momente, kur ato sipas sondazheve partiake vlejnë më shumë. Por, sidomos edhe si efekt qeverisje premtimet e infrastrukturës ndeshen më shumë në partitë që kërkojnë mandat të dytë.

Një luhajtje e tillë dhe mungesë konsistence në premtime vërehet edhe për PD, që përveç premtimeve fiskale dhe buxhetore që vijnë në rritje, për pjesën tjetër të premtimeve nuk shikohet të ruhet qëndrueshmëria.

Natyrshëm, që premtimet lidhen edhe me pjesën e tyre të përmbushjes dhe në rast të kundërt nuk mund të bëhen përsëri. Nisur nga fakti, se mbi gjysma e premtimeve i përkasin atyre që lidhen me buxhetin, shikohet se hapësira për premtime të natyrës ligjore dhe ndryshime që përkojnë me reforma rregullatore kanë një pjesë më të vogël, për vetë natyrën e tyre komplekse për tu përfshirë në premtime të tilla, që vlejné pak për tu perceptuar pozitivisht nga votuesit.

Tab. 10 Tipi i premtimeve 2009-2017

numër

Nr	Tipi i premtimeve	PD			PS			LSI		
		2009	2013	2017	2009	2013	2017	2009	2013	2017
1	I përsëritur	6	9	9	5	9	6	3	8	6
2	Shkurtim shpenzimesh	0	0	0	0	0	0	0	0	0
3	Shkurtim taksash	1	3	8	6	10	5	6	9	19
4	Shtim taksash	0	0	0	0	1	0	0	0	0
5	Shtim shpenzimesh	39	29	18	30	26	26	28	29	9
6	Të tjera	26	30	17	101	67	22	47	40	7
PREMTIME GJITHSEJ		72	71	52	142	113	59	84	86	41

Shënim. Premtimet analitike të Shtojca

Fakte interesante dhe të veçanta lidhur me strukturën e premtimeve nga njera zgjedhje në tjetrën i shikojmë më qartë, kur analizojmë të dhënat në Tabelën 10.


PD ka një përsëritje konstante të premtimeve buxhetore dhe fiskale dhe me një tendencë në rritje të përqindjes së përsëritjes (nga 8% në 2009 në 17% në 2017). PS ka një përsëritje të premtimeve nga niveli 4% në 2009 në 10% në 2017. LSI ka një cikël të ngjashëm të premtimeve të përsëritura buxhetore dhe fiskale, ku në 2009 ka përsëritur vetëm 4% të premtimeve, ndërsa në 2017 ka përsëritur 15% të premtimeve të mëparshme.

Në rastet e përsëritjeve të premtimeve ato shkojnë në funksion të shtimit të buxheteve për sektorët e bujqësisë, arsimit, si dhe të shëndetësisë.

Një fakt interesant është se asnjë rast partitë politike nuk kanë bërë premtime për shkurtim shpenzimesh buxhetore apo shtim të taksave.

Grafik 3

Premtimet e partive për taksat dhe buxhetin (numër)



Ndërkohë, nëse shikojmë te Grafik 3, premtimet për shkurtim taksash, PD ka një rritje të numrit të premtimeve nga 2009 në 2017 dhe një rënie të premtimeve për shpenzime shtesë buxhetore për sektorët dhe temat e ndjeshme sociale.

PS ka një rritje të numrit të premtimeve në 2013 dhe ulje të tyre në 2017, madje poshtë nivelit të premtimeve të 2009. Për premtimet për shpenzime buxhetore shtesë shikohet se ka një rritje në 2009 dhe një rënie të tyre në 2013 dhe kjo parti mban afërsisht të njëjtin nivel premtimesh edhe në 2017.

LSI ka një rritje të ndjeshme të sasisë së premtimeve në 2013 dhe në 2017, në dallim nga dy partitë e mëdha. Për shpenzimet buxhetore shtesë shikohet se ka një rritje në 2009 dhe në 2013, por një rënie të tyre të mprehtë në 2017.

Është interesante të shohim se si historia e zgjedhjeve ka tendencë të përsëritet lidhur me premtimet që zotohen të kryejnë kandidatët e partive politike. Nga analiza e premtimeve fiskale, është e dukshme që dy partitë e mëdha kanë një sinkronizim të premtimeve të politikave fiskale dhe ato buxhetore, ndërsa LSI ka një tendencë të ndryshme për këto premtime.

Kandidatët për kryeministër në zgjedhjet politike nuk e kanë thënë në ndonjë rast, se në vend të premtimit për ulje taksash, ata do të duhet ti rritin ato, që të përballohen shpenzimet për të siguruar një politikë të uljes së borxhit publik dhe kryerja e zotimeve/angazhimeve të tjera. Fatkeqësisht, ajo që premtojnë kandidatët për kryeministra krahasuar me ato që janë në gjendje të bëjnë kanë kundërshti mes tyre, veçanërisht kur kandidatëve për kryeministra u ka ndodhur të përballen gjatë qeverisjeve me probleme të paparashikuara politike, ekonomike, industriale apo fatkeqësi natyrore apo shëndetësore sapo kanë ardhur në detyrë apo gjatë qeverisjes.

A e kanë ndjekur ideologjinë e tyre politike partitë me premtimet e dhëna?

Politikanët e djathtë, bazuar në mendimin e përgjithshëm mbi orientimet politike duhet të mos shohin grupe dhe klasa shoqërore, pasi politika e djathtë zakonisht suksesin e bazon te përpjekjet individuale, duke anashkaluar mbështetjen sociale.

Nga ana tjetër, politikanët e majtë që kanë qasje të përgjithshme barazinë dhe një qeverisje aktive priren të përqendrohen në kategori sociale dhe nevojat e grupeve të ndryshme në nevojë.

Në dhënien e premtimeve të partive të majta (PS dhe LSI) shikohet dukshëm se brenda qasjeve të politikës sociale dhe sektorëve të shëndetësisë, bujqësisë dhe edukimit ka një prirje të lidhur me orientimin e premtimeve për qeverisjen e vendit drejt barazisë sociale, por me qasje të motivuar nga liritë individuale, të cilat shihen të mënyra se si kërkohet që të shpërndahet barra fiskale nëpërmjet parimit të progresivitetit.

Ndërsa partia kryesore e krahut të djathtë (PD), e cila ka qeverisur vendin nga viti 2005 deri në 2013 ka premtuar në zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2013 nisur nga një filozofi që për nga trajtimi fiskal është qasje konservatore duke premtuar vijimësinë e taksimit të sheshtë (me një shkallë tatimore). Nga ana tjetër, nisur nga nevoja elektorale të momentit, prirja e politikës është orientuar në një pjesë të konsiderueshme me premtime (58% e premtimeve) të adresuara drejt shpenzimeve infrastrukturore, bujqësisë dhe arsimit.

Arsye e qenësishme është realiteti social, ku votuesit i kushtojnë vëmendje politikës, por jo ekonomisë.

Natyra e konkurrencës partiake formon shkallën në të cilën pikëpamjet e votuesve përshtaten me dimensionin majtas-djathtas. Kështu, nga premtimet e analizuara shikohet se për premtimet për bashkëpunimin me Kosovën, për integrimin në BE, ku partitë politike kanë qasje të njëjta nuk ka rëndësi për votuesin dimensionin i krahut politik.

Nëse liderët politikë dhe partitë që ata drejtojnë nuk kanë konflikte mes njëri-tjetrit, votuesit me gjasa nuk do ti perceptojnë ato premtime politike në të majta apo të djathta.

3.4. Vlerësimi i premtimeve dhe matja e tyre

Premtimet e fushatës ofrojnë një mekanizëm për votuesit që të zgjedhin midis ofertave të shumta të partive që garojnë në një lojë të përsëritur. Në këtë kuptim, premtimet e besueshme zgjidhin një problem koordinimi që lind natyrshëm në kontekstin e problemeve të krijuara nga qeverisjet, ku shumë drejtues të institucioneve duhet të konvergojnë në një model të përbashkët për të kontrolluar në mënyrë efektive zbatimin e premtimeve të shndërruara në program nga zyrtarët e zgjedhur të partisë/koalicionit që ka fituar të drejtën e qeverisjes.

Fushata e premtimeve ndikon në pritshmërinë e votuesve për faktin se cilat politika do të zgjidhen për zbatim nga zyrtarët e lartë, që janë identifikuar me premtimin sektorial në fushatën zgjedhore. Natyrisht, që këta politikanë kryesorë të partisë të përzgjedhur për të përzgjedhur premtimet ofrojnë një pikë referimi për votuesit për të lidhur vendimet e politikave me rizgjedhjen e ardhshme. Në mungesë të një lidhje të tillë publike është e vështirë të perceptohet nga votuesit se si ata mundet të pranojnë një performancë të mirë bazuar mbi premtimin e një zyrtari politik, që me gjasa do të jetë drejtuesi i një linje ministrore në qeverisjen e ardhme.

Premtimet e besueshme dhe premtimet e tjera, 2009

Ne jemi fokusuar në drejtim të fushatave politike, për të arritur vlerësimet duke analizuar referencat nga ku kalon procesi, në radhë të parë për premtimet e besueshme (premtime që janë të matshme dhe i referohen një dokumenti që tejkalon një periudhë qeverisje, si p.sh. strategjitë, apo programet ekonomike dhe fiskale, programi buxhetor afatmesëm⁸, kuadri makroekonomik dhe fiskal, Programi Kombëtar për Integrim European). Vlerësimi i besueshmërisë së premtimeve janë në fokus të studimit, pasi përdorin një version të përsëritur të modelit politik, ku kandidatët kanë shfaqur premtime të politikave që ndryshojnë me kalimin e kohës.

Tab.11 VLERËSIMI I PREMTIMEVE ZGJEDHORE TË TRE PARTIVE KRYESORE NË ZGJEDHJET 2009

numër

Nr.	Premtimet sipas sektorëve 2009	PD			PS			LSI		
		Besueshme	Pjesërisht të besueshme	Pamatshme	Besueshme	Pjesërisht të besueshme	Pamatshme	Besueshme	Pjesërisht të besueshme	Pamatshme
1	Fiskale dhe Buxhetore	1	5		7	9	4		4	1
2	Shëndetësia	1	2		4	6	5	2	5	1
3	Mbrojtja sociale dhe pensionet		2	1		8	7	2	8	3
4	Punësimi		2			3		1	1	2
5	Arsimi, Gruaja dhe Rinia	2	7	4	1	13	2	5	9	4
6	Bujqësia dhe fshati	1	9	3	4	13	5	2	6	4
7	Mjedis dhe Turizmi					5	6			
8	Infrastruktura dhe veprat publike	3	10	3	1	1			4	2
9	Energjia		1	5					1	
10	Fasonët								2	2
11	Minatorët, naftëtarët, ushtarakët		1		2	5			4	
12	Emigrantët				4	2	1		1	1
13	Legalizimet dhe pronat			2	3	2	1		3	1
14	Integrimi		1		1	1	1	1		
15	Politike		1		2	3	2			1
16	Të përgjithshme		3	2	5	1	2			1
PREMTIME GJITHSEJ		8	44	20	34	72	36	13	48	23

Shënim. Premtimet analitike të Shtojca

⁸ Programi buxhetor afatmesëm (PBA) është parashtrimi për tre vite i planeve të shpenzimeve të buxhetit, përmes lidhjes së drejtpërdrejtë të programeve me veprimtaritë, produktet, objektivat dhe qëllimet e politikës. PBA siguron që alokimet vjetore të buxhetit të reflektojnë prioritetet politike gjatë një periudhe afatmesme (3-vjeçare) duke bërë një lidhje të drejtpërdrejtë midis alokimit të buxhetit dhe objektivave të politikës së programi. PBA-ja shërben si urë lidhëse ndërmjet planit strategjik të zhvillimit dhe projekt-buxheti vjetor, ku viti i parë i PBA-së shërben si projekt-buxheti vjetor.

Nga vlerësimi i premtimeve zgjedhore, ashtu si shihet te Tabela 11, *gjetja kryesore e zgjedhjeve të vitit 2009* është se partitë që janë pjesë e koalicionit qeverisës 2005-2009 (PD dhe aleatët e djathtë) kanë nivel besueshmërie me një shumicë të qartë të premtimeve të besueshme dhe atyre që janë të besueshme pjesërisht në nivelin 72 përqind.

LSI, e cila garoi e vetme në zgjedhjet e vitit 2009 ka një besueshmëri të premtimeve të besueshme dhe pjesërisht të besueshme 72 përqind.

PS, e cila gjithashtu garoi në koalicion me parti të tjera të majta ka një nivel besueshmërie të premtimeve të besueshme dhe pjesërisht të besueshme te 75 përqind.

Sipas *Tabelës 11*, në tërësinë e gjithë premtimeve elektorale të vitit 2009⁹, nga vlerësimet e kryera, niveli i besueshmërisë për premtimet e besueshme dhe pjesërisht të besueshme arrin në 73 përqind, ku:

- 18 përqind e tyre janë të besueshme (55 premtime);
- 55 përqind e tyre janë pjesërisht të besueshme (164 premtime);
- 27 përqind e tyre janë të pamatshme (79 premtime).

Nëse e shikojmë përhapjen e premtimeve të besueshme dhe të matshme sipas partive kryesore:

- PD rezulton se nga gjithë premtimet e bëra nga kjo forcë politike vetëm 11 përqind e premtimeve vlerësohen si të besueshme (8 premtime),
- PS rezulton me 24 përqind premtime të besueshme (34 premtime) dhe
- LSI rezulton me 15 përqind premtime të besueshme (13 premtime).

Një arsye kryesore e shpërndarjes në këto nivele të ndryshme vjen nga fakti i sasisë së premtimeve, ku PS ka premtuar sa 48 përqind e premtimeve gjithsej të fushatës, LSI ka premtuar sa 28 përqind e premtimeve gjithsej të fushatës, ndërsa PD ka premtuar sa 21 përqind e premtimeve gjithsej të fushatës.

Një arsye tjetër është e lidhur me sasinë e premtimeve sipas sektorëve, ku është adresuar premtimi i secilës parti. Në sektorët ku ka me shumicë premtime ka një numër më të ulët të besueshmërisë së tyre.

PD ka më shumë premtime të besueshme për infrastrukturën dhe veprat publike, si dhe ndërkohë më pak të besueshme për bujqësinë, për infrastrukturën dhe për arsimin, gruan dhe rininë.

PS ka premtime të besueshme më shumë në sektorë të tillë si: buxheti dhe politika fiskale, bujqësia dhe fshati, të natyrës së reformimit dhe të përgjithshme, si dhe shëndetësinë.

LSI ka premtime të besueshme më shumë në sektorin e arsimit, gruas dhe rinisë, si dhe në bujqësi, shëndetësi dhe mbrojtjen sociale.

Premtimet e matshme, por pjesërisht të besueshme janë pjesa më dominuese për secilën nga partitë kryesore garuese në zgjedhjet e vitit 2009.

Nga totali i premtimeve të bëra nga PD rezulton, se 61 përqind e tyre i përkasin kategorisë që konsiderohen si pjesërisht të besueshme. Niveli më i lartë i premtimeve pjesërisht të besueshme është te sektori i bujqësisë dhe fshatit, infrastrukturës dhe veprave publike, buxhetore dhe fiskale, si dhe tek sektori i arsimit, gruas dhe rinisë.

Nga totali i premtimeve të bëra nga PS rezulton, se një nivel prej 51 përqind e numrit të tyre janë pjesërisht të besueshme. Sasia më e madhe e premtimeve pjesërisht të besueshme janë për sektorin e bujqësisë dhe fshatit, sektori i arsimit, gruas dhe rinisë, për shtesat e buxhetit dhe politikat fiskale, për mbrojtjen sociale dhe pensionet.

Nga totali i premtimeve të bëra nga LSI rezulton, se një nivel prej 57 përqind i tyre janë pjesërisht të besueshme. Numri më i madh i premtimeve pjesërisht të besueshme shikohen te sektori i arsimit, gruas dhe rinisë, te sektori i mbrojtjes sociale dhe pensioneve, te sektori i bujqësisë dhe fshatit si dhe te sektori i shëndetësisë.

⁹ cdo premtim i detajuar mund të shihet te SHTOJCA.

Premtimet e pamatshme zënë një peshë totale nga premtimet e partive kryesore që shkon te niveli 27 përqind. Këto premtime nuk ishte e mundur të mateshin në asnjë rast, pasi informacioni në shumicën e premtimeve është i pamjaftueshëm për të gjykuar premtimin, edhe pse premtimi është specifik dhe është i përcaktuar si i tillë. Niveli i premtimeve të pamatshme është për të tria partitë kryesore në nivele të afërta me njera-tjetrën.

Fushatat elektorale me qasjen e re të teknologjisë së informacionit

Liderët gjithmonë duhet të mbajnë një ekuilibër midis premtimeve që hartohen duke patur pak përvojë dhe më shumë huazime të politikave të mira dhe premtimeve, që vijnë nga përvoja e një qeverisje të mëparshme duke u pastruar nga ato që nuk duhen dhe në reflektim të të tashmes me të ardhmen e politikave që përçojnë premtimet. Por gjërat duken se nuk janë më interesante në zgjedhjet e viteve të fundit. Fushata e përhershme që tashmë nuk ka pushim gjatë gjithë vitit dhe gjithë kohës nga zgjedhja në zgjedhje inkurajon premtime afatshkurtra dhe jo thelbësore duke e vënë fokusin në kapjen e menjëhershme të titujve kryesorë të mediave.

Informacioni dhe lajmet nga media dhe rrjetet sociale, të cilat nuk bëjnë pushim asnjëherë gjatë ditës mundëson dhe nxit fushatën me premtime të pandërprera, duke kaluar në gjendje lodhje votuesit. Liderët politikë tashmë të nxitur nga kjo rrjedhë e pandërprerë e informacionit janë gjatë gjithë kohës të ngacmuar që të mos lënë hapësira për kundërshtarë, pasi e konsiderojnë si një disavantazh politik. Por, votuesit duke i parë kaq shpesh dhe duke dëgjuar deklarata dhe premtime politike jo të besueshme janë duke u larguar dhe ndihen të painteresuar në krahasim me më përpara për procesin politik dhe sasinë e premtimeve.

Premtimet e besueshme dhe premtimet e tjera, 2013

Problemi me besueshmërinë e premtimeve është vështirësia në argumentimin e deklaratave në fushatë, të cilat në momentin e parë janë një veprim i thjeshtë, por që mbartin mbi vete efekte të mëvonshme financiare apo ligjore. Nisur nga qasja se “ të folurit nuk kushton” shikohet se premtimet e bëra gjatë zgjedhjeve të vitit 2013 kanë vijuar të konsiderohen thjesht angazhime përpara votuesve për të kryer një politikë të veçantë, por që në një moment të dytë rezulton se ato janë edhe zotim, që nuk mund të mbetet vetëm te fjala e dhënë.

Premtimet e fushatës mund të bëhen të kushtueshme në lojën e përsëritur të zgjedhjeve, sepse votuesit mund të kushtëzojnë zgjedhjen e tyre për partitë bazuar mbi këto premtime.

Tab.12 VLERËSIMI I PREMTIMEVE ZGJEDHORE TË TRE PARTIVE KRYESORE NË ZGJEDHJET 2013

numër

Nr.	Premtimet sipas sektorëve 2013	PD			PS			LSI		
		Besueshme	Pjesërisht të besueshme	Pamatshme	Besueshme	Pjesërisht të besueshme	Pamatshme	Besueshme	Pjesërisht të besueshme	Pamatshme
1	Fiskale dhe Buxhetore	1	5	2	1	10	1	4	6	
2	Rendi Publik				1	2				
3	Shëndetësia				2	1	3	4	1	4
4	Mbrojtja sociale		3			5	3	2	2	2
5	Punësimi		5			1			5	
6	Arsimi, Gruaja dhe Rinia	1	1	1	2	6	1	1	8	1
7	Bujqësia dhe peshkimi	1	6	3	3	11			7	2
8	Mjedisi dhe Turizmi		1	3		6	4	2	3	
9	Infrastruktura dhe industria	5	11	3	5	3	1	2	5	5
10	Energjia dhe pasuritë nëntokësore		3	1	5	4	6	2	2	6
11	Pensionet, ushtarakët, fasonët		6	1		6	2		1	
12	Strehimi social					2				4
13	Përndjekurit		1			3				
14	Legalizimet dhe pronat			2	4	1	1			
15	Integrimi			1			1		1	
16	Politike		1	2	1	4				
17	Emigrantët			1			1		2	2
PREMTIME GJITHSEJ		8	43	20	24	65	24	17	43	26

Shënim. Premtimet analitike te Shtojca

Gjetja kryesore e zgjedhjeve të vitit 2013 është se partitë që ishin pjesë e koalicionit qeverisës 2009-2013 (PD dhe LSI), ku edhe pse LSI në këto zgjedhje garon si koalicion parazgjedhor me PS kanë një nivel të premtimeve të besueshme dhe atyre që janë të besueshme pjesërisht të 72 përqind për PD dhe 70 përqind për LSI.

PS garoi në këto zgjedhje si një parti opozitare, por me një marrëveshje parazgjedhore me LSI duke siguruar një nivel besueshmërie të plotë dhe të pjesshme prej 79 përqind nga premtimet e saj.

Në kontekstin e analizës sonë, sipas *Tabelës 12*, në të cilën janë përmbledhur premtimet e dhëna në 2013¹⁰, nga vlerësimet e kryera, niveli i besueshmërisë për premtimet e besueshme dhe pjesërisht të besueshme arrin në 74 përqind (1 përqind më i lartë se në zgjedhjet e vitit 2009), ku:

- të besueshme janë 18 përqind e tyre (49 premtime);
- pjesërisht të besueshme janë 56 përqind e tyre (151 premtime);
- të pamatshme janë 26 përqind e tyre (70 premtime).

Në analizën e vlerësimit të premtimeve për secilën prej partive kryesore politike, rezultojnë se:

- nga premtimet e bëra nga PD përsëri edhe në 2013 vetëm 11 përqind premtime vlerësohen si të besueshme (8 premtime),
- nga premtimet e bëra nga PS vetëm 21 përqind janë premtime të besueshme (24 premtime), me një pakësim prej 3 përqind nga zgjedhjet e kaluara, si dhe
- nga premtimet e bëra nga LSI vetëm 20 përqind janë premtime të besueshme (17 premtime), me një rritje prej 5 përqind nga zgjedhjet e kaluara.

Një arsye kryesore edhe për këto zgjedhje është e lidhur me sasinë e premtimeve sipas sektorëve, ku është adresuar premtimi i secilës parti. Në sektorët ku bëhen premtime me shumicë vërehen ndërkohë një numër më i ulët i premtimeve të besueshme.

PD ka më shumë premtime të besueshme për infrastrukturën dhe industrinë. Ndërkohë, premtimet më pak të besueshme (pjesërisht) janë për bujqësinë, për pensionet dhe për trajtimin e minatorëve dhe ushtarakëve.

PS ka premtime të besueshme më shumë në sektorë të tillë si: infrastruktura dhe industria, bujqësia, buxheti dhe politika fiskale, si dhe shëndetësia. Më pak të besueshme janë te bujqësia dhe alokimet buxhetore.

LSI ka premtime të besueshme më shumë në sektorin e arsimit, gruas dhe rinisë, si dhe në bujqësi, shëndetësi dhe mbrojtjen sociale. Besueshmëria më e pakët është për premtimet për arsimin, bujqësinë dhe politikat fiskale

Edhe në analizën e premtimeve të zgjedhjeve të vitit 2013, premtimet e matshme, por pjesërisht të besueshme janë pjesa më dominuese për secilën nga partitë kryesore, me një rritje të lehtë prej 1 përqind në krahasim me zgjedhjet në 2009.

Nga totali i premtimeve të bëra nga PD rezultojnë se:

- 61 përqind të tyre i përkasin kategorisë që konsiderohen si pjesërisht të besueshme. Niveli më i lartë i premtimeve pjesërisht të besueshme është te sektori i infrastrukturës dhe industrisë, sektori i bujqësisë dhe peshkimit, si dhe te seksioni mbrojtjes sociale.

Nga totali i premtimeve të bëra nga PS rezultojnë se:

- një nivel prej 58 përqind e numrit të tyre janë pjesërisht të besueshme. Sasia më e madhe e premtimeve pjesërisht të besueshme janë te sektori i bujqësisë dhe peshkimit, te buxheti dhe politika fiskale, si dhe një nivel premtimesh pjesërisht të besueshme në të gjithë sektorët e tjerë në nivele të afërta me një-tjetrin.

¹⁰ cdo premtim i detajuar mund të shihet te SHTOJCA.

Nga totali i premtimeve të bëra nga LSI rezulton, se:

- një nivel prej 50 përqind e numrit të tyre janë pjesërisht të besueshme. Numri më i madh i premtimeve pjesërisht të besueshme shikohen te sektori i arsimit, gruas dhe rinisë, te sektori i bujqësisë dhe peshkimit, si dhe te sektori i energjisë dhe pasurive nëntokësore.

Premtimet e pamatshme zënë një peshë prej 26 përqind për të tria partitë së bashku me një ulje me 1 përqind në krahasim me zgjedhjet e kaluara. Niveli i premtimeve të pamatshme është më i ulët (20 përqind) te PD dhe në nivele të afërta me njera-tjetrën te PS dhe LSI.

Partitë japin premtime të lehta për tu përmbushur ose më pak thelbësore

Në rastin e rritjes së nivelit të premtimeve pjesërisht të besueshme, të cilat përbëjnë më shumë se gjysmën e premtimeve që kanë bërë partitë në zgjedhjet e 2009 dhe 2013 vërehet se shumica e tyre janë premtime të lehta në dukje për tu përmbushur, pasi orientohen për kategori të ngushta votuesish.

P.sh. nëse analizojmë premtimet për politikën fiskale dhe buxhetin ato janë dukshëm të orientuara drejt kategorive të caktuara të përfutuesve, që më së shumti prekin bazën e gjerë të votuesve, kryesisht ata që i përkasin shtresave me paga të ulta, si dhe shtresave në nevojë, që janë objekt i përkrahjes sociale, si pensionistë, familje me ndihmë ekonomike etj.

Në thelb, premtime të natyrës specifike janë të lehta në dukje për tu përmbushur, por në përballjen me realitetin e miratimit të buxhetit janë të vështira deri në krijim të problemeve për tu realizuar pasi trajtohen në grup dhe përbëjnë një peshë më të madhe se sa mundet të përballojë një buxhet në nivelet dhe dimensionet që ka buxheti i shtetit shqiptar.

Premtimet e besueshme dhe premtimet e tjera, 2017

Në zgjedhjet e vitit 2017 besueshmëria ka një veçori nga zgjedhjet e kaluara për rënien e madhe të numrit të premtimeve nga partitë (44% më pak se premtimet e vitit 2013), pavarësisht nëse janë në pozitë apo opozitë. Kjo qasje strategjike e tyre ka sjellë si pasojë mbulimin e më pak sektorëve me premtime, duke ruajtur kryesisht ato premtime, që janë më pranë nevojave dhe dëshirave të momentit të votuesve.

Tab.13 VLERËSIMI I PREMTIMEVE ZGJEDHORE TË TRE PARTIVE KRYESORE NË ZGJEDHJET 2017

numër

Nr.	Premtimet sipas sektorëve 2013	PD			PS			LSI		
		Besueshme	Pjesërisht të besueshme	Pamatshme	Besueshme	Pjesërisht të besueshme	Pamatshme	Besueshme	Pjesërisht të besueshme	Pamatshme
1	Fiskale dhe Buxhetore	2	13		10	6		13	1	
2	Rendi dhe siguria	1	1							
3	Punësimi					1		1	2	
4	Shëndetësia		1		2	3			2	
5	Mbrojtja sociale	2	1		2	2			1	
6	Arsimi, Gruaja dhe Rinia	3	2	2	6	7	2		2	
7	Bujqësia dhe fshati	4	2	1	6	2		5	6	
8	Mjedisi dhe Turizmi	2							3	2
9	Infrastruktura dhe veprat publike		1					1		
10	Pensionet		1		1	1				
11	Pasuritë natyrore dhe Energia				1	2		1		1
12	Përndjekurit	1			1					
13	Minatorët, naftëtarët	1								
14	Legalizimet dhe pronat			1		1				
15	Strehimi social				1	1				
16	Politike	3	1	6		1				
PREMTIME GJITHSEJ		19	23	10	30	27	2	8	29	4

Shënim: Premtimet analitike të Shtojcës

Gjetja kryesore e zgjedhjeve të vitit 2017 është se partitë e koalicionit qeverisës 2013-2017 kanë dalë në këto zgjedhje të ndara nga njera-tjetra. Në këto zgjedhje nuk ka asnjë marrëveshje parazgjedhore mes partive kryesore në vend edhe pse marrëveshja politike para zgjedhjeve mes PS dhe PD pati shumë kundërshtime nga baza e partive të mëdha.

PD në këto zgjedhje në raport me totalin e premtimeve të besueshme dhe ato pjesërisht të besueshme arrin në nivelin 81 përqind.

PS në këto zgjedhje në raport me totalin e premtimeve të besueshme dhe ato pjesërisht të besueshme arrin në nivelin 97 përqind.

LSI në këto zgjedhje në raport me totalin e premtimeve të besueshme dhe ato pjesërisht të besueshme arrin në nivelin 91 përqind.

Nga vlerësimi i premtimeve sipas nivelit të matjes së tyre, sipas *Tabelës 13*, në të cilën janë përmbledhur premtimet e dhëna në 2017¹¹, rezulton se premtimet e besueshme dhe pjesërisht të besueshme arrijnë te 90 përqind (16 përqind më lartë se në zgjedhjet e vitit 2013), ku:

- të besueshme janë 38 përqind e tyre (57 premtime);
- pjesërisht të besueshme janë 52 përqind e tyre (79 premtime);
- të pamatshme janë 10 përqind e tyre (16 premtime).

Vlen të theksohet se premtimet e pamatshme kanë një ulje të dukshme me 16 përqind krahasuar me zgjedhjet e kaluara, ku një ndikim në këtë tregues ka numri i vogël i premtimeve.

Në analizën e vlerësimit të premtimeve të partive kryesore politike:

- nga premtimet e bëra nga PD ka një rritje në nivelin e 37 përqind, që vlerësohen si të besueshme (19 premtime),
- nga premtimet e bëra nga PS 30 përqind janë premtime të besueshme (30 premtime), me një rritje prej 6 përqind nga zgjedhjet e kaluara, si dhe
- nga premtimet e bëra nga LSI përsëri janë premtime të besueshme 20 përqind (8 premtime), me një rritje prej 3 përqind nga zgjedhjet e vitit 2013.

PS ka premtuar një numër më të vogël premtimesh se sa në vitin 2013 (10 përqind më pak), por që zë përsëri edhe në këto zgjedhje peshën kryesore për sasinë e premtimeve në raport me partitë e tjera. LSI ka premtuar sa 27 përqind e premtimeve gjithsej të fushatës, ndërsa PD ka premtuar sa 34 përqind e premtimeve gjithsej të fushatës.

PD ka më shumë premtime të besueshme për bujqësinë, turizmin dhe arsimin dhe ndërkohë më pak të besueshme për politikën fiskale dhe buxhetore.

PS ka premtime të besueshme më shumë në sektorë të tillë si: buxheti dhe politika fiskale, bujqësia dhe arsimi, ndërsa më pak të besueshme ka përsëri për arsimin dhe politikën fiskale.

LSI ka premtime të besueshme më shumë në sektorin e bujqësisë, ndërsa më pak të besueshme po në bujqësi, si dhe në politikën fiskale.

Përsëri në analizën e premtimeve të zgjedhjeve të vitit 2017, premtimet e matshme, por pjesërisht të besueshme janë pjesa më dominuese për secilën nga partitë kryesore (për të tria është 52%), me një ulje prej 4 përqind në krahasim me zgjedhjet në 2013.

¹¹ cdo premtim i detajuar mund të shihet te SHTOJCA.

Nga totali i premtimeve të bëra nga PD rezulton se:

- 44 përqind të tyre i përkasin kategorisë që konsiderohen si pjesërisht të besueshme, me një rënie të ndjeshme prej 17 përqind nga viti 2013. Ndërkohë, niveli më i lartë i premtimeve të pamatshme është te sektori i arsimit.

Nga totali i premtimeve të bëra nga PS rezulton, se:

- një nivel prej 46 përqind e numrit të tyre janë pjesërisht të besueshme. Numri më i madh i premtimeve të pamatshme janë te sektori i arsimit.

Nga totali i premtimeve të bëra nga LSI rezulton, se:

- një nivel prej 71 përqind e numrit të tyre janë pjesërisht të besueshme, me një rritje të ndjeshme prej 21 përqind. Numri më i madh i premtimeve të pamatshme janë te sektori i turizmit.

Në Tabelën 14 kemi analizuar tendencën e premtimeve të partive në qeverisje dhe që kanë hyrë në fushatat zgjedhore për të fituar një mandat të dytë qeverisje. Ajo që kemi analizuar është tipi i premtimeve të dhëna nga secila parti dhe performanca e tyre në krahasim me orientimin e premtimeve.

PD në fushatën e vitit 2009 hyn me premtime për të fituar një mandat të dytë qeverisje. Premtimet e saj më të shumta janë adresuar drejt arsimit, infrastrukturës dhe bujqësisë, por pa harruar edhe ato premtime politike që u adresohen ish-të persektuarve, pronarëve të tokave dhe të banesave të palegalizuara. Në krahasim me fushatën e premtimeve të zgjedhjeve të kaluara ka një ulje të premtimeve fiskale dhe shëndetësore.

PS në fushatën e vitit 2017 hyn me të njëjtën ambicie për të fituar mandatin e dytë qeverisës. Orientimi i premtimeve të PS është drejt politikave lehtësuese fiskale dhe shtimit të shpenzimeve buxhetore, si dhe drejt politikave arsimore, sociale dhe bujqësore. Nëse krahasojmë premtimet e vitit 2017 me ato të fushatës së mëparshme ka një rritje të madhe të premtimeve fiskale, arsimore, ashtu si ka rënie të dukshme të premtimeve për infrastrukturën dhe bujqësinë.

Tab. 14 **Tendencat e premtimeve pozitë dhe opozitë, 2009-2017**

Nr	Tipi i premtimeve	PD			PS			LSI		
		2009	2013	2017	2009	2013	2017	2009	2013	2017
1	Fiskale dhe buxhetore	8%	11%	29%	14%	11%	27%	6%	12%	34%
2	Sociale	4%	4%	8%	11%	11%	12%	15%	10%	5%
3	Shëndetësore	4%	0%	2%	11%	5%	8%	10%	10%	5%
4	Edukimi dhe grua	18%	4%	13%	11%	8%	25%	21%	12%	5%
5	Infrastruktura dhe energjia	31%	32%	4%	5%	21%	5%	8%	26%	7%
6	Bujqësia dhe Turzimi	18%	20%	17%	23%	21%	14%	14%	16%	37%
7	Punësimi	3%	7%	0%	2%	1%	2%	5%	6%	7%
8	Siguria/fasonet/ushataraket/minatorët	1%	4%	4%	2%	9%	2%	10%	1%	0%
9	Politike	13%	17%	23%	21%	13%	5%	11%	7%	0%

Shënim: Premtimet analitike të Shtojcës

Efekti i premtimeve të LSI në zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2013, si pjesë e qeverisjeve

Si një rast i veçantë për tu trajtuar është LSI me premtimet e saj në fushatën e vitit 2009, kur pas tyre hyri në koalicion qeverisës me PD, si dhe në fushatën e vitit 2013, kur kishte bërë marrëveshje parazgjedhore për të qeverisur në një koalicion me PS dhe parti të tjera të majta.

Në zgjedhjet e vitit 2009, LSI vjen me premtime të shumta për arsimin, bujqësinë dhe politikën sociale duke përfshirë këtu edhe politikën specifike për mbështetjen e industrisë fason dhe ato për pensionet e ushtarakëve të liruar nga detyra dhe për minatorët. Në njëfarë niveli përfshirje këto premtime janë të përbashkëta me disa nga premtimet kryesore të PD, por edhe PS për të njëjtat sektorë.

Në zgjedhjet e vitit 2013, premtimet kryesore të LSI janë adresuar në sektorin e infrastrukturës, bujqësisë, si dhe politikave fiskale. Në këto zgjedhje ajo premtonte në disa sektorë ku PS si forcë politike kryesore ka bërë premtime më të pakta. Një ndër asyret kryesore të kësaj divergjence premtimesh për disa sektorë si arsimit dhe politikave sociale LSI ka një ulje të intensitetit të premtimeve.

Në analizën që bëhet për premtimet elektorale sipas sektorëve, përveçse shihet se sa faktor ndikues është secila parti në koalicionin e ardhshëm qeverisës, një faktor ndikues është edhe fakti i qeverisjeve të kaluara që partitë dominuese në qeveri nuk kanë dhënë në asnjë rast financat në drejtim të partisë që është minorancë në koalicion.

Nëse shikojmë ndikimin e LSI si efekt në devijimin e mbajtjes së premtimeve nga të dyja krahët e qeverisjeve, shikohet se është në shkallë të ndryshme të përmbushes përgjatë mandateve që janë votuar.

Në rastin e qeverisjes së demokratëve me LSI ka patur një nivel mbajtje premtimesh prej 22 %.

Në rastin e qeverisjes së socialistëve me LSI ka patur një nivel mbajtje premtimesh prej 37 %.

Ndërsa kur socialistët kanë qeverisur të vetëm për një periudhë 4 vjeçare rezultojnë një nivel mbajtje premtimesh prej 50%.

Nga sa shikojmë vërehet se efekti më i madh në deijimin e mbajtjes së premtimeve shihet në rastin e qeverisjes midis PD dhe LSI, ku një pjesë e premtimeve janë edhe si rrjedhojë e një qasje ndryshe të të majtës nga e djathta, por edhe për arsye të mungesës së një marrëveshje parazgjedhore midis tyre.

Ndërkohë, një rritje e efektit të LSI në qeverisje shikohet në 2013, megjithëse nuk mund të konsiderohet një përmbushje në nivel të lartë.

Shëndetësia falas dhe kostoja e premtimeve me vlerat buxhetore të alokuara në 4 vite

Premtimi i Sistemit Universal të Shëndetit të Kandidatit për Kryeministër Edi Rama ishte një risi për PS, ndërsa Kryetari i LSI, Ilir Meta e kishte artikuluar si premtim edhe më përpara pavarësisht nga emërtimi i shërbimit.

Edi Rama premtoi një sistem kombëtar të kujdesit shëndetësor në ofertën e tij elektorale në zgjedhjet e vitit 2013 dhe gjatë qeverisjes së tij në 2013-2017, ai u përpoq ta zbatonte sistemin. Në procesin e zbatimit, ai u përball me një rezistencë të vetë sistemit egzistues, por edhe hezitimeve për mënyrën e financimit të refortmës, e cila është pjesa më e rëndësishme e saj.

Por a i kushtoi politikisht Socialistëve kjo reformë në zgjedhjet e vitit 2017?

Duke e analizuar këtë pyetje nga të dhënat e tabelave të buxhetit për periudhën 2012 deri në 2017, shikohet se sipas Tabelës 15, në serinë e alokimeve të buxhetit për sektorin e shëndetësisë nuk ka patur në asnjërin nga vitet pas deklarimit të reformës alokime fondesh, që të mund të bëjnë ndryshimin e madh të një reforme që duhet të përfaqësojë gjithë popullsinë.

Nr.	Sektori i shëndetësisë	2012	2013	2014	2015	2016	2017
1	Alokimet e buxhetit për shëndetësinë	29.5	28.7	30.8	32.1	31.3	33
2	Ndryshimi vjetor		-3%	7%	4%	-2%	5%
3	Ndryshimi me vitin para fillimit të reformës		-3%	4%	9%	6%	12%

Burimi: Buxheti vjetor

Me këto ritme të alokimit të fondeve kjo reformë nuk mundet të arrijë të krijojë një qëndrueshmëri që të vlejë për politikave shëndetësore të ardhme, për sa kohë burimet e financimit nuk shkojnë më shumë se 28% në krahasim me fillimin e reformës brenda një mandati qeverisës.

Edhe pse shëndetësia në premtimet e dy forcave politike të koalicionit (PS dhe LSI) rezultojnë se mund të konsumonte një buxhet shtesë i propozuar nga PS dhe LSI, respektivisht me 10 deri 29 miliardë lekë më shumë.

Në fakt buxheti i zbatuar përkon me një rritje në 4 vite për jo më shumë se 8.3 miliardë lekë. Në fakt, ky fakt nuk ishte një arsye më shumë për të ndikuar në vendimin e votuesve për të kërkuar llogari për mospërbushje të premtimit të dhënë në ato nivele që u premtua. Një arsye madhore është mungesa e informacionit të detajuar dhe të qartë, si dhe analiza e kuptueshme bazuar në vlerat financiare dhe shërbimet e dhëna.

Gjithsesi, mungesa e studimeve analitike, por edhe mangësia në fokus për çështje që kanë nevojë të argumentohen nga këndvështrimi ekonomik dhe financiar mbeten ende sfida në luftën politike të partive kryesore.

Premtimet për punësimin dhe fakti i mbajtjes së tyre nga qeveritë

Premtimet për krijimin e vendeve të punës janë shumë të popullarizuara për fushatat elektorale në këto dekada të fundit. Veçanërisht ato kanë qenë më agresive kur ambienti ekonomik ka qenë i dobët dhe niveli i papunësisë ka përbërë një problem.

Në parim, një premtim për krijimin e vendeve të reja të punës mund të jetë i arsyeshëm, por edhe i paarsyeshëm. Për të qenë i arsyeshëm, premtimi duhet të përfshijë mënyrën se si kandidati për kryetar qeverie propozon për të arritur rezultatin dhe si do të jetë efekti në buxhetin e shtetit nga ky veprim, i cili lidhet me mundësinë e investimeve, por edhe me mundësinë për rritjen e bazës së kontribuesve për tatime dhe kontribute sigurimesh.

Punët mund të krijohen nga ndërhyrja dhe shpenzimet direkte të qeverisë, një strategji që duhet prezantuar në programet elektorale si një kapitull shumë i rëndësishëm dhe i vecantë. Këto projekte mundet të krijojnë vende pune për një numër të madh qytetarësh të papunë. Por nga ana tjetër, në kushtet kur investimet e huaja që janë të lidhura direkt me punësimin nuk prezantohen në mënyrë të qartë dhe transparente me projekte konkrete do të përbënin një shembull negativ dhe objekt polemikash politike. Në këtë dekadë të fundit, projektet e investimeve private nuk kanë arritur të përmbushin dot nivelet e larta të punësimit, të premtuara me bujë në premtimet elektorale dhe nuk kanë arritur të sigurojnë shpresë të mjaftueshme për ekonominë shqiptare që vihet në vijimësi në vështirësi.

Tab. 16 Premtimet për numrin e të punësuarve dhe fakti i tyre, 2009-2017

numër

Nr.	Premtimet për punësimin	2009	Punësimet Qeverisja 2009-2013	2013	Punësimet Qeverisja 2013-2017	2017	Punësimet Qeverisja 2017-2021*
1	PD	160,000		260,000		0	
2	PS	197,000	49,000	300,000	198,000	220,000	89,000
3	LSI	100,000		225,000		170,000	

Shënim. Premtimet analitike të Shtojcës

* llogaritjet nuk janë përfundimtare

Në krahasimin që mund të bëhet midis premtimeve të partive për punësimin dhe nivelit të punësimit faktik për 4 vite, në të tri qeverisjet e paraqitura në Tabelën 16 shihet se nuk është arritur as niveli 50% i premtimit.

Kjo performancë natyrisht, që përveç se lidhet edhe me treguesit e tjerë të paralelizuar si performanca e ekonomisë që nuk ka arritur treguesit e rritjes së premtuar, por edhe investimet e huaja dhe të brendshme nuk kanë qenë të mundur të krijojnë vende pune më shumë se ky nivel duhet tu shërbejnë partive për të bërë premtime që mësojnë nga euforia politike e të kaluarës e bërë nga vetë këta politikanë që janë edhe sot duke premtuar.

Premtimet për të varfërit dhe përbushja sipas vlerave buxhetore

Premtimet për kategoritë e njerëzve në nevojë kanë qenë të përfshira në fokusin e premtimeve kryesore në fushatat zgjedhore të kaluara. Por, nëse nisemi në krahasimin e vlerës buxhetore të alokuar për këto kategori, që i përket jo gjithë buxhetit për politikën sociale, por vetëm politikave të premtuara, sipas Tabelës 17 shikojmë një disbalancë që tregon për një performancë të përbushjes të jo më shumë se 50% të premtimeve në të tria fushatat.

Tab.17 Shpenzimet për mbështetje sociale, 2009 - 2020		mld lekë		
Nr.	Shpenzime për mbështetje sociale	2009 -2013	2013-2017	2017-2020
	Vlera shtesë e Fondeve të buxhetit	6.4	9	8
1	Kostoja e premtimeve zgjedhore PD	8	19	20
2	Kostoja e premtimeve zgjedhore PS	16	20	20
3	Kostoja e premtimeve zgjedhore LSI	8	20	21

Në fushatën e vitit 2009, partitë e majta (PS dhe LSI) kanë premtuar politika sociale shtesë që përkojnë me një kosto të llogaritur në nivelin 8 miliardë lekë për 4 vite. PD, si parti e krahut të djathtë politik ka bërë premtime që shkojnë në vlerë shtesë për buxhetin sa dyfishi i secilës prej partive të majta. Në fakt, përgjatë periudhës së qeverisjes së koalicionit mes PD dhe LSI nuk u alokuan fonde buxhetore shtesë më shumë se gjysma e vlerës së premtuar.

Në fushatën zgjedhore 2013, nisuar nga qëllime të përfitimeve elektorale, të tria partitë tashmë premtojnë shtim të buxhetit për realizimin e premtimeve sa dyfishi i asaj çfarë kishin premtuar në zgjedhjet e vitit 2009.

Qeverisja e koalicionit të majtë megjithëse rezulton me një rritje të buxhetit në vlerë absolute për politikën sociale nuk ka arritur dot të jetë si nivel përbushje as në nivelin e përbushjes së qeverisjes së kaluar.

Në fushatën e vitit 2017, përsëri premtimet mbeten në nivele të larta shtimi të buxhetit, por të krahasueshme si vlera premtimesh me ato të zgjedhjeve të vitit 2013.

Në qeverisjen që ende është në muajt e fundit të saj nuk shikohet shtim buxheti as në vlerë absolute, por edhe si nivel përbushje më shumë se dy zgjedhjet e kaluara.

Në gjithë këtë analizë vërejmë se premtimet nisen më së shumti nga nevojat elektorale dhe për të maksimalizuar votën e qytetarëve, por nuk kanë në bazë të tyre vlerësimin real të mundësive të përbushjes së premtimeve që japin.

Një analizë e thelluar, bazuar në studime dhe kërkime mundet që të orientojë premtimet për këtë sektor më afër nevojave të ngutshme, por edhe për të administruar më mirë gjithë procesin e premtimeve që krijon te qytetari perceptimin e mungesës së besimit në çdo proces zgjedhor të ri.

Premtimet për investime të mëdha dhe monitorimi i pakët i tyre nga publiku

Në fushatën e vitit 2009, vlera e premtimeve për infrastrukturën nga drejtuesi i PD-së llogaritet në 25 miliardë lekë/vit, ndërsa drejtuesi i PS bëri premtime për të njëjtin sektor në një vlerë të llogaritur 10 miliard lekë/vit.

Në fushatën e vitit 2013, vlera e premtimeve për infrastrukturën nga drejtuesi i PD-së llogaritet në 35 miliardë lekë/vit, ndërsa drejtuesi i PS bëri premtime për të njëjtin sektor në një vlerë të llogaritur 36 miliard lekë/vit.

Në fushatën e vitit 2017, vlera e premtimeve për infrastrukturën nga drejtuesi i PD-së llogaritet në 1.5 miliardë lekë/vit, ndërsa drejtuesi i PS bëri premtime për paketën 1 miliard US.Dollarë, por që për secilin nga vitet e qeverisjes ajo llogaritet të jetë 16 miliard lekë/vit. Këto fonde që në rastin e qeverisjes së PD kulmojnë me rrugën e kombit, e cila ka arritur për periudhën nga fillimi i saj deri më sot mbi 130 miliard lekë, në rastin e PS kulmojnë me paketën 1 miliard US.Dollarë që përkohë si kundëvlerë me kulmimin e PD-së. Ndryshimi është që këto premtime përsëriten një herë në 10 vite dhe që kanë tendencën, që sa herë që buxheti arrin të mbizotërojë situatën e borxhit publik duke ulur nivelin e tij, vijjnë premtime në këto dimensionet që e shndërrojnë gjithë politikën dhe mundimet e ekonomisë anemike, të mos arrijë dot asnjëherë të kapërcejë nivelet e rritjes ekonomike që premtohen nga të dy partitë e mëdha

Por, ndërsa partitë premtojnë dhe angazhohen lehtësisht në projekte me buxhete të mëdhenj, ajo që konstatohet nga analiza jonë është se mund të jetë e vështirë për votuesit të dinë se çfarë rezultatesh të presin nga miliardat e premtuara drejt infrastrukturës.

Një buxhet i madh nuk garanton një vlerë ekonomike më të mirë për publikun.

Politikanët shqiptarë, ashtu si edhe në vende të tjera e kanë premtim kryesor, por edhe program parësor ndërtimin e një infrastrukture të re. Kjo bëhet edhe më e dukshme në rastin e vendit tonë që ka mungesa të mëdha në këtë drejtim. Por, politikanët i favorizojnë projektet e mëdha në krahasim me ato më të vogla, përveç pjesës së marketingut të punës së qeverisë edhe sepse është më lehtë të kapërcejmë kundërshtimin dhe pengesat burokratike dhe mundësia që ti shohim ato deri në realizim brenda mandatit 4 vjeçar është shumë e madhe. Megjithatë, investimet në projektet e mëdha të infrastrukturës duhet të bëhen me qëllime të qarta në mendje dhe këtu në projektet e kaluar duket se nuk është analizuar dhe vlerësuar përfitimi ekonomik i këtyre investimeve. Një provë e qartë është dhënia me koncesion e mirëmbajtjes së rrugës së Kombit, e cila është një investim që përveç tejkaloi mundësitë e financimit nga buxheti jonë, në po të njëjtën vështirësi e ka vendosur gjithë këto vite edhe për mirëmbajtjen e saj. Por, kostoja për gjithë këtë investim shumë të madh për buxhetin mund të rimerret pas më shumë se 100 vitesh dhe natyrisht që ky nuk është një investim i bazuar te përfitimi ekonomik.

Nëse një investim nuk adreson një nevojë të qartë publike, ai mund të rezultojë në një rast dështimi të menaxhimit fiskal dhe ekonomik.

Në po të njëjtin nivel rrisht është edhe projekti i infrastrukturës brenda paketës “1 Miliard”, pasi duket se ekspertët dhe studimet e parafizibilitetit nuk rezultojnë të shfaqin rikthim të shpejtë të investimit në këto projekte.

Aq më tepër kur buxheti aktualisht nuk ka asnjë mundësi të investohet në asnjë kontratë të re, pasi nuk mundet të mbajë dot pagesën e kontratave të nënshkruara (Partneritetet publike-private, PPP) në këto vite të fundit.

Nisur nga mungesa e performancës pozitive në të ardhurat buxhetore është gjetur zgjidhja duke marrë borxh në tregjet e huaja, por kjo është një temë që prek shumë më fort performancën e ekonomisë edhe për të ardhmen.

Në një analizë të ndikimit të investimeve të borxhi publik shikojmë se në 2019, nga një llogaritje e vlerave të investuara në infrastrukturën rrugore nga dy burimet e buxhetit (Ministria e Transportit dhe pas 2017 Ministria e Infrastrukturs, si dhe Fondi i Zhvillimit) shuma e investimeve në infrastrukturë zë 60% të kostos së borxhit publik si mesatare 10 vjeçare (shih Tabela 18). Ndërkohë, për të parë kufijtë e ndikimit në rritjen e ekonomisë

duke analizuar raportin midis vlerës së investimeve rrugore ndaj rritjes së PBB-së, shikohet një korrelacion jo simetrik. Ekonomia ka patur rritje më të vogël se vlera e investimeve në disa vite (2010, 2013), që tregon se në këto vite vlera e investimeve ka qenë në kurriz të vetë rritjes vjetore. Duke marrë si mesatare që norma mesatare e rimarrjes së investimeve në infrastrukturën rrugore nuk kalon më shumë se 15-20% në vit, atëherë analiza tregon se shumë nga këto investime në rrugë kanë gjeneruar më pak të ardhura sesa kostoja e tyre e huamarrjes, duke lënë humbje të mëdha.

Tab.18 Investimet e buxhetit të shtetit për infrastrukturën rrugore, 2009 -2019

mln. Leke

Nr.	Emërtimi	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	Total
1	Shpenzimet kapitale ne infrastrukture rrugore*	53.6	38.4	42.7	34.6	44.7	32.3	27.1	17.1	39.5	38.4	36.8	405.2
2	Sherbimi borshit publik	42.1	48.1	48.7	52.1	56.1	57.7	100.3	58.2	57.6	88.1	64.9	673.9
3	Ndryshimi PBB (vit me vit)	63.26	95.7	60.9	32.2	17.2	45.3	39	38.2	78.2	85.1	42.7	597.7
4	Rritja e PBB / Investimet rrugore	118%	249%	143%	93%	39%	140%	144%	223%	198%	222%	116%	147%
5	Investimet rrugore/ Paga borxheve	127%	80%	88%	66%	80%	56%	27%	29%	69%	44%	57%	60%

Burimi: Ministria e Financave

*Vlera përfshin investimet kapitale ne transportin rrugor, sipas Ministrise së Transportit dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit. Llogaritja nga ALTAX

Nisur nga kjo llogaritje e thjeshtë vetë qeveria duhet të konsiderojë edhe njëherë prioritetet e investimeve nisur nga përvoja dhe vlerat ekonomike të fituara deri më sot.

Sa vlerësohen programet (manifestet) politike në fushatat zgjedhore?

Premtimet mund të jenë të besueshme për aq kohë sa emri i mirë i tyre ka një vlerë. Premtimet mund të ndryshojnë bindjet e votuesve në lidhje me zgjedhjet që do të bëjnë kandidatët nëse ata zgjidhen, sepse votuesit besojnë që ndonjëherë premtimi mund të përmbushet edhe për arsye të egoizmit të kandidatit për të përmbushur premtimet e tij.

Votuesit besojnë premtimet e kandidatëve që kanë një reputacion të mirë dhe priren të besojnë pak ose aspak premtimet e kandidatëve që kanë një reputacion të keq.

Si rregull i përgjithshëm i vlefshmërisë së premtimeve në funksion të tërheqjes së vëmendjes së votuesve është gjithmonë e lidhur me *programet elektorale*, të cilat janë më afër preferencave të tyre për shpenzime më të ulta dhe përfitime më të mëdha në krahasimin mes kandidatëve që garojnë në zgjedhje.

Në fakt, në Shqipëri nuk ndodh e njëjta gjë. Në shumë raste manifestet politike nuk është e lehtë të gjenden, pasi publikohen si një produkt marketingu, por të pakonsultuara me ata subjektet për ku adresohen. Megjithatë, kjo nuk ka ndikuar në fitoren e zgjedhjeve për partitë, kur ato kanë arritur të dalin fituese.

Qytetarët kur dëgjojnë partitë të premtojnë mundet të harrojnë shumë informacione të hollësishme, por ata kanë aftësitë njohëse për të bërë gjykime të informuara.

Ndryshimet që egzistojnë në opinionin publik shoqërohen me ndryshime domethënëse në disponimin e informacionit të qartë dhe të plotë për mënyrën si do të miratohen dhe zbatohen politikat përkatëse.

Shqiptarët nuk janë politikisht të informuar mirë dhe kjo ka të ngjarë të jetë veçanërisht e vërtetë për premtimet zgjedhore dhe përmbushjen e tyre nisur nga parashtrimet në këtë analizë. Një rrugë drejt zgjidhjes së këtij problemi është përmirësimi i cilësisë së informacionit për mbajtjen e premtimeve të raportuara nga të zgjedhurit politikë dhe të pasqyruara në media dhe bërja e tyre më e arritshme për publikun.

Por, pse nuk është bërë ende një standart i domosdoshëm prezantimi formal i manifesteve politike?

Së pari, nga ajo çfarë kemi analizuar vërejmë si arsye se në rrethanat, kur blerja e votës është me kosto më efektive sesa dhënia e informacionit për votuesve mbi politikat e ndryshme, një rol të mundshëm për të ndikuar në fushatat elektorale marrin organizatat e shoqërisë civile ose shoqatat mediatike për të siguruar atë lloj informacioni mbi politikat, i cili mungon apo nuk përmendet nga palët politike garuese. Një mënyrë e mundshme për të nxitur kandidatët për të ndjekur strategji zgjedhore të bazuara në politika dhe jo në blerje votash dhe premtime të parealizueshme është të rrisin monitorimin e kostove të blerjes së votës dhe shënjestrimin e atyre premtimeve që dukshëm janë jo realiste dhe të pamatshme në realizimin e tyre. Kjo qasje ul shkallën e pranueshmërisë së premtimeve boshe, por edhe bën orientimin e garës drejt programeve konkurruese të pranueshme dhe që nuk lidhen me elementët e pandershëm të blerjes së votës.

Së dyti, në mungesë të informacionit të plotë dhe analizave të nevojshme ekziston një problem me sjelljen e votuesve në bazë të vlerësimeve të premtimeve të kandidatëve në zgjedhjet e kaluara. Në kohën e zgjedhjeve të reja, kandidati mund të bëjë që premtimet e vjetra të duken shumë më mirë sesa ato të kundërshtarit të tij, vetëm nëse ka rezultuar se premtimet janë rihartuar apo bërë pjesë e programit qeverisës me kushtin që ato të jenë adresuar për tu përmbushur. Nxitja për të përmbushur premtimet e fushatës bazohet mbi rrezikun, se premtimet e ardhshme nuk do të besohen.

Së treti, votuesit edhe pse nuk fiksojnë manifestet politike të zgjedhjeve për ta një premtim i besueshëm është ngushtësisht i lidhur me besueshmërinë që ka krijuar forca politike konkurruese në zgjedhje për të fituar duke u bazuar në cilësi të tilla, si: (a) zotësia për të qeverisur me kapacitete të provuara apo të testuara më përpara, (b) reputacioni që gëzojnë kandidatët të votuesit, (c) kujdesi dhe vëmendja për çështje dhe politika të ndjeshme për vendin dhe individët.

Përmbushja e premtimeve dhe sa dëgjohen sindikalistët nga partitë në qeverisje

Përmbushja e premtimeve nga partitë qeverisëse ndryshon nëse shikojmë të ndara rastet e qeverisë së krijuar nga koalicioni dhe qeverisë së krijuar nga një parti e vetme. Marrëveshja kryesore për ndarjen e qeverisë, e cila ndikon në përmbushjen e premtimeve dallon midis qeverisë së drejtuar prej një partie nga ajo e koalicioneve.

Qeveria e drejtuar nga një parti rezulton me përqindje më të madhe premtimesh të realizuara, se sa qeveria e krijuar prej koalicionit të dy a më shumë partive.

Vitet parlamentare pas fitores së zgjedhjeve, veçanërisht kur një parti kontrollon ndryshimet kanë paraqitur një numër më të lartë aktesh në Kuvend, se numri mesatar i akteve në vitet kur kanë qenë në koalicione. Nisur nga kjo gjetje shikohet se rritja e produktivitetit të Kuvendit është e varur nga mënyra se si kompozohen qeveritë. Fokusi i qeverisë ka të bëjë kryesisht me marrëdhëniet ndërkombëtare, çështjet territoriale, zhvillimin e qëndrueshëm dhe sigurinë. Ndërsa fokusi i legjislativit synon të shohë përtej vitit të ardhshëm parlamentar.

Ndikimi i partive që përbëjnë koalicionin ndodh që të ndikojnë përtej programit që shpallet nga qeveria e formuar pas zgjedhjeve. Kështu, rasti i paketës së fasonit në vitin 2014-2015 është rasti tipik i ndikimit, nisur nga fakti i premtimeve të fushatës zgjedhore 2013. Në këtë fushatë dhe përpara saj, leadershipi i LSI është shprehur direkt për këtë sektor dhe e kanë përfshirë edhe në programin elektorale të tyre.

Ndërsa qeverisja e djathtë ka prezantuar në mënyrë të qëndrueshme marrëdhëniet midis premtimeve verbale në publik gjatë mandatit qeverisës, kjo marrëdhënie ka qenë në rënie për të njëjtën gjë për socialistët.

Studime më të thelluara mundet të verifikojnë nëse qytetarët kontrollojnë, se si partitë e opozitës votojnë për projektligjet e qeverisë për t'u siguruar që ata u qëndrojnë besnikë premtimeve të artikuluar gjatë fushatës zgjedhore. Një pyetje tjetër pa përgjigje është nëse qytetarët mbajnë nën vëzhgim performancën e premtimit të deputetit të tyre, pavarësisht nëse ai deputet është anëtar i qeverisë apo opozitës.

Ndërkohë një pikë me rëndësi për tu përfshirë në premtimet politike është zëri i *sindikatave shqiptare*, të cilat që pas viteve të para pas pluralizmit politik kanë mungesë përfaqësimi në Kuvend dhe në qeveri, por edhe nuk kanë asnjë lobim nga ndonjë forcë politike.

Edhe pse gjatë analizës sonë ne vërejtëm premtime për statusin e minatorit, për fasonët, për industrinë, apo edhe për sektorë të tjerë që kanë ndërthurje me jetën sindikaliste, ne konstatojmë se një pjesë të fokusit të premtimeve ende nuk e ka marrë edhe nevojat dhe kërkesat e sindikatave shqiptare, që janë ende të pastrukturuara dhe organizuara si homologet e tyre në botë.

Debati për taksat dhe orientimet e premtimeve të partive

Megjithëse taksat janë të pashmangshme, në fushatat zgjedhore nuk kemi dëgjuar kandidat, që të propozojnë të rrisin taksat gjatë fushatës së tyre. Zakonisht është krejt e kundërta. Sidoqoftë, nga ky fakt i dukshëm i fushatave zgjedhore, nga secila parti që pretendon të qeverisë, shumica e premtimeve financiare të një kryeministri të ardhshëm, përfshirë shkurtimet e taksave, në realitetin e përditshëm paguhen nga produkti që vjen prej politikës fiskale që propozohet dhe miratohet në secilin vit buxhetor.

Në këtë orientim, Kryeministri në detyrë, por edhe pretendenti për të ardhmen ka kompetenca të rëndësishme për të përdorur politikën fiskale, pra ka edhe fuqinë të ndikojë drejtpërdrejt në normat e taksave. Por, ndërsa një premtim i fushatës për të ulur taksat tingëllon shumë i lehtë në periudhën e fushatës zgjedhore, ku kandidati për Kryeministër e premtton shumë lehtësisht faktin e uljes së taksave, në fakt kur vjen momenti që të fillojë të drejtojë qeverinë që ka marrë votat e njerëzve rezulton se premtimi është pak më i komplikuar se kaq, pasi mund të realizohet vetëm nëse miratohet me ligj nga Kuvendi. Procesi është i gjatë në kohë dhe i komplikuar në procedurë.

Premtimi për ndryshimin e taksave (ulje apo përjashtim), që të bëhet i realizueshëm kërkon fillimisht një përllogaritje dhe rishikim të buxhetit nga Ministria e Financave. Pastaj ai duhet të kalojë për miratim në Këshillin e Ministrave duke e vendosur në një kohë të përshtatshme të kalendarit buxhetor për tu shqyrtuar, pasi ka edhe shumë akte të tjera që konsiderohen njësoj të rëndësishme. Më tej ky draft ligj, pasi aprovohet nga Këshilli i Ministrave me një vendim qeverie duhet të kërkojë të futet në kalendarin e shqyrtimit dhe për aprovim në Kuvend. Procesi deri në miratimin nga Kuvendi është një kohë që mund të marrë disa muaj, pasi kalon për shqyrtim në Komisionet parlamentare dhe deri në seancën që votohet si akt ligjor, kjo ndryshon ligjin e buxhetit të vitit për të cilin do të zbatohet. Ndërkohë, që në gjithë këtë proces mundet të kenë kaluar edhe deri në 1 vit, arsyeja që e komplikon më shumë realizimin e një premtimi për ndryshim të taksave është kompensimi i buxhetit, që duhet të ndodhë për arsye të pakësimit të të ardhurave buxhetore në funksion të uljes së premtuar.

Në këtë miratim do të duhet të ndodhë që ose do të rriten taksat për një kategori të caktuar, ose do të rriten taksat e konsumit për të paguar të gjithë nga pak si konsumatorë, ose do të ulen një shpenzim i miratuar më parë, ose do të merret borxh për të balancuar të ardhurën e munguar si efekt i uljes së premtuar të normave tatimore apo përjashtimeve nga taksat.

Me fjalë të tjera, synimi i premtimit për ulje të çdo niveli takse, apo çdo përjashtimi takse duhet të argumentohet fillimisht nëse ka efekt neutral në buxhet, veçanërisht nëse ato propozohen jashtë kalendarit të miratimit të buxhetit. Premtimet e fushatës për të ulur taksat janë mjaft të zakonshme dhe tërheqëse, por ato rrallë propozohen pa legjislacionin kompensues ose zgjidhjen që do të mundësojë shkurtimin apo lehtësinë tatimore.

Pra, si një premtim, ulja e taksave është e arsyeshme në mënyrë që të arrihet ndonjë rezultat i dëshiruar përtej joshjes së votuesve, por uljet apo përjashtimet duhet të jenë të gjera dhe të bazuara në prirje të arsyeshme për shëndetin e buxhetit të shtetit.

Ecuria e Premtimeve specifike: Shembulli i TVSH për energjinë, dëshmi e papërgjegjshmërisë së partive

Panorama e premtimeve elektorale të disa prej proceseve zgjedhore nxjerr në pah papërgjegjshmërinë e forcave politike. Qartësisht ato marrin angazhime publike të natyrës populiste, pa u bazuar mbi një analizë të thelluar të treguesve ekonomiko-financiar. Rrjedhimisht, qasja e tyre ndaj premtimit të dhënë ndryshon rrënjësisht kur janë në opozitë dhe pasi marrin të drejtën për të qeverisur vendin. Një prej rasteve ilustruese është çmimi i energjisë elektrike. Sipas raportit zyrtar të Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2004, niveli i humbjeve totale kundrejt energjisë së futur në rrjet në Shqipëri rezultonte 39.7%. PD në opozitë, premtoi në programin e saj elektorale në kuadër të zgjedhjeve parlamentare të Korrikut 2005 se do të ulte TVSH për energjinë për familjarët nga 20% në 6%.

PD i fitoi zgjedhjet e Korrikut 2005 ndërsa niveli i humbjeve të energjisë për këtë vit arriti në 40.9%. Në vitin 2005, çmimi ishte 4.5 lekë/kilovat për konsumin brenda fashës dhe 9 lekë/kilovat për konsumin mbi fashë. Në vitin 2006 u ndryshua çmimi duke u rritur në 7 lekë/kilovat dhe u hoq fasha mbrojtëse. Për ambientet e përbashkëta u rrit si tarifë nga 4.5 në 7 lekë/kilovat. Kjo skemë funksionoi për vitet 2006 dhe 2007. Në vitin 2008 bëhet ndërhyrja e dytë duke rikthyer fashën mbrojtëse, duke mbajtur 7 lekë/kilovat konsumin brenda fashës, 7 lekë/kilovat çmimin për ndriçimin e ambienteve të përbashkëta dhe duke rritur në 12 lekë/kilovat çmimin mbi fashën mbrojtëse. Në vitin 2008 vendoset dhe një tarifë fikse 200 lekë për shërbimin e leximit zero lekë/muaj. Kjo skemë çmimi u mbajt në fuqi për vitet 2008-2009.

Pavarësisht se PD ishte në kushtet e pamundësisë për të përmbushur premtimin e dhënë për reduktimin e TVSH-së për energjinë elektrike, LSI në opozitë, në programin elektorale të vitit 2009 premtonte “subvencionojmë energjinë për 300 kilovat/orë në muaj për konsumatorët familjarë të varfër”. Ndërkohë humbjet totale në rrjetin elektrik për vitin 2008 rezultonin në nivelin 34%.

Në vitin 2010 bëhet ndryshimi i tretë i çmimit: konsumi brenda fashës mbrojtëse rritet si çmim në 7.7 leke/kilovat, konsumi mbi fashën mbrojtëse rritet në 13.5 lekë/kilovat; tarifa për ambientet e përbashkëta rritet në 8 leke/kilovat dhe mbetet 200 lekë tarifa fikse e shërbimit për leximin zero. Ky çmim u mbajt pa prekur për vitet 2010-2014.

Gjatë 8 viteve të qeverisjes së saj, PD nuk mundi të mbante premtimin për reduktimin e TVSH-së për energjinë elektrike. Në seancën parlamentare të 23 Dhjetorit 2011, Partia Socialiste në opozitë paraqiti një amendament në projektbuxhet ku propozonte mes të tjerave edhe “Tatimi mbi Vlerën e Shtuar do të ulet nga 20% që është sot, në 17%. Do të adoptohet një shkallë e dytë tatimore prej 6% vetëm për furnizimet me energji elektrike”. PD rrëzoi propozimin e opozitës socialiste me pretendimin se synon goditjen e qëllimshme të qeverisë në financat publike. Niveli total i humbjeve në rrjet për vitin 2011 rezultoi të ishte 35.6%.

Ndonëse humbjet në rrjetin elektrik do të rriteshin dhe në vitin 2012 do të arrinin 43.9% duke e futur sistemin në kolaps financiar ndërsa konflikti me kompaninë CEZ Shpërndarje arriti kulmin, opozita nuk do të nguronte të “peshkonte” votuesit në fushatën elektorale të Qershorit 2013 me premtimin për ulje të TVSH-së për energjinë. Në programin elektorale të “Rilindjes” parashikohej ulje e TVSH-së për energjinë elektrike në nivelin e 6 % për konsumatorët familjarë. PD në qeverisje do të mjaftohej me një premtim për subvencionim të energjisë elektrike për pensionistët. Më e çlirët në propozime dukej LSI, një forcë politike që vinte nga bashkëqeverisja me demokratët dhe rreshtohet në koalicionin opozitar 3 muaj para zgjedhjeve parlamentare. LSI premtoi 400 kilovat/orë në muaj subvencionim energjie për familjet me të ardhura të ulëta dhe mesatare. 100 kilovat/orë në muaj falas për familjet në nevojë dhe kryefamiljarët pensionist ndërsa për sasinë prej 100 deri 400 kilovat/orë çmimi i energjisë elektrike do të ulej nga 9 lekë në 5 lekë. LSI angazhohej që të nxirrreshin nga skema e subvencionimit familjet me të ardhura të larta ose ato që konsumojnë mbi 600 kilovat/orë në muaj.

PS bashkë me LSI i fituan zgjedhjet parlamentare të Qershorit 2013 dhe krijuan një qeveri koalicioni. Niveli i humbjeve të energjisë elektrike në rrjet në fund të vitit 2014 ishte 35.7%. Qeveria nxitu reformimin e sistemit të

tarifave të energjisë elektrike. Energjia nuk do të faturohej më tej me dy fasha, por vetëm me një të tillë dhe çmimi unifikohet në 9.5 lekë/kilovat. Kjo nënkuptonte rritje të çmimit për ata klientë familjarë të cilët më herët konsumonin deri 300 kilovat orë dhe tarifoheshin me 7.5 lekë/kilovat.

Pamundësia e PS për të mbajtur premtimin e dhënë për uljen e TVSH-së për energjinë nga 20% në 6% për konsumatorin familjar nuk e pengoi PD në opozitë, që në programin elektorale për vitin 2017 të rikthente premtimet populiste. PD premtoi ulje të çmimit të energjisë elektrike dhe falje të kamatëvonesave dhe u angazhua se 300 kilovat energji elektrike do të paguheshin nga shteti për familjet në nevojë.

Ndërsa palët i drejtohen zgjedhjeve parlamentare të 25 Prillit dhe partitë politike i ndërrojnë rolet herë në opozitë e herë në qeverisje, TVSH për çmimin e energjisë elektrike vazhdon të jetë 20%.

PJESA 4 - Premtimet elektorale në programet qeverisëse

Sistemi politik në Shqipëri përçon te votuesit një qasje jo optimiste në lidhje me aftësinë e partive politike për të përmbushur premtimet që japin në fushatat e zgjatura zgjedhore. Një qëndrim i tillë i opinionit publik dikton një çështje të rëndësishme të lidhur me pyetjen nëse janë në sinkron premtimet që partitë u japin votuesve me programin politik që hartojnë kur marrin pushtetin?

Në momentin e mbylljes së fushatës zgjedhore dhe daljes së rezultateve të zgjedhjeve fituesit fillojnë të hartojnë politika që maksimizojnë përfitimet politike, duke marrë parasysh edhe strategjinë ndaj votuesve për zgjedhjet e ardhshme. Për partinë/koalicionin fitues, përfitimet përfaqësohen me programe që mundet të devijojnë nga politika e premtuar. Në vend të disa premtimeve të dhëna zgjidhen programe që shkojnë për rigjenerimin e ideologjisë dhe forcës qeverisëse.

Ndërsa, partitë humbëse të zgjedhjeve analizojnë përfitimet që u ka sjellë riciklimi i një premtimi apo disa prej tyre dhe sa të qarta dhe të besueshme kanë qenë premtimet e reja. Arsyeja për të përsëritur përsëri një qasje të tillë mund të ndodhë vetëm nëse përfitimi i menjëhershëm ka qenë më i madh se sa pritshmëria e humbjes për zgjedhjet e ardhme.

4.1. Programi qeverisës dhe niveli i realizimit të premtimeve, 2009-2013

Vështirësia e argumentimit të deklaratave të fushatës ka lidhje me financat publike, ku nga një një veprim i thjeshtë i premtuar për të kryer një politikë të veçantë, tashmë duhet hartuar dhe zbatuar një politikë. Këto dy qasje kanë kundërshti nga njera - tjetra nga fakti, se zotimit për një politikë të caktuar gjatë fushatës nuk i bashkangjitet asnjë kosto buxhetore. Ndërsa hartimi i një programi ministror gjatë qeverisjes, në çfarëdo niveli të saj i bashkëlidhet fatura e buxhetit dhe nevoja për përshtatjen e kuadrit rregullator. Në fakt duhet të ishin në të dyja rastet e njëjta procedurë pune dhe kostimi.

Në kuptimin e analizës së fushatave zgjedhore ne konstatojmë se premtime të ndryshme nënkuptojnë zgjedhje të ndryshme të politikave për tu zbatuar dhe natyrshëm kjo çon edhe në përfitime të ndryshme prej një premtimi që japin secila prej partive. Në këtë kontekst analiza e premtimeve që jepen, tregon se votuesit besojnë në grup premtime që maksimalizojnë pritshmërinë dhe që kanë stimuj nga zbatimi i tyre.

Tab.19 Vlerësimi mbi Premtimet e koalicionit PD dhe LSI në programin qeverisës, 2009-2013

Nr.	Koalicioni qeverisës PD dhe LSI, 2009-2013	Përmbushur	Në progres	Pa përmbushur	Pa përfshirë
1	Fiskale dhe Buxhetore	1	1	6	10
2	Shëndetësia	2	1	4	7
3	Mbrojtja sociale dhe pensionet	0	0	3	12
4	Punësimi	5	3	16	4
5	Arsimi, Gruaja dhe Rinia	1	3	13	9
6	Bujqësia dhe fshati	0	0	0	0
7	Mjedisi dhe Turizmi	3	3	12	4
8	Infrastruktura dhe veprat publike	0	2	5	4
9	Energjia	0	0	0	0
10	Fasonët	0	0	0	4
11	Minatorët, naftëtarët, ushtarakët	0	0	0	1
12	Emigrantët	0	0	0	1
13	Legalizimet dhe pronat	0	0	3	0
14	Integrimi	2	0	0	0
15	Politike	1	2	2	2
16	Të përgjithshme	1	0	0	3
PREMTIME GJITHSEJ		16	15	64	61

Shënim. Programi analitik dhe premtimet të Shtojca

Kur analizojmë *nivelin e përmbushjes* nga qeveria, të premtimeve të dhëna në fushatë zgjedhore rezulton se jo më shumë se 20 përqind arrihet duke përfshirë në këtë vlerësim edhe premtimet në progress përmbushje. Niveli i premtimeve të papërmbushura është i lartë me 41 përqind të peshës që mbajnë nga gjithë premtimet e manifestit politik. Pjesa tjetër e mbetur janë premtime të papërfshira në programin e qeverisë.

Sektorët dhe premtimet që kanë një përmbushje më të madhe janë shëndetësia, turizmi, punësimi. Mospërmbushjen më të madhe e gjejmë në sektorët e arsimit, punësimi, turizmi, politikat buxhetore.

Sipas të dhënave të Tabela 19, premtimet e fushatës zgjedhore 2009 janë bërë për një gamë të gjerë fushash që mbulojnë tema me rëndësi për votuesit, të tilla si: kujdesi shëndetësor, të drejtat e punësimin, përfitimet sociale, rregullat mjedisore, bujqësia, arsimit, legalizimet, emigrantët, lufta ndaj korrupsionit, integrimi, taksat e tatimet dhe buxheti. Ndërkohë, tema të tilla si infrastruktura, energjia, pasuritë natyrore, turizmi dhe premtimet e tjera që janë në interes më të përgjithshëm përfaqësojnë pjesën tjetër programore të qeverisë Berisha 2.

Qeveria u krijua në koalicion me LSI, për të qeverisur vendin nga viti 2009 deri 2013.

Nga totali i premtimeve (156 premtime) të bëra gjatë vitit 2009 nga të dyja partitë e koalicionit qeverisës nuk janë përfshirë në programin qeverisës 39 përqind e tyre.

Sipas analizimit të programit dhe krahasimit të tij me premtimet, shikohet se programi përfshin 93 përqind të premtimeve të bëra nga PD dhe 33 përqind të premtimeve të bëra nga LSI.

Tab.20 **Përfshirja e premtimeve në programin e qeverisë 2009-2013**

Nr.	Programi qeverisës	PD	LSI
1	Përfshirë nga premtimet	67	28
2	Pa Përfshirë nga premtimet	5	56

Sipas Tabelës 20, Programi nuk përmban 7 përqind të premtimeve (5 premtime) të fushatës zgjedhore të PD, si dhe 67 përqind të premtimeve (56 premtime) të LSI. Ndër premtimet e papërfshira të PD janë premtimet politike, të përgjithshme dhe ato për arsimin. Ndërsa, mospërfshirja e premtimeve të LSI është nga të gjitha sektorët, por më të mëdha mospërfshirjet janë për mbrojtjen sociale, politikat fiskale, si dhe premtimet e arsimit dhe shëndetësisë.

Mospërfshirja e premtimeve të LSI është e argumentuar jo thjesht nga orientimi ideologjik i premtimeve, por më së shumti nga mosrakkordimi i premtimeve mes partive të këtij koalicioni përpara zgjedhjeve.

Sa është niveli i përmbushjes së premtimeve nga qeveritë europiane të dekadave të fundit?

Qeveritë Prodi I dhe Berlusconi II përmbushën 41% dhe 58% përkatësisht të premtimeve të tyre elektorale. Këto rezultate janë të optimalet e pritshmërive mbi premtimet lidhur me përmbushjen e tyre nga qeveritë. Nuk është për t'u habitur, rezultati i përmbushjes së qeverisë Prodi I, e cila nuk e përfundoi mandatin e saj dhe ishte një qeveri pakice, krahasuar me qeverinë Berlusconi II, e cila kishte një shumicë të zgjeruar parlamentare dhe zgjati katër vite. Sidoqoftë, Prodi arriti të përmbushë 41% të 218 premtimeve në më pak se dy vite. Rezultati i përmbushjes së Berlusconi II është shumë i ngjashëm me rezultatin mesatar për partitë me një shumicë të thjeshtë parlamentare europiane (mesatarisht 59% në Hollandë, 54.5% në Irlandë)

Vlera e premtimeve dhe treguesit e alokuar buxhetorë për këto premtime, 2009-2013

Nisur edhe nga prezantimi në Tabelën 21, ndër premtimet më të dukshme nga të dyja partitë e koalicionit qeverisës është ai për *punësimin*. Në fakt, nga statistikat zyrtare, por edhe nga analiza të thelluara të studiuesve që janë përdorur nga ne si referenca në këtë studim duket se përmbushja e premtimit për vende pune nuk ka arritur të kalojë nivelin sa 49% e premtimit të LSI apo sa 31 përqind e premtimit të PD.

Tab 21 **Qeveria Berisha 2 - 2009 -2013**

Nr.	Fakti i premtimeve	Treguesit buxhetore, ekonomike e sociale
1	Premtimit per punesimin – 160 mije ^[1] dhe 100 mije ^[2]	Gjithsej 49 mije punesime shtese ^[3]
2	Premtimit per mbrojtjen dhe perkujdesjen sociale – 8 mld.	Gjithsej buxheti shtese 5.7 mld.Leke
3	Premtimit per bujqesine – 35 mld.	Gjithsej buxheti shtese 3.5 mld.Leke
4	Nuk do ketë pension në fshatra nën 100 dollarë	Masa e pensionit ne fshatra 80 US.D
5	Premtimit per pensionet – 14.7 mld. leke	Gjithsej buxheti shtese 7.4 mld.Leke
6	Investimet e huaja dhe ekonomia – 2.8 mld. Euro	Gjithsej kontributi buxhetor 4 mld.Leke
7	Heqje/ulje taksash	Rezultati te ardhura 20 mld. Leke
8	Premtimit per arsimin – 30 mld. Leke	Gjithsej buxheti shtese 8.6 mld.Leke
9	Premtimit per infrastrukturen rrugore – 140 mld. Leke	Gjithsej buxheti shtese 180 mld.Leke
	Premtimit per energjiine, UK – 20 mld. Leke	Gjithsej buxheti shtese 1.5 mld.Leke
	SHPENZIME BUXHETI	- 212.2 mld. Leke (130 mld. Leke TR-DR)
	TE HYRA BUXHETI	+ 30 mld. Leke
	REZULTATI	- 182.2 ml. Leke

[1] Premtimit e PD

[2] Premtimit LSI

[3] <http://www.ipm.al/wp-content/uploads/2017/06/Raporti-i-Tregut-t%C3%AB-Pun%C3%ABs-Final.pdf>

Premtimit për *mbrojtjen dhe përkujdesjen sociale* megjithëse kanë zënë vend të madh në programet e qeverisë, ato i kanë kushtuar fonde shtesë buxhetit 4 vjeçar jo më shumë se 70 përqind e kostos së premtuar.

Premtimit për *buqësinë*, si një sektor që merr vëmendje të shtuar në fushatë zgjedhore edhe pse është premtuar të shpenzohen deri 35 miliardë lekë shtesë, në fakt nuk ka arritur të alokohen burime shtesë më shumë se 10% e shumës së premtuar.

Premtimi tjetër shumë specifik lidhur me *nivelin e pensioneve në fshatra* është i papërbushur. Ai ka arritur të jetë i realizuar në 4 vite deri në nivelin e 80 përqind të premtimit për të mos patur pensione në fshatra nën 100 US.D. Mospërbushje ka edhe premtimi për rritjen e *pensionit në përgjithësi*. Ndërsa u premtua të shtohet buxheti në funksion të rritjes deri në nivelin e 14.7 miliard lekëve, fakt mbeti se buxheti për 4 vite nuk alokoi dot më shumë se 7.4 miliardë lekë shtesë.

Premtimit për arsimin kanë një vend mjaft të madh në premtimet e dy partive, por nëse krahasojmë vlerën e premtuar të buxhetit (30 miliard lekë) me alokimet shtesë faktike që janë bërë në 4 vite, rezulton se vetëm 29 përqind e premtimeve janë përbushur nga fondet e investuara shtesë nga qeveria.

Premtimit për infrastrukturën rrugore zënë një hapësirë për më shumë se 47 përqind të gjithë fondit 4 vjeçar (294.1 miliard lekë) për investime publike në gjithë fondet e premtuara të buxhetit. Vendin kryesor në gjithë këtë vlerë të premtuar e mban rruga e Kombit (në kohëzgjatjen e saj mbi 10 vjeçare ka konsumuar 130 miliard lekë). Nisur nga fakti se shpenzimet kapitale të buxhetit tonë nuk shkojnë më shumë se 70 miliard lekë në vitin më kulmor, ky premtim ka qenë më i madhi në historinë e zgjedhjeve që po analizojmë. Niveli faktik i fondeve shtesë të alokuara sipas premtimeve të dhëna, me përbushjen me fonde është tejkaluar me 40 miliard lekë. Kjo faturre buxhetore në këto nivele ndikoi në mënyrë direkte në shtimin e borxhit publik me 5.16 përqind.

Premtimit për ujësjellësa dhe rrjetin e kanalizimeve llogaritet të zënë një vlerë jo të vogël në premtimet zgjedhore të partive të koalicionit (20 miliard lekë). Nga krahasimi me alokimet e buxhetit për premtimet në këtë sektor shikohet se nuk është përbushur më shumë se 7.5 përqind e vlerës shtesë të premtuar.

Në aspektin e optimizimit të ekonomisë, premtimi më i përgjithshëm por me mjaft peshë për rritjen e *investimeve të huaja në ekonominë* e vendit duket se nuk ka arritur të jetë më shumë se 2.8 miliard Euro në 4 vitet e qeverisjes së PD dhe LSI, ndërsa u premtuan 8 miliard Euro. Llogaritjet tona tregojnë se investimet faktike kanë dhënë

një kontribut prej 4 miliard lekë në buxhet, nëpërmjet arkëtimit të taksave të konsumit, si dhe tatimit mbi të ardhurat, përfshirë edhe taksat kombëtare dhe ato vendore.

Politika fiskale e premtuar ka dhënë një efekt shtesë në të ardhurat e buxhetit me 20 miliard lekë. Shtesa vjen kryesisht nga efektet e *taksave nacionale* (15 miliard lekë), *kontributet e sigurimeve* (10.2 miliard lekë), si dhe *tatimit mbi të ardhurat personale* (2.8 mld. Lekë). Por nga ana tjetër, edhe pse janë bërë përjashtime për TVSH ato nuk kanë dhënë efektet e pritshme pasi shtesa është vetëm 1.9 miliard lekë, por që më së shumti është ndikim nga rritja e konsumit nga investimet. Po kështu edhe tatim fitimi ka një rezultat negativ me minus 2 miliard lekë. Po të përfshijmë në analizën e fakteve të buxhetit edhe diskutimin lidhur me ndikimin e taksës së sheshtë vlen të thuhet se shtesa e saj është e pakët ndër gjithë nevojat që ka patur buxheti për të ardhura. Në tërësi, taksa e sheshtë ka dhënë një efekt rezultant (\pm) me jo më shumë se 800 milionë lekë. Kjo qeverisje nuk arriti dot të përmbushte programet lidhur me luftën ndaj informalitetit. Kjo politikë bashkë me antikorrupsionin mbeti sfidë që nuk u adresua dot sipas premtimeve të dhëna edhe pse treguesit janë më të ulët se pasardhësit¹².

Një premtim përmbushet nëse ekziston një veprim ose rezultat që i korrespondon veprimit. Vlerësimet e specifikave për premtimet janë mjaft të drejtpërdrejta, pasi ato përshkruajnë saktësisht se çfarë duhet të shikojmë për ta analizuar. Ndërkohë, lidhur me premtimet e paqarta, si dhe ato të përgjithshme edhe pse mund të kenë një fokus grup nuk mundet dot të jenë të matshme dhe të besueshme, nëse ato mund të përmbushen me më shumë se një mënyrë apo me një kompleksitet veprimesh.

Ne e dimë që marrëveshjet e koalicionit në përgjithësi ofrojnë kontroll reciprok ndaj palëve bashkëpunuese dhe se një kontroll i tillë ndihmon për të siguruar që marrëveshjet e koalicionit janë në rrugën e realizimit të tyre. Kjo tregohet, për shembull, në mënyrën se si premtimet që mbështeten në marrëveshjet e koalicionit paszgjedhor kanë më shumë të ngjarë të përmbushen.

Analiza gjithashtu thekson se si premtimet për të cilat partitë e koalicionit bien dakord nuk kanë fatin që gjithmonë të përmbushen në krahasim me premtimet e tjera, pasi varet edhe nga mënyra se si janë kompozuar premtimet që në hartimin e tyre. Për më tepër, në rastin kur mungojnë marrëveshje parazgjedhore (Qeveria 2009-2013) midis partive të koalicionit duket se këto marrëveshje duhet të shihen jo domosdoshmërisht si përcaktuese potenciale dhe të rëndësishme të politikës për të ardhmen, por vetëm si një politikë që më së shumti ka afatin e skadencës brenda një mandati. Një arsye kryesore është filozofia politike që bie në koalicion secila parti, si dhe e kaluara politike e secilës prej tyre.

4.2. Programi qeverisës dhe niveli i realizimit të premtimeve, 2013-2017

Çdo qeveri shpesh do të duhet të përballlet me të njëjtat çështje si paraardhësi i tyre.

Në studimin e premtimeve të natyrës së ngjashme ne vërejtëm se për sektorin e infrastrukturës, për sektorin e bujqësisë, politikat e integritetit dhe të jashtme, si dhe për politikën e shtimit të buxhetit janë politika, që vijojnë si stafetë midis partive politike edhe pse me dallime të qasjeve.

Gjetja që partitë politike arrijnë të përmbushin një pjesë të caktuar nga kjo vijimësi është treguesi që pasqyron një lidhje në rritje nga një zgjedhje te tjetra të programeve elektorale me politikën e qeverisë. Ne gjithashtu vërejmë se premtimet përmbushen më shpesh kur një parti nuk ka pse të ndajë pushtetin me të tjerët, si në rastin kur ka ndodhur një qeverisje në koalicion. Në modelin politik, ku qeveritë e koalicionit u përsëritën në dy mandate qeverisje me partnerë nga të dy krahët politikë, vërehet se në këto qeveri integrohet politika e kompromisit partiak në disfavor të përmbushjes në kohë të premtimeve.

¹² <https://tradingeconomics.com/albania/corruption-index>

Tab.22 Vlerësimi mbi Premtimet e koalicionit PS dhe LSI ne programin qeverisës, 2013-2017

Nr.	Koalicioni qeverisës PS dhe LSI, 2013-2017	Përbushur	Në progres	Pa përbushur	Pa përfshirë
1	Fiskale dhe Buxhetore	4	4	6	18
2	Rendi Publik	1	2	0	0
3	Shëndetësia	6	6	1	6
4	Mbrojtja sociale	3	3	5	6
5	Punësimi	0	0	3	0
6	Arsimi, Gruaja dhe Rinia	1	3	5	9
7	Bujqësia dhe peshkimi	2	2	11	8
8	Mjedisi dhe Turizmi	1	5	3	5
9	Infrastruktura dhe industria	1	7	4	5
10	Energjia dhe pasuritë nëntokësore	2	5	8	12
11	Pensionet, ushtarakët, fasonët	0	1	0	0
12	Strehimi social	0	1	1	1
13	Përndjekurit	0	0	3	0
14	Legalizimet dhe pronat	0	3	3	0
15	Integrimi	2	0	0	0
16	Politike	1	3	1	0
17	Emigrantët	0	2	0	4
PREMTIME GJITHSEJ		24	47	54	74

Shënim. Programi analitik dhe premtimet te Shtojca

Nëse shikojmë nivelin e përbushjes nga qeveria të premtimeve të dhëna në fushatë zgjedhore rezultojn një nivel jo më shumë se 36 përqind me një rritje të nivelit krahasuar me qeverisjen paraardhëse me 16 përqind. Niveli i premtimeve të papërbushura është i lartë me 27 përqind të peshës nga gjithë premtimet e manifestit politik, por edhe ky nivel është dukshëm më ulët se qeveria e mëparshme me 14 përqind ulje të nivelit të tij.

Sektorët dhe premtimet që kanë përbushje më të madhe janë shëndetësia, infrastruktura dhe energjia. Mospërbushjen më të madhe e gjejmë në sektorët e bujqësisë, pasurive nëntokësore, si dhe politikave fiskale dhe premtimeve për alokime buxhetore shtesë.

Një hipotezë e mundshme e këtyre mospërbushjeve është se ministrat e LSI mund të jenë përpjekur të zbatojnë programin e tyre sa më shpejt të kenë mundur, sepse ata e dinin mirë se sa mund të funksiononte performanca në një shumicë parlamentare të thjeshtë dhe e shoqëruar edhe me divergjencë brenda segmentit ideologjik, duke mos patur pritshmëri të qëndronin në qeverisje për një kohë të gjatë.

Të dhënat e Tabelës 22 tregojnë se premtimet e fushatës zgjedhore 2013 janë bërë edhe këtë herë në një gamë të gjerë sektorësh, që mbulojnë tema me rëndësi për votuesit, të tilla si bujqësia, energjia, kujdesi shëndetësor, përfitimet sociale, infrastruktura, arsimi, si dhe politikat tatimore dhe premtimet e fondeve buxhetore. Premtimet për sektorë të tillë, si: turizmi dhe mjedisi, strehimi social, dhe premtimet e tjera që janë bërë në interes më të përgjithshëm vijnë me një tërheqje në qeverisjen Rama 1 (2013-2017).

Qeveria u krijua në koalicion me LSI, parti e cila vjen nga një koalicion me PD duke qeverisur vendin së bashku nga viti 2009 deri 2013.

Nga totali i premtimeve (199 premtime) të bëra gjatë vitit 2013 nga të dyja partitë e koalicionit qeverisës nuk përfshihen në programin qeverisës 37 përqind e tyre.

Nga analizimi i programit qeverisës dhe krahasimi që i bëme programit me premtimet, vërehet se programi i qeverisë përfshin 86 përqind të premtimeve të bëra nga PS dhe 33 përqind të premtimeve të bëra nga LSI.

Nëse bëjmë një paralelizëm me hapësirën që zinin premtimet e LSI në programin e qeverisjes në koalicionin me PD, shihet se zë një hapësirë të njëjtë, por nisur nga fakti se hapësira që mban PS në program me 86 përqind është tregues, se në këtë qeverisje ka një koordinim sasior më të mirë të premtimeve në programin qeverisës.

Tab.23 **Përfshirja e premtimeve në programin e qeverisë 2013 - 2017**

Nr.	Programi qeverisës	PS	LSI
1	Përfshirë nga premtimet	97	28
2	Pa Përfshirë nga premtimet	16	58

Sipas Tabeles 23, Programi qeverisës nuk përmban 14 përqind të premtimeve (16 premtime) të fushatës zgjedhore të PS, si dhe 67 përqind të premtimeve (58 premtime) të LSI. Ndër premtimet e papërfshira të PS janë premtimet sociale,

për energjinë dhe ato për arsimin. Ndërsa, nga premtimet e papërfshira të LSI janë në masë të madhe ato fiskale, si dhe ato për mbrojtjen sociale, bujqësinë dhe energjinë.

Vlera e premtimeve dhe treguesit e alokuar buxhetorë për këto premtime, 2013 - 2017

Nga analiza jonë bazuar mbi studime të thelluara nga burime të ndryshme, të referuara në premtimet analitike, shihet se përrmbushja e premtimit *për punësimin* ka arritur deri në nivelin e 66% të premtimit të PS apo sa 88 përqind të premtimit të LSI (shih Tabela 24).

Tab.24 **Qeveria "Rama 1" - 2013-2017**

1	- Fakti i premtimeve	Treguesit buxhetore, ekonomike e sociale
2	Premtimit për punësimin – 300 mijë ^[1] dhe 175 mijë ^[2]	Gjithsej 198 mijë punësime shtese ^[3]
3	Premtimit për mbrojtjen dhe perkujdesjen sociale –10 mld.	Gjithsej buxheti shtese 9.5 mld.Leke
4	Premtimit për bujqësinë – 34 mld.	Gjithsej buxheti shtese 8.5 mld.Leke
5	Premtimit për pensionet – 13.5 mld. leke	Gjithsej buxheti shtese 9.5 mld.Leke
6	Investimet e huaja dhe ekonomia – 3.6 mld. Euro	Gjithsej kontributi buxhetor 7.5 mld.Leke
7	Premtimit për shëndetësinë – 29 mld. Leke (LSI)	Gjithsej kontributi buxhetor 5.7 mld.Leke
8	Heqje/ulje taksash	Rezultati të ardhura 63 mld. Leke
9	Premtimit për arsimin – 14.5 mld. Leke	Gjithsej buxheti shtese 1.6 mld.Leke
10	Premtimit për infrastrukturën rrugore – 75 mld. Leke	Gjithsej buxheti shtese 29 mld.Leke
11	Premtimit për energjinë, UK – 15 mld. Leke	Gjithsej buxheti shtese 17.2 mld.Leke
	<i>SHPENZIME BUXHETI</i>	<i>- 88.5 mld. Leke</i>
	<i>TE HYRA BUXHETI</i>	<i>+ 63 mld. Leke</i>
	<i>REZULTATI</i>	<i>- 25.5 mld. Leke</i>

[1] Premtimit e PS

[2] Premtimit e LSI

[3] <http://www.instat.gov.al/media/4155/shqiperia-ne-shifra-2017.pdf>

Premtimit për *mbrojtjen dhe perkujdesjen sociale* kanë zënë vend të madh në programet e qeverisë dhe janë ndër premtimet që i kanë marrë fonde shtesë prej buxhetit 4 vjeçar sa 51% përqind të kostos së premtuar.

Premtimit për *buqësinë*, si një sektor që mori shumë premtime dhe vëmendje në fushatën zgjedhore edhe pse është premtuar të shpenzohen më shumë se 34 miliardë lekë shtesë ka përfituar burime shtesë sa 25% e shumës së premtuar.

Mospërrmbushje nga buxheti ka edhe premtimi për rritjen e *pensionit në përgjithësi*. Ndërsa sipas premtimit llogaritet tregojnë se buxheti duhej të shtohet në funksion të rritjes deri në nivelin e 13.5 miliard lekëve, në fakt buxheti për 4 vite nuk alokoi dot më shumë se 70 përqind të tyre si fonde shtesë.

Premtimet për arsimin renditen ndër sektorët që kanë një vend mjaft të madh në premtimet e partive të majta. Në fakt, kur krahasojmë vlerën e premtuar të buxhetit të llogaritur në 14.5 miliard lekë, rezulton se alokimet shtesë buxhetore, që janë bërë në 4 vite mbulojnë vetëm 11 përqind të kostos së premtimeve.

Premtimet për infrastrukturën rrugore llogariten për një vlerë prej 75 miliard lekë, por shumica e kësaj vlere shkon për mbulimin e kostove të prapambetura të qeverisë së mëparshme edhe pse vlera e saktë e borxheve nga koalicioni partive të majta nuk është publikuar asnjëherë i plotë. Vendin kryesor në gjithë këtë vlerë të premtuar e mbajnë shpenzimet për të përfunduar investimet e filluara nga qeverisja e mëparshme. Nëse shikojmë nivelin faktik të fondeve shtesë të alokuara, shikohet se përmbushja me fonde për premtimet e koalicionit të majtë është jo më shumë se 39% e vlerës së premtuar për tu shpenzuar për infrastrukturën rrugore.

Kur analizojmë premtimet për ujësjellësa dhe rrjetin e kanalizimeve llogaritjet zënë një vlerë jo të vogël në premtimet zgjedhore të partive të koalicionit majtë (15 miliard lekë). Nga krahasimi me fondet e alokimeve të buxhetit për këtë sektor shikohet se është përmbushur dhe tejkaluar vlera e premtuar me mbi 15 përqind.

Në aspektin e optimizimit të ekonomisë, premtimi me peshë për rritjen e *investimeve të huaja në ekonominë* e vendit duket se nuk ka arritur të jetë më shumë se 3.6 miliard Euro në 4 vitet e qeverisjes së PS dhe LSI edhe pse është 800 milion Euro më shumë. Por, disa investime janë firmosur në fund të mandatit të qeverisjes së kaluar, të tilla si: HEC e Devoll dhe projekti TAP dhe vijojnë për inerci zbatimin në qeverisjen e koalicionit të majtë. Llogaritjet tona tregojnë se ato kanë një ndikim në të ardhurat e buxhetit që ka arritur deri në 7.5 miliard lekë nëpërmjet arkëtimeve të taksave të konsumit nga efekti zinxhir i qarkullimit, si dhe tatimit mbi të ardhurat, përfshirë edhe taksat kombëtare dhe ato vendore.

Politika fiskale e premtuar ka dhënë një efekt shtesë në të ardhurat e buxhetit me 63 miliard lekë. Ky kontribut, dukshëm më i madh gati 2.5 herë se qeverisja e kaluar vjen më së shumti nga efektet e taksave të konsumit, ku TVSH ka shtuar me 15.8 miliard lekë në fund mandati dhe akciza ka shtuar me 4.3 miliard lekë. Ndikim në këtë rritje të të ardhurave fiskale kanë edhe tatimet mbi të ardhurat, ku tatimi mbi fitimin ka një hyrje shtesë me 10.1 miliard lekë dhe tatimi mbi të ardhurat ka një hyrje shtesë me 3.3 miliard lekë.

Nëse analizojmë tatimin mbi të ardhurat në këndvështrimin e efekteve nga aplikimi i taksës progresive, shihet se shtesën buxhetore më të madhe e ka dhënë rritja e normës së tatimit të fitimit (nga 10% u rrit në 15%). Tatimi progresiv, i cili u zbatua mbi pagat e sektorit privat dhe publik dha një shtesë në të hyrat buxhetore me vetëm 14 përqind më shumë se i njëjti tatim mbi pagat në qeverinë e kaluar.

Ndërkohë, taksat nacionale dhe taksat e tjera bashkë me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore kanë dhënë një të ardhur shtesë me 28.5 miliard lekë. Nisur nga fakti që tatimet mbi konsumin kanë një rritje të dukshme më të mirë se në qeverisjen e kaluar (+13.9 miliard lekë) edhe pse janë bërë përjashtime për TVSH dhe një ritëm rimbursimesh më i lartë, kjo tregon për një rritje të konsumit për arsye të investimeve më të mëdha, por edhe nga formalizimi i punonjësve informalë, të cilët tashmë legalizuan konsumin e tyre në ekonominë formale.

Edhe për këtë qeverisje lufta ndaj informalitetit mbeti sfidë që nuk u adresua dot sipas premtimeve të dhëna bashkë me antikorrupsionin, i cili ka shënuar rritje më të madhe se në qeverinë paraardhëse.

4.3. Programi qeverisës dhe niveli i realizimit të premtimeve, 2017-2021

Votuesit kanë një kuptim të gjerë dhe amorf të premtimeve. Në të kundërt, përmbushja e premtimeve e vendosur në programe qeverisëse bazohet në përkufizime të qarta të tyre, që bëjnë madje dallimin midis programeve politike nga retorika e fushatës.

Nëse qytetarët kanë një mosbesim të argumentuar ndaj partive qeverisëse, kjo i bën ata të vëmendshëm ndaj performancës së qeverisë në kohën kur bëjnë vlerësimet e tyre, lidhur me faktin nëse premtim është përmbushur ose jo. Ky fakt përbën një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë te vlerësimet e tyre.

Mungesa e besimit është mosbesimi, që nënkupton një vigjilencë nga ana e qytetarëve në lidhje me përdorimin dhe abuzimin e pushtetit nga drejtuesit e partive qeverisëse. Në realitet, demokracia funksionon më e plotë, kur qytetarët nuk u besojnë shumë drejtuesve politikë të tyre, pasi kjo i detyron ata të sillen si duhet dhe u mundëson

qytetarëve të denoncojnë performancën e dobët kur kjo ndodh edhe pse mundet që pushteti me raste të përdorë propagandën për të justifikuar dobësitë e veta.

Në qeverisjen 2017-2021, për herë të parë pas dekadash histori politike, pas përmbysjes së rendit politik të kaluar formohet një qeveri e përbërë me anëtarë vetëm nga PS. Sipas Tabelës 25, vërehet se *niveli i përmbushjes* nga qeveria “Rama 2” i premtimeve të dhëna në fushatë zgjedhore rezulton një nivel prej 52 përqind me një rritje të nivelit krahasuar me qeverisjen paraardhëse me 16 përqind më shumë. Niveli i premtimeve të papërmbushura është i lartë krahasuar me qeverisjen e kaluar me 14 përqind të peshës që mbajnë nga gjithë premtimet e manifestit politik.

Tab.25

Nr.	Programi qeverisës PS, 2017-2021	Përmbushur	Në progres	Pa përmbushur	Pa përfshirë
1	Fiskale dhe Buxhetore	4	5	8	1
2	Rendi dhe siguria	0	0	0	0
3	Punësimi	0	0	1	0
4	Shëndetësia	1	2	0	2
5	Mbrojtja sociale	0	4	0	0
6	Arsimi, Gruaja dhe Rinia	5	4	5	1
7	Bujqësia dhe fshati	5	0	3	0
8	Mjedisi dhe Turizmi	0	0	0	0
9	Infrastruktura dhe veprat publike	0	0	0	0
10	Pensionet	0	0	2	0
11	Pasuritë natyrore dhe Energjia	1	0	2	0
12	Përndjekurit	0	0	1	0
13	Minatorët, naftëtarët	0	0	0	0
14	Legalizimet dhe pronat	0	0	1	0
15	Strehimi social	0	0	1	0
16	Politike	0	0	0	0
PREMTIME GJITHSEJ		16	15	24	4

Shënim. Programi analitik dhe premtimet te Shtojca

Sektorët dhe premtimet që kanë një përmbushje më të madhe janë arsimi, bujqësia, politikat sociale dhe politikat fiskale.

Mospërmbushjen më të madhe e gjejmë në sektorët e premtimeve për rritje shpenzimesh buxhetore, politikat e rinisë, politikat e rritjes së pensioneve.

Të dhënat e Tabelës 26, prezantojnë faktin se premtimet e fushatës zgjedhore 2017 këtë herë nuk përfshijnë

Tab.26 **Përfshirja e premtimeve në programin e qeverisë 2017 - 2021**

Nr.	Programi qeverisës	PS
1	Përfshirë nga premtimet	55
2	Pa Përfshirë nga premtimet	4

një numër të gjerë sektorësh, si dhe vlen të përmendim se nuk përmenden fare problemet e sigurisë dhe rendit publik, ndryshe nga premtimet në vitin 2013. Sektorët që janë mbuluar me premtime janë tema me rëndësi për votuesit dhe në përfaqje me ideologjinë e majtë, të tilla si: bujqësia, energjia, kujdesi shëndetësor, përfitimet sociale, arsimi, si dhe politikat e lehtësive tatimore dhe alokimet e fondeve buxhetore. Premtimet për sektorë të tillë si turizmi dhe mjedisi, strehimi social, infrastruktura janë të minguara dhe ka një tërheqje në qeverisjen Rama 2 (2017-2021).

Nga totali i premtimeve (59 premtime) të bëra gjatë vitit 2017 nga partia socialiste nuk përfshihen në programin qeverisës vetëm 4 premtime.

Në një analizë krahasuese të programit qeverisës me premtimet e bëra, shikohet se programi i qeverisë përfshin 93 përqind të premtimeve të bëra nga PS. Sipas Tabelës 26, programi qeverisjes nuk përmban 7 përqind të premtimeve të fushatës zgjedhore të PS.

Ndër premtimet e papërfshira të PS janë premtimet sociale, për politika tatimore dhe për arsimin.

Vlera e premtimeve dhe treguesit e alokuar buxhetorë për këto premtime, 2017 – 2021

Në analizën bazuar te krahasimi i kostove të premtimeve me faktin e alokimeve dhe përfitimeve shtesë nga efekti i premtimeve (Tabela 27), shihet se përrmbushja e *premtimit për punësimin* nuk ka arritur të kalojë nivelin e 40% të premtimit të PS me një rënie të mbajtjes së premtimit në krahasim me qeverisjen e kaluar me 26 përqind. Një ndikim të fortë në këto të dhëna vjen nga efekti i pandemisë Covid-19, e cila për vitin 2020 ka stopuar punësimet sipas ritmeve të parashikuara. Por, edhe sikur të marrim në analizë vetëm dy vitet normale të qeverisjes “Rama2”, vërehet se ritmi i rritjes së punësimeve nuk mund të kalojë më shumë se niveli i përrmbushjes së premtimit të 100 mijë punonjës në 4 vite.

Kjo llogaritje vjen si verifikim i *treguesit të zhvillimit ekonomik*, i cili nuk u rrit sipas premtimeve të dhëna, por edhe te niveli i njëjtë i investimeve të huaja nëse krahasohen me qeverisjen e kaluar. Nga referencat e cituara në tabelat analitike të kësaj analize, rezulton se investimet e huaja për 4 vitet e qeverisjes nuk mundet të kalojnë përtej 3.9 miliard Euro. Këto investime llogaritet të kenë dhënë një efekt pozitiv në buxhet me të paktën 7.5 miliard lekë, duke patur parasysh sektorët ku është investuar dhe efektin zinxhir në të ardhurat tatimore.

Tab.27 **Qeveria “Rama 2” - 2017-2021**

Nr.	– Fakti i premtimeve	Treguesit buxhetore, ekonomike e sociale
1	Premtimet për punësimin – 220 mijë ^[1]	Gjithsej 89 mijë punësime shtesë ^[2]
2	Premtimet për mbrojtjen dhe perkujdesjen sociale – 26 mld.	Gjithsej buxheti shtesë 7.5 mld. Leke
3	Premtimet për bujqesinë – 35 mld.	Gjithsej buxheti me pak 6.5 mld. Leke
4	Premtimet për pagat e sektorit publik – 8 mld. leke	Gjithsej buxheti shtesë 4.5 mld. Leke
5	Investimet e huaja dhe ekonomia ≤ 3.9 mld. Euro	Gjithsej kontributi buxhetor 7.5 mld. Leke
6	Heqje/ulje taksash	Rezultati të ardhura me 25 mld. Leke
7	Premtimet për arsimin – 18.5 mld. Leke	Gjithsej buxheti shtesë 24.5 mld. Leke
8	Premtimet për infrastrukturën rrugore ^[3] – 65 mld. Leke ^[4]	Gjithsej buxheti shtesë 78 mld. Leke
9	Premtimet për energjinë, UK – 15 mld. Leke	Gjithsej buxheti shtesë 12 mld. Leke
	SHPENZIME BUXHETI	- 82.8 mld. Leke
	TE HYRA BUXHETI	+ 69 mld. Leke
	REZULTATI	- 13.8 mld. Leke

[1] 50 mijë punonjës me pak prej pandemisë në 2020

[2] <http://www.instat.gov.al/media/7174/tregu-i-punes-2019.pdf>

[3] <https://new.financa.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/Raporti-Paraprak-i-Permbledhur-i-koncesioneve-PPP-i-perditesuar.pdf>

[4] Pa përfshirë një pjesë nga paketa investimeve 600 milione Euro për rrugët

Premtimet për *mbrojtjen dhe perkujdesjen sociale* nuk kanë zënë vend më të madh se në qeverinë e kaluar në programet e qeverisë, ku premtimet llogariten se duhet të alokohen 8 miliard lekë fonde shtesë. Në fakt nga matja e alokimeve shtesë të realizuara ato i kanë kushtuar buxhetit 4 vjeçar vetëm 29% përqind të kostos buxhetore së premtuar.

Në këtë kategori premtimesh përfshihen edhe premtimet për pensionet, të cilat nuk arritën të përrmbusheshin edhe pse ky premtim nuk është përrmbushur asnjëherë nga asnjë qeveri që ne kemi analizuar për përrmbushjen e premtimeve të pensioneve. Në një krahasim të dy premtimeve të vitit 2017 për pensionet: (a) Paketa e solidaritetit për pensionistët 24 miliard lekë dhe (b) Rritje vjetore pensionesh dhe shpërblim fundviti nga 7-10 mijë lek, nga verifikimi i të dhënave të buxheteve 2017-2021 (ky i fundit është në zbatim) nuk rezulton përrmbushja në nivelet e premtuara.

Premtimet për *bujqësinë*, si një sektor që vijon të adresohen shumë premtime dhe në fushatën zgjedhore, vërehet se edhe pse është premtuar të shpenzohen më shumë se 35 miliardë lekë shtesë, fakti i burimeve shtesë nga buxheti arrin deri në 19% të shumës së premtuar.

Premtimet për arsimin zënë një vend nga më kryesorët në premtimet e përfshira në programin qeverisës dhe vijon si pjesë e konsistencës së premtimeve të vitit 2013. Kur krahasojmë vlerën e premtuar të buxhetit të llogaritur në 18.5 miliard lekë, me alokimet shtesë faktike që janë bërë në 4 vite, rezulton se shtesat buxhetore e tejkalojnë këtë kosto të vlerës së premtimeve me 32 përqind. Alokimet shtesë kanë kaluar në pjesë të madhe për rritjen e numrit të shkollave të arsimit parauniversitar duke qenë një sektor, ku premtimet janë përmbushur në masë më të madhe se sektorët e tjerë.

Për infrastrukturën rrugore, për mjedisin, urbanizimin dhe turizmin nuk ka premtime të reja duke qenë se pas fushatës së vitit 2017 qeveria “Rama 2” shpalli paketën “1 miliard”. Ndërkohë, programi qeverisës vijon të mbulojë pjesën e shpenzimeve që janë paguar nga buxheti në vite rutinore duke e kaluar pjesëm më të madhe të kostos së infrastrukturës rrugore te sektori privat që ka nënshkruar marrëveshje parteshipi me qeverinë. Natyrisht, që kjo kosto do të mbulojë hapësira fiskale në 10-15 vitet në vijim duke mos lënë shumë për të planifikuar nga qeverisjet që do të vijnë. Megjithatë edhe pse nuk ka premtime me emërtime, vlera e premtimeve të përgjithshme, sipas analizës që ne i bëmë rezulton në 65 miliard lekë. Në fakt, aktualisht buxheti ka alokuar burime shtesë në vlerën 78 miliard lekë, por këtu përfshihen edhe kostot e inceneratorëve dhe planeve urbane e telekomunikacionit. Nisur nga paqartësitë dhe të dhënat jo të plota, ne nuk mundemi të bëjmë dot një krahasim të detajuar për nënkomponentët që përbëjnë infrastrukturën, por shprehemi edhe pse me rezerva, se vlerat e premtuara janë përmbushur pjesërisht me alokimet shtesë buxhetore.

Kur analizojmë premtimet për ujësjellësa dhe rrjetin e kanalizimeve llogaritjet zënë një vlerë jo të vogël në premtimet zgjedhore të partive të koalicionit (15 miliard lekë). Në fakt, nga krahasimi me fondet e alokimeve të buxhetit për këtë sektor shikohet se është përmbushur vlera e premtuar në nivelin e 80 përqind.

Politika fiskale e premtuar në analizën që ne bëmë është kufizuar në të paktën dy vite fiskalë, 2018 dhe 2019 duke marrë në konsideratë situatën e jashtëzakonshme të ndikuar prej bllokimit të ekoonomisë nga pandemia. Për periudhën e analizuar rezulton se politikat e zbatuara sipas premtimeve të vitit 2017 kanë dhënë një efekt shtesë në të ardhurat e buxhetit me 6.9 miliard lekë. Ky kontribut, është ndikuar nga rritja e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale me 9.6 miliard lekë. Në këtë rritje të lartë ka ndikuar efekti i uljes së tatimit mbi dividendin, i cili ka favorizuar pagesat nga kompanitë e mëdha që janë rezidente në Shqipëri në kontribut vjetor prej 7.8 miliard lekë.¹³ Kjo rritje e të hyrave nga ky tatim ka mbuluar deficitet edhe për TVSH dhe tatim fitimin. Gjithashtu edhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore kanë dhënë një vlerë të shtuar në buxhet me 5.3 miliard lekë.

Nëse analizojmë tatimin mbi të ardhurat personale pas më shumë se 6 vitesh nga fillimi i zbatimit të mekanizmit fiskal të taksimit progresiv shikojmë se efekti në buxhet është 16.5 miliard lekë, ku 8 miliard lekë është kontributi vetëm nga tatimi mbi pagat. Nisur nga ky fakt buxhetor, progresiviteti është bazuar dhe rënduar mbi pagat e punonjësve, ku më i rënduari është pjesa e pagave të larta nga sektori privat. Natyrshëm, që ky efekt është i rëndësishëm për të hyrat e buxhetit, por momenti që një taksë rëndon mbi një kategori apo segment taksapaguesish dhe nuk takson gjithë kategoritë e tjera nevojitet të rishikohet për një shpërndarje të re dhe të drejtë të barrës fiskale.

¹³ <https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=7511>

PJESA 5 - Trendi i ofertave elektorale dhe mbajtja e premtimeve, 2009-2017


5.1. Ofertat elektorale dhe tendenca e tyre

Ofertat elektorale që kemi analizuar përgjatë 2009-2017 kanë qenë të orientuara në dy drejtime të mëdha:

- Premtime që kanë synuar në masë të madhe për të ruajtur *status quo* të partive që kanë premtuar për të mbajtur vijimësinë
- Premtime që kanë synuar të bëjnë ndryshimin.


Në një analizë të tendencave të premtimeve të PD në harkun kohor 2009 – 2017, sipas Grafikut 4 shikohet një luhajtje e dukshme në premtimet për politikën fiskale dhe buxhetore, për infrastrukturën, për arsimin, gruan dhe rininë, për bujqësinë dhe turizmin, si dhe në premtimet e natyrës politike. Ndërsa, për politikën sociale, për shëndetësinë, për punësimin dhe premtimet për bujqësinë ka një konsistencë dhe premtimet kanë qenë në nivele të afërta nga një zgjedhje në tjetrën.

Grafik 4




Në analizën e tendencave të premtimeve të PS, në të njëjtin hark kohor 2009 – 2017, sipas Grafikut 5 shikohet një luhajtje e dukshme në premtimet për politikën fiskale dhe buxhetore, për infrastrukturën, për arsimin, gruan dhe rininë, për bujqësinë dhe turizmin, si dhe në premtimet e natyrës politike. Premtime më konsistente PS demonstroi në politikën sociale, punësimin, si dhe politikën shëndetësore.

Grafik 5



Në analizën e tendencave të premtimeve të LSI, për periudhën 2009 – 2017, sipas Grafikut 6 shikohet një luhajtje e dukshme në premtimet për politikat fiskale dhe buxhetore, për infrastrukturën dhe energjinë, për arsimin, gruan dhe rininë, për bujqësinë dhe turizmin, si dhe në premtimet e natyrës politike. Nëse shikojmë se ku janë sektorët me premtime konsistente mund të veçojmë politikat shëndetësore, punësimin dhe mbështetjen për industrinë fason dhe shërbimet.

Grafik 6



Përgjithësisht premtimet që shoqërohen me luhatshmëri janë kategoria e premtimeve që synojnë të sjellin në vëmendjen e votuesve ndryshimin e madh me kundërshtarin politik.

Në tërësinë e gjithë premtimeve zgjedhore për periudhën e analizuar, të gjitha partitë kanë një luhajtje të madhe për politikat fiskale, të cilat dukshëm janë edhe ato që përbëjnë pjesën më të pabesueshme në tërësinë e tyre, për vetë mungesën e përgjegjshmërisë për të mos qenë realistë me premtimet e buxhetit.

Luhajtje të madhe kanë edhe premtimet për infrastrukturën, por që më së shumti lidhen me dëshirën për të zhvilluar projekte të mëdha, të cilat përkthehen në më shumë vota për komunitete të votuesve në masë të gjerë. Po ashtu edhe premtimet për bujqësinë dhe arsimin janë ndër sektorët për të cilët premtohet shumë dhe realizohet më pak se gjysma. Nisur nga fakti që premtimet për këto sektorë kërkojnë të afrojnë sa më shumë votuesë bën që ato të mos bazohen mbi programe dhe politika të qëndrueshme, por kryesisht kanë qasje të përkohshme, afatshkurtër dhe elektorale.

Nga vëzhgimi që i kemi bërë premtimeve, gjetjet tona konstatojnë dhe mbrojnë idenë, që palët nuk bëjnë vetëm premtime që ata presin të jenë në gjendje t'i përmbushin, por edhe premtime që e dinë nga përvoja apo analizat që kërkojnë kohë dhe burime buxhetore më shumë se sa janë mundësitë.

Partitë e vogla si LSI nuk lëshojnë premtime modeste për zgjedhje në krahasim me partitë e mëdha duke patur në konsideratë se ato kanë shumë pak të ngjarë të qeverisin të vetme. Në vend të kësaj situatë premtimesh që ajo e përcakton si të realizueshme, në fakt përkon me dëshirat e votuesve çfarë do të donin të përmbushej nëse do të vareshin nga parti të vogla si LSI. Çështja e LSI është tregues se partitë jo domosdoshmërisht përshtaten me premtimet e tyre dhe nuk vendosin kufizime të perceptueshme si të realizueshme nga votuesit. Kështu, LSI premtonte politika fiskale që nuk ka gjasa të përmbushen pa fituar vendin e parë në zgjedhje.

Ndikimi të zbatimi premtimeve prej pjesmarrjes së LSI në koalicionet qeverisëse në 2009 dhe në 2013

Ne shohim që partitë qeverisëse në koalicione respektojnë premtimet e tyre shumë më pak sesa qeverisja njëpartiake. Ky rezultat është i pritshëm, pasi pjesëmarrja e LSI në të dy rastet e pas zgjedhjeve të vitit 2009 dhe 2013, në koalicionet qeverisëse respektivisht me PD dhe PS e bën gjetjen e marrëveshjeve për çdo ligj të vetëm më të vështirë, por gjithashtu edhe në aspektin e zbatimit e bën më të vështirë për këto qeverisje që të përmbushin premtimet edhe pse nuk kanë bërë pjesë të programeve qeverisëse shumë nga premtimet e LSI. Megjithatë, nga ana tjetër ndryshimi midis këtyre dy qeverisjeve që kanë patur të përbashkët pjesmarrjen e LSI ka dhënë ndikim në frenimin e bipolarizmit të plotë, ku koalicioni fitues ose partia e parë fituese në zgjedhje ka një pozicion favorizues për të zbatuar një pjesë të madhe të programit të saj.

5.2. Kostoja e ofertave elektorale dhe tkurrja e tyre në buxhetet faktike

Premtimet e fushatave zgjedhore, si rregull i përgjithshëm janë më shumë të mundura të përmbushen nga qeveria nëse ka burimet financiare të duhura, por edhe mandatin e plotë qeverisës për të patur kohën e nevojshme në dispozicion.

Kushtet ekonomike janë ndër faktorët më të rëndësishëm në shpjegimin e ndryshimeve në rezultatet e zgjedhjeve. Qeveria që ka siguruar një rritje ekonomike të qëndrueshme për të paktën 4 vitet e qeverisjes, duke siguruar në rastin më të mirë edhe të ardhura më të larta, të cilat janë drejtpërdrejt të rëndësishme për t'u përmbushur premtimet do të japë direkt efekt në rritjen e shpenzimeve ose uljen e taksave, ku indirekt do të përmbushë edhe masat rregullatore që ka premtuar. Ashtu si të ardhurat, koha është një element që përmirësohet direkt nga aftësia e qeverive për të kryer gjërat. Në rastin kur qeveritë kanë kohë të mjaftueshme përtej mandatit 4 vjeçar kjo është koha e mjaftueshme për të patur një besueshmëri më të lartë të votuesit.

Nga njëra anë, mund të jetë më e vështirë për t'u përmbushur më shumë sesa më pak premtime. Nga ana tjetër, një numër i madh premtimesh mund të tregojë se partia është më e përqendruar në premtime si pjesë e zgjedhjeve dhe qeverisë së saj, fakt që mund të nënkuptojë një gjasë më të lartë të nivelit të përmbushjes.


Premtimet që kanë një gjasë të ulët për t'u përmbushur krijojnë hapësirë për negociata në bisedimet e partive të koalicionit. Premtime të tilla gjithashtu shërbejnë për të sinjalizuar përkushtimin ndaj mbështetësve kryesorë. Ofertat elektorale, sipas viteve kur janë zhvilluar fushatat zgjedhore kanë një dinamikë ndryshimi, si përsa i përket sektorëve në të cilat janë orientuar, por mbi të gjitha kostot e premtimeve.

Në Grafikon 7 shikohet se efekti i premtimeve në të hyrat buxhetore, të cilat vijnë nga llogaritja e efekteve fiskale të premtimeve për shkurtime taksash dhe tarifash janë në nivele pritshmërie të përafërt nga secila parti politike. Shmangie nga mesatarja e llogaritjeve bëjnë premtimet e PS në vitin 2017, të cilat tregojnë një efekt në rritje në më shumë se dy herë nga tendenca mbi 10 vjeçare e efekteve fiskale shtesë në buxhetet e shtetit 2009-2017. Ndikimi në këtë efekt ndryshe vjen nga premtimet për rritje ekonomike dhe investime të huaja.

Në analizën e llogaritjeve të shpenzimeve shtesë, si efekt i premtimeve zgjedhore shikohet një nivel i përafërt midis PD dhe LSI¹⁴ në nivele që e ngarkojnë buxhetin me të paktën 1 miliard Euro më shumë ($\pm 35\%$) nga sa llogaritet për vite normale. Në këtë drejtim, PS konstatohet që ka një paketë premtimesh më të kufizuar. Përveç vitit 2013, ku PS ka shtuar dozën e premtimeve me përmbajtje buxhetore në nivele të njëjta me PD dhe LSI, në dy fushatat e tjera zgjedhore (2009 dhe 2017) është në nivele që e rëndojnë buxhetin nga 15% deri 30%.

Kostot ndaj buxhetit edhe pse janë një mesatare vjetore, janë pasqyrim i efektit të premtimeve, por që në fakt nëse do të llogariteshin për 4 vite duke pasur parasysh se instituti i premtimeve nuk mbyllet brenda vitit do të rezultonin jo vetëm të papërbalueshme nga buxheti i shtetit, por edhe jashtë çdo mundësie në rastin më të mirë të investimeve të huaja, por edhe zhvillimit të brendshëm të ekonomisë dhe performancës pozitive të taksave.

Grafik 7




¹⁴ përveç vitit 2009, ku premtimet e LSI kanë një kufizim në vlerat e premtuara duke ngjasuar me PS

Nëse shikojmë efektin real në buxhet nga ndikimi i premtimeve zgjedhore, te Grafik 8 shihet se:

- qeverisja në vitet 2009 – 2013 ka një nivel shpenzimesh shtesë shumë të lartë se qeverisjet në vijim, ku shkaku kryesor janë shpenzimet në infrastrukturën rrugore, por edhe vijimësia me investimet e tjera kapitale dhe ato operacionale. Nisur nga niveli i lartë i shpenzimeve ka edhe një rezultat të thellë negativ, i cili ka ndikuar në rritjen e borxhit publik nëse krahasohet me fillimin e mandatit qeverisës.
- qeverisja në vitet 2013-2017 ka një reflektim në shtesën e nivelit të shpenzimeve si rrjedhojë e premtimeve afër 90% më të ulët se qeverisja paraardhëse dhe me një ndikim më të ulët në rezultatin financiar, ashu si shihet edhe në grafik.
- qeverisja në vitet 2017 – 2021¹⁵ ka ruajtur nivel të afërt shpenzimesh shtesë si efekt i premtimeve të fushatës 2017, por me një rezultat më negativ, krahasuar me qeverisjen paraardhëse, për arsye të një performance 2.3 herë më të ulët të të hyrave, e cila ka ndikuar direkt në këtë rezultat negativ.

Grafik 8



* llogaritjet janë vlerësime për 2021

Kur ballafaqojmë përlllogaritjet e efekteve buxhetore dhe fiskale të premtimeve zgjedhore me vlerat e zbatuara nga buxhetet e secilës qeverisje, sipas Grafikut 9 vërehet një ndryshim midis tyre.

Realizimi faktik i buxheteve, sipas tri qeverive që kanë marrë mandatin qeverisës, rezulton se:


- qeverisja midis PD dhe LSI edhe pse ka përfshirë 61% të premtimeve të fushatës 2009 për të dyja partitë e koalicionit ka një efekt real buxhetor për të hyrat, që arrin sa 79% e premtimeve. Për shpenzimet shtesë, ka një zbatim sa 56% e kostove të premtuara nga buxheti.
- qeverisja midis PS dhe LSI edhe pse ka përfshirë 63% të premtimeve të fushatës 2013 për të dyja partitë e koalicionit ka një efekt real buxhetor për të hyrat, që tejkalon me 15% llogaritjet sipas premtimeve. Për shpenzimet shtesë, ka një zbatim nga buxheti sa 32% e kostove të premtuara.
- qeverisja e PS edhe pse ka përfshirë një numër rekord në nivelin e 93% të premtimeve të fushatës 2017 ka një efekt real buxhetor për të hyrat, që arrin sa 28% e llogaritjeve sipas premtimeve. Për shpenzimet shtesë, ka një zbatim nga buxheti sa 24% e kostove të premtuara.

¹⁵ Viti 2021 bazohet mbi të dhënat e parashikuara sipas PBA 2021-2023

Nëse analizojmë tendencën e premtimeve për të hyrat dhe shpenzimet, si efekt shtesë i bazuar te premtimet zgjedhore, shikohet se më pranë zbatimit të buxheteve faktike në reflektim të llogaritjeve elektorale është qeverisja e vitit 2009-2013, veçanërisht për shpenzimet e alokuara. Ndërkohë, për të hyrat e llogaritura si efekte nga premtimet elektorale në krahasim me administrimin real të tyre qeverisja 2013-2017 është ajo, e cila tregon madje për një performancë më të mirë se vetë llogaritjet.

Grafik 9

Kostot e premtimeve dhe buxheti zbatuar sipas premtimeve, 2009-2021



Por duhet të theksojmë se në analizën e qeverisë 2017-2021 ka nevojë të shihet me kufizime si përsa i përket periudhës së vitit 2020 (për arsye të pandemisë) dhe vitit 2021, i cili është në fillimet e zbatimit, por edhe për arsye objektive të ndikimit të buxhetit direkt nga efekti i katastrofës natyrore në fund të 2019.

Megjithatë, nga analizat paraprake të buxhetit, rezultojnë se ndikimi negativ në buxhetin 2020 për të hyrat është minus 6.5% (krahasuar me 2019) dhe për shpenzimet është minus 9.1% (krahasuar me 2019), fakt që tregon se performanca e buxhetit duhet analizuar më thellë për të parë realisht ndikimet dhe efektet.

5.3. Informacionet dhe referencat vizionare në përgatitjen e ofertave elektorale

Qytetarët nuk zotërojnë nivelin e informacionit të nevojshëm për të bërë dallime të hollësishme se çfarë premtimi është bërë, kur është përmbushur dhe nga kush është përmbushur. Në vend të kësaj, ata mbështeten në informacionit e shkurtra dhe propagandën partiake që priren të besojnë. Disa qytetarë vlerësojnë politikat bazuar në përvojat e tyre personale me qeverinë, dhe përvoja e tillë vjen ekskluzivisht në formën e produktit dhe jo si rezultat i finalizimit të reformës së premtuar me efekt për të gjithë qytetarët njësoj.

Studimet mbi votimin ekonomik argumentojnë se vlerësimet mbi ndikimin që vjen prej perceptimeve ekonomike (agjentëve ekonomikë) në votim ndikohen nga zgjedhja e e programit dhe premtimeve që u prezantohen votuesve si zgjidhje politike në ndihmë të zhvillimit ekonomik. Nëse votuesit kanë ndërmend të votojnë për atë forcë politike që është në qeverisje, atëherë ata e arsyetojnë përgjigjen e tyre ndaj pyetjes se si është perceptimi mbi ekonominë duke deklaruar se ekonomia ka qenë e mirë. Por, nëse realisht ky perceptim është prezantuar dukshëm nga forcat politike e tjera se ka deformime të rënda midis perceptimit dhe realitetit,

atëherë vërehet se perceptimet ekonomike ndikojnë në zgjedhjen e votës, për sa kohë ekziston një marrëdhënie e sinqertë dhe e besueshme e politikanëve në interpretimin e realitetit.

Situata ekonomike kombëtare vërehet se ka ndikuar më pak në pjesën e votave të fituara nga secila parti në nivel lokal, pasi situata ekonomike lokale ka patur ndikim shumë më të fortë për votuesin. Në veçanti, vetëm rritja e të ardhurave kombëtare për frymë dhe normat e papunësisë mundet të kenë efekte disi më të fuqishme në rezultatet e zgjedhjeve në nivel kombëtar, por edhe ato do e kishin këtë efekt vetëm nëse do të sqaroheshin dhe do të përktheheshin në kontekstin e përfitimit të votuesit në nivel lokal. Nga ana tjetër, rritja e nivelit të të ardhurave për frymë dhe norma e inflacionit do të ishin përcaktuese në përqindjet e pjesëmarrjes në votime, vetëm nëse votuesit do të ishin pjesë e vendimmarrjes për çështjet ekonomike dhe investimet e rëndësishme dhe strategjike. Ndërkohë, që për shpenzimet që prekin pjesë të mëdha të parave të mbledhura nga taksat duhet të ketë informacion që duhet të garantohet për secilin qytetar pa patur nevojë për kërkesë.

Pas verifikimit të të dhënave buxhetore, ne konstatojmë se të dhënat e shpenzimeve publike në dhjetë vitet e fundit nuk japin ndonjë shenjë devijimi të justifikojë dimensionet e kostove të premtimeve në drejtim të rritjes apo zvogëlimit pas zgjedhjeve. Gjithsesi shpenzimet publike në vitet para-zgjedhore dhe ato zgjedhore janë më lart se vitet para apo mbrapa procesit zgjedhor. Qeveritë kanë rritur shpenzimet buxhetore në kohën e zgjedhjeve, të cilat në mënyrë të veçantë duket se kanë ndikuar edhe inflacionin në tregun e shërbimeve dhe shpenzimet bazë të familjeve. Por ky efekt duhet të merret jo seriozisht, pasi informaliteti në ekonomi është mbi nivelin normal të krahasuar me mesataren e vendeve të BE.

Partia politike në pushtet gjithmonë përpiqet të sjellë përfitime ekonomike dhe reforma që janë veçanërisht një nxitje për votuesit në periudhën parazgjedhore për të marrë më shumë vota. Investimet dhe reformat kryesisht në këtë periudhë mund të quhen kosto afatshkurtra politike për përfitime afatgjata. Ky nivel shpenzimesh tregon se, për raste të rritjes së shpenzimeve për shtresa sociale apo investime kapitale të rritura më shumë se vitet buxhetore normale nuk mund të jenë referenca njësoj si gjetjet që përmenden në studime të ndryshme lidhur me tendencat e zhvendosjes së shpenzimeve për qëllime të përfitimeve elektorale. Fakti i rritjes minimale të shpenzimeve sociale dhe kapitale lidhet edhe me nivelin e informalitetit dhe të korrupsionit, që është i lartë dhe si i tillë krijon hapësira për të marrë përfitimet elektorale direkt nga përdorimi i fondeve informale përveç fondeve publike.

Në rastin e shpenzimeve publike, të cilat zbatohet në projekte afatshkurtra mund të fillojnë gradualisht të humbasin efektin deri në zgjedhjet e ardhshme. Por, votuesit janë racionalë dhe ata kujdesen për performancën post-zgjedhore të qeverisë. Nisur nga kjo logjikë e testuar në vite qeveria nuk ka nxitjen e mjaftueshme nga votuesi për të fryrë investime që rrezikojnë të mos përthithen dot nga infrastruktura ekonomike.

Një karakteristikë tjetër është efekti në ekonomi i bazuar në ofertat politike zgjedhore të bëra nga politikanët, të cilat në terma ekonomike konsiderohen si investime elektorale. Këto investime janë ato që do të ishin të pamundura ose shumë të kushtueshme për t'u kthyer mbrapa, pasi të ndërmerren, por me dëm ekonomik për imazhin e vendit në sytë e investitorëve seriozë.

Për shembull, konsiderojmë një kompani që po vendos nëse do të ndërtojë një HEC për prodhimin e energjisë elektrike. Nëse HEC-i do të jetë i përfunduar, ai nuk mund të përdoret për qëllime të tjera pa modifikime të shtrenjta. Sipas fizibilitetit rimarrja e vlerës së investimeve rezulton pozitive. Por, nëse vështirësohet rimarrja e kapitalit e ndikuar nga pasiguria e politikës që lind në vetvete nga zgjedhjet, ajo mund të nxisë firmën që të shtyjë vendimin për ndërtimin e HEC-it, duke supozuar që shpenzimet prej vonësës janë më të ulëta se dobia nga të mësuarit e rezultatit zgjedhor.

Nëse partitë e mëdha mbajnë qëndrime të ndryshme mbi energjinë e rinovueshme dhe ka paqartësi se kush do të fitojë zgjedhjet, firma mund të vendosë në mënyrë racionale të shtyjë vendimin, duke supozuar se zgjedhjet nuk janë shumë larg.

Të marra së bashku, vendimi i investimeve oportune dhe zgjedhore tregon ndikimin e zgjedhjeve që variojnë nga komponentët e ndryshëm të PBB-së. Për investime private të tilla si formimi i kapitalit fiks bruto, zgjedhjet do të nxisin një ngadalësim. Për shpenzimet qeveritare dhe shumicën e konsumit privat, zgjedhjet do të inkurajojnë një zgjerim të përkohshëm të tyre. Një kategori e caktuar, konsumi privat i mallrave afatgjata, përballet me presione kundërbalancuese. Konsumi personal duhet të rritet ndërkohë që investimi zgjedhor duhet të bjerë. Sidoqoftë, nuk është e qartë se cili efekt duhet të dominojë. Zgjedhjet duhet të nxisin një rritje më të madhe të konsumit personal me afat të shkurtër sesa në terma afatgjatë, nëse rritet edhe konsumi afatgjatë.

Informacioni mbi ekonominë dhe vizioni për të ardhmen: sa ndikojnë te votuesit?

Votuesit që kanë informacion në lidhje me platformat e partiveve preferojnë ato parti, të cilat premtojnë më afër nivelit të tyre të kënaqshëm të plotësisht të kërkesave edhe pse kjo mund të jetë jo reale nisur nga kostoja buxhetore e ofertave. Nga analiza e kostove buxhetore të premtimeve të partive, shikohet si rregull jo unifikues se ndërsa PD në zgjedhjet e 2009 premtoi koston më të lartë buxhetore, si dhe PS premtoi koston më të lartë buxhetore në 2013, të dyja partitë rezultuan që fituan zgjedhjet respektive në ato vite. Megjithatë, në zgjedhjet e 2017 edhe pse PD dhe LSI premtuan kosto buxhetore më të larta se PS ato nuk fituan dot. Në këtë drejtim, argumenti i premtimit është i lidhur edhe me koston e lartë që prezantoi për votuesit PS me marrjen e qeverisë në vitin 2013 duke stigmatizuar efektin e borxheve të mëdha për ecjen e vendit dhe mirëqenies së votuesve. Për më tepër, duke përdorur një kornizë rigoroze sasiore, ne shikojmë se efektet elektorale të premtimeve bazuar te informacioni janë thelbësore. Votuesit e përdorin informacionin në mënyra racionale dhe azhurnojnë edhe bindjet e tyre për politikën ashtu dhe dimensionet e valencës politike në përgjithësi.

Njerëzit që kanë nivele të larta besimi në forcën politike dhe drejtuesit e saj në përgjithësi presin që premtimet zgjedhore të kryhen, sepse një sjellje e tillë korrespondon me pritjet e tyre pozitive për sjelljen e partisë/ve qeverisëse. Një mekanizëm përmes të cilit besimi i madh ndikon në vlerësimet e qytetarëve është se ata janë më pak të interesuar në informacionin e plotë dhe zakonisht nuk e vlerësojnë faktin edhe kur ky informacion është i kufizuar. Por edhe nëse qytetarët janë të mirëinformuar në secilën fushatë premtimesh mungon informacioni i hollësishëm i kërkuar për të vlerësuar përmbushjen e premtimeve specifike zgjedhore.

Transformimi i partive politike në parti elektorale dhe fushata e pandërprerë

Duke pasur parasysh natyrën e premtimeve në historikun e tyre përgjatë 2009-2017, shikohet se disa premtime në zgjedhjet e 2009 dhe 2013 janë të natyrës klienteliste (p.sh. premtimet e LSI për fasonët, premtimet e PS për portet turistike dhe zonat e lira ekonomike, premtimet e PD për ish-pronarët). Në këtë analizë shikohet se në zgjedhjet e fundit partitë politike nuk bëjnë kryesisht premtime klienteliste, por me marrjen e pushtetit ato zbatojnë politika klienteliste (p.sh. programi për heqjen e rentës minerare për përpunimin e mineraleve, programi për dhënien me koncesion të tokave dhe ambjentëve ndërtimore për 1 euro).

Tashmë partitë janë bërë parti të mirëfillta elektorale dhe nuk rrezikojnë të identifikohen gjatë fushatave zgjedhore me grupe dhe interesa të ngushta klienteliste.

Përmbledhja e gjetjeve

Partitë që janë në qeverisje nuk e respektojnë etikën zgjedhore lidhur me barazinë e garës zgjedhore përpara fillimit të fushatës, por secila prej tyre miratojnë në mënyrë të dukshme Vendime që për efektin dhe mesazhin që ato përcjellin synojnë të ndikojnë në votën zgjedhore duke dëmtuar besueshmërinë e votuesve ndaj partive dhe sistemit. Pavarësisht perceptimeve negative për politikanët dhe mbajtjes së premtimeve me votuesit, analiza jonë na tregon, se politikanët e të dy krahëve politike priren ti përmbushin zotimet zgjedhore.

Nga analiza e aktivitetit elektoral të tre partive kryesore në Shqipëri, ne kemi vërejtur disa gjetje kryesore, të cilat duam ti ndajmë me lexuesit e këtij studimi.

Nga zgjedhjet e 2009 (298 premtime), në zgjedhjet e 2013 (270 premtime) dhe deri në zgjedhjet e 2017 (152 premtime) ka një pakësim me 49 përqind të premtimeve të partive. PD ka një pakësim me 38 përqind. PS ka një pakësim të premtimeve me 60 përqind. LSI ka një pakësim me 52 përqind.

Në vitin 2009 opozita (PS dhe LSI) ka një numër premtimesh sa trefishi i premtimeve të pozitës, ndërsa në 2017 pozita ka një numër premtimesh sa gjysma e partive të opozitës (PD dhe LSI).

Në 2009, partitë së bashku kanë bërë premtime më të shumta për bujqësinë dhe fshatin (47 premtime), si dhe për arsimin, rininë dhe gruan (47 premtime). Premtimet për politikën fiskale dhe buxhetin, si dhe premtimet për mbrojtjen sociale dhe pensionet zënë vendin e dytë, dhe në vijim një numër më i pakët i premtimeve janë dhënë për shëndetësinë (26 premtime), si dhe për infrastrukturën dhe veprat publike (23 premtime).

Në 2013, Partitë kanë bërë premtime më së shumti për infrastrukturën dhe industrinë (40 premtime), për bujqësinë dhe fshatin (33 premtime), për buxhetin dhe politikën fiskale (30 premtime), si dhe për energjinë dhe pasuritë nëntokësore (29 premtime).

Në 2017, premtimet më të shumta në numër për të tri partitë së bashku i përkasin më shumë politikës fiskale dhe shpenzimeve buxhetore (45 premtime), sektorit të bujqësisë dhe peshkimit (26 premtime), si dhe sektorit të arsimit, gruas dhe rinisë (24 premtime). Sektorët e tjerë kanë një numër të vogël premtimesh.

Konsistenca dhe adresimi i premtimeve të partive politike orientohet drejt grupeve të votuesve, që lidhen me qasjet ideologjike të partive, por që kanë devijime përgjatë fushatave.

Përsëritja e premtimeve politike është më e lartë te PD dhe LSI dhe më e ulët te PS. Në rastet e përsëritjeve të premtimeve ato shkojnë në funksion të shtimit të buxheteve për sektorët e bujqësisë, arsimit, si dhe të shëndetësisë. Një pamje edhe më pak pozitive rezulton nga shqyrtimi më i afërt i përsëritjes së premtimeve. Disa prej premtimeve janë shumë larg nga arritja e rezultatit të dëshiruar edhe pas 10 vitesh përsëritje të tyre (premtimet për legalizimet, për pronën, për rritjen e pensioneve, pagave). Kjo ecuri shumë e ngadaltë ka ardhur ose sepse partitë nuk e kanë adresuar në mënyrë reale problemin duke e shkëputur nga politika buxhetore (premtimi për pensionet, pagat), ose sepse partitë nuk gjejnë dot konsensusin dhe koordinimin e politikave midis tyre të lidhur gjithashtu edhe me faturën e papagueshme buxhetore që shoqëron procedurat reformuese (legalizimet, pronat).

Premtimet e partive nisen më së shumti nga nevojat elektorale dhe për të maksimalizuar votën e qytetarëve, por nuk kanë në bazë të tyre vlerësimin real të mundësive të përmbushjes së premtimeve që japin. Premtimet për shtim shpenzimesh buxhetore kanë një ulje për secilën nga partitë kryesore, ndërsa premtimet për ulje/heqje taksash kanë një rritje të tyre nga njera-fushatë në tjetrën.

Kandidatët kryeministrorë vendosin platformat e tyre me premtime fushate të krijuara për të lëkundur mendimet e atyre votuesve të pavendosur për kë do të votojnë. Disa nga premtimet janë të natyrës ideologjike dhe të vështira për tu matur, ndërsa të tjerat janë më të drejtpërdrejta dhe të përgjegjshme. Në një botë ideale, secili premtim i fushatës do të paraqitej me historinë e plotë, por procesi politik nuk duket se e promovon këtë koncept. Do të ishte ideale që të gjithë kandidatët kryeministrorë të na thoshin se do të duhet të rrisim taksat

dhe të ulim shpenzimet për të siguruar jetesën, por fatkeqësisht ajo që ata premtojnë në krahasim me atë që janë në gjendje të japin mund të jenë gjëra shumë të ndryshme, veçanërisht kur kandidatët ndeshin me pengesa të paparashikuara politike ose ekonomike sapo vijnë në detyrë.

Është e dukshme që dy partitë e mëdha kanë një sinkronizim të premtimeve të politikave fiskale dhe ato buxhetore, ndërsa LSI ka një tendencë të ndryshme të sasisë së premtimeve. Partitë e vogla, si LSI nuk lëshojnë premtime modeste për zgjedhje duke marrë parasysh se ato kanë shumë pak të ngjarë të qeverisin të vetme. Kështu, LSI premtonte politika fiskale që nuk ka gjasa të përmbushen pa fituar vendin e parë në zgjedhje.

Niveli i besueshmërisë së premtimeve zgjedhore në 2017 është në rritje për secilën parti politike krahasuar me vitin 2009, me një rritje 9 përqind për PD, 22 përqind për PS dhe 19 përqind për LSI.

Edhe pse partitë kanë bërë premtime për statusin e minorit, për fasonët, për industrinë, që kanë ndërthurje me kërkesat e sindikalistëve, ne konstatojmë se nevojat dhe kërkesat e sindikatave shqiptare, të cilat janë pjesë e diskutimeve me secilën qeveri janë ende të pastrukturuara dhe organizuara në programet qeverisëse, njësoj si homologet e tyre në botë.

Në asnjë rast partitë politike nuk kanë bërë premtime për shkurtim shpenzimesh buxhetore apo shtim të taksave.

Partitë politike shfaqin luhajtje të mëdha në premtimet për politikën fiskale dhe buxhetore, për infrastrukturën, për arsimin, gruan dhe rininë, për bujqësinë dhe turizmin, si dhe në premtimet e natyrës politike. Ndërsa, për politikën sociale, për shëndetësinë, për punësimin dhe premtimet për bujqësinë kanë një konsistencë dhe premtimet e partive janë në nivele të afërta, pavarësisht kraut politik.

Kur analizojmë nivelin e përmbushjes të premtimeve zgjedhore nga qeverisjet rezulton një nivel përmbushje nga 20 përqind në vitin 2009 deri në 52 përqind në vitin 2017. Niveli i premtimeve të papërmbushura ka ardhur në rënie me të paktën 27 përqind për tre qeverisjet e fundit.

Ne vërejmë se koalicionet qeverisëse nuk kanë arritur ta përmbushin programin e tyre në të njëjtën masë si qeveria njëpartiake. Në të vërtetë, në rastet e koalicioneve qeverisëse, shumë premtime të rëndësishme nuk u miratuan pavarësisht theksimit të përsëritur të tyre gjatë fushatave.

Gjithsesi niveli i përmbushjes së premtimeve zgjedhore gjatë qeverisjeve në një qasje optimiste mund të thuhet se kanë patur përparim në nivelin e tyre përmbushës. Edhe pse larg të qenit të krahasueshëm me nivelet e përmbushjes nga vendet anëtare të BE-së, të cilët arrijnë deri 3 herë më lart se niveli më i lartë i përmbushjes së premtimeve nga qeveria (rasti i Suedisë me nivel përmbushje të premtimeve deri në 80% të tyre) duket se rruga e mbajtjes së premtimeve kur partitët krijojnë qeveri është ende larg këtij pragu mjaft të lartë për standartet e politikës shqiptare.

Sektorët që kanë një përmbushje më të madhe të premtimeve janë shëndetësia dhe energjia, ndërsa mospërmbushjen më të madhe të premtimeve e ndeshim te bujqësia, politikën fiskale, premtimet për shpenzime shtesë buxhetore dhe rritjen e pensioneve dhe pagave, si dhe premtimet politike për antikorrupsionin, emigrantët, si dhe luftën ndaj informalitetit.

Premtimet e fushatës mund të ndryshojnë pak nga një fushatë zgjedhjesh te tjetra, por ato janë pothuajse gjithmonë të lidhura me ndryshimin e çështjeve aktuale që synojnë të përpunojnë dhe ndikojnë mendimet e votuesve. Disa mund të jenë me natyrë ideologjike, si "taksimi i ndershëm", ndërsa disa janë më specifike, si propozimi i uljeve të normave të taksave për kategori dhe aktivitete të caktuara. Sidoqoftë në propozimet që bëjnë politikanët në fushata zgjedhore ka premtime të besueshme dhe të arsyeshme dhe ka edhe premtime nga ato që janë thjesht të shprehura sa për të kaluar periudhën e fushatës. Ky fakt duket pikërisht në momentin, kur një parti politike merr mandatin për të drejtuar qeverinë. Paraqitja e premtimeve të fushatës në programin qeverisës përfshin në përmbajtjen e vet jo më premtimet e fushatës, por ato që gjykohen se vlejnë për qeverisjen duke harruar apo transformuar edhe zotime të konsideruara të rëndësishme gjatë fushatës elektorale.

Mungesa e një burimi zyrtar ose jozyrtar të informacionit në lidhje me premtimet dhe programet zgjedhore, që në fakt gjithashtu kanë qenë një sfidë për ne pasi në asnjë nga faqet zyrtare të internetit nga partitë politike nuk gjenden të pasqyruara programe zgjedhore për secilën zgjedhje është një pasqyrim i mungesës së transparencës sipas standardeve të një demokracie të provuar dhe përbën një problem lidhur me memorien për premtimet dhe mbajtjen e tyre.

Një gjetje tjetër në analizën tonë është realiteti i lidhur me pengesat dhe zvarritjet e miratimit të ligjeve të rëndësishëm dhe në kuadër të reformave, të cilët kalojnë mjaft pengesa nga një proces i rënduar ligjvënies, pasi betejat politike kanë ndikuar në kompromise dhe zvarritje të ligjeve të rëndësishme. Këto debate politike të zgjatura krijojnë pengesa që legjislacioni të ngadalësohet në mënyrë të konsiderueshme. Ndërkohë, një pjesë e konsiderueshme e programeve zgjedhore që vijnë më së shumti nga partitë që kërkojnë mandat shtesë nuk ka më tej frymën e gjithëpërfshirjes së premtimeve pjesërisht të besueshme apo të pamatshme, por vijon si një rutinë e proghrakmeve të nisura nga liderët e partive, por që kanë devijuar nga premtimet fillestare. Shembull për këtë janë programet e mëdha të infrastrukturës.

Ndërsa diskutojmë për besueshmërinë e premtimeve zgjedhore si dhe përmbushjen e tyre nga qeveria ne vërejmë se partitë politike nuk marrin në konsideratë në mënyrë të qartë dhe transparente problemin e informalitetit në ekonomi dhe të vjedhjes apo blerjes së votave, të cilat janë faktorë ndikuesë në hartimin e premtimeve. Ky fakt shikohet nga numri i madh i premtimeve të pamatshme, por edhe atyre që janë të matshme por pjesërisht të besueshme nisur nga mos patja e një reference afatgjatë ku ato të mbështeten.

Nga analiza e kauzave të partive të mëdha shikohet, se ndërsa janë në opozitë bëjnë premtime që tentojnë ti promovojnë si reformat e mëdha dhe të zbatueshme Brenda mandatit qeverisës, në fakt mungon llogaridhënia në rastet kur nuk është arritur të përmbushet premtimi. Raste të tilla janë premtimet për pronarët, për legalizimet, për ndërtimin e infrastrukturës ujore, për shëndetësinë, për arsimin, si dhe politika të tjera që lidhen me to.

Një tjetër dukuri që mendojmë se nuk ndeshet në premtimet elektorale mendojmë se duhet lidhur me një analizë të detajuar të gjithë programeve kombëtare dhe strategjive që do të vijnë më tej, për të patur një vijueshmëri të zhvillimit të projekteve, pavarësisht dëshirës për protagonizëm politik. Raste të tilla kemi ndeshur gjatë analizës së projekteve për arsimin, projekteve për shëndetin dhe atyre për ndërlidhjen dhe infrastrukturën, si dhe për projekteve për turizmin dhe bujqësinë. Një mungesë e kësaj stafete vjen nga fakti i moszbatimit me konsequencë të objektivave dhe plan veprimeve të strategjive sektoriale dhe kombëtare.

Në çdo qeverisje të re të formuar pas zgjedhjeve, referenca ndaj strategjive mbetet një faktor ndikues në premtimet e partive, por ndërsa ato mund të shërbejnë si udhërrëfyes nga analiza jonë shikohet se secila qeveri tenton të krijojë strategji të reja. Ky fakt ndikon në konsistencën e programeve buxhetore, si dhe në një vijimësi të pandikuar nga politika fragmentare. Një pjesë e strategjive ndoshta mund të jenë të nevojshme që të jenë detyrim aprovimi ligjor nga Kuvendi dhe jo vetëm të miratohen nga qeveria, pasi vetë qëllimi i strategjive është tentativa që të udhëheqë sektorët e vendit përtej mandatit të qeverisë dhe në disa raste ato parashikojnë veprime dhe politika edhe më shumë se ligjet.

Një qasje bazuar te strategjitë dhe programet kombëtare nevojitet që të jetë si reference në modelimin ekonomik dhe parashikimin konsensual të zhvillimeve të treguesve makroekonomikë. Edhe votuesit do të ishin më të informuar dhe të vëmendshëm, nëse referencat e premtimeve elektorale do të buronin nga strategjitë dhe programet kombëtare. Nëse do të kishim disa referenca të pandryshueshme dhe konsensuale nga të gjitha partitë, atëherë kjo do të jepte një ndikim edhe në qasje novatore lidhur me politikën fiskale. Kjo qasje novatore do të fillonte të përfshinte në ofertat elektorale edhe diskutimet për nevojën e rritjes së taksave (në vend të uljes së taksave), si një tendencë që ndihmon fuqizimin dhe konsolidimin fiskal dhe rritjen e përfitimeve nga buxheti.

SHTOJCA

PREMTIMET ELEKTORALE NË ZGJEDHJET POLITIKE 2009

PREMTIMET ZGJEDHORE TË PD, 2009

PREMTIME FISKALE DHE BUXHETORE

N r.	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				
			Program elektoral	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
1	160 mijë të punësuar ¹⁶ në mandatin e dytë (2009-2013)	±	Po	2009-2011 ¹⁷ 2010-2012 ¹⁸ 2011-2013 ¹⁹	S.PUNE SIMIT 2007- 2013 ²⁰	INSTAT ²¹⁻ 22 FMN ²³ OECD ²⁴ DCED ²⁵	Strategjia parashikon ≤ 123.000
2	Do nxjerrim nga varfëria 4 vitet e ardhshme edhe 300 mijë shqiptarë.	±	Po		M.SOCI ALE 2007- 2013 ²⁶	INSTAT ²⁷⁻ 28	Strategjia parashikon ≤ 240.000
3	Trifishojmë investimet në zonat rurale	±	Po	2009-2011 2010-2012 2011-2013	SKZHI 2007- 2013 ²⁹	PBA 2005- 2009 ³⁰	Strategjia nuk e parashikon këtë nivel rritje
4	Nuk do ketë pension në fshatra nën 100 dollarë	±	Po		SKZHI 2007- 2013	INSTAT ³¹ ISSH ³²	Strategjia nuk e parashikon këtë nivel

¹⁶ Sipas INSTAT, të punësuar janë personat në moshë pune që gjatë periudhës së referencës kanë patur një punë si të punësuar me pagë ose si të vetëpunësuar. Përfshihen edhe personat që kanë një punë por që kanë munguar përkohësisht në punë gjatë periudhës që shqyrtohet, për motive si sëmundje, trainim, leje lindje etj. Ndërsa, ISSH publikon një numër të siguarish në skemën e kontributeve deri 45% më pak se numri të punësuarve sipas INSTAT. Në këtë llogaritje të premtimeve do të ecet me të dhënat e raportimit të INSTAT, që lidhen edhe me Llogaritë Kombëtare etj.

¹⁷ <https://www.imf.org/external/np/seminars/eng/2008/alb/11.pdf>

¹⁸ https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2017/12/vendim_i_km_21_14_01_2009_2336_1.pdf

¹⁹ https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2017/12/vendim_i_km_4_07_01_2010_2337_1.pdf

²⁰ https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/05/strategjia_punesim.pdf

²¹ http://www.instat.gov.al/media/3072/dinamikat_e_tregut_t_pun_s_2001-2011.pdf

²² <http://www.instat.gov.al/media/1886/tregu-i-pun%C3%ABs-2009.pdf>

²³ <https://www.imf.org/External/Pubs/FT/irb/2016/03/index.pdf>

²⁴ <http://www.oecd.org/employment/leed/LEED-Flagship-Policy-Highlights.pdf>

²⁵ http://www.oit.org/wcmsp5/groups/public/---ed_emp/---emp_elm/documents/publication/wcms_143163.pdf

²⁶ https://www.crcal.com/sites/default/files/publications/Strategjia_ektoriale_e_mbrotjes_sociale2007-2013.pdf

²⁷ Agenda 2030-17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG)

²⁸ http://www.instat.gov.al/media/2063/anketa_e_matjes_se_nivelit_te_jeteses_2008.pdf

²⁹ <http://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/05/Strategjia-Kombetare-per-Zhvillim-dhe-Integrim2.pdf>

³⁰ <https://financa.gov.al/programi-buxhetor-afatmesem-ne-vite-2/>

³¹ http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START__SS/SS0008/table/tableViewLayout2/?rxid=ff4b0d2f-25b2-411d-9bc0-94e7c4d2ee4b

³² http://www.iss.gov.al/?page_id=75

5	Do të barazojmë pensionet e fshatit me pensionet e qytetit	±	Po		SKZHI 2007-2013	INSTAT ³³ ISSH	Strategjia nuk e parashikon këtë
6	Taksa e tabelës për bizneset do të përcaktohet me ligj dhe do të jetë vetëm 1 euro	√	Po			KUVEND ³⁴	Nuk ka strategji të posaçme
7	Investimet e huaja në Shqipëri do të çojmë në 8 miliard euro	±	Po	2009-2011 2010-2012 2011-2013	SKZHI 2007-2013	IHD ³⁵	IHD ne vitet 2005-2008 ≤ 660 mln. Euro
8	Për të nxitur punësimin në zonat e varfra heqim taksat për bizneset për 5 vjet ³⁶ .	±	Po		S. FINANC AT 2008-2013 ³⁷		Strategjia nuk e parashikon
9	Mandatin e ardhshëm asnjë shqiptar nën nivelin e 2 dollarëve në ditë	±	Po		M.SOCI ALE 2007-2013	INSTAT ³⁸ SKZHI 2007-2013	Strategjia parashikon zbritje ≤ 10%
10	Do të ndërtojmë banesa sociale dhe do të zgjidhim përfundimisht problemin e 450 familjeve	±	Po			KM	Nuk ka referenca të matshme
11	Rrogat dhe pensionet do të jenë dy herë më të larta se sa gjashtë vende anëtare të BE	?	Po				Nuk ka referenca

PREMTIME PËR SHËNDETËSINË

N r.	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				
			Program elektoral	Strategji	Tjetër dokument	Shënime	
1	Krijojmë partneritet publik-privat në shëndetësi	±	Po			KM	Nuk ka referenca të matshme
2	Luftojmë korrupsionin në sektorin e shëndetësisë	±	Po	STR.ANTI-KORRUPSION ³⁹			Nuk është e matshme
3	Shtrijmë sigurimet shëndetësore edhe në sektorin privat	√	Po	SKZHI			Përmendet te Strategjia

³³ http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START__SS/SS0008/table/tableViewLayout2/?rxid=56dc5722-03dd-4ddf-bb3c-75be71dc6a31

³⁴ <http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20181105112055Ligji%20per%20sistemin%20e%20taksave%20vendore.pdf>

³⁵ <https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2013/01/web-fdi-report-albanian.pdf>

³⁶ Qeveria merr përsipër kualifikimin, trajnimin dhe rikualifikimin e punëtorëve, paguan për ta primin dhe sigurimet shoqërore

³⁷ https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/05/strategjia_financave_publike1.pdf

³⁸ http://www.instat.gov.al/media/2064/shqiperi-trendi_i_varferise_2012_.pdf

³⁹ https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2013/01/kunder-korrupsionit-dhe-per-nje-qeverisje-transparente2008_2013.pdf

PREMTIME PËR ARSIMIN DHE RININË

N r.	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				
			Program elektoral	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
1	Dyfishojmë buxhetin për sektorin e arsimit në 8% të PBB	±	Po	PBA 2005-2009	SKZHI 2007-2013 S. P-UT. 2009-2013 ⁴⁰ STR. A. LARTE 2008-2013 ⁴¹		Nuk përmendet ky nivel
2	2 mijë vende shtesë në universitetet publike	√	Po		STR. A. LARTE 2008-2013		Përmendet te Strategjia
3	Bursë plus 100 mijë USD/vit për çdo të ri që fiton studimet në 1 nga 10 universitetet më të mira të planetit	√	Po	PBA 2005-2009	STR. A. LARTE 2008-2013		
4	Plani ynë është që asnjë fëmijë analfabet të mos jetë në Shqipëri	?	Po		S. P-UT. 2009-2013		Permendet zbutja, jo zhdukja
5	Çdo fëmijë që mbaron 9-vjeçaren të mund të vazhdojë gjimnazin	±	Po		S. P-UT. 2009-2013		Referencë e paqartë te Strategjia
6	Hapje ndaj sektorit privat në arsim	±	Po		S. P-UT. 2009-2013		
7	Në 2013 Shqipëria do të ketë 160 mijë studentë	?	Po				Nuk ka referencë
8	Internet në çdo familje brenda mandatit të ardhshëm	±	Po		S. SHOQ. INFORM. ⁴²		Nuk është e besueshme
9	Çdo i ri shqiptar të ketë kompjuterin e tij	?	Jo				Nuk ka referencë
10	Çdo i ri që kërkon punë të mund të punësohet	±	Po		S.PUNESI MIT 2007-2013		Nuk ka referencë të matshme
11	Çdo i ri që krijon familje të ketë mundësi të krijojë strehën e vet	±	Po		SKZHI 2007-2013		Nuk ka referencë
12	Nuk do ketë shkollë të mos jetë e re ose e rindërtuar	?	Po				Nuk ka referencë të matshme
13	Përhapja e të mësuarit e-learning apo mësimi dixhital	±	Po		S. P-UT. 2009-2013		Referencë e paqartë

⁴⁰ <http://planipolis.iiep.unesco.org/sites/planipolis/files/ressources/albania-strategy-pre-university-2009-2013-alb.pdf>

⁴¹ https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2012/12/skala_121_07_2008_5_511_1.pdf

⁴² https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/strategjia_versioni_i_printuar_shqip.pdf

PREMTIME POLITIKE

N r.	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria			
			Program elektoral	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
1	Liberalizim i plotë i regjimit të vizave brenda vitit të parë të mandatit të dytë	±	Po	SKZHI 2007-2013	PKIE 2007-2012 ⁴³	Referencë e paqartë
2	Çojmë para ligjit këdo që kërkon të mbushë xhepat me paratë tuaja	±	Po	SKZHI 2007-2013 S. ANTI-KORRUPSION 2008-2013		Referencë e paqartë dhe e pamatshme

PREMTIME PËR FSHATIN DHE BUJQËSINË

N r.	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria			
			Program elektoral	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument
1.	Urbanizojmë plotësisht gjithë pjesën e Myzeqesë	?	Po	PBA 2005-2009	S.ZH FIER ⁴⁴	Referenca e paqartë dhe e pamatshme
2.	4 vitet që vijnë do të pesëfishojmë rrënjët e ullirit në Shqipëri ⁴⁵	±	Po	PBA 2005-2009	S.B.U ⁴⁶	Nuk është si prioritet në keto nivele
3	Do të pesëfishojmë së paku grantet për prodhimet bujqësore	±	Po	PBA 2005-2009	S.B.U	Nuk është si prioritet në keto nivele
4	Investojmë 4 vitet e ardhshme për bujqësinë më shumë se në 70 vitet që shkuan	±	Jo	PBA 2005-2009	S.B.U ⁴⁷	Nuk është si prioritet në keto nivele
5	Çdo fshat do të ketë ujësjellësin e tij, çdo familje shqiptare do të ketë ujën brenda shtëpisë	±	Po	PBA 2005-2009	SKZHI 2007-2013	Referencë e paqartë dhe e pamatshme
6	Lidhim fshatrat e komunave me rrugë të asfaltuara me qendrat	±	Po	PBA 2005-2009	SKZHI 2007-2013	Referencë e paqartë dhe e pamatshme
7	Importet, nafta, plehrat rimbursim me skemën anti-korrupsion	?	Jo			Referenca e paqartë dhe e pamatshme
8	Financim çdo projekti për rritjen e prodhimit të fermerëve	±	Po	PBA 2005-2009	SKZHI 2007-2013	Referencë e paqartë dhe e pamatshme
9	Subvencionim naftës dhe importeve të tjera për sipërfaqet e mbjella	±	Po	PBA 2005-2009	SKZHI 2007-2013	Referencë e paqartë dhe e pamatshme

⁴³ <https://www.scribd.com/document/95283956/pkzmsa-2007-2012#download>

⁴⁴ http://www.co-plan.org/wp-content/uploads/2011/07/strategjia_fier.pdf

⁴⁵ Më vonë deklarohet se do mbillen 20 milion rrënjë ullinj

⁴⁶ https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/05/strategjia_e_bujqesise_dhe_ushqimit.pdf

⁴⁷ https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/05/strategjia_e_bujqesise_dhe_ushqimit.pdf

10	Rindërtim i plotë i sistemeve të vaditjes	?	Po				Referenca e paqartë dhe e pamatshme
11	Qeveria do ndërtojë dhe rindërtojë sistemin më modern të vadiljes	±	Po	PBA 2005-2009	SKZHI 2007-2013		Referencë e paqartë dhe e pamatshme
12	Me sistemin e kanalizimeve, pastrim i plotë i ujërave	±	Po	PBA 2005-2009	SKZHI 2007-2013		Referencë e paqartë dhe e pamatshme
13	Investime në agrobiznes dhe nxitje të përpunimit	±	Po	PBA 2005-2009			Referencë e paqartë dhe e pamatshme

PREMTIME PËR INFRASTRUKTURËN DHE VEPRAT PUBLIKE

N r.	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				Shënime
			Program elektoral	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	
1	Asfaltuam 6000 km rrugë, asfaltojmë mandatin tjetër edhe 12000 km po të kishte	±	Po	PBA 2005-2009	STR. E TRANSPORTIT. RTTT. 2008-2013 ⁴⁸	SKZHI 2007-2013	Nuk është si prioritet në këto nivele
2	Autostrada Qafë Plloçë - Qukës, e cila do të përfundojë në fund të vitit 2010	√	Po	PBA 2005-2009			Përmendet në PBA
3	Do të fillojmë ndërtimin e autostradës Tiranë-Elbasan	√	Po	PBA 2005-2009			Përmendet në PBA, me koncesion
4	Rruga e Gjinarit, asfaltim Librazh-Qafë Plloçë, hyrja e Gramshit, Kuçovë-Belsh-Cërrik	√	Po	PBA 2005-2009			Përmenden në PBA
5	Fillon ndërtimi i rrugës Baldushk-Papër	±	Po		STR. E TRANSPORTIT. RTTT. 2008-2013		Nuk matet dot, pasi referenca e paqartë
6	Shumë shpejt do të fillojë ndërtimin Boshti i Jugut që afron Sarandën me Tiranën	?	Po				Referenca e paqartë dhe e pamatshme
7	Ndërtojmë Parkun Industrial të Vlorës	±	Jo		STR. E TRANSPORTIT. RTTT. 2008-2013		Referencë e paqartë dhe e pamatshme
8	Vlora ndër portet më të mëdha të Mesdheut me 50 mijë të punësuar, 2 miliard euro investim	±	Jo	PBA 2005-2009	STR. E TRANSPORTIT. RTTT. 2008-2013		Referencë e paqartë dhe e pamatshme
9	Vlora do të ketë aeroportin e vet	±	Po	PBA 2005-2009	STR. E TRANSPORTIT		Përmendet te PBA dhe S.T

⁴⁸ https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2012/10/strategjia__transportit.pdf

					RTTT. 2008-2013		
10	Do të përfundojmë Rrugën e Arbrit	±	Po	PBA 2005-2009	STR. E TRANSPO RTTT. 2008-2013		Përmendet te PBA dhe S.T
11	Do të përfundojmë rrugën Kardhiq-Delvinë	±	Po	PBA 2005-2009	STR. E TRANSPO RTTT. 2008-2013		Përmendet te PBA dhe S.T
12	Tirana do të jetë në katër vite kryeqyteti me unazën më moderne dhe më të re në Europë	?	Po				Referenca e paqartë dhe e pamatshme
13	Qeveria do të mbështesë financimin projektit për ndërtimin dhe sistemimin e tregut çam	?	Jo				Referenca e paqartë dhe e pamatshme
14	Rrogzhina do të nisë së shpejti by pass-in e saj	±	Jo	PBA 2005-2009			Përmendet te PBA
15	Inaugurojmë Velipojë-Ulqin, së shpejti rruga Koman-Ferizë, së shpejti bypass i Shkodrës dhe Unaza e liqenit tuaj madhështor	±	Po	PBA 2005-2009	STR. TRANSPO RTTT 2008-2013		Përmendet te PBA dhe S.T, por referencat janë të paqarta
16	Do të ndërtojmë rrugën e re Tiranë - Krujë - Qafë Shtamë	±	Jo	PBA 2005-2009			Përmendet te PBA

PREMTIME PËR ENERGJINË

N r.	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				
			Program elektoral	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
1	Mandatin e dytë Shqipëria eksportues i rëndësishëm i energjisë elektrike në Ballkan	?	Po				Nuk ka referencë dhe nuk mund të matet
2	60 mijë të punësuar në hidrocentralet në gjithë Shqipërinë	?	Po				Nuk ka referencë dhe nuk mund të matet
3	Filloi ndërtimin Parku energjetik në Lezhë me ndërtimin e centralit me biomasë të lëngshme 140 MWH, investim 1.1 miliard euro	?	Po				Nuk ka referencë dhe nuk mund të matet
4	Kemi gati 5.6 miliard euro investime në 104	?	Po				Nuk ka referencë dhe

	hidrocentrale, në 6 parqe industriale, në 4 parqe energjetike						nuk mund të matet
5	Shfrytëzimi i potencialeve ujore dhe Shqipëria superfuqi të vogël energjetike në rajon	±	Po		S. ENERGI 49		Përmenden potencialet, e pamatshme
6	Nuk do të ketë ndërprerje të energjisë për mungesë të saj	?	Po				Nuk ka referencë dhe nuk mund të matet

PREMTIME TË PËRGJITHSHME

N r.	Premtimi elektoral	Vlerësi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				Shënime
			Program elektoral	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	
1	Katër vitet që vijnë nuk do të ketë familje shqiptare që të mos ketë ujë 24 orë	?	Po				Nuk ka referencë dhe nuk mund të matet
2	Do të dyfishojmë prodhimin e naftës në katër vitet që vijnë	±	Po		S. ENERGI		Përmenden versionet, e pamatshme
3	Do të shkurtojmë 5 vite pensionin e minorëve dhe me efekt prapaveprues	±	Po			KM	Nuk është e matshme
4	Të gjitha blerjet e qeverisë do të bëhen në mënyrë elektronike	±	Po		S. SHOQ. INFORM		Përmendet te Strategjia, nuk matet dot
5	Do të krijojmë Qendrën Kombëtare, sportelin unik	±	Po		SKZHI 2007-2013		Përmendet vetem te Strategjia
6	80% të vlerës për legalizimet mund të paguhet me letra me vlerë	?	Po				Nuk është e matshme
7	Ligji i parë që do miratojmë është ai për Gjykatën Administrative	±	Po				Nuk ka referencë dhe nuk mund të matet
8	Nuk do përdorim ndonjëherë vlerë tjetër përveç vlerës së tregut për kompensimin monetar apo fizik të pronarëve	?	Po				Nuk ka referencë dhe nuk mund të matet

⁴⁹ http://www.aidharmonisation.org/al/skedaret/1203091412-Strategjia%20Sektoriale%20e%20Energjise_shqip_2007.pdf

PREMTIMET ZGJEDHORE TË PS, 2009

PREMTIMET FISKALE DHE BUXHETORE

N r.	Premtimi elektoral	Vlerësi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				Shënime
			Program politik	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	
1	Brenda 50 ditëve të para të mandatit do të prezantohet një paketë antikrizë	±	Po				Nuk ka referencë dhe nuk mund të matet
2	Do të bëjë të prekshme 197,000 mundësi të reja punësimi	±	Po	KMF 2009-2011	S.PUNESI MIT 2007-2013	INSTAT FMN OECD DCED	Strategjia parashikon ≤ 123.000
3	Ritme më të larta rritjeje ekonomike, për vitet 2011-2013 do të jetë mbi 6%	±	Po	KMF 2009-2011			Përmendet te KMF. Nuk mund të matet
4	Ulje e papunësisë në 9%	±	Po	KMF 2009-2011	S.PUNESI MIT 2007-2013		Nuk ka reference të matshme
5	Inflacion jo më shumë se 3% në vit.	√	Po	KMF 2009-2011		Raporti BSH 2008 ⁵⁰	
6	Deficit buxhetor jo më shumë se 3%	√	Po	KMF 2009-2011 PBA 2005-2009	SKZHI 2007-2013		
7	Borxhi publik në vitin 2013 jo më shumë se 50% e PBB	√	Po	KMF 2009-2011 PBA 2005-2009	SKZHI 2007-2013		
8	Borxh publik vetëm për investime	±	Po			KM KUVENDI	Nuk ka reference të matshme
9	Politika fiskale lehtësuese e nxitëse për teknologjitë moderne	?	Po				Nuk ka reference të matshme
10	Transparencë maksimale për çdo politikë fiskale dhe buxhetore	±	Po			KM	Nuk ka reference të matshme
11	Bashkëpunim maksimal dhe efikas me Institucionet Financiare Ndërkombëtare	±	Po	PBA 2009-2011	SKZHI 2007-2013		Nuk ka reference të matshme në këto nivele
12	Do të përgjysojmë nivelin e papunësisë në fshat dhe deri në fund të mandatit tone	±	Po		S.PUNESI MIT 2007-2013		Nuk ka reference të matshme në këto nivele
13	Do të mbështesim veçanërisht punësimin e të rinjve dhe grave	±	Po		SKZHI 2007-2013		Nuk ka reference të

⁵⁰ https://www.bankofalbania.org/Botime/Botimet_sipas_viteve/Raporti_Vjetor_2008.html

							matshme në këto nivele
14	Deri në vitin 2013 do të eliminohet puna e fëmijëve nën 16-vjeç në sektorin formal	±	Po		S.PUNESI MIT 2007-2013		Nuk ka reference të matshme në këto nivele
15	Do të ulet informaliteti e parandalohet shfrytëzimi i fëmijëve në ekonominë gri	±	Po		SKZHI 2007-2013		Nuk ka reference të matshme në këto nivele
16	Do të eliminojmë çdo vonesë në rimbursimin e TVSH dhe çdo taksë dhe tatimi të paguar më tepër	±	Po		S.FINANC A 2008-2013	Ligji TVSH ⁵¹	Nuk ka qartësi për veprimet
17	Rimbursimit të TVSH do t'i shtojmë incentivat fiskale për importin e makinerive të reja dhe investimet	√	Po			Ligji TVSH ⁵² Kodi Doganor ⁵³	
18	Nxitje vetdeklarimit, çinstalim i sistemit të referencave, garantohej rimbursimi i TVSH-së	√	Po			Ligji TVSH Kodi Doganor	
19	Do të heqim çdo ngarkesë fiskale për importet e teknologjive moderne dhe për ekonominë e dijes	?	Po				Nuk ka reference të matshme
20	Do të shfuqizojmë dhe hedhim poshtë ligjet anti – biznes	?	Po				Nuk ka reference të matshme
21	Rishikimi dhe përmirësimi sa më parë i çdo ligji ekonomik dhe fiskal që ka rritur vështirësitë për biznesin dhe ka inkurajuar abuzivitetin e administratës fiskale	?	Po				Nuk ka reference të matshme
22	Asnjë ligj dhe akt ligjor, nuk do të miratohet nga Parlamenti dhe qeveria pa u diskutuar me transparencë me komunitetin e biznesit dhe grupet e interesit	√	Po		SKZHI 2007-2013	KM	
23	Do të mbështesim marrëveshjet për ristrukturim të kredive të këqija midis bankave dhe	√	Po		SKZHI 2007-2013	KM	

⁵¹ <https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=427>

⁵² <https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=427>

⁵³ <http://dogana.gov.al/dokument/324/ligji-nr-8449-date-27-01-1999-per-kodin-doganor-te-republiken-e-shqiperise>

	biznesit dhe do të propozojmë krijimin e një fondi garancie për likuiditet						
24	Do ti jepet fund praktikave fiskale antiligjore e korruptive që rëndojnë bizneset	?	Po				Nuk ka reference të matshme

PREMTIMET PËR SHËNDETËSINË

Nr.	Premtimi elektor	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				Shënime
			Program politik	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	
1	Do të ofrojmë mbulim universal me shërbim shëndetësor për të gjithë shqiptarët ⁵⁴	?	Po				Nuk ka reference të matshme
2	Shërbimi shëndetësor që ne do të ngremë do të shtrihet në të gjithë vendin ⁵⁵	±	Po		SKZHI 2007-2013		Nuk ka reference të matshme
3	Do t'u ofrojmë qytetarëve tanë, vëmendje ⁵⁶	√	Po		SKZHI 2007-2013		
4	Do të koordinojmë sistemin e vërtetë publik me atë privat	√	Po		SKZHI 2007-2013		
5	Do të ofrojmë shërbime të sigurta ⁵⁷	±	Po		SKZHI 2007-2013		Nuk ka reference të matshme
6	Do të vlerësojmë, akreditojmë dhe monitorojmë çdo ofrues të shërbimit shëndetësor publik dhe privat	√	Po		SKZHI 2007-2013		
7	Do të mundësojmë që të gjitha barnat në Shqipëri të shiten kudo njësoj dhe jo më shtrenjtë sesa në tregun e vendit të origjinës	?	Po				Nuk ka reference të matshme
8	Do të rrisim cilësinë dhe sigurinë e barnave ⁵⁸	±	Po		SKZHI 2007-2013		Nuk ka reference të matshme

⁵⁴ pavarësisht nga të ardhurat e tyre, gjendja shoqërore, vendbanimi, gjinia apo mosha. Edhe pse një pjesë me peshë e forcës së aftë për punë në marëdhënie pune nuk është e mbuluar me sigurime shëndetësore përsëri cdo individ do përfitojë nga shërbimi shëndetësor, nuk ka rëndësi nëse është i siguar apo jo

⁵⁵ do të mbështesë në të gjitha hallkat e ecurisë së kujdesit për shëndetin

⁵⁶ gjatë gjithë zinxhirit të shërbimeve që ata kanë nevojë përfshirë parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin

⁵⁷ku qytetarët do të kenë mundësinë të zgjedhin midis shërbimit shëndetësor publik apo atij privat

⁵⁸ duke shtuar kujdesin për indikacionet e barnave në përputhje me standardet europiane

9	Programi për shëndetësinë zgjidhje për parandalim, diagnostikim, kurim dhe rehabilitim	√	Po		SKZHI 2007-2013		Nuk ka reference të matshme
10	Me mjekët e talentuar e të përkushtuar shqiptarë ne do të rindërtojmë shëndetësinë shqiptare	?	Po				Nuk ka reference të matshme
11	Do të rivendosim besimin e tradhëtuar të shqiptarëve për shëndetësinë	?	Po				Nuk ka reference të matshme
12	Do të rivendosim dinjitetin e nëpërkëmbur të mjekëve	?	Po				Nuk ka reference të matshme
13	Do t'u ofrojmë mjekëve dhe infermierëve tanë njohuritë, shpërblimin dhe teknologjitë e nevojshme	±	Po		SKZHI 2007-2013		Nuk ka referencë për veprimet
14	Do të financojmë më shumë për shëndetin publik dhe programet e parandalimit	±	Po		SKZHI 2007-2013		Nuk ka reference të matshme në PBA
15	Do të reduktojmë sorollatjet dhe radhët duke përmirësuar planifikimin dhe koordinimin	±	Po		SKZHI 2007-2013		Nuk ka reference të matshme

PREMTIMET PËR ARSIMIN

N r.	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				Shënime
			Program politik	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	
1	Do ta çojmë minimum 5% kontributin e buxhetit për arsimin	±	Po	PBA 2005-2009		Buxheti 2009 ⁵⁹	Nuk gjendet te Strategjia. Paqartësi për veprimet
2	Abetaren dhe librat e shkollës do t'i japim falas për të gjithë fëmijët e varfër, jo me rimbursim, por drejtë e në dorë	±	Po				Nuk ka reference të matshme
3	Do ti japim vlerë diplomave duke bërë në 4 vjet më shumë se sa është bërë në 18 vjet	?	Po				Nuk ka reference të matshme
4	Unifikojmë modelin e programeve mësimore me Kosovën	±	Po				Nuk ka reference të matshme

⁵⁹ <https://www.financa.gov.al/buxheti-2009/>

5	Rritje e nivelit të frekuentimit të çerdheve dhe kopshteve deri në 40% për grupmoshën 0-3 vjeç	?	Po				Nuk ka reference të matshme
6	Do ta shndërrojmë Normalen e Elbasanit në një gjimnaz si gjithë të tjerët	√	Po			KM	
7	Mbështetje të biznesit, që ka të bëjë me sistemin e taksave apo investimeve në fushën e arsimit dhe formimit profesional	±	Po		S. P-UT. 2009-2013		Nuk ka reference të matshme
8	Unifikimi i vërtetë i programeve tona shkollore me ato të Europës, për ta përmbushur kështu ëndrrën që përkund çdo prind shqiptar për bijtë e vet!	±	Po		S. P-UT. 2009-2013		Nuk ka reference të matshme
9	Shkollimi me laboratorë moderne e mjete didaktike funksionale ⁶⁰	±	Po		S. P-UT. 2009-2013		Përmendet te Strategjia, e pamatshme
10	Shpërblimi real i punës së arsimtarëve, duke mos u ndalur vetëm te paga po edhe te rivendosja e dinjitetit të tyre	±	Po		S. P-UT. 2009-2013		Përmendet te Strategjia, e pamatshme
11	Politika në raportin sistem publik–sistem privat, e sheh privatin si partner të shtetit drejt synimit të përbashkët	±	Po		S. P-UT. 2009-2013		Nuk ka reference të matshme
12	Do të lindë edhe arsimiti i vërtetë profesional në Shqipëri ⁶¹	±	Po		S. P-UT. 2009-2013		Përmendet te Strategjia, e pamatshme
13	Shkollimi i gjithsekujt sipas talentit dhe aftësisë ⁶²	±	Po		S. P-UT. 2009-2013		Përmendet te Strategjia, e pamatshme
14	Do ta shpallim armik e do ta luftojmë me forcë të paparë analfabetizmin	±	Po		S. P-UT. 2009-2013		Nuk ka reference të matshme
15	Do të nisë epoka e re e rilindjes së Arsimit të çliruar nga zinxhirët e interesave politike	?	Po				Nuk ka reference të matshme

⁶⁰ ku mësues e pedagogë nuk detyrohen më të shpjegojnë me gishta

⁶¹ për ti ofruar biznesit punëtorë të kualifikuar dhe mundësi që ai të eci

⁶² duke e shndërruar shkollën në një kultivuese të vërtetë dhuntish e mundësish

PREMTIMET PËR FSHATIN DHE BUJQËSINË

N r.	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				
			Program politik	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
1	Do të ngremë një ministri të posaçme për fshatin që do të quhet Ministria e Zhvillimit Rural	±	Po		KM		Nuk ka reference të matshme
2	Do dyfishojmë menjëherë buxhetin e bujqësisë	±	Po	PBA 2005-2009		BUXHETI 2009	Nuk ka reference të matshme
3	Asnjë bujq dhe fermer pa certifikatën e pronësisë mbi token	±	Po		S.B.U		Përmendet te Strategjia, por jo nivelit
4	Biznesi Agrar do të përjashtohet nga taksat për 3 vite ⁶³	?	Po				Nuk ka reference të matshme
5	Synojmë rritjen e ekonomisë rurale me aktivitete si: agroindustria, turizmi, bimët e egra dhe medicinale, produktet bio dhe artizanale, peshkimi, pyjet, gjetia dhe agroturizmi	±	Po		S.B.U		Përmendet te Strategjia. Nuk ka reference të matshme
6	Çdo pronë që është e lirë do t'i kthehet pronarit, çdo tokë që është marrë me ligjin 7501, do t'i jepet menjëherë me letër dhe vulë pronarëve të saj, që janë ata që e kanë marrë me ligjin 7501	±	Po		S.B.U	SKZHI 2007-2013	Përmendet te Strategjia. Nuk ka reference të matshme
7	Do të subvencionojmë prodhimet bujqësore, që sot nuk arrijnë të shkojnë dot në tregun e qytet	?	Po				Nuk ka reference të matshme
8	Do të reduktojmë koston e lartë të prodhimeve, duke zhdukur akcizën e naftës	±	Po			L.AKCIZES	Nuk ka reference të matshme
9	Nafta për prodhimin në fshat do të jetë pa akcizë	±	Po			L.AKCIZES	Nuk ka reference të matshme
10	Do të ngremë një Agjenci të Biznesit Agrar, e cila do të ketë si funksione kryesore, monitorimin dhe garantimin e cilësisë së	√	Po			KM	

⁶³ Do të mbështesim prodhimin vendas nëpërmjet zhvillimit, profilizimit dhe konsolidimit të Biznesit Agrar në një treg funksional

	farave, fidanëve, pesticideve, të fertilizuesve						
11	Do të ndërtojmë dhe aprovojmë në Parlament “Kodin e Tokës”	√	Po			KM KUVENDI	
12	Do të përfundojmë regjistrimin në të gjitha zonat kadastrale të vendit	±	Po		S.B.U		Paqartësi për veprimet
13	Do ta nxitim zhvillimin e tregut të tokës, duke ofruar qoftë lehtësi fiskale, qoftë lehtësi procedurale	±	Po		S.B.U		Paqartësi për veprimet
14	Do të ndërtojmë një sistem të administrimit të tokës, duke unifikuar gjithë informacionin dhe duke ristrukturuar qoftë kadastrën ligjore ⁶⁴	√	Po		S.B.U		
15	Bizneset agrare të reja ne do t'i përjashtojmë nga çdo tatim fitimi dhe çdo taksë në 3 vitet e para	?	Po				Nuk gjendet referenca. Paqartësi për veprimet
16	Inventarizim i plotë i pronës në tërësi dhe tokave bujqësore	√	Po		S.B.U		
17	Dhënie e certifikatave të pronësisë atyre që u takon me ligj	±	Po		S.B.U		Paqartësi për veprimet
18	Mbyllim procesin e certifikimit të pronësisë mbi tokën bujqësore mbi bazën e ligjit 7501	±	Po		S.B.U		Paqartësi për veprimet
19	Rritja e mirëqenies në fshat dhe garantimi i pronës dhe i sigurisë social-ekonomike	±	Po		S.B.U		Nuk ka reference të matshme
20	Asnjë familje shqiptare në fshat pa ndihmën e shtetit, duke filluar nga nënat e reja që fitojnë lejen e barrëlindjes	?	Po				Nuk ka reference të matshme
21	Asnjë bujk, fermer e peshkatar pa shtetin pranë për të ulur kostot e prodhimit dhe garantuar infrastrukturën e tregut të shitjes së tij	?	Po				Nuk ka reference të matshme
22	Arsimim profesional për të rejtat e të rinjtë e fshatit, shërbim shëndetësor për të	±	Po		S.B.U		Nuk ka reference të matshme

⁶⁴ që është Zyra e Regjistrimit të Pasurive, por nga ana tjetër duke krijuar Kadastrën Shumëqëllimshme

gjithë dhe një plan tërësor për rindërtimin e marrëdhënieve mes fermerit e shtetit						
------------------------------------------------------------------------------------	--	--	--	--	--	--

PREMTIMET PËR MJEDISIN

N r.	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				Shënime
			Program politik	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	
1	Do të mbjellim në Shqipëri më shumë pemë se ç'janë mbjellë në këto 18 vjet të marra së bashku	±	Po			KM	Nuk gjendet referenca. Paqartësi për veprimet
2	Do ta pastrojmë Shqipërinë nga plehrat e kudondodhura nëpër rrugët urbane dhe ato kombëtare e nga mbeturinat urbane	±	Po			KM	Nuk gjendet referenca. Paqartësi për veprimet
3	Integrim të komponentes mjedisore në politikat ekonomike të zhvillimit të vendit	?	Po				Nuk ka reference të matshme
4	Adoptim të politikave që mundësojnë shfrytëzimin racional e të qëndrueshëm të natyrës	?	Po				Nuk ka reference të matshme
5	Ndërrhyrje energjike me faktorë financiarë, menaxhues dhe instrumente ligjorë për të penguar degradimin e natyrës	?	Po				Nuk ka reference të matshme
6	Mbrojtje të mjedisit me një përqsasje të re, duke e konsideruar dhe menaxhuar atë në mënyrë integrale	?	Po				Nuk ka reference të matshme
7	Partneritet serioz në bashkëpunimet bilaterale dhe multilaterale ⁶⁵	±	Po		S.S.T. 2007-2013 ⁶⁶	KM	Nuk ka reference të matshme
8	Arritje të standardeve mjedisore, për rehabilitimin e zonave të ndotura, të pyjeve, për uljen e ndotjeve në ajrin urban, në ujërat	±	Po		S.S.T. 2007-2013		Nuk ka reference të matshme

⁶⁵ si dhe me konventat ndërkombëtare për të përmbushur, jo thjesht në letër detyrimet që rrjedhin prej tyre

⁶⁶ <http://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/06/Strategjia-e-Turizmit-2007-2013.pdf>

	sipërfaqësore dhe për zvogëlimin e erozionit						
9	Do ta ndalim këtë shkatërrim, pasuritë tona të përbashkëta t'i vemë në dispozicion të shoqërisë ⁶⁷	?	Po				Nuk ka reference te matshme
10	Asnjë qesë plastike nuk do të hidhet më në Shqipëri, plazhe, lumenj, rrugë, parqe, oborre	±	Po			KM	Nuk gjendet referenca. Paqartësi për veprimet

PREMTIMET PËR MBROJTJEN SOCIALE

N r.	Premtimi elektorale	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				
			Program politik	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
1	Do të shpallim edhe minimumin jetik ⁶⁸	?	Po				Nuk gjendet referenca. Paqartësi për veprimet
2	Brenda mandatit të ardhshëm qeverisës, do të 4-fishojmë ndihmën ekonomike për shtresat në nevojë	±	Po	PBA 2005-2009			Nuk gjendet referenca. Paqartësi për veprimet
3	Angazhohemi për një politikë të re që do të rimëkëmbë arsimin, ku librat e shkollës do t'i japim falas për çdo fëmijë të varfër	±	Po	PBA 2005-2009		KM	Nuk ka reference të matshme
4	Do krijojmë Fondin e Integritimit Social ⁶⁹	±	Po	PBA 2005-2009			Nuk gjendet referenca. Paqartësi për veprimet
5	Do të përgjysmojmë nivelin e varfërisë në vend brenda mandatit	±	Po	PBA 2009-2011	S.M.SOCIALE 2008-2013 S.P.SOCIALE 2008-2013	SKZHI 2007-2013	Permenden te Strategjite. Paqartësi per veprimet
6	Duam që të krijojmë për çdo shqiptar e shqiptare, Kartën Sociale ⁷⁰	±	Po		S.M.SOCIALE 2008-2013		Nuk gjendet referenca.

⁶⁷ duke ndryshuar rrënjësisht dhe marrëdhëniet me zonat rurale

⁶⁸ nuk do të lejojmë që të ketë familje shqiptare nën minimumin jetik, duke filluar nga pagesa e papunësisë, që së paku do ta dyfishojmë

⁶⁹ Ky fond brenda 2010 do bëjë që familjet e varfëra të përfitojnë 50% më shumë. Në 2011 përfitimi do të jetë dyfish. Në fund të mandatit të parë përfitimi i ndihmës ekonomike 4 herë më i madh

⁷⁰ e cila është një kartë që në bazë të profilit individuale dhe gjendjes shoqërore e ekonomike, t'i japë mundësi çdo qytetari e qytetareje të përfitoj në mënyrë të thjeshtë dhe tërësisht transparente shërbime e kujdes social e shëndetësor, arsimor, apo kulturor

							Paqartesi për veprimet
7	Komision për identifikimin e nevojave dhe të problemeve që ka komuniteti egjiptian	±	Po		S.M.SOCIA LE 2008-2013		Nuk gjendet referenca. Paqartësi për veprimet
8	Një mekanizëm që me të vërtetë fëmijët jetimë pa nënë ose pa baba, të garojnë të barabartë në fushën e jetës me të gjithë fëmijët e tjerë	?	Po				Nuk ka reference të matshme
9	Zëvendësojmë ndihmën ekonomike si lëshime me ndihmën si mundësi reale për punësim	?	Po				Nuk ka reference të matshme
10	Rritje e punësimit dhe shërbimeve sociale për gratë dhe vajzat	?	Po				Nuk ka reference të matshme
11	Do të rishikohet sistemi i vlerësimit të paaftësisë, duke kaluar nga një vlerësim thjesht mjekësor, në vlerësim mjekësor dhe social	±	Po		S.M.SOCIA LE 2008-2013	SKZHI 2007-2013	Nuk gjendet referenca. Paqartësi për veprimet
12	Individët që u shërbejnë personave me aftësi të kufizuara, vitet që kalojnë pranë tyre do tu llogariten si vite pune për efekt pensioni	±	Po		S.M.SOCIA LE 2008-2013	SKZHI 2007-2013	Nuk gjendet referenca. Paqartësi për veprimet
13	Rritje e rimbursimit të karburantit për personat me aftësi të kufizuara	?	Po				Nuk ka reference të matshme
14	Punësimi do të jetë për ne kryefjala e përpjekjes tonë dhe çdo njeri i papunë do të jetë njeri nga ne që ka nevojë për ndihmë	±	Po		S.M.SOCIA LE 2008-2013		Nuk ka reference të matshme
15	Ndryshim radikal në treguesit statistikor të pjesëmarrjes së grave në politikë dhe ekzekutiv	?	Po				Nuk ka reference të matshme

PREMTIMET PËR MINATORËT

N r.	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria			
			Program politik	Strategji	Tjetër dokument	Shënime

1	Do të përcaktojmë kufirin e veçantë për pension për moshën e minatorëve ⁷¹	?	Po		KM	Nuk ka referenca të matshme.
2	Ne angazhohemi solemnisht përpara jush se ajo kërkesë legjitime e kahershme, që ka të bëjë me statusin e minatorit, do të merret nga ne parasysh ⁷²	√	Po	PBA 2009-2013		
3	Për kategorinë e atyre që nuk punojnë dot dhe nuk e kanë arritur moshën e pensionit, nuk do i japim më trajtimin e veçantë prej 6.500 lekësh, por pensionin minimal	√	Po	PKIE 2007-2012 ⁷³		
4	Do t'u lidhen pensione fëmijëve të minatorëve për dhënien fund të trajtimit të tyre nga koncesionarët pa kushte pune	√	Po		KM	
5	Do t'i qëndrojmë mbi kokë për ditë çdo koncesionari, çdo sipërmarrësi që ka një kontratë me shtetin për shfrytëzimin e minierave ⁷⁴	±	Po	S.M.SOCIAL E 2008-2013		Nuk ka referenca të matshme.
6	Masa për kushtet elementare të sigurisë në miniera	±	Po	S.M.SOCIAL E 2008-2013		Nuk gjendet referenca. Paqartësi për veprimet

PREMTIMET PËR EMIGRANTËT

N r.	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria			
			Program politik	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
1	Ne do të lidhim marrëveshje me Greqinë dhe Italinë për njohje reciproke të periudhës së sigurimit për efekt pensioni	√	Po		KM KUVENDI	
2	Krijimi i mundësive për të votuar jashtë Shqipërie është një objektiv i plotësueshëm i yni pas 28 qershorit ⁷⁵	±	Po	PKIE 2007-2012		Nuk gjendet referenca. Paqartësi për veprimet
3	Kanali i dytë i televizionit publik për mësimin e gjuhës shqipe në	√	Po		LIGJI PER RADION DHE TV ⁷⁶	

⁷¹ për minatorët ne do ta frenojmë moshën e pensionit qysh në janarin e vitit 2010

⁷² dhe do të kthehet në realitet në 100 ditët e para të qeverisjes sonë

⁷³ <https://www.scribd.com/document/95283956/pkzmsa-2007-2012>

⁷⁴ dhe do të kërkojmë kushte të standardeve europiane, mbi dhe nën tokë

⁷⁵ Vota e emigrantëve është një mungesë e qënësishme në procesin tonë demokratik. Hera e fundit që për të shprehur vullnetin tuaj juve duhet të bëni rrugë për të shkuar në qytetin apo fshatin tuaj në Shqipëri, herën tjetër ne do të garantojmë votën tuaj nga këtu ku jeni

⁷⁶ <https://www.infocip.org/al/?p=6594>

	çdo cep të globit ku jetojnë shqiptarë					
4	Transformim i shërbimeve në ambasada dhe konsullata për shqiptarët e shqiptarët	±	Po		SKZHI 2007-2013	Nuk gjendet referenca. Paqartësi për veprimet
5	Emigrantët e emigrantet shqiptarë të mund të aplikojnë dhe të marrin pasaportën biometrike ⁷⁷	√	Po	L.PASAPOR ⁷⁸	M.JASHTM E ⁷⁹	
6	Paketë stimuluuese për investimet në ekonominë rurale ⁸⁰	±	Po	PKIE 2007-2012		Nuk ka referenca të matshme.
7	Do të bëjmë gjithçka me qeverinë greke për të rritur numrin e shkollave shqipe	?	Po			Nuk ka referenca të matshme.

PREMTIMET PËR INTEGRIMIN

N r.	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria			
			Program politik	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
1	Kemi parashikuar hapa konkretë që përmbushin detyrimet për liberalizimin e vizave brenda 6 muorit të parë të qeverisjes	±	Po	PKIE 2007-2012		Nuk ka referenca të plota.
2	Do marrë të gjitha masat ⁸¹ dhe do ketë angazhimin maksimal për ta bërë vendin tonë anëtar të BE	±	Po	PKIE 2007-2012	KM	Nuk ka referenca të matshme.
3	Do të përshpejtojmë reformat që synojnë menaxhimin në mënyrë të decentralizuar të fondeve të para aderimit ⁸²	?	Po			Nuk ka referenca të matshme.

PREMTIMET PËR LEGALIZIMET DHE PRONAT

N r.	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria			
			Program politik	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
1	Legalizimet, ne do t'i kryejmë brenda mandatit tonë të parë ⁸³	±	Po		SKZHI 2007-2013	Nuk ka referenca të matshme.

⁷⁷ në një sërë sportesh kryesore, në Evropë, Amerikë, Kanada,

⁷⁸ <https://www.vendime.al/wp-content/uploads/2015/07/Ligj-Nr.8668-dat-23.10.2000-i-perditesuar.pdf>

⁷⁹ http://www.punetejashtme.gov.al/files/userfiles/Sherbime_Konsullore.pdf

⁸⁰ të të gjithë atyre burrave dhe grave, djemve dhe vajzave, emigrantë që çojnë kursimet e tyre drejt fshatit ku jeton familja e tyre

⁸¹ Qeveria e re, e cila ka në themel të programit të saj integrimin e vendit

⁸² që kanë të bëjnë me zhvillimin rajonal, rural dhe zhvillimin e burimeve njerëzore

⁸³ Mbyllje e plotë e procesit të legalizimeve të shtëpive dhe hapjen e një fondi të posaçëm për kanalizimet, ujësjellësit, rrugët, çerdhjet, kopshtet, shkollat dhe gjithçka duhet

2	Që në vitin e parë, do të rregullojë të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore, lidhur me qeramarrjen e tokës, me shitblerjen e tokës dhe me ruajtjen e tokës ⁸⁴	±	Po		SKZHI 2007-2013	
3	Inventarizim i plotë i pronës duke i dhënë fund abuzimit dhe korrupsionit qeveritar	±	Po		SKZHI 2007-2013	
4	Do të fillojë fundi i kaosit për hapësirat informale, investime në kanalizime, rrugë, ndriçim, çerdhe, kopshte e shkolla	?	Po			Nuk ka referenca të matshme.
5	Komitet Shtetëror të Zhvillimit të Rrethinave ⁸⁵	√	Po		LIGJI PER KM ⁸⁶	Kopetenca e përcaktuar ne ligj
6	Ndëshkim për abuzimet dhe korrupsionin me pronat	±	Po	S. ANTI-KORRUPSIO N 200-2013		Nuk ka referenca të matshme.

PREMTIMET POLITIKE

N r.	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria			
			Program politik	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
1	Auditim keqpërdorimit të fondeve të buxhetit për reklama dhe spote qeveritare	√	Po		L. AUDITIMIT BRENDSEHEM ⁸⁷	
2	Do ta zhveshim administratën publike nga “sistemi i favoreve politike e korruptive” ⁸⁸	?	Po			Nuk ka referenca të matshme.
3	Do të mundësohet një reformë reale në drejtësi me konsensus publik dhe institucional	±	Po	PKIE 2007-2012		Paqartësi për veprimet
4	Do korrigojmë dëmet e shkaktuara nga legjislacioni antikushtetues, pa fuqi juridike	?	Po			Paqartësi për veprimet
5	Do marrë fund sjellja mbytëse ndaj sipërmarrjes dhe pozicionet monopoliste	?	Po			Nuk ka referenca të matshme
6	Bëjmë gjithçka për të forcuar pavarësinë kushtetuese e financiare të sistemit gjyqësor	±	Po	PKIE 2007-2012		Paqartësi për veprimet

⁸⁴ PSSH shpreh edhe njëherë besimin se zgjidhja përfundimtare e ceshtjes së pronës do të takojë qeverisjes së saj të pas zgjedhjeve, harmonizimit të interesave të pronarëve me ato të të gjithë shqiptarëve

⁸⁵ për t’iu dhënë të gjithë të ardhurave që jetojnë në mjerimin e zonave informale, politikën e re të integritimit urban

⁸⁶ <http://dap.gov.al/legjislacioni/per-administraten-publike/49-ligj-nr-9000-date-30-01-2003-per-organizimin-dhe-funkcionimin-e-keshillit-te-ministrave>

⁸⁷ <http://www.ikub.al/LIGJE/302130008/Article-Per-Auditimin-e-Brendshem-ne-Sektorin-Publik-.aspx>

⁸⁸ Kush përdor paratë publike në kundërshtim me ligjet do përgjigjet penalisht. Do të lëvizim dhe do të vijmë tek ju, për t’ju folur dhe dëgjuar e për të vendosur së bashku edhe nesër kur të jemi në qeveri

7	Harta e investimeve në rrugët para e pas 2005, por edhe transparencë abuzimeve	√	Po	PBA 2002-2009	SKZHI 2007-2013	
---	--------------------------------------------------------------------------------	---	----	---------------	-----------------	--

PREMTIME TË PËRGJITHSHME

N r.	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria			
			Program politik	Strategji	Tjetër dokument	Shënime
1	Zgjidhje për situatën monopol në tregun e hidroarbureve	?	Po			Nuk ka referenca të matshme
2	Mbështetje 606 naftëtarëve të Ballshit për pagat e prapambetura	?	Po			Nuk ka referenca të matshme
3	Merr fund epoka e televizionit të pushtetit dhe nis epoka e televizionit të qytetarëve (RTSH)	√	Po		KM	
4	Do të përfundojmë rrugën Durrës-Kukës	±	Po	S.TRANSP. 2008-2013	SKZHI 2007-2012 PBA 2005-2009	Paqartësi për buxhetin
5	Elementët e provueshëm të dhunës në familje do të bëjmë pjesë të krimeve penale	?	Po			Nuk ka referenca të matshme.
6	Zbatim i vendimit të Gjykatës Kushtetuese dhe njohje e detyrimeve të qeverisë ndaj ish-ushtarakëve	√	Po	PBA 2005-2009		
7	Sistem licensimi dhe vlerësimi të njësisve hotelerie në bazë të standarteve europiane	?	Po			Nuk ka referenca të matshme
8	Do të ndërtojmë një strukturë të integruar të sigurisë kombëtare	±	Po	L.SIG.KO MB ⁸⁹	KONFERENCE NDERKOMB. ⁹⁰	Paqartësi për zbatimin
9	Do të uniformojmë trupat policore në Policinë e Shtetit	√	Po	BUXHETI		
10	Fillimi i ndërtimit të një porti europian dhe fillimi i punës për një universitet europian për Vlorën	?	Po			Nuk ka referenca te matshme.
11	Do t'i japim fund etjes së Tiranës dhe do të kemi 24 orë ujë në të gjithë Qarkun e Tiranës	±	Po	PBA 2009-2011	ERRU RAP. ⁹¹ SKZHI 2007-2013	Paqartësi për veprimet e buxhetit
12	Kerkese per hetim per Gerdecin, Rrugen e Kombit, Albtelekom, ARMO, INSIG, blerjet energjise, tokat Porto-Palermo, Cimento, HEC Devolli dhe grabitjet e tokave ne bregdet dhe Kinostudio.	√	Po		KM	

⁸⁹ <http://qzbz.gov.al/eli/ligj/2004/11/25/9322>

⁹⁰ https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2014/10/MBI-ZHVILLIMIN-E-STRATEGJIS%C3%8B-SE-SIGURISE-KOMBETARE_2007.pdf

⁹¹ https://www.erru.al/doc/Raporti_2009_ERRU_Total.pdf

PREMTIMET ZGJEDHORE TË LSI, 2009

PREMTIMET FISKALE DHE BUXHETORE

N r.	Premtimi elektoral	Vlerësimi	Referencat ku vlerësohet matja dhe besueshmëria				Shënime
			Program politik	KMF/PBA	Strategji	Tjetër dokument	
1	Për çdo biznes të ri që do punësojë më shumë sesa pesë veta do të heqim tatim fitimin për disa vite	?	Po				Nuk ka reference të matshme
2	Do të rishikojmë politikën e taksave për të ardhurat e individit, duke përfshirë nga tatimi mbi të ardhurat të gjitha pagat deri në 25 mijë lekë të reja në muaj	±	Po	PBA 2005-2011			Nuk ka reference të matshme
3	Përgjysmimi i TVSH-së për këto produkte ⁹² nga 20% në 10 %	±	Po	KMF 2010-2012 PBA 2005-2011			Nuk ka reference të matshme
4	Do të subvencionojmë energjinë për 300 kilovat/orë në muaj për familjarët e varfër	?	Po				Nuk ka reference të matshme
5	Për çdo vend të ri pune që do të krijohet do të - heqim tatimin mbi fitimin deri në Dhjetor të vitit 2010, - subvencionojmë sigurimet shoqërore në masën 50 për qind deri në fund të vitit 2011, dhe - subvencionojmë 100 % sigurimet shoqërore	?	Po				Nuk ka reference të matshme
<https://pd.al/2017/03/mesazhi-lulzim-bashes-sot-ne-diten-e-15-te-protestes-ne-sheshin-e-lirise/>
<https://pd.al/2017/03/cdo-para-ne-shendetesi-te-hidhet-vetem-per-ti-sherbyer-njerezve/>
<https://pd.al/2017/03/fermeret-dhe-blegtoret-kane-falimentuar-edi-rama-dha-7-milione-dollare-per-fshatin-harxhoi-15-milione-dollare-per-bileta-avioni/>
<https://pd.al/2017/03/lulzim-basha-bashkebesedim-aktiviste-pedagog-dhe-qytetare-te-thjeshte-mbi-problemin-e-mbetieve-ne-vend/>
<https://pd.al/2017/03/ne-fund-te-mandatit-te-pare-te-qeverise-se-pare-te-republikes-se-re-rrogat-e-mesuesve-te-dyfishohen/>
<https://pd.al/2017/03/lehtesojme-grate-dhe-nenat-nxenesit-nga-ora-7-30-deri-ne-16-00-nen-kujdesin-e-shtetit/>
<https://pd.al/2017/03/pse-ka-falimentuar-ekonomia-4-vite-qeveria-ne-kurri-ze-qytetareve-zgjidhja-vjen-republiken-e-re/>
<https://pd.al/2017/03/uljen-e-taksave-shqiperia-behet-vendi-konkurrenca-ne-rajon-per-investitoret/>
<https://pd.al/2017/03/qeveria-teknike-te-funksioje-vetem-kur-te-kete-vulen-e-opozites-se-bashkuar-dhe-qytetareve-te-kesaj-levizje-popullore/>
<https://pd.al/2017/03/republike-e-re-per-artin-dhe-artistet-shqiptare/>
<https://pd.al/2017/03/jemi-gati-ge-zgjedhje-te-lira-besimin-e-shqiptareve-te-nisim-ge-neser-qeverisjen-e-shqiperise-nje-program-ge-ta-nxjerre-ate-nga-kriza-ekonomike/>
<https://pd.al/2017/03/mesazhi-lulzim-bashes-sot-ne-diten-e-31-te-protestes/>
<https://pd.al/2017/03/nje-e-treta-e-kandidateve-te-pd-ne-zgjedhjet-e-lira-dhe-te-ndershme-te-jene-te-rinj-e-te-reja/>
<https://pd.al/2017/03/prona-e-grabitur-nga-komunizmi-duhet-tu-kthehet-100-pronareve-te-ligjshem/>
<https://pd.al/2017/03/shqiperia-te-pastrohet-nga-droga-nga-krimi-dhe-inkriminimi-vetem-vote-te-lire-e-te-ndershme/>
<https://pd.al/2017/03/afere-e-vez-bashkepunim-mafias-shqiptare-ate-nderkombetare-ne-kurri-ze-te-popullit-te-varfer-te-europes/>
<https://pd.al/2017/03/te-rinjte-sot-nuk-ndjehen-te-lire-sepse-nuk-zgjedhin-shkollim-punesim-apo-edhe-vete-perfaqesuesit-e-tyre-ne-parlament/>
<https://pd.al/2017/03/situata-e-biznesit-te-vogel-ne-shqiperi-ne-krize-per-shkak-te-taksimit-te-larte-dhe-tatimeve-abuzive/>
<https://pd.al/2017/03/kane-shkaterruar-arsimin-e-larte-universitetet-kthehen-ne-sherbm-te-studenteve-dijes-dhe-interesit-publik/>
<https://pd.al/2017/04/mesazhi-plote-lulzim-bashes-ne-mbrejten-e-43-te-protestes-ndjesa-per-te-perndjekurit-politik-dhe-zotimi-per-te-cuar-aty-ku-e-kane-vendin-xhelatet-e-diktatures/>
<https://pd.al/2017/04/dinjtetin-ne-vend-te-perndjekurve-vendin-ge-meritojne-persekutoreve/>

¹⁸⁰ <https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/06/Draft-strategjia-e-Zhvillimit-t%C3%AB-Turizmit-n%C3%AB-Shqip%C3%ABri-2014-2020-draft.docx>

<https://pd.al/2017/04/dita-e-republikes-se-re-po-vjen-pushteti-krimet-dhe-korrupsionit-ka-rene/>
<https://pd.al/2017/04/forca-jone-eshte-tek-bashkimi-forca-jone-eshte-tek-vendosmeria-forca-jone-eshte-tek-natyra-paqesore-demokratike-por-e-vendosur-dhe-popullore-e-kesaj-levizje-bashke-per-nje-republike-te-re-e-cila/>
<https://pd.al/2017/04/te-rinjte-ne-sheshin-e-lirise-cfare-presim-nga-republika-e-re/>
<https://pd.al/2017/04/edi-rama-largohet-oret-e-droges-oret-e-krimet-po-numerohen-mbrapsht/>
<https://pd.al/2017/04/ka-vetem-nje-hapesire-per-kundershtaret-te-ulemi-per-qeveri-teknike/>
<https://pd.al/2017/04/republika-e-re-te-kete-arsimin-dhe-shkollat-te-mira-ne-ballkan/>
<https://pd.al/2017/04/vetingu-menjehere-pas-paktit-kombetar-per-qeveri-teknike-presidenti-ti-kthehet-popullit-zgjedhje-18-qershor-nuk-ka-zgjedhje-pa-opoziten-nuk-ka/>
<https://pd.al/2017/04/dialog-ose-perballje-populli-gjithmone-te-fitoje/>
<https://pd.al/2017/04/republika-e-re-ka-te-gjitha-mundesite-te-ndryshoje-jeten-e-shqiptareve-ajo-nis-voten-e-lire-e-te-ndershme/>
<https://pd.al/2017/04/ndihma-ekonomike-e-familjeve-ne-nevoje-te-dyfishohet-brenda-vitet-te-pare-te-republikes-se-re/>
<https://pd.al/2017/04/energjia-dhe-nafta-nen-qeverisjen-e-re-te-republikes-se-re-te-kene-cmimin-te-ulet-ne-rajon/>
<https://pd.al/2017/04/republika-e-vjeter-nisi-si-pazari-ngjalave-dhe-u-mbyll-si-pazari-peshkut-republika-e-re-ka-nisur-qytetaret-dhe-per-qytetaret/>
<https://pd.al/2017/05/lulzim-basha-bashkebisedon-me-qytetare-ne-sheshin-e-lirise-arenen-e-bashkimit-me-te-madh-popullor-79-ditor-qe-do-te-kulmoje-me-13-maj/>
<https://pd.al/2017/05/edi-rama-lufton-zgjedhjet-e-lira-se-ato-jane-fundi-koncesioneve-tenderave-oligarkeve-trafikanteve-dhe-krimet/>
<https://pd.al/2017/05/cdo-shqiptar-bashkohet-neser-qe-permes-celesit-te-arte-votes-se-lire-te-hapim-deren-e-nje-te-ardhme-te-re/>
<https://pd.al/2017/05/mesazhi-lulzim-bashes-ne-marshimin-popullor-per-republiken-e-re/>
<https://pd.al/2017/05/lulzim-basha-republika-e-re-nis-marshimin-drejt-fitores-ne-cdo-shesh-te-shqiperise/>
<https://pd.al/2017/05/rama-braktisi-fermeret-favorizoi-vetem-14-miqte-e-tij-pd-premton-150-milione-euro-cdo-vit-per-fshatin/>
<https://pd.al/2017/05/lulzim-basha-ne-fier-ftese-rames-per-debat-ne-television-2/>
<https://pd.al/2017/05/republika-e-re-eshte-kantier-pune-me-paga-te-mira-pensione-te-larta-para-per-fermeret-arsim-e-shendetesi-cilesore/>
<https://pd.al/2017/05/te-jem-kryeministri-njerezve-prane-njerezve-ne-dite-te-mire-e-ne-dite-te-keqe/>
<https://pd.al/2017/05/shtet-forte-eshte-kur-ekonomia-eshte-e-forte-kur-qytetari-eshte-forte/>
<https://pd.al/2017/06/republika-e-re-do-te-thote-300-kv-e-pare-te-energjise-te-paguara-nga-shteti-per-familjet-ne-nevoje/>
<https://pd.al/2017/06/do-ta-nis-duke-ndrequr-motorrin-e-ekonomise/>
<https://pd.al/2017/06/do-jem-kryeministri-i-ekonomise-i-vendeve-te-punes-i-taksave-te-uleta/>
<https://pd.al/2017/06/ulje-taksash-10-mije-stazhe-te-paguara-per-te-rinjte-ndihme-per-fermeret-vende-te-reja-pune/>
<https://pd.al/2017/06/basha-ne-gramsh-e-belsh-mundesi-per-shqiptaret-per-ekonomi-te-forte-e-te-neserme-te-sigurte/>
<https://pd.al/2017/06/republika-e-re-eshte-per-njerezit-per-ekonomi-te-forte-ulje-taksash-vende-te-reja-pune-ndihme-per-fermeret-e-te-rinjte/>
<https://pd.al/2017/06/pulla-mbi-biznesin-e-vogel-do-mbaje-larg-tatimoret-e-hajdutet-e-shtetit/>
<https://pd.al/2017/06/ulje-taksash-shtet-qe-stimulon-zhvillimin-jo-qe-spiunon-qytetaret-per-ti-zhvatur/>
<https://pd.al/2017/06/ulje-taksash-ekonomi-e-forte-parate-do-u-kthehen-qytetareve-dhe-tregut/>
<https://pd.al/2017/06/ulja-e-taksave-do-te-rrise-ekonomine-familjare/>
<https://pd.al/2017/06/100-milione-euro-ne-vit-per-fermeret-dalje-nga-kriza-nisje-e-prodhimit-e-mireqenies/>
<https://pd.al/2017/06/modeli-im-ekonomik-ka-funksionuar-ne-europe-do-funksionojte-dhe-ne-shqiperi/>
<https://pd.al/2017/06/plani-im-do-ndeze-motorrin-e-ekonomise-heqja-e-taksas-se-naftes-nga-vendimet-e-para-do-ule-cmimin-2/>
<https://pd.al/2017/06/lulzim-basha-me-qytetaret-e-durresit-ky-plan-po-funksionon-me-ekonomine-e-presidentit-trump-e-te-angela-merkel-premtimi-per-anullimin-e-kamatevonesave-ne-vendimet-e-para-si-kryeminister-lulzim-bas/>
<https://pd.al/2017/06/ky-eshte-plani-ekonomik-do-rrisim-konsumin-prodhimin-vendet-e-reja-te-punes/>
<https://pd.al/2017/06/vetem-nga-ulja-e-tvsh-400-euro-ne-vit-perfiton-cdo-familje/>
<https://pd.al/2017/06/basha-me-te-rinjte-e-tiranes-gjysma-e-atyre-qe-diplomohen-do-te-perfitojne-stazh-te-paguar-pune/>
<https://pd.al/2017/06/edi-rama-mbaje-mend-mire-nuk-ka-bashkejetese-me-republiken-e-vjeter-te-zullumit/>
<https://pd.al/2017/06/basha-cfare-votojme-te-dielen-palmat-dhe-pushtetin-e-rames-apo-rritjen-e-pensioneve-shkollat-me-dreke-te-paguar-uljen-e-taksave-uljen-e-cmimit-te-energjise-e-naftes/>
<https://pd.al/2017/06/basha-mengjes-pune-me-dhomen-amerikane-te-tregtise-ulje-taksash-nxitje-investimesh-konkurrenca-ndershme/>

Linku premtimeve PS 2017

https://issuu.com/ps.al/docs/manifesti_ps_previcë_small

Linket e premtimeve LSI 2017

<http://www.lsi.al/platforma-politike/>

http://snip.ly/tr8hg#http://www.lsi.al/wp-content/uploads/2017/06/PLANI_I_VERTETE_LSI_2017.pdf

http://www.lsi.al/wp-content/uploads/2017/05/PROGRAMI_ELEKTORAL_LSI.pdf

<http://www.lsi.al/wp-content/uploads/2017/05/PDF-FINAL-PROGRAMI-final.pdf>

http://www.lsi.al/wp-content/uploads/2017/05/PLANI_PER_PUNESIMIN_E_TE_RINJVE.pdf

Programi politik

Respektimi dhe konsolidimi i ndarjes dhe kontrollit të pushteteve, pavarësisë së sistemit gjyqësor në të gjitha nivelet, përmirësimi rrënjësor i kushteve të veprimtarisë së këtij sistemi, transparencë e vendimeve gjyqësore, ekzekutimi me vendosmëri i vendimeve të gjykatave, përcaktimi më i qartë i kompetencave midis Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, transparencë e sistemit të emërimeve dhe kontrollit të gjykatësve, do të jenë objektivat kryesorë të punës sonë.

Riorganizimi i sistemit të akuzës, përgjegjshmëria e tij para ligjit dhe lufta kundër korrupsionit në çdo qelizë të jetës së vendit mbetet një nga përparësitë tona.

Ne angazhohemi për një rishqyrtim tërësor të legjislacionit të vendit, kodeve, ligjeve dhe procedurave ligjore, për t'i përshtatur ato me standardet europiane.

Reforma do të vazhdojë me vendosmëri në sistemin e vuajtjes së dënimit, për arritjen e standardeve europiane në këto institucione.

Po kështu, do të konsolidohet sistemi i përmbartimit shtetëror dhe privat, me qëllim zbatimin e vendimeve të gjykatave, duke arritur mesataren e vendeve anëtare të BE-së në këtë fushë të zbatimit të ligjit.

Reforma institucionale do të vazhdojë në të gjitha institucionet e vendit, me qëllim përmirësimin e funksionit të tyre. Reformës do t'i nënshtrohen Policia e Shtetit, Shërbimi Informativ Kombëtar, Entet rregullatore, agjencitë që merren me reformën e pronësisë, në mënyrë që ato të përmbushin misionin e tyre të ardhshëm për Shqipërinë europiane.

Qeveri e vogël, eficiente dhe në dietë do të jetë zotimi ynë solemn para qytetarëve shqiptarë. Ne zotohemi të zvogëlojmë me 10% administratën publike të Shqipërisë.

të instalojmë brenda vitit 2010 *e-government*, çka do të rrisë transparencën e qeverisjes dhe do të përmirësojë të gjitha shërbimet ndaj qytetarëve.

Statusi i nëpunësit civil do të konsolidohet dhe zgjerohet. Për trajnimin dhe kualifikimin e administratës publike, Qeveria do të konsiderojë ngritjen e Universitetit të Administratës Publike brenda këtij mandati.

Në këtë kontekst, Qeveria e Integritetit Europian sërisht luftën kundër korrupsionit do ta bazojë në reformat e gjithanshme dhe në penalizime të vendosura të zyrtarëve të korruptuar. Objektivi ynë do të jetë rendja drejt grupit të 20 vendeve të para me korrupsion më të ulët, objektiv ky që, sigurisht, nuk mund të përmbushet me një mandat, por do të jetë frymëzues në të gjithë veprimtarinë tonë.

Për suksesin e luftës kundër korrupsionit ne zotohemi për qeveri të vogël dhe shkurtimin e shpenzimeve operative të saj edhe me 25%, duke filluar nga vitet 2009-2010.

Prandaj, në kuadrin e zvogëlimit të shpenzimeve, abuzimeve, në muajin e parë të këtij Parlamenti ne do të sjellim për miratim projektligjin për heqjen e disa privilegjeve të pamërituara të administratës dhe institucioneve shtetërore. Vetëm me këtë ligj kursehen mbi 35 milionë dollarë në vit në rrafshin financiar, por dhjetëra herë më shumë fitohet në rrafshin etiko-moral të qeverisjes, duke e shkëputur administratën e sistemit demokratik nga trashëgimia e nomenklaturës së vjetër komuniste.

Shqipëria sot është vendi i vetëm në botë me prokurime elektronike 100%, por përsosja e këtij sistemi, si dhe shtrirja e tij edhe për blerjet e vogla e ankandet mbeten objektiva madhorë të këtij mandati.

Konsolidimi i heqjes së 2/3 të lejeve dhe licencave, krijimi i *One Stop Shop*-eve për lejet e licencat e mbetura dhe *One Stop Shop*-eve për energjinë, si dhe ngritja e tij për minierat janë reforma efikase kundër korrupsionit.

Vendosja e parimit “heshtja është pranim” në lejet e ndërtimit, por edhe në lejet dhe licencat e tjera, përbën kushte *sine qua none* për të prerë me gërshtërit e ligjit dorën e zezë të ryshfetit.

Privatizimi i të gjitha sipërmarrjeve publike, shitja e aksioneve të shtetit, si dhe dhënia me koncesion i shërbimeve publike, përfshirë këtu ato të pronave dhe regjistrimit të pasurive, janë mekanizma të tjerë të luftës efikase kundër korrupsionit.

Antifragmentarizimi i buxhetit, kontrolli rigoroz i shpenzimeve do të jenë objektiva të tjerë madhorë në luftën kundër korrupsionit.

¹⁸¹ <http://shtetiweb.org/2015/09/13/programi-qeverise-berisha-2005-2009/>

Ligji për transparencën e plotë të financimeve të partive politike i bën nder çdo partie që zotohet për luftën kundër korrupsionit. Ju garantoj se votat e maxhorancës do të jenë të tëra në favor të këtij projektligji.

Heqja e imunitetit për ministrat dhe deputetët e kësaj maxhorance, në çdo rast dhe për çdo motiv që do ta kërkojnë organi i akuzës apo gjykatat do të jetë një qëndrim i pandryshuar i maxhorancës sonë.

Amendimi i ligjit të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive dhe krijimi i të gjitha mundësive për hetim të plotë për pasuritë e zyrtarëve është një premtim tjetër i kësaj maxhorance për të rritur më tej luftën kundër korrupsionit.

Konsolidimi i zbatimit të ligjit të denoncuesve të korrupsionit, reformimi e konsolidimi i të gjitha institucioneve të kontrollit, si dhe i *Task Force*-s së luftës kundër krimit ekonomik dhe korrupsionit në gjashtë qarqet kryesore të vendit.

Kontrolli i integruar i kufijve, sistemi i ri i identifikimit të qytetarëve janë një mbështetje e fuqishme për këtë objektiv. Shqipëria do të mbajë në fuqi moratoriumin për skafet. Lufta kundër trafikut të qenieve njerëzore do të përbëjë një ndër përparësitë më madhore në kuadrin e tolerancës zero ndaj krimit të organizuar.

Programi Ekonomik

Konsolidimi i rritjes së shpejtë ekonomike, rritja e kompetitivitetit të ekonomisë sonë, Shqipëria lider në rajon për thithjen e investimeve të huaja dhe zhvillimin e qëndrueshëm të saj.

Regjistrimi i biznesit, pagesa e taksave dhe bilancet do të jenë *online*.

Do të konsolidohen *One Stop Shop*-et për licencat e lejet edhe për energjetikën dhe do të ndërtohet *One Stop Shop*-i për minierat.

Do të ridimensinohet partneriteti publik privat në të gjitha fushat e ekonomisë, si levë kryesore për thithjen e investimeve private dhe zhvillimin e vendit.

Do të reformohet tërësisht Agjencia e Investimeve të Huaja.

Diplomacia shqiptare do të shndërrohet në një promotor të fuqishëm të potencialeve të Shqipërisë për investimet e huaja dhe bashkëpunimin ekonomik ndërkombëtar të vendit.

Do të krijohen gjashtë qarqet industriale në gjashtë qarqe të vendit, të cilat do të shndërrohen në gjeneratorë të fuqishëm të prodhimit dhe të punësimit.

Sistemi i minierave të vendit do të riaktivizohet mbi bazën e standardeve më të mira të shfrytëzimit, të transparencës financiare, mbrojtjes së mjedisit dhe bashkëpunimit me komunitetin.

Në të gjitha lejet dhe licencat do të vendoset parimi “heshtja është miratim”.

Borxhi publik do të zbrësë në fund të këtij mandati në 50%.

Inflacioni do të jetë i kontrolluar në vlerat jo më shumë se 3%,

Deficiti buxhetor do të zbrësë në 3%.

Heqja e TVSH-së për mallrat dhe shërbimet në arsim dhe shëndetësi,

Reformimi tërësisht i sistemit të pensioneve dhe sigurimeve shoqërore

Reformë ligjore institucionale dhe modernizimi i mëtejshëm i sistemit të tatimeve dhe doganave, taksa, bilance *online*, skaner dhe kontroll imazhor në të gjitha doganat kryesore të vendit.

Rimbursim i TVSH-së brenda 30 ditëve dhe aplikim i parimit “heshtja është miratim”.

Modernizim i menaxhimit të borxhit publik.

Bujqësia dhe zonat rurale

Në katër vjetët që shkuan, në infrastrukturën e zonave rurale të vendit, për prodhimin bujqësor dhe agrobiznesin u investuan rreth 1.6 miliardë dollarë.

Gjatë mandatit të dytë, Qeveria ime do të bëjë çdo përpjekje për të trifishuar investimet për infrastrukturën, nxitjen e prodhimit bujqësor, përpunimin e tij dhe zhvillimin e qëndrueshëm rural të vendit.

Do të ndërtohen dhe rindërtohen në zonat rurale, komunat dhe fshatrat e vendit, rreth 6 mijë km rrugë kombëtare rurale dhe dytësore.

Qendra e çdo komune të Shqipërisë do të lidhet për 15-25 minuta me rrugët kombëtare.

Do të ndërtohen dhe rindërtohen të gjitha shkollat e zonave rurale të vendit.

Do të ketë internet me bandë të gjerë në të gjithë fshatrat e vendit dhe familjet shqiptare.

Do të garantohet 24 orë ujë i pijshëm dhe do të ndërtohen sistemet e kanalizimit në mbarë fshatrat e Shqipërisë, do të ketë shërbime cilësore në shëndetësi, arsim dhe fusha të tjera.

Qëllimi i gjithë kësaj është që në vitin 2013 fshatrat e këtij vendi të llamburisin njëlloj si lagjet e qyteteve të Shqipërisë.

Përcaktimi si objektiv kryesor dyfishimi i prodhimit bujqësor dhe blegtoral në Shqipëri në një hark kohor 6-vjeçar. Ky është një objektiv tejet ambicioz, i vështirë, por absolutisht i arritshëm dhe vendimtar, për të garantuar zhvillimin e harmonishëm ekonomik të vendit, luftën efikase kundër varfërisë.

Mendoj se arritja e këtij objektiv duhet të nisë me:

– ndërtimin e një sistemi të ri vaditës në mbarë vendin, duke kaluar nga presa dhe shati, te vaditja me pika apo në formë shiu. Shqipëria nën ujë – duhet të jetë motoja jonë;

– mbrojtjen e tokës nga kalbëzimi dhe erozioni, me një seri projektesh kullimi dhe anti-erozioni. Këto janë kushte për të fituar, gjatë viteve që vijnë, dhjetëra-mijëra hektarë tokë. Për të dyfishuar prodhimin, duhet që tokat e braktisura t'u jepen nga komunat me sistemin e të dhjetës atyre që dëshirojnë të punojnë.

Për dyfishimin e prodhimit bujqësor, Qeveria, përveç realizimit të projektit të mbjelljes në katër vjet të 20 milionë rrënjëve ullinj, do të nxisë dhe subvencionojë edhe mbjelljen e dhjetëra milionë rrënjëve vreshta, drurë frutorë, mollë, arra, gështenjë, kumbulla, lajthi, fiq, bimë aromatike, në përputhje me traditën dhe kushtet lokale. Qeveria do të shumëfishojë grantet për nxitjen e prodhimit në zonat kodrinore, malore, për mbjelljen e drurëve frutorë, rritjen e sipërfaqeve me serra diellore dhe me ngrohje, si dhe kreditë e buta për zonat fushore.

Do të ketë një reformë të plotë të sistemit të certifikimit të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale të vendit, zhvillim intensiv të akuakulturës në detet, liqenet dhe rezervuarët e vendit. Qeveria do të subvencionojë naftën për sipërfaqet e mbjella. Arsimi bujqësor në disa qarqe të vendit do të organizohet sipas modelit të shkollës amerikane dhe traditës së hershme shqiptare.

Në katër vjet, ne duhet të trifishojmë mbjelljen e drurëve frutorë. Pensionet e fermerëve do të barazohen me ato të qytetit.

Energjia

Objektivi ynë madhor për katër vjetët që vijnë është që në Shqipëri, në parqe industriale, në parqe energjetike, në porte, veçanërisht në Portin e ri të Vlorës, autostrada e aeroporte, hidrocentrale dhe vepra të tjera, në mijëra kilometra rrugë që do të ndërtohen do të investohen rreth 12 miliardë euro.

Disa miliarda euro do të investohen në rreth 150 hidrocentrale, që do të ndërtohen apo do të nisin ndërtimet në rrethet e Elbasanit, Peshkopisë, Gjirokastrës, Mirditës, Tiranës, Gramshit, Shkodrës, Kukësit, Tropojës.

Miliarda të tjera do të investohen në porte, vepra energjetike dhe parqe industriale në Vlorë, Durrës, Tiranë, Shëngjin, Fier, Elbasan, Korçë.

Deri tani janë licencuar rreth katër mijë megavat hidrocentrale, termocentrale me biomas dhe eolike, që kapin një investim prej rreth 5 miliardë eurosh, ndër të cilat do të veçoja kaskadën e Devollit, projektin më të madh energjetik ujqor në Europë, por janë gati për t'u paraqitur në treg kaskada e Vjosës, Osumit, Shkumbinit, Matit, Skavicës, degëve të Drinit dhe parqet e mëdha eolike të Lezhës, Karaburunit, parqet energjetike të Porto Romanos, Lezhës etj.

Ne do të reformojmë kuadrin ligjor dhe do të përcaktojmë stimujt konkretë për ndërtimin e qindra e mijëra hidrocentraleve të vogla në mbarë vendin, për të cilat Qeveria zotohet t'u garantojë ndërtuesve të tyre lidhjen e tyre me sistemin energjetik të vendit, kudo që ata t'i ndërtojnë.

Ne zotohemi të bëjmë çdo përpjekje për të shfrytëzuar të gjitha burimet energjetike nga ato eolike, ujore, tek nafta, qymyret dhe burimet nukleare që ky vend, me një pozicion strategjik gjeografik, të shndërrohet, duke ruajtur standardet më të larta mjedisore, në një vend kryesor prodhimi dhe eksporti energjie në rajon.

Në këto vepra do të punësohen rreth 160 mijë punonjës.

Shfrytëzimi i qymyreve të vendit apo të importit, duke ruajtur standardet më të larta mjedisore, do të jetë një drejtëm tjetër i programit të Qeverisë shqiptare. Termocentralet me qymyr po ndërtohen sot në mbarë Europën. Shqipëria-superfuqi energjetike në rajon parakupton një infrastrukturë të re të transmetimit dhe lidhjeve energjetike me rajonin. Në këtë kontekst, pas përfundimit të linjës Elbasan- Podgoricë, do të fillojë dhe do të përfundojë brenda këtij mandati linja Tiranë-Prishtinë, Elbasan-Shkup, si dhe linja nënujore Shqipëri-Itali.

Infrastruktura

Në katër vjetët që shkuan, në mbarë vendin, ne ndërtuam rreth 6 mijë km rrugë, autostrada, rrugë kombëtare të standardeve ndërkombëtare, rrugë rurale dhe dytësore, ndër të cilat do të mbeten si monumente të infrastrukturës sonë:

korridori i kombit, që vetëm vitin e parë, pa llogaritur kursimin në kohë, efektin në bumin turistik dhe shkëmbimin e mallrave, por vetëm kursimet në automjete dhe shpenzime të tjera të lidhura me to, do të sjellë një fitim prej rreth 70 milion euro në vit,

rruga Dhërmi- Sarandë, e cila do të mbetet edhe kjo si rruga më panoramike e vendit.

Po të një rëndësie të veçantë janë dhe do të mbeten edhe autostradat Lushnjë-Fier, Korçë-Qafë Pllaçë, Ura e Çerenecit-Bulqizë, Gjirokastrë- Tepelenë, Vorë-Fushë-Krujë etj., etj. Gjatë këtij katërvjeçari janë për t'u ndërtuar edhe rreth 7 mijë km autostradë, rrugë kombëtare, rurale, dytësore, në fshatrat dhe qytetet e vendit.

Me infrastrukturën e re moderne të vendit ne kemi si objektiv madhor:

– përgjysmimin e distancës kohore me Tiranën nga çdo fshat dhe qytet i vendit;

– lidhjen brenda 15-25 minutash të qendrës së çdo komune të vendit me rrugën më të afërt kombëtare;

– lidhjen me rrugë të asfaltuar të çdo fshati me qendrën e komunës për një kohë prej rreth 15-20 minutash;

– dyfishimin e lidhjeve ndërkombëtare tokësore me Kosovën, Greqinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi, duke ndërtuar rrugë të reja;

– ndërtimin e Portit të Vlorës, si një ndër portet më të mëdhenj të Mesdheut për kontenerë, si dhe ndërtime të tjera portuale.

– ndërtimin e një aeroporti të ri në Jugun e Shqipërisë;

– lidhjen hekurudhore me Maqedoninë dhe hartimin e projektit për lidhje hekurudhore me Kosovën.

Ky katërvjeçar do të jetë, pra, katërvjeçari i përfundimit të rrjetit modern rrugor, që do të përgjysmojë distancën me Tiranën nga të gjitha skajet e vendit, Vermoshi e Konispoli, Saranda, Gjirokastra e Tropoja, Dibra e Korça. Brenda dy vjetëve që vijnë, do të përfundojnë këto autostrada: Rruga e Arbrit, Levan-Vlorë, Levan-Tepelenë, Tiranë- Elbasan, Qafë Pllaçë-Qukës, Boshti i Jugut në trajektoren Elbasan-Belsh-Kuçovë-Berat-Kardhiq-Delvinë-Konispol-Sarandë, autostrada Fushë-Krujë- Ura e Limuthit, si dhe shndërrimi në katër korsi i autostradës Shkodër-Vlorë.

Brenda vitit 2013 do të përfundojë së ndërtuari Unaza e Madhe e Tiranës, unaza veriore dhe juglindore e vendit, me trajektore: Shkodër-Theth- Valbonë-Krumë- Kukës-Peshkopi-Librazhd-Kolonjë- Përmet-Delvinë; autostradat Fierzë-Koman, Shkodër-Vermosh, segmenti Berat-Memaliaj i boshtit të Jugut, si dhe disa mijëra kilometra rrugë turistike dhe rrugë rurale e dytësore në mbarë vendin.

Një objektiv tjetër ambicioz i Qeverisë sime është që brenda këtij katërvjeçari të ketë ujë 24 orë për familjet shqiptare, në fshat dhe qytet, duke ndërtuar apo rindërtuar rreth 800 ujësjellës në mbarë vendin.

Mbrojtja dhe integrimi

Qeveria e Integritit do të vazhdojë të mbështesë politikisht, financiarisht e me çdo mënyrë tjetër Forcat e Armatosura shqiptare për reformën më të madhe që ato kanë njohur në historinë moderne të shtetit shqiptar, duke përfunduar ndërtimin e strukturës më efektive të organizimit të tyre sipas modelit të ushtrive të NATO-s, përmes vënies në jetë të një sistemi eficient rekrutimi e trajnimit të personelit ushtarak e civil dhe një buxheti prej 2% të PBB-së në vit, si dhe përmes zbatimit rigoroz të tij gjatë gjithë katërvjeçarit të ardhshëm.

Përmirësimi i kapaciteteve të bazave moderne ushtarake të përzgjedhura si pikat më të përshtatshme strategjike për dislokimin e Forcave të Armatosura do të shoqërohet me reduktimin e kapaciteteve të tepërta që prodhojnë kosto apo paraqesin rrezikshmëri, si reduktimi i depove të municioneve dhe shkatërrimi i një sasive prej 85.000 tonë municionesh të vjetruara e të rrezikshme për sigurinë e qytetarëve, deri në vitin 2013.

Autostrada që e lidh me portet e Shqipërisë është një ndihmë e madhe, por, natyrisht, Porti i Shëngjinit, që ne do t'ia ofrojmë së shpejti Qeverisë së Kosovës, përbën një lehtësi tjetër për konsolidimin e pavarësisë së këtij shteti. Duhet theksuar se konsolidimi dhe njohja e Kosovës së pavarur në arenën ndërkombëtare mbetet një nga objektivat e politikës sonë të jashtme. Theksojmë edhe një herë se njësimi i standardeve me vëllezërit tanë në Kosovë dhe me vendet përreth është një qëllim madhor i politikës dhe i qëndrimit të Shqipërisë. Unë besoj se marrëdhëniet e Shqipërisë me Kosovën, por edhe me Malin e Zi dhe Maqedoninë, si vende me hapësira të kufizuara, janë në interesin më jetik për zhvillimin e tregut, biznesit, afarizmit, turizmit dhe ekonomisë së këtyre vendeve.

Diaspora duhet të shndërrohet në një faktor madhor të bashkëpunimit të Shqipërisë me vendet ku ajo jeton dhe punon. Këto katër vjet ne do të hapim shtëpitë kulturore shqiptare, do të punojmë së bashku me opozitën për t'u dhënë të drejtën e votës kudo që ata janë. Ligji për blerjen e tokës ishte vetëm një hap në drejtim të solidifikimit të diasporës. Hapa të tjerë të rëndësishëm do të ndërmerren (fjalite e papercaktuara ne programet qeverisese).

objektivi më madhor i Qeverisë së Integritimit European për katër vjetet e ardhshëm është realizimi i ëndrrës së qytetarëve shqiptarë për lëvizje të lirë në hapësirat europiane, si dhe përfitimi i statusit të vendit kandidat dhe hapja e negociatave për anëtarësim të plotë të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Turizmi dhe mjedisi

Brenda vitit 2011 do të përfundojë masterplani i zhvillimit të turizmit të zonave malore, si dhe brenda këtij mandati, zonat malore të Shqipërisë, nga Vermoshi në Gjirokastrë, do të kenë infrastrukturën rrugore moderne, të gatshme për investime të gjera turistike.

Investimet për mbrojtjen nga ndotjet e ajrit, ujit dhe mjedisit, në tërësi, do të dyfishohen. Kështu, për mbrojtjen dhe ruajtjen e pastërtisë së ajrit, në përputhje me standardet europiane, duke filluar nga 1 janari i vitit 2010, do të ndalohet tërësisht përdorimi i naftës D2, e cila shkarkonte në mushkëritë e shqiptarëve 7500 ton squfur në vit. Sektori i ndërtimit do të detyrohet të marrë të gjitha masat për pakësimin e grimcave të pluhurave në sheshet e ndërtimit.

Për përpunimin e ujërave të ndotura dhe mbrojtjen e pastërtisë së ujërave të brigjeve të deteve dhe liqeneve të vendit, do të përfundojë ndërtimi i 14 impianteve të mëdha të përpunimit të tyre. Përprjekje të mëdha po bëhen për të ndërtuar edhe *landfield*-et, por do të kalohet edhe në praktikat e djegies së mbeturinave të ngurta.

Zgjerimi i sipërfaqes së gjelbëruar dhe mbjellja e drurëve frutorë do të jetë një drejtim tjetër kryesor i punës sonë.

Brenda vitit 2010 do të përfundojnë të gjithë ujësjellësit në ndërtim e sipër në zonat turistike bregdetare dhe do të nisë ndërtimi i ujësjellësve të mëdhenj për zonat turistike, duke filluar nga Kepi i Rodonit, Durrësi, Kavaja, Divjaka dhe do të merren masat për garantimin sa më parë të furnizimit me 24 orë ujë të kryeqytetit.

Po brenda vitit 2011 do të përfundojnë të gjitha impiantet e përpunimit të ujërave të zeza, kanalizimet dhe *landfield*-et për mbetjet e ngurta, në të gjithë zonën bregdetare të vendit.

Brenda vitit 2011 do të përfundojë masterplani për zonat turistike malore të Alpeve, vargmaleve të Shqipërisë së Mesme dhe të Jugut. Brenda këtij mandati do të ndërtohet infrastruktura rrugore që do të bëjë të mundur shfrytëzimin e potencialeve të virgjëra turistike të tyre dhe të zonave të tjera turistike malore të vendit.

Politika sociale

Në katër vjet ne ia dolëm të rrisim nga 50-100% buxhetin për 860 mijë familje shqiptare të punësuar në administratë, pensionistë apo qytetarë me ndihmë ekonomike, të punësojmë rreth 80 mijë vetë, të nxjerrim nga varfëria rreth 400 mijë qytetarë shqiptarë. Rënie prej 70% pësoi varfëria ekstreme apo mjerimi, sipas një studimi të Bankës Botërore. Por, me gjithë këto arritje, Shqipëria sërish ka një varfëri prej 12,1% të popullatës së saj dhe akoma më rëndë, ajo ka një varfëri ekstreme prej 1,34% të popullatës së saj, pra e konvertuar në njerëz e në familje, Shqipëria ka edhe sot me mijëra familje që ende qajnë çdo ditë me lotët e ftohtë të mjerimit. Shqipëria ka hartën e varfërisë dhe mjerimit që shtrihet nga Buzi i Tepelenës, Frashëri i Përmetit deri në Dukagjin. Në këto rajone mijëra familje përballen me egërsinë e tregut dhe dhimbjet e mjerimit. Qeveria ime është e vendosur të veprojë në mënyrë më efektive, më energjike për të nxjerrë nga mjerimi çdo shqiptar dhe çdo familje shqiptare.

Qeveria e Integritimit European është e vendosur të konsolidojë në Shqipëri standardet europiane të shtetit social. Ne angazhohemi se, duke ruajtur standardet më liberale të ekonomisë së tregut, do të thellojmë gjithnjë e më shumë frymën sociale të qeverisjes sonë, luftën e pamëshirë kundër njërit prej dy armiqve më kryesorë të njerëzve të lirë – varfërisë,

do të zgjerojmë, konsolidojmë dhe përsosim më tej sistemin e mbrojtjes sociale,

do të realizojmë një rishpërndarje gjithnjë e më të mirë dhe më të ndershme të të ardhurave do të bëjmë çdo përprjekje që në Shqipëri, qoftë dhe një qytetar i vetëm, të mos ndjehet i braktisur nga shoqëria shqiptare.

Lufta kundër varfërisë në zonat verilindore dhe juglindore të vendit do të përbëjë përparësinë madhore për Qeverinë tonë. Të gjitha investimet private në këto zona do të kenë lehtësime të ndjeshme fiskale.

Me një skemë të veçantë financimesh me grante, do të nxiten të gjitha potencialet lokale bujqësore, blegtorale e turistike të këtyre zonave.

Reformë të thellë do të njohë ndihma ekonomike, e cila do të dalë me çdo kusht jashtë informalitetit. Dhënia e saj, përveçse për personat me aftësi të kufizuara, do të kushtëzohet me punën e dobishme për komunitetin dhe punimin e tokës.

Brenda vitit 2013, ne synojmë që çdo qytetar shqiptar të ketë ndihmë ekonomike mbi dy dollarë në ditë dhe pensionet e fshatit të barazohen me pensionet e qytetit.

Në politikën tonë të Shqipërisë sociale, një kujdes të veçantë do t'u kushtohet dy moshave më delikate: vogëlushëve të këtij vendi dhe moshës së tretë.

Një ligj i veçantë do të miratohet brenda vitit 2010, i cili do t'u garantojë kujdesin, trajtimin e merituar dhe dinjitoz personave të moshës së tretë, si dhe problematikave të tyre specifike.

Rritja e rrogave dhe e pensioneve, duke lënë mbrapa gjashtë vende anëtare të BE-së, do të jetë një tipar tjetër i rëndësishëm i politikës tonë sociale, si dhe kusht vendimtar në zhvillimin e shpejtë e të qëndrueshëm të këtij vendi.

Shëndetësia

Reforma e shëndetësisë është reforma e të gjitha reformave që Qeveria ime do të ndërmarrë me përparësi gjatë këtij mandati.

Gjatë mandatit 2009-2013 ne zotohemi për mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve, të luftojmë uljen e mortalitetit infantile, duke e ulur atë në nivele europiane,

të shtrijmë vaksinimin ndaj të gjitha sëmundjeve të rrezikshme për shëndetin e fëmijëve,

reformat në sistemin e shëndetësisë do të jenë edhe reformat e para dhe më të rëndësishme të Qeverisë sonë.

Për këtë qëllim, në katër vjetët që vijnë:

– zhvillimi i shëndetit, edukimi shëndetësor dhe parandalimi i sëmundjeve do të jenë drejtimet themelore të sistemit tonë shëndetësor;

– do të rrisim me 60% buxhetin për shëndetësinë;

– do të reformohet tërësisht sistemi i menaxhimit dhe financimit të shërbimit shëndetësor;

– do të vendosim praktikën më të sigurtë të luftës kundër korrupsionit në këtë sistem;

– do të vazhdojmë rritjen e madhe të rrogave dhe pensioneve të mjekëve dhe infermierëve, duke parakaluar gjashtë vende anëtare të BE-së;

– do të zgjerohet partneriteti publik-privat në fushën e shëndetësisë;

– do të hiqet TVSH-ja për mallrat dhe shërbimet shëndetësore në sektorin privat;

– në spitalet tona do të instalohen teknologjitë dhe laboratorët më modernë;

– blerja e shërbimeve për qytetarët do të shtrihet edhe në sektorin privat;

– kujdesi për fëmijët, për vaksinimin e tyre, do të ridimensionohet. Po kështu kujdesi për gratë, mamografia dhe pap-testi do të jenë falas, sikundër ekografia për gratë shtatzëna;

– sigurimet shëndetësore do të shtrihen për të gjithë qytetarët.

Qeveria do të marrë përsipër sigurimet shëndetësore për çdo qytetar që nuk është në gjendje t'i paguajë. Ne do të paguajmë për ata që nuk kanë. Një pjesë tjetër do të marrë përsipër të mbajë një peshë në emër të një shërbimi jetik për veten, prindërit dhe fëmijët e tyre.

Edukimi

Zotohemi që me programin tonë katër vjeçar, reformave të thella dhe të gjithanshme do t'u nënshtrohen arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar, me objektivin kryesor standardet europiane për shkollimin e fëmijëve dhe të rinjve shqiptarë.

Shkollimi i fëmijëve tanë, shkolla si shtëpia e dytë e tyre, mësuesit si edukatorët kryesorë të tyre pas prindërve, mbeten epiqendra e programit tonë

të ngremë në të katër anët e vendit sistemin e arsimit parashkollor, si kusht për një parapërgatitje dinjitoze të fëmijëve tanë në shkolla.

Krijimi i mjedisve për lojëra dhe zbatimet e fëmijëve do të jetë një detyrim për qeveritë vendore.

Në katër vjet ne ia dolëm të dyfishojmë buxhetin për arsimin, rrogat e arsimtarëve, numrin e studentëve, të ndërtojmë apo rindërtojmë rreth 1012 shkolla, të shtrijmë internetin në të gjitha shkollat e vendit, të kapim

standarde europiane në rekrutimin e nxënësve nga shkollat e mesme në universitete, vendosëm dhe zbatuam fondin Brain Gain dhe atë të Ekselencës.

Në këtë kontekst, brenda këtij mandati, buxheti për arsimin, nga sektori publik dhe privat do të arrijë në 7% të PBB-së, kurse ai i sektorit publik në 6% të prodhimit të brendshëm bruto.

Parimi ynë do të jetë: çdo fëmijë që mbaron klasën e nëntë, duhet të ketë kushte për të ndjekur shkollën e mesme, kudo që ndodhet dhe banon, duke e tërhequr atë në konvikte, në rast se aty nuk ka shkollë të mesme.

Çdo i ri që mbaron shkollën e mesme duhet t'i ketë të hapura dyert e universiteteve.

Rekrutimi i nxënësve nga shkollat e mesme në universitete të kalojë mbi mesataren e vendeve anëtare të BE-së.

Numri i studentëve, nga 115 mijë që është sot, do të rritet në 150 mijë në vitin 2013. Të rritet së paku me 10% numri i nxënësve që ndjekin shkollat profesionale.

Shteti do të dyfishojë numrin e studentëve nga zonat verilindore dhe juglindore të vendit, duke ofruar cikël parapërgatitor, që të garatojë suksesin e shkollimit të tyre.

Shteti të marrë përsipër të gjitha librat shkollorë për arsimin parashkollor dhe parauniversitar, për familjet me ndihmë ekonomike dhe do të dyfishojë bursat për shkollat e mesme dhe universitetet e vendit që këtë vit.

Do të rindërtohen ose do të ndërtohen nga e para edhe rreth një mijë shkolla që kanë mbetur në mbarë vendin. Në fund të këtij mandati fëmijët shqiptarë do të kenë shkolla të reja ose të rindërtuara plotësisht.

Mësimet dixhitale do të zhvillohen në të gjitha shkollat e vendit.

Do të lehtësohet barra fiskale dhe t'u ofrohet toka për shkolla sektorit privat.

Do të dyfishohen investimet në sektorin privat në arsim, dhe, siç e theksova, do të hiqet TVSH-ja. Rrogat e mësuesve të vendit do të rriten, për të parakaluar në fund të mandatit gjashtë vende anëtare të BE-së.

Fondi i Ekselencës do të zgjerohet me bursa për studentët shqiptarë, jo tashmë në 10, por në 15 universitetet më të mira të planetit. Cilido i ri apo e re që aplikon dhe fiton të drejtën të ndjekë shkollimin apo gradimin në këto universitete, Qeveria Shqiptare do t'i përgjigjet atij kudo që të jetë ai, në Shqipëri, në diasporë, në Maqedoni, në Kosovë, në Mal të Zi e kudo kundrejt një kontrate të caktuar.

Pas reformës së thellë të institucioneve shkencore, krijimit të Agjencisë për Kërkime Shkencore dhe Inovacionit, Qeveria është e vendosur të dyfishojë buxhetin për kërkimin shkencor. Në kuadrin e projektit Brain Gain dhe fondit të Ekselencës, do të rritet dhe inkurajohet bashkëpunimi i institucioneve shkencore të vendit me ato të huaja.

Garantoj institucionet kulturore kombëtare, artistët dhe krijuesit e këtij vendi se këto katër vjet fondet për kulturën do të ndiejnë një rritje të madhe;

statusi i tyre do të ketë një përmirësim të madh.

Një kujdes të veçantë Qeveria do të dëshmojë drejt trashëgimisë kulturore të këtij vendi.

Riorganizimi tërësor i sistemit të arkeologjisë mbi bazën e distrikteve, alokimi i fondeve dhe i resurseve të nevojshme njerëzore për zbulime të reja arkeologjike, konservimi i tyre është një detyrim madhor jo vetëm për të pasuruar trashëgiminë tonë kulturore, por për ta paraqitur atë para mbarë botës, para turistëve që vërshojnë nga të katër anët e dheut për të vizituar Shqipërinë.

Qeveria me programe të veçanta do të përparësojë punësimin e të rinjve me linja krediti, do të ndihmojë inicimin e bizneseve, por edhe strehimin e çifteve të reja.

Sporti dhe sportistët shqiptarë do të kenë mbështetjen e fuqishme të Qeverisë, së pari, në masivizimin e sporteve, por edhe në elitarizmin e tij.

Punësimi

Mjeti më efikas, antidodi më absolut kundër varfërisë është punësimi dhe vetëm punësimi. Punësimi i qytetarëve shqiptarë do të jetë përparësi e të gjitha përparësive.

Ne jemi zotuar që në katër vjetët që vijnë do të krijojmë rreth 160 mijë vende pune.

Do të ndërmerren reforma të thella dhe të gjithanshme të tregut të punës.

Do të dyfishohet buxheti për shkollimin, trajnimin, kualifikimin, përshtatjen e aftësive të të papunëve dhe të atyre që humbasin vendin e punës me kërkesat e tregut.

Do të aplikohen stimuj fiskalë për punëtorët. Në vitin e parë të punësimit të tyre i gjithë sistemi arsimor do të përshtatet me kushtet dhe kërkesat e tregut. Do të merren përsipër sigurimet shoqërore të punonjësve të rinj.

Dixhitalizimi

Shqipëria aktuale është sot vendi me ritmet më të larta të rritjes së penetrimit të IT-së, por njëkohësisht është ende larg standardeve mesatare europiane.

Ajo është vendi i internetit në të gjitha shkollat, i taksës dhe i doganave, i regjistrimit elektronik kombëtar të Gjendjes Civile, të biznesit, të penaliteteve, prokurimit elektronik 100%.

Ne synojmë të finalizojmë brenda vitit 2010 e-government dhe e-governance.

Mosha dixhitale do të shtrihet dhe konsolidohet në të gjitha shërbimet dhe fushat e jetës së vendit, interneti me bandë të gjerë duhet të sigurohet brenda vitit 2012 në të gjitha familjet, në fshatrat dhe qytetet e vendit, kompjutera për të gjithë të rinjtë shqiptarë në shkollat e vendit, brenda vitit 2013.




Reforma

Reforma e pronësisë do të mbetet një nga reformat themelore të vendit. Në këtë kontekst, kjo reformë do bazohet në:











- përfundimin e Regjistrimit Dixhital të Pronave në Shqipëri, brenda viti 2011;
- dixhitalizimin e të gjithë arkivit dhe dokumentacionit të procesit të kthimit dhe kompensimit të pronave, brenda vitit 2010;
- përzgjedhjen e një kompanie serioze, me garë të hapur, për regjistrimin e pronave, brenda vitit 2011; – rritjen progresive të fondit të kompensimit monetar dhe fizik të pronave dhe rikthimit të tyre në të gjitha rastet e mundshme;
- mbrojtjen dhe garancinë shtetërore për investitorët dhe investimet në prona të blera mbi bazën e dokumenteve shtetërore të rregullta të pronësisë;
- zgjidhjen brenda vitit 2010 të titujve të pronësisë, bazuar në ligjin nr.7501;
- përfundimin e procesit të legalizimit në të gjithë territorin e vendit, në përputhje me ligjin ekzistues, brenda shtatorit të vitit 2010.

E drejta e pronarëve shqiptarë është dhe do të mbetet përparësi kryesore e Qeverisë së Integritimit European.

QEVERISJA E PD DHE LSI PREMTIMET NË PROGRAMIN QEVERISËS 2009-2013

Përbushur		Në progres		Pa përbushur	
-----------	-----------------------------------------------------------------------------------	------------	-----------------------------------------------------------------------------------	--------------	-------------------------------------------------------------------------------------

PËRFSHIRJA DHE PËRMBUSHJA E PREMTIMEVE TË PD NË PROGRAMIN QEVERISËS

N r.	FISKALE/ BUXHETORE	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/ BURIMI
1	160 mijë të punësuar në mandatin e dytë (2009-2013)		PO	INSTAT ¹⁸² ISSH ¹⁸³
2	Do nxjerrim nga varfëria 4 vitet e ardhshme edhe 300 mijë shqiptarë		PO	INSTAT ¹⁸⁴
3	Trifishojmë investimet në zonat rurale		PO	PBA 2009-2014 S.ZH.R.B 2014-2020
4	Nuk do ketë pension në fshatra nën 100 dollarë		JO	INSTAT, 2013 ¹⁸⁵
5	Do të barazojmë pensionet e fshatit me pensionet e qytetit		PO	INSTAT, 2013
6	Taksa e tabelës për bizneset do të përcaktohet me ligj dhe do të jetë vetëm 1 euro		JO	L.S.T.V ¹⁸⁶
7	Investimet e huaja në Shqipëri do të çojmë në 8 miliard euro		JO	INSTAT, 2013
8	Për të nxitur punësimin në zonat e varfra heqim taksat për bizneset për 5 vjet.		JO	LIGJET TATIMORE ¹⁸⁷
9	Mandatin e ardhshëm asnjë shqiptar nën nivelin e 2 dollarëve në ditë		JO	INSTAT, 2013
10	Do të ndërtojmë banesa sociale dhe do të zgjidhim përfundimisht problemin e 450 familjeve		JO	TCH ¹⁸⁸

¹⁸² <http://www.instat.gov.al/media/1733/albania-in-figures-2013.pdf>

¹⁸³ http://www.iss.gov.al/wp-content/uploads/2014/02/Raport_Vjetor_2013.pdf

¹⁸⁴ http://www.instat.gov.al/media/2064/shqiperi-trendi_i_varferise_2012_.pdf




¹⁸⁵ <http://www.instat.gov.al/media/1733/albania-in-figures-2013.pdf>






¹⁸⁶ <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/8.pdf>

¹⁸⁷ <https://www.tatime.gov.al/c/6/legjislacioni>

¹⁸⁸ <https://top-channel.tv/2013/09/10/tirane-banesat-sociale-ende-asnje-zgjidhje/>

11	Krogat dhe pensionet do të jenë dy herë më të larta se sa gjashtë vende anëtare të BE		PO	EUROSTAT, 2013 ¹⁸⁹ INSTAT, 2013
----	---------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------	----	-----------------------------------------------

N r.	SHËNDETËSIA	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Krijojmë partneritet publik-privat në shëndetësi		PO	MFE ¹⁹⁰
2	Luftojmë korrupsionin në sektorin e shëndetësisë		PO	MSH ¹⁹¹
3	Shtrijmë sigurimet shëndetësore edhe në sektorin privat		PO	FSDKSH ¹⁹²

N r.	ARSIMI DHE RINIA	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Dyfishojmë buxhetin për sektorin e arsimit në 8% të PBB		PO ¹⁹³	PBA 2009-2014
2	2 mijë vende shtesë në universitetet publike		PO	MAS ¹⁹⁴ MONITOR ¹⁹⁵
3	Bursë plus 100 mijë USD/vit për çdo të ri që fiton studimet në 1 nga 10 universitetet më të mira të planetit		PO	PBA 2009-2014
4	Plani ynë është që asnjë fëmijë analfabet të mos jetë në Shqipëri		PO	UNESCO ¹⁹⁶
5	Çdo fëmijë që mbaron 9-vjeçaren të mund të vazhdojë gjimnazin		PO	INSTAT ¹⁹⁷⁻¹⁹⁸

¹⁸⁹ <https://ec.europa.eu/eurostat/documents/3930297/5968986/KS-FP-13-001-EN.PDF/6952d836-7125-4ff5-a153-6ab1778bd4da>

¹⁹⁰ <http://financa.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/Raporti-Paraprak-i-Permbledhur-i-koncesioneve-PPP-date-24.12.2019.docx>

¹⁹¹ https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2014/11/Monitorimi-i-strategjise-antikorrupsion_MSH.pdf

¹⁹² https://www.fsdksh.com.al/images/stories/baza_ligjore/11janar2016/Ligj_nr_10_383_dat_24_2_2011_Pr_sigurimin_e_detyrueshm_t_kujdesit_shndetsor_n_Republikn_Shqipris_i_ndryshuar.pdf

¹⁹³ buxheti për arsimin, nga sektori publik dhe privat do të arrijë në 7% të PBB-së, kurse ai i sektorit publik në 6% të prodhimit të brendshëm bruto




¹⁹⁴ <https://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Analiza-Kuota-Tarifa.pdf>





¹⁹⁵ <https://www.monitor.al/numri-studenteve-ne-universitetet-publike-hyn-ne-cikel-renes-ja-shkaqet/>

¹⁹⁶ https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000259245_alb

¹⁹⁷ http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START__ED__REG/REG03/table/tableViewLayout2/?rxid=89b7111c-1800-4671-b5b2-fd31eb9ccac8

¹⁹⁸ http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START__ED__REG/ArSm01/table/tableViewLayout2/?rxid=89b7111c-1800-4671-b5b2-fd31eb9ccac8

6	Hapje ndaj sektorit privat në arsim		PO	L.A. L ¹⁹⁹
7	Në 2013 Shqipëria do të ketë 160 mijë studentë		PO	INSTAT ²⁰⁰ MONITOR ²⁰¹
8	Internet në çdo familje brenda mandatit të ardhshëm		PO	KM ²⁰²
9	Çdo i ri shqiptar të ketë kompjuterin e tij		PO	PBA 2009-2014
10	Çdo i ri që kërkon punë të mund të punësohet		PO	INSTAT ²⁰³
11	Çdo i ri që krijon familje të ketë mundësi të krijojë strehën e vet		PO	N/A
12	Nuk do ketë shkollë të mos jetë e re ose e rindërtuar		PO	PBA 2009-2014
13	Përhapja e të mësuarit e-learning apo mësimi dixhital		PO	UNESCO

N r.	BUJQËSIA DHE FSHATI	PERMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/ BURIMI
1	Urbanizojmë plotësisht gjithë pjesën e Myzeqesë		JO	PBA 2009-2014
2	4 vitet që vijnë do të pesëfishojmë rrënjët e ullirit në Shqipëri		PO	STUDIM ²⁰⁴
3	Do të pesëfishojmë së paku grantet për prodhimet bujqësore		PO ²⁰⁵	RAPORT KLSH ²⁰⁶
4	Investojmë 4 vitet e ardhshme për bujqësinë më shumë se në 70 vitet që shkuan		PO ²⁰⁷	MONITOR ²⁰⁸ PBA 2009-2014
5	Çdo fshat do të ketë ujësjellësin e tij, çdo familje shqiptare do ketë ujin brenda shtëpisë		JO	PBA 2009-2014

¹⁹⁹ <https://ascap.edu.al/wp-content/uploads/2017/03/Ligji-per-arsimin-e-larte.pdf>

²⁰⁰ http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START__ED__REG/ED0101/?rxid=2e23b513-ac38-4230-8e64-6216d994d43b

²⁰¹ <https://www.monitor.al/biznesi-50-milione-euro-universiteteve-private-kush-e-mori-tregun-e-atyre-qe-u-mbyllen/>

²⁰² <https://akep.al/wp-content/uploads/2018/09/VENDIM-Nr.468-date-30.05.2013-Per-miratimin-e-planit-kombetar-Broadband.doc>

²⁰³ http://databaza.instat.gov.al/pxweb/sq/DST/START__TP__AD__ADY/ADY137/table/tableViewLayout2/?rxid=dc796fad-d041-487d-8da6-c8770ddfd07a


²⁰⁴ <http://atcvlore.al/wp-content/uploads/2019/05/Pershtatshmeria-e-kultivareve-te-ullirit.pdf>



²⁰⁵ Ne vend te premtimit per pesefishim eshte shprehur per shumefishim




²⁰⁶ http://www.klsh.org.al/web/209_vendimi_efektiviteti_i_granteve_ne_azhbr_3783.pdf

²⁰⁷ trefishim te investimeve

²⁰⁸ <https://www.monitor.al/100-vjet-bujqesi/>

6	Lidhim fshatrat e komunave me rrugë të asfaltuara me qendrat		PO	PBA 2009-2014
7	Importet, nafta, plehrat rimbursim me skemën anti-korrupsion		JO	N/A
8	Financim çdo projekti për rritjen e prodhimit të fermerëve		PO	RAPORT KLSH
9	Subvencionim naftës dhe importeve të tjera për sipërfaqet e mbjella		PO	STUDIM ²⁰⁹
10	Rindërtim i plotë i sistemeve të vaditjes		PO	PBA 2009-2014
11	Qeveria do ndërtojë dhe rindërtojë sistemin më modern të vaditjes		JO	PBA 2009-2014
12	Me sistemin e kanalizimeve, pastrim i plotë i ujërave		PO	PBA 2009-2014
13	Investime në agrobiznes dhe nxitje të përpunimit			MONITOR ²¹⁰














N r.	INTEGRIMI/ ANTIKORRUPSIONI	PERMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/ BURIMI
1	Liberalizim i plotë i regjimit të vizave brenda vitit të parë të mandatit të dytë		JO	KM ²¹¹
2	Çojmë para ligjit këdo që kërkon të mbushë xhepat me paratë tuaja		PO	


N r.	INFRASTRUKTURA VEPRAT PUBLIKE	DHE PERMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/ BURIMI
1	Asfaltuam 6000 km rrugë, asfaltojmë mandatin tjetër edhe 12000 km po të kishite		PO	PBA 2009-2014
2	Autostrada Qafë Plloçë - Qukës, e cila do të përfundojnë në fund të vitit 2010		PO	PBA 2009-2014
3	Do të fillojmë ndërtimin e autostradës Tiranë-Elbasan		PO	PBA 2009-2014

²⁰⁹ <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/13139.pdf>

²¹⁰ <https://www.monitor.al/me-2013-mbi-26-milione-euro-investime-ne-bujqesi/>




²¹¹ <http://arkiva.km.gov.al/showalbum.php?albumID=16&gj=gj1&start=7128>





4	Rruga e Gjinarit, asfaltim Librazh-Qafë Plloçë, hyrja e Gramshit, Kuçovë-Belsh-Cërrik		PO	PBA 2009-2014
5	Fillon ndërtimi i rrugës Baldushk-Papër		JO	PBA 2009-2014
6	Shumë shpejt do të fillojë ndërtimin Boshti i Jugut që afron Sarandën me Tiranën		PO	PBA 2009-2014
7	Ndërtojmë Parkun Industrial të Vlorës		PO	PBA 2009-2014
8	Vlora ndër portet më të mëdha të Mesdheut me 50 mijë të punësuar, 2 miliard euro investim		JO	PBA 2009-2014
9	Vlora do të ketë aeroportin e vet		JO	PBA 2009-2014
10	Do të përfundojmë Rrugën e Arbrit		PO	PBA 2009-2014
11	Do të përfundojmë rrugën Kardhiq-Delvinë		PO	PBA 2009-2014
12	Tirana do të jetë në katër vite kryeqyteti me unazën më moderne dhe më të re në Europë		PO	PBA 2009-2014
13	Qeveria do të mbështesë financimin projektit për ndërtimin dhe sistemimin e tregut çam		PO	PBA 2009-2014
14	Rrogzhina do të nisë së shpejti by pass-in e saj		PO	PBA 2009-2014
15	Inaugurojmë Velipojë-Ulqin, së shpejti rruga Koman-Fierzë, së shpejti bypass i Shkodrës dhe Unaza e liqenit tuaj		JO	PBA 2009-2014
16	Do të ndërtojmë rrugën e re Tiranë - Krujë - Qafë Shtamë		JO	PBA 2009-2014

N r.	ENERGJIA	PERMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Mandatin e dytë Shqipëria eksportues i rëndësishëm i energjisë elektrike në Ballkan		PO	ITC ²¹²
2	60 mijë të punësuar në hidrocentralet në gjithë Shqipërinë		JO	INSTAT ²¹³
3	Filloi ndërtimin Parku energjetik në Lezhë me ndërtimin e centralit me		PO	E.R.E. 2008-2014

²¹² <http://energija.al/2014/09/11/eksporti-dhe-importi-i-energji-se-2008-2013>

²¹³ <http://www.instat.gov.al/media/1897/tregu-i-pun%C3%ABs-2013.pdf>

	biomasë të lëngshme 140 MW, investim 1.1 miliard euro			
4	Kemi gati 5.6 miliard euro investime në 104 hidrocentrale, në 6 parqe industriale, në 4 parqe energjetike		JO	E.R.E. 2008-2014
5	Shfrytëzimi i potencialeve ujore dhe Shqipëria superfuqi të vogël energjetike në rajon		PO	ËORLD BANK ²¹⁴
6	Nuk do të ketë ndërprerje të energjisë për mungesë të saj		JO	RAPORT I E.R.E. 2013 ²¹⁵

N r.	POLITIKA/REFORMA	PERMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Katër vitet që vijnë nuk do të ketë familje shqiptare që të mos ketë ujë 24 orë		PO	RAPORT E.RR.U 2013 ²¹⁶
2	Do të dyfishojmë prodhimin e naftës në katër vitet që vijnë		PO	AKBN ²¹⁷
3	Do të shkurtojmë 5 vite pensionin e minatorëve dhe me efekt prapaveprues		JO	KUVENDI BUXHETI 2013
4	Të gjitha blerjet e qeverisë do të bëhen në mënyrë elektronike		PO	AKSHI ²¹⁸
5	Do të krijojmë Qendrën Kombëtare, sportelin unik		JO	KM 2013
6	80% të vlerës për legalizimet mund të paguhet me letra me vlerë		JO	MF ²¹⁹
7	Ligji i parë që do miratojmë është ai për Gjykatën Administrative		JO	L.GJ.A. ²²⁰
8	Nuk do përdorim ndonjëherë vlerë tjetër përveç vlerës së tregut për kompensimin monetar apo fizik të pronarëve		JO	WORLD BANK ²²¹

²¹⁴ <http://documents1.worldbank.org/curated/ar/201391544823541838/pdf/Western-Balkans-Energy-Directions-Paper.pdf>

²¹⁵ https://www.ere.gov.al/doc/Raporti_Vjetor_2013_perfundimtar.pdf

²¹⁶ https://www.erru.al/doc/UK-Albanian_B_lowres_opt.pdf

²¹⁷ <http://www.akbn.gov.al/prodhimi-i-naftes/>

²¹⁸ <https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/RAPORTI-VJETOR-AKSHI-2015-1.pdf>

²¹⁹ <https://financa.gov.al/pse-e-shtyme-afatin-e-bonove-ja-kategorite-perfituese/>


²²⁰ <http://gjykataadministrativeapelit.al/wp-content/uploads/2014/07/LIGJgjkadm.pdf>





²²¹ <http://documents1.worldbank.org/curated/pt/735421468003297969/text/625190EGR0ALBA00Property0Rights0ALB.txt>

PËRFSHIRJA DHE PËRMBUSHJA E PREMTIMEVE TË LSI NË PROGRAMIN QEVERISËS

N r.	FISKALE/BUXHETORE	PERMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Për çdo biznes të ri që do punësojë më shumë sesa pesë veta do të heqim tatim fitimin për disa vite		JO	L.T.A.
2	Do të rishikojmë politikën e taksave për të ardhurat e individit, duke përjashtuar nga tatimi mbi të ardhurat të gjitha pagat deri 25 mijë lekë/muaj		JO	L.T.A.
3	Përgjysmimi i TVSH-së për produktet baze ushqimore nga 20% në 10 %		JO	L.T.V.SH.
4	Do të subvencionojmë energjinë për 300 kilovat/ orë në muaj për familjarët e varfër		JO	E.R.E.
5	Për çdo vend të ri pune që do të krijohet - heqjen e tatimit mbi fitimin deri në Dhjetor të vitit 2010, - subvencionimin e sigurimeve shoqërore në masën 50 për qind deri në fund të vitit 2011, dhe - subvencionimin 100 për qind të sigurimeve shoqërore		JO	L.T.A. L.K.S.SH.
6	Do të synojmë që pagat në administratën publike të jenë plotësisht të konkurueshme me ato në sektorin privat		JO	INSTAT
7	Të garantohen lehtësira fiskale për industrinë fason		JO	L.T.V.SH. L.T.A. ETJ
8	Qeveria të subvencionojë sigurimet shoqërore për punonjësit. Të bëhet në kohë rimbursimi i TVSH		JO	L.K.S.SH. L.T.V.SH.
9	Subvencionim në masën 50 %, të sigurimeve shoqërore për punëdhënësit deri në Dhjetor 2011 dhe heqjen e tatimit fitimit deri në Dhjetor 2010		JO	L.K.S.SH. L.T.A.
10	Qeveria dhe Banka të mundësojnë ristrukturimin e kredive për bizneset fason		JO	BSH ²²²

²²² https://www.bankofalbania.org/rc/doc/Raporti_Vjetor_i_Mbikeqyrjes_2013_7112_1_7510.pdf

N r.	SHENDETESIA	PERMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Garantimi i një shërbimi mjekësor gjithnjë e më pranë qytetarëve		JO	MSH ²²³
2	Krijimi i një urgjence kombëtare të arritshme nga çdo qytetar dhe me teknologjinë e duhur		JO	RAPORT FSDKSH 2013 ²²⁴
3	Kritje e menjëhershme e financimit të shëndetësisë në PBB deri në minimumin 4% në fund të mandatit qeverisës		JO	PBA 2009-2014
4	Ndërtimi i një skeme të sigurimeve shëndetësore reale që garanton e mbulon plotësisht qytetarët për shërbimin parësor të tyre		JO	RAPORT FSDKSH
5	Realizimi i rajonalizimit të spitaleve në nivel të çdo qarku		JO	RAPORT FSDKSH
6	Ndryshimi rrënjësor i spitaleve tona duke nxitur e mbështetur autonominë e tyre dhe sigurimi i një shërbimi mjekësor spitalor me cilësi		JO	RAPORT FSDKSH
7	Sigurimi i një kontrolli sanitar dhe epidemiologjik intensiv, profesional dhe të mbështetur me kompetencat ligjore të duhura		PO	RAPORT FSDKSH
8	Sigurimi i shërbimit mjekësor të specializuar për të moshuarit në të gjithë spitalet e vendit		JO	N/A

N r.	ARSIMI	PERMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Paga e mësuesit do të dyfishohet brenda mandatit të ardhshëm qeverisës		PO	PBA 2009-2014
2	Brenda 4 viteve të ardhshme do të rristrojmë mbi 80 përqind infrastrukturën e shkollave		PO	PBA 2009-2014
3	Brenda 4 viteve të ardhshme do të realizojmë decentralizimin e plotë të shkollës me qëllim rritjen e efektivitetit të saj		PO	UNESCO ²²⁵
4	Heqja e menjëhershme e TVSH nga shërbimet e arsimit, si dhe ulja e detyrimeve të tjera, duke përfshirë edhe tatimin mbi fitimin		PO	L.T.V.SH. ²²⁶

²²³https://extranet.who.int/countryplanningcycles/sites/default/files/planning_cycle_repository/albania/draft_strategt_albania_2016-2020.pdf

²²⁴ <https://fsdksh.gov.al/wp-content/uploads/2019/11/RAPORTI-2013-final.pdf>

²²⁵ https://unesdoc.unesco.org/ark:/48223/pf0000259245_alb

²²⁶ <https://www.tatime.gov.al/shkarko.php?id=427>

5	Do të vendosim një partneritet solid midis sektori publik dhe atij privat të arsimit		PO	L.A.L.
6	Diplomat e studentëve që përfundojnë arsimin e lartë, të duhet të jenë në përputhje me kategoritë dhe mundësitë e punës		JO	
7	Minimalizimi i braktisjes së shkollës duke ndryshuar ligjin ekzistues		JO	
8	Ne do t'i kthejmë shkollat në qendra të integruara për shërbime komunitare		JO	
9	Paketa jone e Bonusit jetik parashikon subvencionimin e plotë të librave për familjet e varfra, një masë që do ndikojë në zbutjen e braktisjes së shkollës		JO	
10	Do të krijojmë mundësi për kreditimin e studimeve universitare nga Bankat, pa interes, për ata studentë që kanë nevojë		PO	
11	Mësimi i gjuhës shqipe nga emigrantët do të jetë pjesë e rëndësishme e reformës sonë arsimore		PO	
12	Do të punojmë për të krijuar filiale të universiteteve në qytetet më të rëndësishme		PO	
13	Rikonceptim te reformes se Matures Shteterore		PO	STUDIM ²²⁷
14	Do të punojmë që rinia të ketë sa më shumë ambiente sportive		PO	
15	Do të përmirësojmë në mënyrë të ndjeshme raportin midis shkollës së mesme profesionale dhe shkollës së përgjithshme		PO	RAPORT MONITORIMI ²²⁸
16	Kërkimi shkencor është një prioritet shumë i rëndësishëm		PO	

N r.	BUJQËSIA	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Krijimi dhe zhvillimi i tregut të tokës për ne është abc-ja e zhvillimit të këtij sektori		PO	
2	Do të konsolidojmë pronësinë mbi tokën dhe të zgjerojmë tregun e saj		PO	
3	Zgjidhja e çështjes së pronësisë		PO	S.N.D.P. 2012-2020
4	Synohet që deri në vitin 2010 të dyfishohen investimet për bujqësinë		JO	


²²⁷ <https://www.idrainstitute.org/files/reports/State%20Matura/Matura%20Shteterore%202012.pdf>

²²⁸ https://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/2016_Raporti_i_Monit_12-mujori_Janar-Dhjetor_2016_30.01._2017_F_N_Final.pdf

5	Subvencionim për njësi produkti, pra subvencione për çdo kg mish, grurë, fruta apo litër qumësht të prodhuar			JO	
6	Krijimi i markave e brandeve, që do të konkurojnë nesër në tregun e eksporteve, por edhe që do të furnizojnë në mënyrë atraktive industrinë turistike në vend			JO	
7	Stimujt fiskalë do të përqendrohen në mënyrë të veçantë tek agro-përpunimi, ku do të përjashtojnë nga tatimi mbi fitimin për tri vitet e para çdo biznes agro-përpunues			JO	
8	Do të ketë një fond të veçantë për garanci kreditimi, si dhe do të ketë zbritje të konsiderueshme nga tatimi për bizneset agro-përpunuese për punësimin			JO	
9	Bonusi jetik dhe punësimi jetik do të jenë pjesë themelore e politikës sonë edhe në fshat, pasi aty është edhe varfëria më e madhe			JO	
10	Do të krijohen lehtësira fiskale për bizneset e reja prodhuese			JO	
11	Investimi në kualifikimin profesional të të rinjve dhe fermerëve në fushën e bujqësisë	✗		PO	
12	Përmes krijimit dhe zhvillimit të industrisë agropërpunuese, në 4 vitet e ardhshme të krijojmë 30 mijë vende të reja pune në të gjithë Shqipërinë			JO	
13	Kërkimi shkencor është një prioritet shumë i rëndësishëm	✗		PO	STUDIM ²²⁹ PBA 2009-2014

N r.	MBROJTJA SOCIALE	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Punësim për çdo familjar që ka nevojë për të punuar për të siguruar të ardhura		JO	
2	“Plani ynë për Veprim” është plani që ndihmon gati 1 milion shqiptarë që të kapërcejnë njëherë e mirë pragun e varfërisë		JO	
3	Kemi një plan real, të mirëstudiuar dhe konkret për krijimin e 100.000 vende te reja pune, në të gjithë sektorët, veçanërisht ata që lidhen me agro-industrinë e agro-turizmin		JO	

²²⁹ <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/12/Doktoratura-Nada-Kallciu-Fakulteti-i-Shkencave-Sociale-Departamenti-Psikologji-Pedagogjise.pdf>

4	20 mijë vende pune mund të hapen për të gjithë ata të rinj apo të gjithë ata shqiptarët që do të dëshironin të punësoheshin në transportin detar		JO
5	Punësimi do të motivohet me skema incentivash konkrete fiskale		JO
6	Kemi qëllimin e punësimit të plotë të shqiptarëve brenda mandatit të ardhshëm		JO
7	Punësim për të gjithë shqiptarët që dëshirojnë të sigurojnë një vend pune brenda katër viteve të ardhshme		JO
8	Do të propozojmë paketën e Bonusit jetik, një paketë parash në <i>cash</i> , incentivash fiskale, dhe politikash të tjera		JO
9	Në reformën e asistencës sociale do të institucionalizojmë modelin e “punësimit jetik”		JO
10	Kushtëzim përfundim të ndihmës ekonomike kryesisht me punësimin në sektorin publik dhe sferën komunitare		JO
11	LSI ka paraqitur në Kuvend projektligjin për kujdesin ndaj moshës së tretë dhe propozojme një pension të 13-të për çdo person të moshës së tretë		PO
12	Ngritje të institucioneve të kujdesit për moshën e tretë nga pushteti vendor në gjithë vendin		JO
13	Rimbursim të plote të çdo medikamenti që përdor moshë e tretë		JO
14	Transport urban falas apo me gjysëm çmimi, Shërbim shëndetësor në familje falas, strehim me prioritet për moshën e tretë, Pagesë minimale për pensionistët që jetojnë në shtëpi me të paaftë të tjerë		JO
15	Do të favorizojmë me lehtësira fiskale, në veçanti, bizneset që punësojnë gra e sidomos ato që punësojnë kryefamiljare		JO
16	Do të mbështesim konkretisht gratë që synojnë të hapin biznese		JO
17	Do të aplikojmë një sistem totalisht të ri të kontrollit shëndetësor duke ofruar shërbime falas për gratë, për vaksinimin dhe patologjitë specifike që prekin ato		JO
18	Të gjitha gratë kryefamiljare do të marrin ndihmë ekonomike të plotë dhe do të ketë një politikë të veçantë nga ana e qeverisë dhe e shtetit për to		JO

19	Do të garantojmë strehim, punësim dhe arsim për komunitetin rom dhe atë egjiptian	✗	PO
20	Lufta me program konkret kundër varfërisë dhe kundër monopoleve	✗	PO



N r.	INFRASTRUKTURA	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Do ta përfundojmë dhe do ta inagurojmë Durrës-Kukës të gjithë së bashku	✗	PO	
2	Do të jetë përgjegjësia, nderi dhe privilegji ynë të përfundojë edhe rrugën e Kosovës edhe rrugën e bregdetit		JO	
3	Ndërtimi i rrugës së Arbrit është një domosdoshmëri	✗	PO	PBA 2009-2014
4	Do të ndërtojmë në Durrës, Portin më të fuqishëm në Ballkan		JO	
5	Karaburuni do të shndërrohet në perlën turistike të gjithë Mesdheut		JO	
6	Do ta kthejmë Lezhën në një perlë të Adriatikut tonë		JO	

N r.	ENERGJIA DHE INDUSTRIJA	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Projektligji i paraqitur nga LSI për Statusin e minatorit		JO	
2	Në mënyrën më të padrejtë është mohuar "Statusi i Usharakut"		JO	
3	Do të hapim 6 mijë vende të reja pune, në sektorin e naftës	✗	PO	INSTAT, TREGU PUNES 2013
4	Garanton statusin e naftëtarit, dhe pagesën e plotë për ish-punonjësit e ARMO-s		JO	
5	Kundër mënyrës së privatizimit të OSSH sh.a. Ky do të jetë një nga privatizimet që do të rishikohet menjëherë me ardhjen në qeveri		JO	

N r.	ZHVILLIMI URBAN	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Ne garantojmë legalizimin për t'i dhënë fund kësaj drame që keni ju që keni gati dy dekada	✗	PO	RAPORT ASHK ²³⁰

²³⁰ <https://www.ashk.gov.al/wp-content/uploads/2015/11/Raportim-p%C3%ABr-periudh%C3%ABn-2013-2014.pdf>

2	Zgjidhja dhe konsolidimi i çështjes së pronësisë në Shqipëri		PO	S.N.D.P. 2012-2020
3	Do të shfuqizojmë moratoriumin për mjetet e vogla lundruese		JO	

N r.	INTEGRIMI/POLITIKE	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Do të bëjmë gjithçka për të njohur të gjitha sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe të gjitha llojet e tjera të sigurimeve të vëllzërve e motrave tanë emigrantë		JO	
2	Do të favorizojmë investimet e emigrantëve në Shqipëri		PO	
3	Do të realizojmë heqjen e vizave brenda rajonit deri në fund të vitit 2009, dhe do të realizojë lëvizjen e lirë në BE brenda një viti.		PO	KM

Mbrojtja, siguria dhe integrimi

Angazhimi i institucional për përgatitjen e Dokumentit të Strategjisë Kombëtare. I mbetur i paripunuar që nga viti 2004, ky dokument i rëndësishëm do të hartohet në përputhje me kushtet e reja të mjedisit të sigurisë, si dhe bazuar në “Konceptin e ri Strategjik” të Aleances, të vitit 2010. Pas miratimit në Kuvendin e Shqipërisë, qeveria do të përgatitë Dokumentin e Ri të Strategjisë Ushtarake, për të realizuar përputhjen e nivelit të ambicjeve kombëtare, me burimet financiare në fushën e mbrojtjes, të parashikuara këto në dokumentin e Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes.

Plan afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të FARSH për periudhën 2013-2020. Synimi i hartimit e zbatimit të planit afatgjatë të zhvillimit do të jetë:

- Krijimi i një strukture të re organizative të FA, duke ulur në mënyrë graduale numrin aktual të personelit;
- Rishikimi i tërë sistemit të edukimit, arsimimit dhe trajnimit të Forcave të Armatosura, me qëllim përgatitjen e ushtarit profesionist, nënoficerit, oficerit të trupës dhe shtabit të Forcave të Armatosura, në përputhje me nevojat e strukturës së re të kësaj force.

Prioritet do të marrë realizimi i gatishmërisë operacionale të Grup Batalionit të Këmbësorisë së Mekanizuar si dhe Grupit të Forcave Tokësore për Operacionet Speciale, duke përbushur në këtë mënyrë detyrimet ndaj NATO-s në kapacitetet ushtarake, të kërkuara për mbrojtjen kolektive dhe operacionet e ruajtjes së paqes.

Ne do të ripunojmë kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e Forcave të Armatosura. Në thelb të kësaj pune do të jetë përmirësimi i Statusit të Ushtarakut me synim, rikthimin e dinjitetit të nëpërkëmbur dhe rritjen e besimit të tyre tek shteti.

Duke e konsideruar një prioritet absolut, sigurinë dhe rivendosjen e rendit publik, Qeveria angazhohet për të rikthyer besimin e publikut në një Shqipëri më të sigurt, ku forca e ligjit vlen për të gjithë në mënyrë të barabartë, në përbushje dhe respekt të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Objektivi ynë absolut është shembja e murit të pandëshkueshmërisë dhe imuniteteve të paligjshme.

- (i) do të rikthejmë Policinë e Shtetit në krye të detyrës, për të garantuar rendin dhe qetësinë publike;
- (ii) do të rikthejmë Policinë e Shtetit në kontroll të territorit, duke angazhuar të gjitha burimet e nevojshme për parandalimin e krimit dhe uljen dukshëm të shkallës së kriminalitetit;
- (iii) do të normalizojmë trafikun rrugor, duke marrë masat e domosdoshme për evitimin e aksidenteve të rënda;

- (iv) do të përmirësojmë cilësisht shërbimin e Policisë së Shtetit në kufi dhe luftën kundër krimit ndërkufitar. Duke përfutur edhe nga ndihma dhe përvoja e partnerëve ndërkombëtarë, do të shënojmë rritje cilësore në luftën kundër krimit ekonomik e veçanërisht kundër pastrimit të parave.

Rikonceptimin strukturor dhe funksional të Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit. Synimi kryesor është ndërtimi i një sistemi mekanizmesh të përqëndruara që garantojnë efikasitet, përgjegjshmëri, veprim funksional për mbrojtjen e plotë të ligjit në të gjithë vendin dhe efektivitet në kohë. Parimi i reformës “Një Shtet – Një Polici” do të bëjë të mundur njësimin e funksioneve policore të disa agjencive ligjzbatuese të ngjashme, duke eliminuar mbivendosjen e kompetencave, anarkinë e veprimit ose mosveprimin, si dhe duke garantuar standardizimin e veprimit në territor dhe kohë.

Marrja e statusit të vendit kandidat dhe fillimi i bisedimeve për anëtarësimin në Bashkimin Evropian do të përbëjnë përparësinë e veprimit politik të shumicës së re.

Përbushja e pjesës së mbetur nga 12 prioritetet e Planit të Veprimit, janë elementë kryesorë për cilësinë dhe shpejtësinë e procesit të aderimit të Shqipërisë në BE.

Strategji të re për Zhvillim dhe Integrim 2014 – 2020 dhe strategjitë e tjera sektoriale, duke siguruar përputhshmërinë e këtyre dokumenteve me IPA II, sikundër do të përditësojmë Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA.

²³¹ https://akshi.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Programi_Qeverise.pdf

Do të përmirësojmë rrënjësisht modelin aktual të bashkërendimit të ndihmës së BE dhe asistencën dypalëshe e ndërkombëtare, duke e kanalizuar atë drejt agjendës zhvillimore të vendit. Në vend të ping pongut institucional do të ndërtojmë një mekanizëm në nivel ndërinstitucional për identifikimin e nevojave dhe kapaciteteve për programimin dhe zbatimin e projekteve të financuara nga BE.

Do të zbatojmë rekomandimet e auditorëve të BE-së në lidhje me akreditimin e strukturave për menaxhimin e fondeve të BE-së.

Do të bashkërendojmë përgjegjësitë ndërmjet autoriteteve shtetërore në lidhje me projektet e infrastrukturës të financuara nga BE dhe do të ndërmarrim masat paraprake për të mundësuar menaxhimin e fondeve bujqësore IPARD.

Angazhimi ynë kryesor është marrja e statusit të vendit kandidat dhe fillimi i bisedimeve për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

Do t'i japim një shtysë të re bashkëpunimit rajonal përmes gërshetimit të “Evropës Juglindore 2020” me projektet e agjendës “Evropa 2020”, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejt në përmbushjen e kritereve ekonomike të anëtarësimin në BE.

Ne do të mbështesim aktivisht shqiptarët që jetojnë dhe studiojnë jashtë vendit, duke i dhënë prioritet vendeve ku ka më shumë prezencë shqiptarësh. Do të ndërtojmë një politikë shumëkahëshe, e cila përfshin rrezatimin e gjuhës dhe kulturës shqiptare, njohjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, ofrimin e incentivave për ata që dëshirojnë të investojnë në ekonominë shqiptare, reformimin e shërbimit konsullor, duke krijuar shërbime të posaçme, sipas praktikave më të mira evropiane.

Reformat

Për pronat

Mekanizmat që garantojnë respektimin e pronës publike dhe private në Shqipëri janë sot të bllokuara. Menaxhimi i pronave publike është kaotik, nuk ka strategji që e udhëheq, bëhet pa transparencë dhe është shpesh pre e korrupsionit. Qeveria jonë do t'i verë këta mekanizma në lëvizje, duke zhbllokuar dhe bërë funksionale katër shtyllat, mbi të cilat do të mbështet ngrehina pronësore e shtetit:

- (i) kthim-kompensimi i pronave private;
- (ii) Agjencia e Legalizimeve;
- (iii) Zyra e Hipotekës (ZRPP);
- (iv) pronat publike në nivel të qeverisjes qendrore dhe vendore.

Qeveria jonë do të ndërmarrë një ristrukturim të gjerë të sistemit të menaxhimit të pronës në Shqipëri, për ta kthyer atë në një sistem modern, efikas dhe transparent në përputhje me praktikën më të mira të vendeve të tjera evropiane. Kjo reformë do të nisë me riorganizimin e të gjitha agjencive që merren me administrimin, regjistrimin dhe dokumentimin e pronave (si Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, ALUIZNI, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike).

Qeveria jonë do të rishikojë Strategjinë Ndërsektoriale në Fushën e të Drejtave të Pronësisë 2012 – 2020, për të përcaktuar hapat konkretë dhe prioritarë për t'i dhënë fund kaosit në administrimin e pronave publike dhe private dhe ngritjen në këmbë të një sistemi sa më të përshtatshëm për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë, si një prej të drejtave themelore të individit.

Qeveria do t'i kushtojë rëndësi të posaçme hartimit të një dokumenti strategjik për konsolidimin e tokës bujqësore; përfundimit të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore dhe ngritjes së infrastrukturës së përshtatshme për ndjekjen dhe trajtimin në vijimësi të këtij procesi.

Qeveria jonë do të zhdukë tri ‘zarfat’ e hallkave të korrupsionit: zarfi tek kthimi i pronave, zarfi tek legalizimet dhe zarfi tek regjistrimi i pronës. Për të arritur këtë qëllim, qeveria:

- (i) do të përfundojë regjistrimin fillestar në zonat kadasrale që kanë mbetur, duke bërë të mundur krijimin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- (ii) do të realizojmë regjistrimin e pronave në zonat turistike, bregdetare, akset e rrugëve kryesore;
- (iii) do të verë në zbatim një program të veçantë për regjistrimin e pronave në bregdetin e jugut të Shqipërisë;

- (iv) do të krijojë Regjistrin Kombëtar Elektronik të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, si një regjister efektiv dhe efikas që u shërben institucioneve publike, atyre private dhe individëve;
- (v) do të rishikojë legjislacionin në fuqi lidhur me legalizimin e ndërtimeve informale, me qëllim përcaktimin e rregullave të qarta dhe të drejta që do të shërbejnë për përfundimin e procesit të legalizimit dhe parandalimin e ndërtimeve të paligjshme në të ardhmen.

Qeveria do ta zgjidhë çështjen e pronarëve të vjetër duke:

- (i) i dhënë përparësi kompensimit në natyrë, në raport me kompensimin financiar, në mënyrë që të ulet fatura financiare për shtetin;
- (ii) e orientuar procesin e privatizimit të pasurive publike drejt kompensimit të ish-pronarëve;
- (iii) saktësuar fondin e kompensimit për ish-pronarët, i cili do të operojë në mënyrë transparente sipas një skeme të qartë dhe të barabartë për të gjithë të interesuarit; dhe
- (iv) eliminuar me ligj dhe në praktikë zvarritjet burokratike, si bazë për korrupsionin që lidhet me procesin e kthim-kompensimit të pronave.

Qeveria do t'i japë zgjidhje çështjes së pronave të institucioneve fetare.

Për drejtësinë

Në katër vitet e ardhshme, ne angazhohemi:

- (i) të ndërmarrim të gjitha nismat ligjore dhe masat në kompetencën tonë për të forcuar pavarësinë, paanshmërinë, profesionalizmin dhe efikasitetin e sistemit gjyqësor;
- (ii) të ndërmarrim reforma rrënjësore, afatgjata dhe gjithëpërfshirëse për të rivendosur integritetin e pushtetit gjyqësor dhe institucioneve të sistemit të drejtësisë;
- (iii) të krijojmë të gjitha kushtet e domosdoshme për funksionimin efikas të sistemit të drejtësisë shqiptare në përputhje me standardet e BE-së;
- (iv) të sigurojmë respektimin e standardeve më të larta ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, duke përfshirë aksesin e plotë dhe të barabartë në drejtësi për të gjithë;
- (v) të krijojmë një kuadër ligjor penal modern;
- (vi) të garantojmë bashkëpunimin e plotë dhe efektiv me institucionet ndërkombëtare të drejtësisë;
- (vii) të përmirësojmë procesin e hartimit të legjislacionit.

Qeveria do të ndërmarrë nisma strategjike dhe të mirëpërlllogaritura për të përmirësuar strukturën e sistemit të drejtësisë në Shqipëri, në pajtim me praktikat më të mira të vendeve anëtare të BE-së dhe në bashkëpunim të plotë me aktorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë në vend. Për këtë qëllim, qeveria do të iniciojë:

- (i) ndryshime në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë” dhe në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, me qëllim përcaktimin e rregullave dhe procedurave të qarta që duhet të ndjekin strukturat inspektuese përkatëse pranë këtyre dy institucioneve;
- (ii) ndryshime në ligjin për Gjykatën Kushtetuese;
- (iii) amendimin e Kodit të Procedurës Penale.

Qeveria do të ndërmarrë disa nisma të rëndësishme për ta bërë sa më funksional administrimin e drejtësisë në Shqipëri. Disa nga këto nisma janë:

- (i) hartimi dhe miratimi i ndryshimeve në të drejtën materiale e procedurale civile dhe administrative, me qëllim harmonizimin me ligjin “Për Gjykatën Administrative”;
- (ii) sigurimi i burimeve financiare të nevojshme për zgjerimin e shërbimit të provës;
- (iii) reforma e sistemit të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si garanci në rritjen e besimit të qytetarëve dhe ndërkombëtarëve tek sistemi i drejtësisë;
- (iv) përfundimi i instalimit të sistemit të audio-regjistrimit në të gjitha gjykatat.

Qeveria do të ndërmarrë nismat ligjore dhe rregullatore për të siguruar ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut apo në raste të tjera kur shteti shqiptar është palë përgjegjëse.

Qeveria do të hartojë dhe miratojë Strategjinë kundër Korrupsionit në Sistemin e Drejtësisë, duke përfshirë si subjekte të saj jo vetëm gjyqtarët, prokurorët dhe administratën e tyre, por edhe policinë, avokatët, noterët, si

dhe agjencitë e tjera të ngarkuara me zbatimin e vendimeve gjyqësore (përmbarimin, burgjet, hipotekat, etj.) si dhe të një plani veprimi me masa konkrete e transparente për publikun. Në zbatim të kësaj strategjie, qeveria do të krijojë një Grup të Posaçëm Pune për evidentimin dhe hetimin e sjelljeve dhe akteve korruptive në administratën dhe sistemin e drejtësisë, duke bërë ndryshimet përkatëse në Kodin e Procedurës Penale.

Për të garantuar akses të plotë në drejtësi për grupet në nevojë, qeveria do të rishikojë tarifat për trajtimin gjyqësor të pretendimeve të qytetarëve edhe nëpërmjet harmonizimit të ndryshimeve të kushteve të përcaktuara për ndihmën juridike falas.

Qeveria do të hartojë, miratojë dhe zbatojë në bashkëpunim me institucione të tjera publike dhe me shoqërinë civile një Strategji të Drejtësisë për të Miturit.

Qeveria do të miratojë ndryshime në ligjin “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të të paraburgosurve”, me qëllim përmirësimin e trajtimit të të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, konkretisht përcaktimin e rregullave të qarta për trajtimin e kërkesave dhe ankesave të të dënuarve, shërbimin mjekësor, masat disiplinore dhe procedurat e ndryshme për leje, në përputhje me kriteret dhe rekomandimet e Komitetit për parandalimin e dhunës e të torturës të Këshillit të Evropës.

Qeveria do të miratojë ndryshime në ligjin “Për Policinë e Burgjeve”, me qëllim përmirësimin e procedurave të punësimit, transferimit, trajnimit dhe rritjes së përgjegjshmërisë së punonjësve të policisë së burgjeve.

Qeveria do të angazhojë të gjitha burimet e duhura njerëzore, teknike dhe financiare për një bashkëpunim të plotë dhe efektiv me partnerët rajonalë e ndërkombëtarë në luftën kundër terrorizmit dhe krimin ndërkombëtar. Për këtë qëllim, qeveria do të themelojë Byronë Kombëtare të Hetimit, si një njësi e specializuar në luftën kundër krimin të organizuar, luftës kundër trafikëve, veçanërisht trafikut të qenieve njerëzore dhe lëndëve narkotike, krimin ekonomik dhe luftës kundër korrupsionit, për të garantuar një standard të lartë të evidentimit dhe hetimit të veprave penale. Ngrija e kësaj byroje do të jetë në zbatim të Strategjisë së re dhe Planit të Veprimit kundër Krimin të Organizuar, të cilën qeveria do ta hartojë gjatë vitit të parë të qeverisjes e do ta vërë në zbatim në vitet në vijim.

Për pushtetin vendor

Qeveria e re do të mbështesë fuqizimin e pushtetit vendor dhe procesin e decentralizimit në funksion të rritjes së efikasitetit të qeverisjes vendore përmes:

- (i) zbatimit të reformës administrativo-territoriale;
- (ii) përmirësimit të procesit të decentralizimit të financave publike;
- (iii) rritjes së cilësisë dhe modernizimit të shërbimeve publike në nivel të qeverisjes vendore, bazuar në standardet evropiane;
- (iv) rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore në raport me komunitetin; dhe
- (vi) rritjes së përfshirjes së qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendimmarrjen në nivel të qeverisjes vendore.

Prioritetet e qeverisë në këtë fushë janë si më poshtë vijon.

Reforma administrativo-territoriale. Prioriteti kryesor i qeverisë do të jetë rishikimi i ndarjes administrativo-territoriale, duke synuar konsolidimin territorial të njësisve vendore të nivelit të parë dhe nivelit të dytë.

Reforma e decentralizimit fiskal. Qeveria do të ndër marrë nisma të rëndësishme ligjore, duke përfshirë

- (i) hartimin e ligjit të ri integral për financat e qeverisjes vendore,
- (ii) të paketës së re të decentralizimit fiskal, i cili do të përfshijë zbatimin e konceptit të ndarjes së taksave kombëtare (tax sharing), si dhe përmirësimin e kriterëve
- (iii) të ndarjes së transfertës së përgjithshme nga buxheti i shtetit për qeveritë vendore. Ne do të rishikojmë mekanizmin financiar të transfertave të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, duke synuar financime të integruara sipas instrumentit të “Kontratave Rajonale të Zhvillimit”, duke rritur transparencën dhe efikasitetin në shpërndarje, si dhe në bashkërendim me objektivat kombëtare.

Rajonalizimi dhe reforma e qarqeve.

Qeveria do t'i japë prioritet zbatimit të një reforme të posaçme për nivelin e dytë të qeverisjes vendore që do të synojë krijimin e rajoneve dhe rikonfigurimin e qarqeve sipas modeleve evropiane të Rajoneve Vetëqeverisëse. Asnjë vendimarrje me impakt në qeverisjen vendore nuk do të merret pa u konsultuar më parë me përfaqësuesit e qeverisjes vendore. Kjo do të arrihet nëpërmjet krijimit të Këshillit Konsultativ Qeveri Qendrore - Qeverisje Vendore, përfshirjes së përfaqësuesve vendorë në instrumentat dhe mekanizmat vendimarrës të politikave sektoriale, që kanë pikëprerje me qeverisjen vendore, si dhe forcimit të bashkëpunimit institucional me shoqatat e të zgjedhurve vendorë dhe organizata të tjera të shoqërisë civile.

Sistemi i adresave. Qeveria angazhohet t'i japë fund një herë e mirë kaosit në administrimin e Regjistrimit të Gjendjes Civile dhe sistemit të adresave. Në bashkëpunim të ngushtë me qeverisjen vendore, do të angazhohemi në projekte konkrete për të sistemuar përfundimisht administrimin e Regjistrimit të Gjendjes Civile dhe Regjistrimit të Adresave, duke synuar përputhjen dhe administrimin e unifikuar të të dhënave të shtetasve.

Për antikorrupsionin

do të hartojmë Strategjinë dhe Planin Kombëtar të Veprimit kundër Korrupsionit brenda vitit të parë të qeverisjes dhe do ta zbatojnë me efektivitet atë në vitet në vijim;

do të ngrejme strukturën e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, që do të ketë mandat:

- (i) për të propozuar nisma ligjore dhe institucionale me qëllim çrrënjësues të korrupsionit nga radhët e administratës publike dhe të të gjithë segmenteve shtetërore që ofrojnë shërbim publik;
- (ii) për të koordinuar, monitoruar dhe raportuar mbi zbatimin e politikave qeveritare dhe shtetërore kundër korrupsionit. Po ashtu, në çdo ministri qeveria e re do të angazhojë një drejtues të lartë si përgjegjës për koordinimin e punës, për zbatimin e legjislacionit dhe të programeve qeveritare për eliminimin e korrupsionit.

Modeli ri ekonomik

Kryefjala mbetet "rritja e prodhimit të brendshëm dhe shtimi i eksporteve", shtimi i PBB nga prodhimi dhe jo nga konsumi siç ka qenë modeli dominues i deritashëm.

Qeveria e re do ta ndryshojë këtë tablo, duke ndryshuar strukturën e ekonomisë, nga një ekonomi e bazuar tek konsumi i mallrave të importuara, emigracioni e informaliteti në një ekonomi që bazohet tek puna dhe rritja e produktivitetit.

Do të fokusohemi maksimalisht drejt politikave prodhuese e sidomos politikave energjetike, industriale dhe agrare, të ndërtojmë politika specifike për mbështetjen dhe nxitjen e eksporteve;

Mbështetje për biznesin e vogël e të mesëm

- Do të thellojmë reformën rregullatore për reduktimin në maksimum të barrierave administrative dhe kostot e biznesit, për eliminimin e informalitetit dhe korrupsionit;
- Do të punojmë për thellimin e lirisë së tregut, garantimin e konkurrencës së ndershme dhe eliminimin e monopoleve;
- Do të hiqet taksa e biznesit të vogël dhe do të reduktohet barra fiskale e biznesit të vogël brenda vitit të ardhshëm;
- Do të rrisim efikasitetin e shërbimeve të administratës publike në favor të biznesit të vogël e të mesëm duke krijuar një partneritet të qëndrueshëm e të suksesshëm shtet-biznes;
- Do të përputhim plotësisht politikën tona të zhvillimit të biznesit të vogël e të mesëm me politikën evropiane për ndërmarrjet e vogla e të mesme me theks të veçantë në rritjen e konkurrueshmërisë dhe të punësimit;
- Do të nxitim dhe mbështetim kulturën moderne të sipërmarjes për biznesin, me theks të veçantë përmirësimin e menaxhimit, kualifikimin e punonjësve, standardet e cilësisë dhe konkurrueshmërinë, thithjen e investimeve, thellimin e inovacioneve dhe teknologjitë e reja, etj.

Sektori financiar

Reforma e ristrukturimit të sistemit financiar, duke krijuar një institucion mbikëqyrës për të gjithë sistemin financiar.

Mbështetje funksionimit të sistemit shumëkolonësh të pensioneve, duke nxitur sidomos për brezin e ri, pjesëmarrjen edhe në skemat private, suplementare e vullnetare të pensioneve. Zgjerim dhe thellim të tregut financiar me njësi e produkte të reja dhe aktivizim real të ekzistuesve, sidomos të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë etj. Zhvillime më cilësore do të synohen edhe në tregun e sigurimeve (e pergjithshme pa perbere pike programore)

Tregu dhe PPP

Me masa e politika konkrete, do të nxitim e mbështetim lirinë e tregjeve, eliminimin e monopoleve dhe informalitetin, si dhe çdo formë tjetër që cënon funksionimin normal të tregjeve.

Do rritim në maksimum efikasitetin e masave dhe strukturave të mbikëqyrjes së tregjeve.

Do të përmirësojmë rrënjësisht mënyrën e organizimit dhe funksionimit të enteve të ndryshme rregullatore në funksion të rregullimit dhe mbikëqyrjes së tregjeve.

Për të mundësuar një mbrojtje sa më të mirë të të drejtave të konsumatorëve do të ngrihet dhe do të funksionojë Inspektoriat i Mbikëqyrjes së Tregut.

Do të fuqizohet më tej Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe rifreskimi i tij për shmangien e situatave problematike të vërejtura vitet e fundit.

Do ta konsiderojmë PPP si një politikë specifike dhe efektive për tërheqjen e kapitalit privat në ekonomi.

Do të ndërmerren masa e politika specifike për një promovim sa më të plotë të PPP në Shqipëri.

Buxheti dhe treguesit makro

Në një periudhë relativisht të shpejtë, borxhi publik do të plotësohet dhe me pjesën “e fshehur” të tij: në bashkëpunim me institucione të njohura financiare do të bëjmë transparencë të plotë të gjithë detyrimeve të bartura dhe të pakontabilizuara në borxhin publik të deritanishëm.

- Ulje graduale e borxhit nëpërmjet kontrollit të deficitit fiskal dhe përshtatjes me rritjen ekonomike (vendosja e një rregulli fiskal transparent e të besueshëm).

- Në periudhën afatmesme synohet një borxh publik në parametra të përshtatshëm për nxitjen e ritmeve pozitive të rritjes, për strukturën ekonomike të vendit, si dhe për t'i lënë hapësira të mjaftueshme financimi sektorit privat.

- Fillimi i uljes së borxhit publik në pjesën e dytë të mandatit do të realizohet nga një qeverisje e përgjegjshme e kontrollit mbi deficitin buxhetor.

Politika dhe administrimi fiskal

Politika fiskale që prodhojnë më shumë qëndrueshmëri fiskale. Kjo politikë do të ketë në fokus rritjen e efikasitetit të shpenzimeve publike, prioritarizimin e shpenzimeve me efekte sa më të gjera dhe të shpejta, hapjen e perspektivave të reja për investime nga sektori privat, të prirura nga perfitime e rritje ekonomike, dhe punësimi.

Objektivat dhe mbështetësit e politikave afatmesme do t'i orientojmë:

- për përmirësimin e klimës së biznesit,
- për uljen e taksave dhe thjeshtimin e sistemit tatimor e fiskal
- për lehtësimin e presionit fiskal,
- për konsolidimin e biznesit dhe krijimin e një “kolone vertebrale” të qëndrueshme e të strukturuar të biznesit shqiptar e cila do të përbëjë dhe skeletin bazë të ekonomisë së qëndrueshme shqiptare, etj.
- për pagimin e borxheve publike ndaj bizneseve për shërbime apo kontrata të realizuara;
- për realizimin e pagesave të TVSH-së së rimbursueshme të papaguar;
- për nxitjen e investimeve të brendshme dhe të huaja në sektorin privat dhe zhvillimin e vendit.

Administrata tatimore do të bashkohet me atë doganore si dhe do të përthithë edhe administratën tatimore vendore, duke synuar rritjen e efikasitetit dhe një kontroll edhe më të arsyeshëm të tatimpaguesve.

Për tatimet indirekte politikat tona 4-vjeçare përmbledhin:

- Do të kemi një përgjysmim të TVSH-së për ushqimet më jetike të shportës, bazë të konsumit.
- Përrjashtimi/ ulja nga ky tatim për barnat dhe shërbimet shëndetësore.

- Realizimi i premtimit për heqjen reale të TVSH-së për importimin e makinerive dhe pajisjeve.
- Ulja/ kompensimi i TVSH-së për pjesën e domosdoshme të furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve familjarë të varfër.
- Për të nxitur prodhimin bujqësor do mundësohet përjashtimi ose vendosja e një norme të ulur, për plehurat kimike, farat e fidanët dhe për lëndët e tjera të para që përdoren në bujqësi dhe blegtori.
- Heqja e akcizës dhe taksës së qarkullimit të naftës për bujqësinë dhe peshkimin.
- Do të heqim tatimin mbi vlerën e shtuar në shërbimet dhe mallrat mjekësorë me efekt nga fillimi i vitit 2014.
- Do të rishikohet me kujdes projektligji i ri i TVSH-së për të pasur një heqje graduale të skemave speciale të shtuara gjatë viteve, të cilat nuk janë në linjë me Direktivën e TVSH-së së Bashkimit Evropian.

Për tatimet direkte politikat tona 4-vjeçare përmbledhin:

- Tatimi mbi fitimin e biznesit të vogël do të jetë rreth dy herë më i vogël se tatimi mbi fitimin e biznesit të madh, ndërsa do të hiqet taksat mbi biznesin e vogël.
- Tatimi mbi fitimin për biznesin e madh do të ketë një normë më të lartë se ajo aktuale, për të reflektuar parimin e taksimit të ndershëm dhe nevojën që kompanitë e mëdha të kontribuojnë më shumë se bizneset e vogla që funksionojnë nëpërmjet vetëpunësimit.
- Tatimi mbi të ardhurat personale të individëve do të ndryshohet në një skemë të normave progresive, duke rritur ngarkesën fiskale për pagat më të larta dhe duke e ulur për pjesën tjetër.
- Do të përdoret legjislacioni i ri në lidhje me transferimin e çmimit në përputhje me modelet e OECD-së.

Do të kthejmë seriozitetin dhe pavarësinë e Institutit të Statistikave, duke e vënë drejtimin e tij nën kontrollin e Kuvendit të Shqipërisë. Në një periudhë afatmesme, drejtimi i përditshëm i aktivitetit profesional të Institutit të Statistikave do të realizohet nëpërmjet binjakëzimit me një institucion të ngjashëm të një vendi të Bashkimit Evropian.

Punësimi

Angazhohemi të krijojmë 300 mijë vende të reja pune. 40 mijë vende të reja pune në industrinë prodhuese dhe 12 mijë vende pune shoqëruese të lidhura me to, 15 mijë në industrinë e lidhura me detin, 155 mijë në aktivitetet e lidhura me bujqësinë e blegtorinë, 62 mijë përmes reformimit të programit të ndihmës ekonomike, 11 mijë vende pune në industrinë e turizmit dhe 4 mijë vende të reja pune në teknologjinë e informacionit.

Do të ndërtojmë Agjencinë Kombëtare të Punësimit, si një njësi me buxhet dhe administrim autonom, e cila do të do mbledhë në një dhe do të rikonceptojë sipas praktikave më të mira modernizimin e zyrave të punës, sistemin e sigurimeve të punësimit, programin e nxitjes së punësimit dhe trajnimet profesionale.

Angazhohemi të përgjysojmë papunësinë e regjistruar femërore dhe të rritim aksesin e Personave me Aftësi të Kufizuar në punësim, përmes programeve dhe kurseve kualifikuese të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara.

Politikat sociale

Brenda mandatit të parë, strehim dhe punësim në kushte të përshtatshme për të gjithë jetimët që aktualisht janë të papunë e të pastrehë.

Brenda mandatit të parë, strehim dhe punësim në kushte përshtatshme të jetimëve që dalin periodikisht nga institucionet rezidenciale.

Do të realizojmë reformë në fushën e pensioneve, të përqendruar në konsolidimin e sistemit aktual të sigurimeve shoqërore. Reformë në fushën e pensioneve që kontribuon në zgjidhjen e problemit të papunësisë dhe informalitetit. Sigurim i raportit optimal midis përfitimeve maksimale e minimale, në nivele të qëndrueshme. Fillimi i negociatave dypalëshe me shtetet e tjera për të arritur në një marrëveshje për të siguruar mundësinë e transferimit të sigurimeve shoqërore për emigrantët shqiptarë që kthehen në atdhe.

Do të zgjidhim ngerçin ligjor të pensioneve të ushtarakëve në lirim. Do të përcaktojmë të drejtat e tyre në bazë të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese.

Do të miratojmë statutet e profesioneve të vështira për të harmonizuar kontributet specifike me të drejtat e përgjithshme sociale.

Do të hartojmë paketën rregullatore për transformimin e Programit të Ndhmës Ekonomike në një Program për e Riintegrimin Social.

Programi i Riintegrimin në zonat rurale do të zëvendësojë pagesat e Ndhmës Ekonomike me Programin “Punë në Vend të Asistencës.”

Përcaktim i masës së pagesës nga Programi i Riintegrimin Social për individë dhe jo për familje. Masa e pagesës nga Programi i Riintegrimin Social do të synojë kapërcimin e vijës së varfërisë.

Krijim i Fondit Kombëtar për Shërbimet Sociale dhe Fondeve Rajonale për Shërbimet Sociale si pjesë e Fondit Social.

Do të krijojmë një program elektronik për regjistrimin në lindje të të gjithë fëmijëve dhe sigurim i regjistrimit të të gjithë fëmijëve nga shtresa vulnerabël në Regjistrin e Gjendjes Civile.

Do të institucionalizojmë sistemin shtetëror për mbledhjen e të dhënave për komunitetin rom dhe egjiptian, si dhe do të sigurojmë regjistrimin e tyre në Regjistrin e Gjendjes Civile në mënyrë që të lehtësojmë procedurat për përfitimin e Ndhmës Ekonomikë për këtë shtresë.

Ne do të ngremë një institucion evropian të kujtesës historike që do të dokumentojë dhe bëjë të aksesueshme për publikun historinë e persekutimit nën regjimin komunist.

Skema jonë e re e kompensimit për të përndjekurit politikë do të zgjerojë grupin e përfituesve dhe do të zbatojë një shpërblim progresiv, në varësi të viteve të dënimit dhe moshës aktuale të ish të përndjekurve.

Të gjitha shërbimet publike për veteranët do të jenë falas.

Do të realizohet një zgjidhje definitive e strehimit për familjet që mbetën të pastreha nga akti normativ i nëntorit të 2012-s.

Edukimi, Sporti, Kultura

Politikat arsimore do t'i mundësojnë çdo të riu deri në moshën 26 vjeç diplomim në universitet, formim në një profesion, ose sistemimin në një vend pune.

Kujdes i veçantë do të tregohet në zbatimin e politikave sociale në ndihmë të nxënësve të dizavantazuar dhe atyre në nevojë.

Cdo nxënës që duhet të udhëtojë në këmbë mbi 20 minuta për të shkuar në shkollë, do të këtë transport falas të garantuar.

Cdo fëmijë që është i treti e më lart në radhën e shkollimit të fëmijëve të së njëjtës familje do të këtë librat falas gjatë gjithë ciklit të shkollimit të detyrueshëm.

Do të krijohet një sistem arsimit parashkollor i konsoliduar që ofron akses për të gjithë fëmijët deri në moshën 5 vjeç.

Nuk do të këtë asnjë shkollë me tri turne dhe asnjë klasë me më shumë se 30 nxënës.

Krijimi i “Kartës së Performancës së Shkollës” do t'u ofrojë prindërve informacion mbi standardet, cilësinë e mësimdhënies, shkallën e kënaqësisë së prindërve me punën e shkollës, dhe renditjen e saj në performancë.

Do të reformohet tërësisht kurrikula e arsimit parashkollor, në kontekstin e reformës kurrikulare të arsimit bazë.

Kthimi i shkollës, në një mjedis pa barriera për të rinjtë me aftësi fizike të kufizuara. Do të sigurohet zgjerimi dhe forcimi i shërbimit të këshillimit psikosocial në shkolla.

Pajisja e çdo shkolle publike të ciklit të parë dhe të dytë me punonjësit përkatës të shërbimit këshillimor.

Riorientim tërësor i arsimit profesional drejt nevojave reale të tregut dhe kthim i shtetit në financuesin e mbështetësin kryesor të aftësimin profesional.

Në bashkëpunim me sektorin privat në partneritete publike-private do të krijojmë shkollat e larta të arsimit profesional.

Deri në fund të mandatit të parë të qeverisjes do të rritet deri në 90% niveli i përfundimit të arsimit të mesëm.

Në maturën shtetërore, do të arrihet rritja e numrit të provimeve me detyrim dhe konsiderim i maturës shtetërore si provim dalës, çka do të shërbejë në rritjen e cilësisë së pranimeve në shkollat e larta.

Qeveria do të realizojë ngritjen e qendrave këshillimore për karrierën në shkollat e mesme dhe vendosjen e programit të “mentorëve” (kurse pa pagesë pas orarit të mësimin).

Qeveria do të sigurojë ngritjen e një organizmi të drejtë e të pavarur vlerësimi, akreditimi, dhe renditjeje të universiteteve publike dhe jopublike.

Do të ndryshohet skema e financimit të arsimit të lartë duke rritur financimet që shkojnë drejt sistemit dhe duke mundësuar cilësinë që ai ofron.

Sigurimi i autonomisë së universiteteve deri në njësitë bazë, shoqëruar me rritjen e kapaciteteve menaxhuese të njësisë.

Mbështetja e zhvillimit të shkencës do të përfshijë subvencionimin e institucioneve akademike e shkencore në funksion të punës kërkimore. Ne do të krijojmë mundësitë për një kombinim të burimeve publike dhe private në shërbim të financimit të kërkimit shkencor si dhe do të sigurojmë sinergjinë midis zhvillimit shkencor dhe programeve të zhvillimit kombëtar.

Qeveria do të mbështesë rritjen e kontributit shkencor të Akademisë së Shkencave sipas vizionit shkencor për zhvillimin e vendit.

Do t'i ofrohet mbështetje Akademisë së Shkencave për t'u bërë një forcë shtytëse e veprimtarisë kërkimore e shkencore në vend dhe përfaqësuese e denjë e komunitetit shkencor.

Ne synojmë rikonstruktimin institucional, legjislativ dhe infrastrukturor të sportit, duke praktikuar modelet më të mira evropiane dhe duke synuar partneritetin me komunitetin për decentralizimin dhe promovimin e tij.

Nxjerrja e menjëhershme e legjislacionit sportiv nga gjendja kaotike, përshtatja e tij me standardet dhe normat ndërkombëtare dhe vendosja e masave administrative që sigurojnë zbatimin rigoroz të tij. Në kuadër të rishikimit dhe hartimit të një legjislacioni funksional për sportin, qeveria do të ndër marrë hapat e mëposhtëm:

- Krijimi i “Këshillit të Lartë të Ekspertëve në Sport”;
- Krijimi i komisioneve sipas nevojave të sportit;
- Përcaktim i “Statusit të Sportistit të Nivelit të Lartë”;
- Qartësim i çështjeve të pronësisë së objekteve sportive;
- Sigurimi i fondeve themelore dhe dytësore për sportin
- Përcaktimi i kompetencave midis pushteteve dhe lëvizjeve sportive (federatave, shoqatave, klubeve, etj.)

Krijimi i Statusit të Sportistit Elitar, bazuar në kriteret e arritjes dhe rezultateve të larta, do të sigurojë të tashmen dhe të ardhmen e sportistëve duke krijuar lehtësime në shkollim, punësim, stimulim financiar, sigurim shëndetësor, dhe pensione të veçanta, me qëllim konvertimin e sportit në punë.

Do të synohet rritja e fondeve për sportin, si dhe nxitja dhe sigurimi i kushteve për kryerjen dhe zhvillimin e aktiviteteve sportive në nivel lokal. Në këtë kuadër, do të stimulohen politika fiskale në favor të sportit.

Do të hartojë dhe zbatojë një Program Kombëtar Anti-Doping sipas standardeve dërkombëtare dhe Kartës Evropiane të Sportit.

Krijimi i “Federatës së Sportit Universitar” dhe “Federatës së Sportit Shkollor”, do të shërbejë për të koordinuar dhe gjallëruar jetën sportive në të gjitha shkollat e vendit, me aktivitete sportive kurrikulare dhe jashtëkurrikulare. Gjithashtu, do të arrihet përfshirja në kurrikula e standardit shtetëror të vlerësimit të aftësive bazike motore të fëmijëve nga 3 deri në 6 vjeç.

Në Bibliotekën Kombëtare do të përfundojë dixhitalizimi dhe do të rritet roli i saj në trajnimin e bibliotekave të tjera, në qasjen proaktive ndaj lexuesit dhe në nxitjen e kulturës së leximit.

Do të përpunohet një strategji për të promovuar letrat shqipe në hapësirën evropiane, duke u përfaqësuar në panairët më të mëdha ndërkombëtare dhe duke lidhur marrëveshje me rrjetet kulturore që bëjnë të mundur qarkullimin e këtyre vlerave në hapësirën evropiane. Politikatat e mësipërme do të realizohen nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Letrave që do të jetë një ndër objektivat e programit kulturor.

Do të krijojmë e zbatojmë Programin Kombëtar për Nxitjen e Spermarrjes Rinore dhe e Korpusit Kombëtar të të Rinjve, si edhe themelimi i Programit të Formimit Profesional në Punë («çirakëria»).

Do të krijohet një fond i veçantë për rjetësimin e organizatave rinore, ngritjen e Qendrave Rinore, ku të rinjtë e talentuar do të ndihmohen e fuqizohen për zhvillimin e potencialit të tyre krijues.

Do të krijohen “Inkubatorët e Biznesit Rinor” që u mundësojnë të rinjve sipërmarrës hapësira për zyra, kryerjen e aktiviteteve dhe lehtësira administrative.

Do të nxitet sistemi i kredive dhe mikrokredive, si dhe do të krijohen lehtësira fiskale për sipërmarrjet e të rinjve.

Shëndetësia

Do të arrijmë tek financimi i kujdesit shëndetësor me taksimin e përgjithshëm, duke eliminuar fillimisht regresivitetin në pagesën e kontributeve të sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor.

Do të ndërtojmë Shërbimin Kombëtar Shëndetësor që do të jetë paguesi i vetëm i shërbimit të kujdesit shëndetësor.

Spitalet do të administrohen në mënyrë efikase dhe do të financohen në bazë të paketave të shërbimit që paguesi i vetëm do të kontrakttojë për kujdesin e nevojshëm spitalor të çdo individ.

Synojmë që të kalojmë nga pagesa e shërbimeve sipas kostove në zbatimin e “Algoritmeve Klinike” (Clinical Pathways) dhe më pas në vendosjen e DRG-ve (Diagnosis – Related Group).

Të gjithë spitalet publike dhe jopublike do t’i nënshtrohen procesit të akreditimit fillestar dhe rivlerësimit periodik.

Ne do të ulim çmimin e shitjes së barnave në Shqipëri.

Ne do të rrisim cilësinë dhe sigurinë e barnave, duke shtuar kujdesin për indikacionet, në përputhje me standardet evropiane dhe njëkohësisht, do të rrisim kontrollin e cilësisë gjatë të gjithë zinxhirit të shpërndarjes të barnave.

Urdhërat e profesionistëve të shëndetësisë do të reformohen duke u qeverisur me standarde të njëjta,

Do të ngrejmë një sistem të plotë të gjurmimit (track and trace) të barnave në territorin e vendit, duke siguruar që barnat dhe materialet mjekësore të nevojshme të arrijnë tek pacienti i duhur, në kohën e duhur, në dozën e duhur dhe nëpërmjet një kanali shpërndarjeje të autorizuar. Qendra e Kontrollit të Barnave do të shëndrrohet në Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Materialeve Mjekësore.

Do të zbatojmë periodikisht mbajtjen e Llogarive Kombëtare të Shëndetësisë.

Do të zhvillojmë programe kombëtare të parandalimit dhe zbulimit të hershëm të sëmundjeve tumoriale dhe sëmundjeve kardiovaskulare. Brenda vitit 2014 do të fillojë zbatimi i një programi kombëtar për kontrollin bazë të shëndetit për popullsinë në intervalin moshor 40-60 vjeç si dhe në mosha më të reja për disa shtresa të veçanta të shoqërisë.

Do të ngrejmë një Shërbim Kombëtar të Urgjencës Mjekësore që të sigurojmë prezencë të shpejtë e profesionale në të gjithë territorin e vendit, duke vendosur standarde të njëjta në të gjitha qendrat pritëse duke iu përgjigjur nevojave të ndryshueshme gjatë stinëve të vitit për kujdes në sëmundshmëri dhe trauma.

Energjia

Qeveria do të synojë hartimin e një strategjie afatgjatë dhe efikase për sistemin elektro-energjetik të Shqipërisë, me qëllim krijimin e një Sistemi Elektroenergjetik të qëndrueshëm operacionalisht, teknikisht dhe financiarisht, të aftë për të plotësuar kërkesën në rritje për energji elektrike brenda vendit duke e shndërruar Shqipërinë nga vend importues i energjisë elektrike, në vend eksportues të saj.

Rritja e efikasitetit në përdorimin e energjisë elektrike në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, shërbime dhe përdorim individual e ulja e humbjeve teknike dhe joteknike në shpërndarjen e energjisë elektrike.

Qeveria synon integrimin e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar (SESH) me Sistemet Rajonale dhe Evropiane të energjisë elektrike, si dhe rritjen e bashkëpunimit midis dy sistemeve elektroenergjetike Shqipëri-Kosovë, duke mundësuar shfrytëzimin me efikasitet të lartë të burimeve energjetike të të dy vendeve.

Do të kryhet një reforme legjislative - strukturore në SESH dhe në tregun e energjisë elektrike, duke plotësuar kushtet për liberalizimin e shitjes së energjisë elektrike në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Do të rritet pavarësia e Institucionit Rregullator, duke garantuar ushtrimin e kompetencave të këtij institucioni në mënyrë të paanshme dhe transparente, për të qënë gardian i interesave publike, konkurrencës së lirë e të ndershme dhe transparencës.

Qeveria do të synojë hartimin e një strategjie afatgjatë dhe efikase për sektorin e hidrokarbureve në Shqipëri, vënien nën një monitorim të plotë të veprimtarisë në sektorin e hidrokarbureve për të patur një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit, duke garantuar interesat publike në këtë sektor, forcimin e kapaciteteve shkencore dhe teknike në funksion të zhvillimit të sektorit hidrokarbur sot e në perspektivë.

Tregu i karburanteve dhe gazit të lëngët do të zhvillohet me standarde teknike cilësore, në nivelin e vendeve evropiane, duke prishur monopolet e krijuara në këtë treg.

Do të nxitim përpunimin e naftës bruto brenda vendit.

Do propozojmë ndryshime ligjore dhe institucionale të domosdoshme, si dhe një paketë masash nxitëse e stimuluese për përdorimin efikas të gazit në ekonomi, shërbime dhe përdorim individual në Shqipëri, në dekadën e ardhshme.

Do të sigurohet mbështetje për zbatimin e politikave efektive për të mbështetur ndërtimin e Gazsjellsit TAP, duke realizuar përfitimet maksimale prej këtij projekti, përfshirë dhe mundësinë e shtritjes në tregun e brendshëm.

Ne drejtim të minierave:

- Zhvillimin dhe modernizimin e mëtejshëm të sektorit të gjeologjisë dhe minierave duke e shndërruar këtë sektor në një industri me kushte e standarde bashkëkohore.
- Hartimin e politikave specifike që nxisin, orientojnë dhe garantojnë investime e financime masive të brendshme e të huaja në industrinë minerare.
- Ndërmarrjen e masave ligjore dhe strukturore për të mundësuar rritjen e shkallës së pasurimit dhe përpunimit të mineraleve në vend.
- Rritjen e eksporteve minerare si një element i rëndësishëm i rritjes ekonomike, punësimit dhe nivelit të jetesës në zonat minerare.
- Monitorimin e veprimtarisë minerare me synim garantimin e interesit publik në këtë sektor.
- Do të kryejmë ndërprerjen e menjëhershme të veprimtarive minerare të rrezikshme dhe të jashtëligjshme e ndërprerjen e veprimtarive minerare që nuk kanë respektuar detyrimet kontraktuale, që kanë dëmtuar e dëmtojnë rëndë mjedisin, sidomos të atyre veprimtarive pranë zonave urbane.

Turizmi dhe mjedisi

Krijimi i një modeli turizmi vjetor të integruar, aktiv dhe social, me fokus në dimensionin kulturor-natyror-ekologjik dhe si një kombinim midis turizmit familjar dhe elitar.

Hartimin dhe zbatimin e Strategjisë së Turizmit, në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit dhe me Planin Kombëtar të Territorit.

Realizimin në mënyrë të pandërprerë të një fushate informuese dhe promovuese për imazhin e Shqipërisë turistike. Rol të rëndësishëm do të kenë jo vetëm institucionet publike, por edhe operatorët e industrisë dhe të gjithë agjentët e zhvillimit në vend, përfshirë median, shoqërinë civile, por edhe sistemin e shërbimit diplomatik. Do të formalizojmë dhe standardizojmë tregun e hotelerisë.

Do të krijojmë bazën e integruar të informacionit për turizmin, përfshirë operatorët, strukturat dhe sitet turistike dhe do të ndërmarrim një reformë fiskale që synon reduktimin e TVSH-së për operatorët turistikë.

Do të krijojmë një paketë të veçantë turistike Shqipëri-Kosovë-Rajon, si bashkëpunim mes vendeve me popullsi shqiptare dhe fqinjëve në rajon, me qëllim kontributin në zhvillimin ekonomik të integruar.

Në përputhje me modelin e Turizmit, do të krijojmë tri programe kyç:

Programi për Turizmin Kulturor-Historik, që fokusohet në zonat e mbrojtura dhe monumentet e kulturës; promovon traditat shqiptare; adreson veçanërisht turizmin e bazuar në ekonominë familjare dhe biznesin e vogël, në bashkëpunim me operatorët e turizmit elitar.

Programi për Eko-Turizëm që ndërton mbi burimet natyrore, përdorimin ekologjik të tyre dhe pajisjen me infrastruktura dhe shërbime bazike, sigurinë e lartë dhe guida të përsosura profesionalisht.

Programi për Turizmin Malor dhe Bregdetar, i cili shoqërohet me projekte madhore të investimeve kapitale për infrastrukturë dhe shërbime, veçanërisht afër qendrave të banuara dhe përmes praktikave të partneritetit-publik-privat.

Përmes planifikimit rajonal, do të realizojmë dy programe të rëndësishme, Programin e 10 Poleve Turistike të Shqipërisë dhe Programin e fashës rajonale “Korridori i Kaltër”, nga veriu në jug.

Do të hartohet e miratohet strategjia kombëtare për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve pyjore. Kompanitë që marrin lejet për shfrytëzimin e pyjeve do të kenë edhe përgjegjësinë e mirëmbajtjes së tyre, duke mbjellë një fidan për çdo dru të prerë.

Do të kryhet riinventarizimi kombëtar i pyjeve, duke mundësuar krijimin e një kadastrë të re të pyjeve.

Do të hartohet një program kombëtar për pyllëzimet si dhe do të organizohet dita kombëtare e mbjelljeve në pyje.

Do të hartojë një program të ri investimesh me qëllim rehabilitimin e shpejtë të zonave pyjore me vlerë kombëtare si Lura, Qafshatama etj. (programet duhet të kenë saktësi dhe pa përgjithësim)

Do të përgatit plane për manaxhimin efektiv të baseneve kryesore ujore, në mënyrë të veçantë për Drinin, e Bunën dhe Semanin do të perfundojmë Kadastrën e Ujit. Një përkujdesje e veçantë do t'i kushtohet lumenjve, liqeneve dhe burimeve të tjera ujore, veçanërisht atyre që janë tepër të dëmtuar nga aktiviteti jashtëligjor ose ndotja mikrobiologjike dhe kimike.

Qeveria do të synojë uljen me 30% të nivelit të ndotjes në zonat urbane nëpërmjet:

- Shtimit të sipërfaqeve të gjelbra në zonat urbane;
- Kontrollit të emetimit të pluhurit në zonat urbane, duke aplikuar teknologji të reja monitorimi;
- Përdorimit të karburanteve konform kritereve të BE;
- Zbatimit të standardeve të repta në aktivitetet ekonomike që ndotin ajrin.

Pronësia dhe zhvillimi urban

Hartimi dhe miratimi i Planit të Përgjithshëm Kombëtar si përkthim i strategjisë kombëtare të zhvillimit në territor dhe bazë për zhvillimin e qëndrueshëm, investimet dhe kontrollin e territorit. Miratimi i planit, do të paraprihet nga miratimi i Zonave të Rëndësishme Kombëtare, mbi bazën e së cilave do të vendosen 3 Moratoriume të rëndësishme për ndalimin e aktivitetit ndërtimor në Bregdet, në burime pyjore dhe sipërfaqe ujore e në të gjitha zonat me rëndësi për Turizmin.

Do të vlerësohet informaliteti në territor, do të krijohet baza e integruar e të dhënave për territorin dhe do të ndërmerret procesi i legalizimit dhe integritetit të vendbanimeve informale, për t'i dhënë fund veprimeve të paligjshme.

Do të shpallet Momenti ZERO, pas të cilit çdo ndërtim është subjekt prishjeje të menjëhershme.

Qeveria do të realizojë pa pagesë legalizimin e banesave pa leje në zonat informale.

Do të hartojmë dhe zbatojmë Programin për Bregdetin e Jonit që konsiston në pastrimin e territorit nga informaliteti dhe keqpërdorimi e do të paraqesë modelet e para të rigjenerimit të qëndrueshëm të hapësirave urbane dhe natyrore me potencial turistik.

Do të rritim standardet e zhvillimit të tokës në bregdet dhe do të evidentojmë rrjetin ekologjik.

Do të ndërmarrim një program të thellë reformues për Rigjenerimin Urban dhe Zhvillimin cilësor të Tokës përmes projektsh-pilot për qendrat urbane, por edhe përmes mbështetjes së projekteve dhe agjendave të zhvillimit të lagjeve, mbi baza konkurruese.

Do të mbështetim pushtetin vendor, që të marrë rolin udhëheqës në zhvillimin e tokës, duke mbrojtur zonat natyrore, historike dhe bujqësore, për të garantuar partneritet publik e privat në financimin e infrastrukturave dhe shërbimeve e duke administruar shpërndarjen e së drejtës së zhvillimit.

Do të percaktohen tiparet arkitekturore dhe urbanistike tradicionale të zonave dhe fshatrave e qendrave të banuara, veçanërisht në zonat turistike.

Bujqësia

Inputet bujqësore dhe punimi i tokës, zënë një peshë kryesore në koston e përgjithshme dhe për këtë arsye :

- Do të reduktohet tatimi mbi vlerën e shtuar për farërat, fidanet, materialin gjenetik shtazor, plehërat kimike, pesticidet, vaksinat e blegtorisë etj.
- Do të krijohet dhe vihet në funksion qendra e kontrollit të cilësisë dhe sigurisë së inputeve bujqësore.
- Do të zbatohet programi i furnizimit të naftës pa akcizë për bujqësinë dhe aktivitetet rurale të ngjashme.
- Do të nxitet shpërndarja me çmime të favorshme e farërave të zgjedhura dhe të rendimenteve të larta.
- Do të nxitet dhe mbështetet, blerja në grup e pajisjeve të mekanikës bujqësore, traktorëve dhe moto-kultivatorëve.
- Rritja e eksporteve të prodhimeve bujqësore, përbën një tjetër përparësi. Ulja e koston së lëndëve të para është thelbësore, prandaj do të përjashtohen nga barra fiskale lëndët e para, ato të ndërmjetme dhe të ambalazheve për prodhimet e eksportit.

Është e rëndësishme të rimëkëmbet sistemi kullues dhe vaditës i vendit. Për këtë arsye:

- Do të zgjerohet parku i mjeteve të nevojshme publike dhe private, të duhura për mirëmbajtjen e sistemit kullues dhe vaditës të vendit.
- Do të miratohen tarifatat e reja të furnizimit me energji elektrike për sistemin e kullimit dhe të vaditjes.

- Do t'u jepet një rol më i madh komunave në mirëadministrimin e burimeve ujore dhe rrjetit ujitës dhe kullues.

Synojmë të investojmë 160 mln USD për rimëkëmbjen e sistemit të kullimit dhe vaditjes.

- Do të 5-fishojmë financimin publik për mbështetjen e zhvillimit rural,
- Do të mbështeten me përparësi ngritja e qendrave të grumbullimit, ruajtjes dhe tregtise me shumicë të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale.
- Të vënë në funksion të plotë sistemin e identifikimit dhe të regjistrimit të blegtorisë;
- Të modernizuar sistemin e identifikimit, sinjalizimit të sëmundjeve infektive dhe parazitare në bimë dhe kafshë;
- Të zgjeruar mbulesën vaksinale në blegtori për të parandaluar dëmtimet në kafshë dhe shpendë dhe pasojat mbi shëndetin publik;
- Të mbikëqyrur tregjet e kafshëve si dhe kontrolluar procesin e përpunimit dhe shpërndarjes të tyre për mish në tregjet e vendit;
- Të promovuar të gjitha ndërmarrjet e agropërpunimit, të cilat zbatojnë sisteme të përparuara të kontrollit të sigurisë dhe cilësisë ushqimore si dhe për të caktuar afate mbi ndërmarrjet që ende nuk i përfshijnë këto standarde në teknologjinë e prodhimit.
- Të përfunduar akreditimin ndërkombëtar të qendrave kombëtare të referencës në fushën e sigurisë ushqimore.
- Do të përfundojë harta e rajonalizimit të kulturave të ndryshme bujqësore dhe e racave të ndryshme që do të mbështeten me financime publike;
- Do të përcaktohen nevojat për specialitete të reja dhe do të plotësohen nevojat me specialistë të bujqësisë, si dhe do të hartohet një program 4-vjeçar i edukimit dhe i formimit profesional në fushën e bujqësisë;

Infrastruktura dhe transporti

Do të realizohen me prioritet projektet për Ujësjellës-Kanalizime në zonën e Durrësit dhe atë turistike të bregdetit të jugut.

Do të krijojmë e zbatojmë standarde të reja në administrimin dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane, duke përdorur mekanizma ekonomikë për të stimuluar grumbullimin e diferencuar të mbetjeve në burim, duke vendosur një partneritet sërish të ngushtë privat-publik. Do të bashkëpunojmë ngushtë me pushtetin vendor, duke e mbështetur në këtë proces.

Do të ndalojmë importin e mbetjeve.

Do të eliminojmë venddepozitimet e mbetjeve që janë buzë lumenjve dhe do të përcaktojmë vende të tjera të përshtatshme për depozitim.

Do të pastrohen në mënyrë prioritare akset kryesore rrugore nga mbetjet dhe ndotës të tjerë.

Do të ndalojmë në mënyrë urgjente zjarret në vendgrumbullimet e plehrave pranë qyteteve.

Do të përfundojë hartimi i të gjitha planeve rajonale për menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve dhe do të monitorohet zbatimi i tyre

Do të nxitim riciklimin e mbetjeve dhe me synim pakësimin e landfillleve e për të mundësuar incinerimin e tyre me qëllim prodhimin e energjisë elektrike.

Objektiv kryesor në fushën e transportit është përshpejtimi i integritetit të sistemit të transportit, ngritja e një tregu të integruar, të përbërë për infrastrukture dhe transport me tokë, me det dhe me rrugë ujore të brendshme që të mbështetë në mënyrë efikase kërkesën zhvillimore për transport. Masë me e rëndësishme themelore është miratimi i Planit Kombëtar të Transportit.

Rritja e sigurisë rrugore përbën gjithashtu një prioritet madhor. Kjo do të realizohet në tri ndërhyrje kryesore: në drejtim të përfundimit të veprave të papërfunduara sipas standardeve si dhe eliminimit të pikave të zeza të aksidenteve; forcimit të rregullave të qarkullimit rrugor dhe zbatimit të tyre pa kompromis; si dhe një fushate ndërgjegjësuere e edukative që fillon në bankat e shkollës. Numri i aksidenteve rrugore synohet të ulet në masën 20%, vetëm gjatë vitit të parë të këtij mandati qeverisës.

Me rëndësi në sektorin e transportit është përcaktimi i strategjisë kombëtare për hekurudhat shqiptare. Në synojmë modernizimin e rrjetit hekurudhor, duke rritur cilësinë e tij, veçanërisht në drejtim të intermodalitetit, duke realizuar lidhjen me Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, si dhe duke synuar integrimin me korridoret evropiane hekurudhore.

Hartimi i Planit Kombëtar për Zhvillimin e Porteve dhe realizimi i projekteve për rritjen e kapaciteteve të tyre, është gjithashtu një drejtim i rëndësishëm në këtë sektor. Plani Kombëtar për Zhvillimin e Porteve synon rritjen e aftësive përpunuese të tyre, rritjen e punësimit në transportin detar dhe projektimin e një sistemi modern të transportit detar. Një vëmendje të veçantë do të marrë zgjerimi i Portit të Shëngjinit, si dhe ndërtimi i porteve turistike.

Në transportin ajror, do të realizojmë hapjen e tregut dhe uljen e kostos së tarifave të udhëtimit për pasagjerët. Investimet e bazuara në partneritetin publik-privat do të realizohen edhe në transportin ajror për qëllime të brendshme e turistike.

Dixhitalizimi




Qeveria do të punojë në 3 drejtime kryesore duke vendosur objektiva të matshme:

Së pari, për shtimin dhe promovimin e shërbimeve dixhitale, e-shërbimeve, për qytetarët dhe biznesin. Prioritet do të jetë rritja e transparencës dhe përmirësimi i shërbimeve në administratën publike sipas parimeve të iniciativës Open Government Partnership.









Së dyti, në futjen masive të shërbimeve në arsimit për të kapërcyer hendekun dixhital dhe për të aftësuar rininë. Politikat do të jenë të orientuara drejt përmirësimit dhe zgjerimit të kapaciteteve njerëzore në mënyrë që të rritet si numri i përdoruesve ashtu edhe numri i ofruesve vendas të e-shërbimeve.

Së treti, konsolidimi i infrastrukturës dixhitale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke respektuar me rigorozitet parimet evropiane të konkurrencës së lirë e të ndershme.

QEVERISJA E PS DHE LSI – PREMTIMET NË PROGRAMIN QEVERISËS 2013-2017

Përbushur		Në progres		Pa përbushur	
-----------	-----------------------------------------------------------------------------------	------------	-----------------------------------------------------------------------------------	--------------	-------------------------------------------------------------------------------------

PËRFSHIRJA DHE PËRMBUSHJA E PREMTIMEVE TË PS NË PROGRAMIN QEVERISËS

N r.	FISKALE DHE BUXHETORE	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/ BURIMI
1	Krijim i 300 mijë vendeve të reja të punës		PO	PBA 2013-2017 INSTAT 2013-2017
2	Taksim i ndershëm progresiv që ul taksat për 95% të shqiptarëve		PO	L.T.A. ²³² MEDIA ²³³
3	Taksë progresive për të ardhurat personale		PO	L.T.A.
4	Tatim mbi fitimin me dy nivele: një nivel për biznesin e madh dhe tjetri më ulët se ekzistuesi për biznesin e vogël		PO	L.T.A.
5	Heqje e taksës së biznesit të vogël		PO	L.T.A.
6	Tatimi mbi të ardhurat 10%		JO	
7	Tatim fitimi për biznesin e madh do ketë vetëm një nivel.		PO	L.T.A.
8	Shmangie e taksës së korrupsionit dhe taksën e kohës		PO	C.P.I. 2014-2017 ²³⁴
9	Heqje e referencave aktuale në dogana e tatime		JO	A.I.C. 2017 ²³⁵
10	Rimbursim korrekt i TVSH-së duke rimodeluar hallkat administrative		JO	MONITOR ²³⁶ A.I.C. ²³⁷

²³²<http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20191125111737Ligji%20per%20tatimin%20mbi%20te%20ardhurat.pdf>

²³³ <https://www.youtube.com/watch?v=QhCFOxSIVqI>




²³⁴ <https://www.transparency.org/en/cpi/2017/index/nzl> <https://www.transparency.org/en/cpi/2017/index/nzl>






²³⁵ https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2015/08/AL_TN-Mbi-Lehtesimin-e-Procedurave-Doganore.pdf

²³⁶ <https://www.monitor.al/rimbursimi-tvsh-se-ende-larg-premtimit/>

²³⁷ https://www.investment.com.al/wp-content/uploads/2019/05/AL_-Survey-Findings.pdf

11	Thjeshtim i procedurave tatimore, fuqizim i shërbimit të asistencës ndaj tatimpaguesve		PO	DOING BUSINESS ²³⁸
12	Deficit dhe borxh publik nën kontroll përmes politikave të përgjegjshme fiskale		PO	PBA 2014-2018
13	Hapa serioz për shlyerjen e pjesës më të shtrenjtë të borxhit ekzistues		PO	TREGUESIT' BORXHIT ²³⁹

N r.	RENDI PUBLIK	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Rikthim i policisë së shtetit në krye të detyrës brenda 300 ditëve		PO	RAPORT P.P ²⁴⁰
2	Rritja e pagave		PO	M.B. ²⁴¹ BUXHETI 14-17 ²⁴²
3	Strehim për familjet e policëve të vrarë, punësim për gratë e policëve të vrarë, përkujdesje për arsimin e jetimëve		PO	

N r.	SHENDETESI	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Ngritje e Shërbimit Shëndetësor Kombëtar që do ofrojë kujdesin shëndetësor pa pagesë për qytetarët		PO	M.SH FSDKSH ²⁴³
2	Financim i sistemit shëndetësor përmes taksimit të përgjithshëm të popullsisë		PO	PBA 2014-2018
3	TVSH-së në shkallën 10% për barnat dhe shërbimet shëndetësore ²⁴⁴		PO	L.T.V.SH.2014
4	Brenda vitit të parë kontrolli bazë i përvitshëm për çdo shqiptar mbi 40 vjeç		PO	M.SH. ²⁴⁵
5	Barna jo më të shtrenjta se në vendin e prodhimit		PO	MONITOR ²⁴⁶

²³⁸ <https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/25433>

²³⁹ <https://financa.gov.al/treguesit-e-borxhit/>

²⁴⁰ http://www.pp.gov.al/web/fiinal_final_raporti_pp_06_03_2015_1093.pdf

²⁴¹ <https://mb.gov.al/2017/03/09/rritja-me-e-madhe-e-pagave-policise-se-shtetit-per-dinjitet-ne-permbushje-te-detyres/>









²⁴² <https://www.financa.gov.al/buxheti-ne-vite/>

²⁴³ https://www.fsdksh.com.al/images/2018/Analiza_Vjetrore_2017_23.07.2018/Raporti_Vjetor_2017_1.pdf

²⁴⁴ Heqje e taksës së sëmudjes

²⁴⁵ <https://shqiptarja.com/lajm/beqaj-nisi-kontrolli-mjekesor-falas-br-nga-40-65-vjec-me-apo-pa-sigurime>

²⁴⁶ <https://www.monitor.al/milionat-e-biznesit-te-ilaceve/>

N r.	MBËSHËTETJA SOCIALE	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Fonde buxhetore në mbështetje të pastrehëve ose kush rrezikon të humbasi shtëpinë		PO	PBA 2014-2017
2	Strehim dhe punësim për gjithë jetimet e papunë e pastrehë		PO	UNDP ²⁴⁷
3	Screening falas për gjithë gratë në moshë produktive		PO	RAPORT M.SH.
4	Lehtësim i barrës fiskale me reduktim të pjesshëm të taksave për familjet me shumë fëmijë		JO	
5	Përfitim nga leja e lindjes për çdo nënë pavarësisht kontributit në sigurime		PO	L.S.SH. ²⁴⁸
6	Paga minimale do të garantohet mbi minimumin jetik të indeksuar me shtrenjtimin e shportës së ushqimeve		JO	
7	Kontroll dhe ulje e informalitetit në tregun e punës		PO	PUNËSIMI INFORMAL ²⁴⁹ INSPEKTIVE ²⁵⁰
8	Shërbime falas në shtëpi për të moshuarit mbi 75 vjeç		JO	
9	Mbështetje me pagesa në nivelin e pagës minimale për kujdestarët e personave me aftësi të kufizuar		JO	
10	Zbatim real i kuotës së përfaqësimit 30% të grave dhe vajzave në institucionet e zgjedhura dhe të emëruara		PO	UNDP ²⁵¹ UN ²⁵²
11	Të gjitha shërbimet publike për veteranët do të jenë falas dhe do të përballohen nga shteti		PO	PL.KOMB.MOS HIMIT 20-24 ²⁵³
12	Reformë në fushën e pensioneve që zgjidh papunësinë dhe informalitetin		PO	WORLD BANK ²⁵⁴

²⁴⁷<http://www.undp.org/content/dam/albania/docs/misc/Vleresimi%20i%20Nevojave%20per%20Strehim%20Social%20ne%20Shqiperi%20for%20web.pdf>

²⁴⁸ http://www.iss.gov.al/?page_id=61

²⁴⁹ https://idmalbania.org/wp-content/uploads/2017/01/Dokument-politikash_Ekonomia-e-Fshehur-dhe-Puna-e-Padeklaruar-n%C3%AB-Maqedoni-Shqip%C3%ABri-dhe-Kosov%C3%AB.pdf

²⁵⁰ <https://www.monitor.al/informaliteti-gri-si-shkelen-te-drejtat-e-punonjesve-shqiptare/>

²⁵¹ <https://www.undp.org/content/dam/albania/docs/Forcimi%20i%20Pushitetit%20Vendimmarres%20te%20Grave%20Keshilltare%20ne%20Shqiperi.docx>

²⁵² https://un.org.al/sites/default/files/1.%20Gender%20ne%20Partite%20Politike%202017%20-%20Shqip_1.pdf

²⁵³ <http://qbz.gov.al/eli/vendim/2019/12/24/864>

²⁵⁴ <https://www.worldbank.org/sq/results/2015/10/20/albania-pension-reform>

13	Raport optimal midis përfitime maksimale e minimale në nivele 3:1		PO	MONITOR ²⁵⁵
14	Ndryshim i mënyrës së llogaritjes së pensioneve duke e llogaritur 1.3%-1.5% të pages mesatare për çdo vit pune		PO	MONITOR ²⁵⁶
15	Garantimi i raportit paga/pensione duke synuar koeficient mesatar zëvendësimi jo më pak se 56%-60%		JO	
16	Zgjidhje problemeve të pensionit të ushtarakëve në lirim, policisë dhe shërbimit informativ		PO	ISSH ²⁵⁷
17	Ushtarakët e liruar përfitojnë pensionin e parashikuar me ligjin nr.9418, 20.05.2005		PO	ISSH
18	Aplikim i pensionit social rezidencial për të moshuarit mbi 75 vjeç pa të ardhura		PO	ISSH
19	Zgjidhje e problemit të sigurimit të emigrantëve		PO	ISSH ²⁵⁸
20	Dëmshpërblim në vitin e parë të qeverisjes për gjithë ish të burgosurat gra mbi 70 vjeç dhe ish të burgosurit burra mbi 75 vjeç		JO	MFE ²⁵⁹
21	Dëmshpërblim brenda dy viteve në vijim i gjithë ish të burgosurve që janë në jetë		JO	MFE
22	Dëmshpërblim i trashëgimtarëve të të pushkatuarve dhe ish të burgosurve nga viti i tretë i qeverisjes		JO	MFE
N r.	ARSIMI	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Burim financiar jo më pak se 5% e PBB për arsimin		JO	
2	Asnjë shkollë me tri turme dhe asnjë klasë me mbi 30 nxënës		PO	BASHKIA TR ²⁶⁰ MASR ²⁶¹
3	Libra falas gjatë ciklit të shkollimit të detyrueshëm për fëmijën e tretë e lart		PO	KM ²⁶² VJETARI ²⁶³

²⁵⁵ <http://www.monitor.al/multimedia/Dokumenti%20i%20Politikave%20te%20Pensioneve.pdf>

²⁵⁶ <https://www.monitor.al/mosha-dhe-vitet-e-punes-ja-si-ndryshon-skema-e-pensioneve-per-2017>

²⁵⁷ https://www.iss.gov.al/?page_id_all=2&author=3

²⁵⁸ <https://www.iss.gov.al/?cat=248>





²⁵⁹ <https://financa.gov.al/informacion-per-kategorine-paresore/>







²⁶⁰ <http://prokurimettransparente.al/tenders//agreements/STUDIMI%20I%20FIZIBILITETIT%20SHQIP-1-150.pdf>

²⁶¹ <https://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2019/01/Vjetari-statistikor-2016-2017-varianti-per-botim.pdf>

²⁶² <https://kryeministria.al/newsroom/190-mije-nxenes-libra-falas-nga-klasa-e-pare-deri-ne-te-katerten/>

²⁶³ https://www.arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Vjetari_statisikor_faqosur_ok.pdf

4	Transport falas për çdo nxënës që duhet të udhëtojë në këmbë mbi 20 minuta		PO	P.V. ²⁶⁴ D.A.R. ²⁶⁵
5	Dyfishim i shkollave të arsimit profesional		PO	PBA 2014-2018 AKFP ²⁶⁶
6	PPP në krijimin e institucioneve të larta të arsimit profesional		JO	
7	Pajisje me tablet elektronik e çdo nxënësi që fillon rishtaz shkollën e mesme nga 2014-2015		PO	M.SHT. ²⁶⁷
8	Pajisje kompjuterike individuale për çdo nxënës të shkollës së mesme		JO	
9	Nxitje sistemit të kredive dhe mikrokredivë si dhe lehtësi fiskale për sipërmarrjet e të rinjve		PO	ADRIAPOL ²⁶⁸

N r.	BUJQËSIA	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Pesëfishim i financimit publik për mbështetjen e bujqësisë		JO	
2	Ulje e drejtpërdrejt e çmimeve të mekanikës dhe inputeve bujqësore		PO	MONITOR ²⁶⁹
3	Ulje rreth 35% e çmimit të naftës, me heqjen e akcizës, taksës së qarkullimit bashkë me TVSH që zbatohet mbi këto dy taksa		PO	KM ²⁷⁰ L.AKCIZES L.T.KOMBËTA MONITOR
4	Heqje e TVSH për plehurat kimike, farat e fidanet		PO	L.TV.SH.
5	Heqje e TVSH për vaksinat dhe ilaçet që përdoren për bujqësinë		PO	L.T.V.SH.
6	Përfundimi i reformës së tokës sipas ligjit 7501 brenda 2 viteve të para të qeverisjes		PO	A.SH.K. M.D. ²⁷¹
7	Regjistrim i pasurive në zonat rurale dhe zgjidhje e konflikteve për pronësinë brenda 2 viteve		PO	M.D.

²⁶⁴ <https://portavendore.al/2017/04/20/sherbim-pa-standarde-deshton-transporti-per-nxenesit-dhe-mesuesit-ne-elbasan/>

²⁶⁵ http://dartiraneqark.edu.al/images/Analiza_vjetore_2017.pdf

²⁶⁶ http://www.akafp.gov.al/wp-content/uploads/2015/05/RAPORTI-VJETOR-2017_AKAFPK_FINAL2.pdf

²⁶⁷ <https://maturashitetore.com/2019/09/22/me-pak-nxenes-ne-bankat-e-shkolles-pasojat-afatgjata-ne-ekonomi/>

²⁶⁸ <https://adriapol.al/wp-content/uploads/2020/09/Nj%C3%AB-analiz%C3%AB-e-startup-eve-q%C3%AB-operojn%C3%AB-ne-shqiperi.pdf>

²⁶⁹ <https://www.monitor.al/bujqesia-pa-orientim-2/>

²⁷⁰ <https://kryeministria.al/newsroom/karburanti-per-prodhimin-bujqesor-pa-akcize-pa-takse-qarkullimi-pa-takse-mjedisi/>

²⁷¹ http://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/Strategjia_Reforma_ne_fushe_e-te-drejtave_te_pronesise.pdf

8	Uji në parcel synim parësor në ndihmë të bujqësisë		PO	KM ²⁷²
9	Regjistrim i pronësisë dhe pajisje me certifikimin e pronësisë brenda 2 viteve të para		PO	M.D.
10	160 milion USD për të rimëkëmbur systemin e ujitjes dhe kullimit brenda 4 viteve		PO	PBA 2014-2018
11	Ndalim i eksportimit të lëndës drusore të papërnuar apo i qymyrit të drurit për 3 vjet		PO	MONITOR ²⁷³
12	Heqje e akcizes dhe e taksës së qarkullimit të naftës për peshkimin		PO	L.AKCIZES L.T.K
13	Heqje e tatim-fitimit, në katër vitet e para për industrinë reja agro-përpunuese		PO	L.T.A.
14	Krijim i një tregu të përbashkët bujqësor me Kosovën		PO	F.E.S. ²⁷⁴

N r.	TURIZMI DHE MJEDISI	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Zhvillim i një industrie të qëndrueshme turistike		PO	INSTAT ²⁷⁵ CO-PLAN ²⁷⁶
2	Oferta turistike “Made in Albania”		PO	
3	Zhvillim i turizmit shqiptar mbështetur në 10 pole		PO	N/A
4	Rishikim i barrës fiskale mbi njësitë akomoduese		PO	L.TVSH
5	Zëra progresiv në buxhet për investime në infrastrukturën turistike		PO	PBA 2013-2017
6	Deri në 10% e të ardhurave nga portet që shkojnë në favor të buxheteve vendore (Durrës, Vlorës, Sarandë dhe Shëngjin)		JO	
7	Ndalim i derdhjes së ujërave të zeza në dete, liqene e lumenj		PO	A.K.M. ²⁷⁷

²⁷² <https://kryeministria.al/newsroom/inovacion-per-sigurimin-e-ujit-dhe-kullimit-ne-cdo-parcele/>

²⁷³ <https://www.monitor.al/moratorium-ne-vend-te-venies-nen-kontroll-2/>

²⁷⁴ <http://library.fes.de/pdf-files/bueros/albanien/12288.pdf>

²⁷⁵ <http://instat.gov.al/media/4169/turizmi-ne-shifra-2018.pdf>

²⁷⁶ <http://www.co-plan.org/wp-content/uploads/2018/12/6.pdf>

²⁷⁷ http://akm.gov.al/assets/raporti-akm-2017_preview_09052018.pdf-ardhur-nga-shtepia-botuese.pdf

8	Ndalim i shfrytëzimit të lumenjve të tejpendorur për nxjerrje inertesh		PO	A.K.M. ²⁷⁸
9	Shfuqizim i menjëhershëm i ligjit për importin e mbetjeve		PO	MEDIA, KUVEND ²⁷⁹
N r.	ENERGJIA DHE INDUSTRIJA	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Ulje e TVSH-së së energjisë elektrike në nivelin 6% për familjarët		JO	
2	Zbatimi sa më shpejt i një ligji për energjinë		PO	L.S.E.E. ²⁸⁰
3	Verifikim i gjitha lejeve koncesionare në fushën e energjisë		PO	LEJE KONCESION ²⁸¹
4	Anulim i lejeve koncesionare që janë marrë në konflikt interesi dhe tejkaluar afatet e zbatimit		PO	OSHC ²⁸²
5	Përfundim nga tatim-fitimi gjatë 3 viteve të para për sipërmarrësit që zbatojmë me korrektësi lejet		JO	
6	Reformim i metodologjisë së përcaktimit të tarifave		PO	RAPORT ERE ²⁸³
7	Energji elektrike me tarifë të reduktuar për familjet e varfra, në nevojë		JO	
8	Rishikim i koncesioneve për HEC-e në zonat e mbrojtura		PO	A.K.M. ²⁸⁴ RR.M.N. ²⁸⁵
9	Politika që ta kthejnë naftën në pasuri reale të shqiptarëve duke përmirësuar bilancin e rezervave efektive		JO	A.K.B.N. ²⁸⁶
10	Rritje e investimeve private në sterë dhe det në kërkim-zbulim		PO	E.I.T.I. ²⁸⁷

²⁷⁸ <https://citizens-channel.com/2017/07/27/agjencia-kombetare-e-mjedisit-rreziku-i-lumenjve-hec-et-dhe-inertet/>

²⁷⁹ <https://exit.al/ligji-rama-e-lehteson-me-shume-se-ai-berisha-importin-e-plehrave-dhe-ul-kontrollin-e-qeverise/>

²⁸⁰ https://infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2017/10/ligj_nr_43_dt_30_4_2015_22652_1.pdf

²⁸¹ <https://www.infrastruktura.gov.al/info-lejet-koncesionare/>

²⁸² <http://energji.al/2015/08/03/organizatat-mjedisore-falenderojne-kryeministrin>













²⁸³ <https://www.ere.gov.al/mat.php?idr=184&idm=190&lang=1>

²⁸⁴ http://akzm.gov.al/wp-content/uploads/2020/02/Studimi_ZM_Draft_Dhjetor_2019.pdf

²⁸⁵ http://www.senior-a.al/docs/INCA_Raporti_Final.pdf

²⁸⁶ <http://www.akbn.gov.al/wp-content/uploads/2019/02/Raporti-i-Bilancit-2017-ok3.pdf>

²⁸⁷ https://eiti.org/files/documents/albanian_-_albania_report_on_initial_data_collection_and_stakeholder_co_2.pdf

11	Analizim ligjor dhe kontroll zbatimit të kontratave hidrokarbure, licensave dhe lejeve ²⁸⁸		PO	K.L.SH. ²⁸⁹
12	150 milion USD të ardhura në Buxhetin e Shtetit nga e drejta sovrane		JO	
13	200 milion të ardhura shtesë në ekonominë kombëtare nga dhënia fund e vjedhjes në prodhim, përpunim e tregtim të naftës		JO	
14	Realizim i ciklit të plotë të nxjerrës dhe përpunimit të naftës në vend		PO	ALB.E.I.T.I. 2014-2017 ²⁹⁰
15	I japim fund evazionit dhe kontrabandës në rrjetin e tregtimit me pakicë		JO	MONITOR ²⁹¹
16	Garantojmë cilësinë e karburantit për konsumatorët		PO	MEDIA ^{292, 293}
N r.	ZHVILLIMI URBAN	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Ndërtim i Korridorit të Gjellbër, autostradat Veri-Jug që lidh bashkë 22 copëzat e rrugëve Hani i Hotit-Kakavijë		PO	PBA 2014-2018
2	Ndërtim i Korridorit të Kaltër Veri-Jug që lidh zonat turistike nga Velipoja në Butrint		PO	PBA 2014-2018
3	Lushnje-Berat-Polican-Corovodë, Memaliaj-Tepelenë, Lin-Pogradec etj.		PO	PBA 2014-2018
4	Ndërtimi i rrugës së Arbrit, Elbasan-Kuçovë-Berat-Tepelenë, si dhe Rruga e Labërisë		PO	PBA 2014-2018
5	Përfundim i Bypass Tiranës, Unaza e Madhe TR, Unaza e Elbasanit, bypass Rogozhinë, bypass Vlorë, unaza e Durrësit, Unaza e Bypass Pogradec		PO	PBA 2014-2018
6	Rikonstruksion i akseve Shkodër-Pulë, Lezhë-Fushë Krujë, Tiranë-Vorë-Durrës, Tiranë-Ndroq-Plepa, Ersekë-Leskovik, Tepelenë-Këlcyrë-Përmet, Fier-Ballsh-Memaliaj		PO	PBA 2014-2018
7	Zvogëlim deri 50% i aksidenteve rrugore brenda mandatit të parë		PO	INSTAT ²⁹⁴
8	Ndërtim i portit të ri të Shëngjinit		PO	K.L.SH. ²⁹⁵

²⁸⁸ Ketu mund te perfshiheshin ato vendburimet qe ju moren privatit Amonica, Ballsh Hekal etj

²⁸⁹ http://www.klsh.org.al/web/hidrokar_perf_2993.pdf

²⁹⁰ <https://www.albeiti.org/site/publikime/>

²⁹¹ <https://www.monitor.al/zbulohet-evazoni-larte-naftes-vendase-paguan-vetem-50-te-taksave/>





²⁹² <https://www.newsbomb.al/investigimi-cilesia-e-naftes-ne-shqiperi-ne-nivelin-me-te-ulet-cfare-u-gjet-ne-perberjen-e-saj-76725>

²⁹³ <http://www.gazetama.net/2017/09/08/cilesia-e-dobet-e-karburantit-rama-paralajmerim-te-for-te-ka-nje-problem-serioz-ja-si-do-te-zgjidhet/>

²⁹⁴ <http://www.instat.gov.al/media/5102/tab2.xlsx>

²⁹⁵ <https://www.monitor.al/porti-i-shengjinit-pa-investime-klsh-shoqeria-me-humbje-pagat-u-caktuan-nga-titullari/>

9	Hapje e tregut në fushën e operatorëve ajrorë		PO	A.A.C ²⁹⁶
10	Zhdukim 3 zarfet e hallkave të korrupsionit: zarfin tek kthimi i pronave, zarfin tek legalizimet dhe zarfin tek regjistrimi i pronës		PO	T.I. ²⁹⁷ K.L.SH. ²⁹⁸ REPORTER ²⁹⁹
11	Legalizim brenda 2 vitesh i ndërtimeve informale mbi prona vetjake dhe publike		PO	A.SH.K ³⁰⁰
12	Legalizim brenda mandatit ndërtimeve informale mbi toka me pronarë		PO	A.SH.K
13	Zbatim i një programi të veçantë për regjistrimin e Pronave në Bregdetin e Jugut		PO	A.ZH.T. ³⁰¹
14	Përparësi kompensimit në natyrë, në raport me dhënien e kompensimit financiar		PO	I.S.P. KOMENTAR ³⁰²
15	Orientim i procesit të privatizimit të pasurive publike drejt kompensimit të ish-pronareve		PO	I.S.P. KOMENTAR

N r.	INTEGRIMI/ ANTI-KORRUPSION	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/ BURIMI
1	Reformë kushtetuese që do të shërbejë rivendosjes së balancave mes pushteteve		PO	L.O.F.K.L.D. ³⁰³ L.GJ.K. ³⁰⁴
2	Nxitje për rihapjen e hetimeve për 21 Janarin, Gërdecin, korrupsionin Durrës-Kukës, privatimet e paligjshme, vrasjet me sfond politik, deformimin e proceseve zgjedhore		PO	MEDIA ³⁰⁵
3	Reformë për të rivendosur integritetin e pushtetit gjyqësor dhe institucioneve të drejtësisë		PO	L.O.P.GJ. ³⁰⁶
4	Hartim brenda 100 ditëve të Strategjisë Antikorrupsion në Sistemin e Drejtësisë		JO	MEDIA ³⁰⁷

²⁹⁶ <http://www.aac.gov.al/wp-content/uploads/2018/07/Buletini-I-Maj-2018.pdf>

²⁹⁷ <https://www.transparency.org/en/countries/albania>

²⁹⁸ http://www.klsh.org.al/web/vend_atp_tirane_web_2840.pdf

²⁹⁹ <https://www.reporter.al/pandeshkueshmeria-ne-hipoteka-ndihmon-perhapjen-e-korrupsionit-me-pronat/>

³⁰⁰ <https://www.ashk.gov.al/wp-content/uploads/2015/05/RAPORT-I-ANALIZES-SE-VEPRIMITARISE-2017.pdf>

³⁰¹ http://www.azht.gov.al/files/pages_files/DRAFT_PLANI_BREGDETTT.pdf

³⁰² <https://rm.coe.int/commentary-on-law-on-treatment-of-property-alb-/168094784a>



³⁰³ https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/LIGJ_K_LD-1.pdf

³⁰⁴ https://www.gjk.gov.al/web/ligj_per_organizimin_dhe_funksionimin_e_gjykates_kushtetuese_2016_1667.pdf

³⁰⁵ <https://sot.com.al/politike/rikthehet-21-janari-dhe-gerdec-komisioni-i-sigurise-paralajmeron-rihapjen-e-dosjeve>

³⁰⁶ http://www.gjykataelarte.gov.al/web/ligj_nr_98_2016_organizimi_pushtetit_gjyqesor_1727.pdf

³⁰⁷ <http://www.panorama.com.al/cuci-strategjia-kunder-korrupsionit-gati-ne-prill-2014-plani-i-veprimit-rishikim-cdo-fund-viti/>

5	Hartim planveprimi për çmontimin e korrupsionit		PO	S.D.K.K. ³⁰⁸
6	Marrja e statusit të vendit kandidat dhe fillimi i bisedimeve për anëtarësimin në BE brenda vitit të parë të mandatit qeverisës		PO	EUHUB ³⁰⁹
7	Miratimin e Ligjit për Votën e Jashtme, duke mundësuar votimin për të gjithë emigrantët		JO	


³⁰⁸ https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/pasaporta_treguesve.pdf




³⁰⁹ <https://www.eupolicyhub.eu/rrugetimi-i-shqiperise-drejt-bashkimit-europian/>

PËRFSHIRJA DHE PËRMBUSHJA E PREMTIMEVE TË LSI NË PROGRAMIN QEVERISËS

N r.	FISKALE/BUXHETORE DHE EKONOMIKE	PËRMBUSHJA	PROGRAMI QEVERISËS	REFERENCA/BURIMI
1	Korrektim social të taksës së sheshtë dhe barrës fiskale		PO	L.T.A.
2	Pagat deri 35.000 lekë/muaj, zero tatim mbi të ardhurat		JO	
3	Pagat 35.000 – 50.000 lekë/muaj, TAP 10% do llogaritet vetëm mbi shumën 35,000 lekë		JO	
4	Pagat mbi 50.000 lekë aplikohet 10% mbi gjithë pagesën		JO	
5	Rimbursim automatik i TVSH në të gjitha llojet e detyrimeve që ka biznesi dhe eksportuesit		JO	
6	Brenda vitit 2017 rrisim eksportet shqiptare deri në 40% të GDP		JO	
7	Kredi me interes të butë 3% për bizneset e reja që përpunimit ushqimor që punojnë mbi 20 punëtorë dhe eksportojnë të paktën 50% të prodhimit		JO	
8	Transaksionet tatimore dhe doganore në “one-stop-shop”		JO	
9	Heqje e akcizës dhe taksave doganore për të gjitha lëndët e para, lëndët ndihmëse e ambalazhet që eksportohen		JO	
10	Flotë moderne peshkimi duke stimuluar me grante financimin e barkave të peshkimit		JO	
11	Për çdo të punësuar shtesë qeveria subvencionon fazonët në masën 10% të pagës së punëtorit		JO	
12	Krijojmë Fondin e Granteve për blerjen e makinerive prodhuese ³¹⁰		JO	
13	20% e faturës së konsumit ushqimor bazë do jepet si pagesa të drejtpërdrejta për familjet në nevojë		JO	
14	Tatim fitim ZERO për 3 vitet e para për bizneset prodhuese që punojnë mbi 30 punëtorë		JO	
15	Taksa dhe tatime ZERO për gjithë bizneset e reja të huaja jo-koncesionare		JO	

³¹⁰ për bizneset e reja që punësojnë minimalisht 50 gra menjëherë dhe bizneset që shtojnë punësimin menjëherë me 50 punëtorë të rinj









	që investojnë mbi 30 mln. EU/vit për një periudhë 5 vjeçare			
16	Zona te lira ekonomike ku bizneset përjashtohen per 5 vite nga tatim taksat		PO	TEDA ³¹¹
